

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32

7 76



Tregime
të zgjedhura

Nasho
Jorgaqi

8JH-32
7 76

NASHO V. JORGAQI

SHKËRIMET E NASHO V. JORGAQI

TREGIME TË ZGJEDHURA



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

FYTYRA E HEROIZMIT

Kishim disa orë që udhëtonim dhe Gazi ynë ngjitej vazhdimisht në të përpjeta, duke lënë prapa male e hone, aq sa mua, që udhëtoja për herë të parë në këto anë. më dukej se, ashtu si e kishim nisur, do të sosnim në Hënë. Kjo ndjenjë më mbetej e gjallë, bile edhe kur qëllonte të zbritnim nga makina. Në lartësinë e atyre maleve, yjet më ngjanin fare afër dhe nata kishte një ngjyrë të çuditshme. Ishte një natë prilli pa hënë. Flladi i lehtë që hynte nga dritarja, mbushte herë pas here makinën me kundërmimin e pyjeve. Ne ishim aq të topitur nga rruga e gjatë, sa ajo erë e këndshme na e lehtësonte dhe na bënte të merrnim frymë thellë. Megjithatë, tek vështrojmë jashtë, shpesh ngatërronim yjet që regëtinin nëpër qiell, me dritëzat e fushave e luginave që shtriheshin nën këmbët tona.

— E fundit, doktor, — tha Xheloja, duke ndërruar marshet.

Gazi ngjiti të përpjetën e fundit, mori djathtas dhe hyri në një rrugë pa rrugë duke dredhuar në të dyja anët. Kur u futëm në pyll, makina e uli shpejtësinë dhe atëherë unë fillova të shikoja jashtë me vëmendje.

Në errësirën e dendur të pyllit dritat e makinës u bënë edhe më të forta. Dukej sikur aty nata ishte e dyfishtë. Unë ndiqja lëvizjet e makinës dhe vështroja drurët e pyllit që vinin drejt nesh si një valle pa mbarim.

Kishim hyrë thellë në pyll, kur qëndruam në një korië të vetmuar dhe aty zbritëm që të tre. Unë e Faredini hodhëm plaçkat në krah dhe pritëm Xhelon sa mbylli makinën e na udhëhoqi përmes drurëve me një elektrik dore. Ne zumë të ecim pas tij, nëpër disa shtigje të ngushta që, si duket, i njihte vetëm ai. Më ka mbetur akoma në mendje ajo qetësi e thellë që ndillte përqark nesh një atmosferë fshehtësie e të papriturash. Hapat tanë jehonin me një kumbim të rëndë, kurse nga thellësia e pyllit dëgjoheshin disa zhurma të pakuptuara.

Në të dalë të pyllit, ne qëndruam në një shesh të mbuluar me bar të thatë. Aty pushuam disa minuta më këmbë dhe, pa folur, vazhduam rrugën për më tej. Xheloja shoi elektrikun e dorës dhe këtë e bëri, me sa kuptova, jo vetëm se tani kishim dritën e yjeve, por dhe për t'u maskuar. Rruga këndeje kalonte prapë në të përpjeta. Në mbarim të pyllit, ngriheshin disa shkëmbinj të paformë. Ne përpiqeshim t'i shkonim pas Xhelos, po shtigjet në të përpjeta ishin të vështira. Ai, si sorkadhe, hipte e zbriste nga një shkëmb në tjetrin, aq sa unë e Faredini mezi e ndiqnim. Bile, vende-vende filluam të ngjiteshim këmbadorës duke pasur kujdes orë e çast sendet që kishim me vete.

Kur dolëm në krye të shkëmbit të dytë, (se ishin tre shkëmbinj njëri mbi tjetrin, sikur të kishin hipur kaluar), aty na priste Xheloja.

Faredini u mbush me frymë dhe tha me zë të ulët:
— Thirri!

Unë vështrova Xhelon. Ai vuri të dyja duart në buzë dhe, papritur, vendi jehoi nga disa klithma të thekshme. Në fillim nuk e dallova, por, kur ai e përsëriti disa herë, m'u kujtua zëri i gjelit të egër. Vendi aty vinte gjysmë i mbyllur dhe jehona dukej sikur vërtitej mbi kokat tona. Pas kësaj sundoi një heshtje e rëndë. Ne qëndronim me sy të ngulur andej nga errësira ishte më e dendur. Nuk kaloi shumë dhe nga lart erdhi një fishkëllimë e zgjatur që s'di të them se çfarë zëri imitonte. Xheloja klithi prapë në mënyrën e tij, po kësaj radhe vetëm një herë.

U bë një heshtje e shkurtër dhe në këtë kohë dy shokët e mi u morën vesh vetëm me një të tundur të kokës. Unë shikoja shkëmbin që ngrihej pranë nesh dhe nuk e merrja dot me mend se nga do të ngjiteshim, kur vura re hijen e Xhelos që lëvizte me zigzage në givsmën e tij. Për një çast ai më humbi nga sytë. Faredini dukej shumë i qetë dhe, si një komandant në luftë, ndiqte me vëmendje të gjitha veprimet e Xhelos. Vetëm kur hija e tij u zhduk nga sytë tanë dhe pas kësaj zbritën nga lart ca zëra të mbytur, atëherë Faredini më dha shenjë ta ndiqja pas.

Tani çdo gjë po më dukej si një ëndërr. Ngjitesha këmbadorës dhe, padashur, vështroja honin e errët që hapej poshtë nesh dhe pyllin që nxinte tej në horizontin e natës. Mendja ime, e pamësuar me këto gjëra, mezi e rrokte atë çka ndodhte rreth e qark. Më bëhëj se në këta shkrepë të braktisur, në mes të kësaj shkretëtire të errët, ishte e vështirë e, ndoshta e pamundur të rronte njeri i gjallë. Po unë nuk pata kohë të arsyetoja më gjatë, mbasi atë çast kishim arritur në vend. Në gjirin e shkëmbit të lartë, fshehur pas disa drurëve të vetmuar, hapej goja e një shpelle. Këtë mezi e dallova nëpër errësirë dhe e vërtetova vetëm kur e dëgjova Faredinin të më thoshte:

— Futu, doktor, po kujdes, ulë kokën!

Unë përkula trupin dhe hyra në shpellë, pa ditur ku të shkelja. Pastaj ndjeva dorën e Xhelos që më kapi dhe eca më tutje nëpër errësirën e thellë. Po kjo nuk zgjati shumë sepse, pasi hyri dhe Faredini, Xheloja ndezi dritën e cila ndriçoi një pjesë të shpellës. Shpella ishte e ngushtë në krye e pastaj vinte e zgjerohej në thellësi. Në fillim nuk më zuri syri asnjë të huaj veç shokëve me të cilët kisha ardhur, por, kur Xheloja lëvizi dritën, m'u duk sikur papritur doli nga thellësia e shkëmbit një njeri që hijet i jepnin përmasa të çuditshme. Bile, para se të shikoja atë, më buçiti papritur në vesh një zë i fortë:

— Mirë se erdhët, burra!

Ne u hodhëm menjëherë në krahët e njëri-tjetrit dhe mbaj mend që duart e tij më shtrënguan fort, sikur të më kishte mbërthyer një darë e hekurt. Zëri i tij i fuqishëm plot gjëmim, në çastin e parë m'u duk sikur nuk i takonte atij njeriu të gjatë, me trup të thatë, fytyrëhajtëm e me buzë të holla. Vetëm sytë e mëdhenj e të thellë, që shkrepëtinin paprerë, i shkonin zërit të tij burrëror.

Pastaj ne u ulëm mbi ca gurë të lagur dhe ai na dha prapë dorën, thujse i kishim shkuar në shtëpi. Gjithë fytyra i vetëtimte nga gazi, ndërsa gjoksi i ulej e i ngrihej paprerë. Ai nuk dinte si t'i gëzohej qenies sonë. Matej të fliste e s'fliste dot.

— Ju mundova, shokë, — tha më në fund.

— Ç'të munduar, a derëbardhë! — ia priti menjëherë Xheloja, që atë kohë po zbërthente çantën. — Ti na thuaj, sa ditë ke pa ngrënë?

Ai nuk foli, po vështroi nga ne të tjerët.

— Mirë e ka Xheloja, — tha Faredini. — Vërtet, sa ditë t'u bënë pa ngrënë, Martin?

— Lëre, mos pyet, — tha Martini dhe murmuriti diçka nëpër dhembë, që ne nuk e morëm vesh.

Pastaj Xheloja i vuri përpara çantën e hapur me ushqime. Ai zgjati dorën, mori një copë të madhe bukë dhe filloi të hante me nxitim. Kishte pothuaj një javë pa ngrënë dhe kjo kishte ndodhur jo nga pakujdesia jonë, po ngaqë vendi i fshehtë ku i linim ushqimet, ishte kontrolluar ato ditë, herë nga bandat, herë nga forcat tona të ndjekjes. Këtë ai nuk na e tha drejtpërdrejt, po e morëm vesh në bisedë e sipër.

Ne u munduam të mos e vinim re tek hante dhe, ndërsa unë fillova të hapja çantën time sanitare, Faredini, me vetulla të mbledhura dhe me vështrim të përqëndruar, zuri t'i komunikonte direktivat e reja të qendrës.

Para disa ditësh, më pati thirrur në zyrë Faredini.

— Ti e di, doktor, — tha ai me një seriozitet që ia diktonte detyra, — se lufta jonë vazhdon. Bile, nga ndonjë pikëpamje, është bërë ndofta më e vështirë. Bandat e kriminelëve sillen akoma nëpër male. Po i bien popullit më qafë. Detyra jonë është që t'i asgjësojmë sa më parë dhe për këtë nuk mjafton që të ndeshemi ballë për ballë, por edhe t'i shkatërrojmë nga brenda. Kjo është arsyeja që një shoku ynë, i ngarkuar të hyjë në bandat e tyre, ka disa kohë që ka dalë në mal, po deri sot kriminelët nuk i kanë zënë besë. Ai është i detyruar të endet maleve fill i vetëm, i ndjekur herë nga bandat, herë nga forcat tona. Kuptohet që, sa më shumë kohë kalon, aq më tepër rrezikohet jeta e tij dhe, si pasojë, dhe plani ynë për asgjësimin e kriminelëve. Tani kemi vendosur të bëjmë provën e fundit: t'i hapim shokut tonë një plagë fiktive në trup. Kjo është dhe arsyeja që të thirra. Ne e kuptojmë fare mirë se ç'do të thotë kjo për një mjek. E kuptojmë sa delikate dhe e ndërlikuar paraqitet situata për ty, po ne jemi komunistë dhe Partia e kërkon këtë prej nesh.

Pa mbaruar ai, unë e ndjeva menjëherë barrën e rëndë që po merrja mbi vete. Të them të drejtën u hutova. Qëndroja në heshtje para shokut tim dhe mundohesha t'i shpëtoja shikimit të përqëndruar të tij. Ishte një çast që nuk mund të kapërcehej me një përgjigje sa për të kaluar radhën.

— Do të mendohem, — thashë në fund dhe u ngrita. Ai e kuptoi gjendjen time dhe, pa e zgjatur, e mbyllëm me kaq takim in e parë.

Shkova në shtëpi dhe, më parë se të gjeja zgjidhjen praktike, nxora librat. Shfletova qindra faqe, konsultova disa atlase anatomike. Në ato çaste më dukej vetja student dhe jo mjek i kaq viteve siç isha. Tërë ato që dija mbi trupin e njeriut, tani më ngatërroheshin. Pas çdo ideje që më lindte, më dukej sikur fshihej një pikëpyetje tinzare që më trondiste besimin. Thosha se, po

të dështoja unë, do të rrezikohej puna e gjithë shokëve.

Me këto mendime kalova gjithë natën. Kur erdhi mëngjesi, mbylla librat dhe, si u qetësova ca, fillova rishtazi të mendoja. Ndoshta këshilla e një kolegu do të më ndihmonte mjaft. Po kjo nuk më lejohej kurrsesi. Çdo gjë duhej ta zgjidhja vetë. E pra, nga ta filloja provën? Nga ç'pjesë e trupit të gjallë duhej të kalonte plumbi, që mundësisht të dëmtonte sa më pak? Duhej të çmësohesha nga mënyra e zakonshme e arsytimit. Tani duhej të arsyetoja kështu. Ç'duhet të bëja, jo për të mbyllur një plagë, po për ta hapur?

Në vështrim të parë këto arsyetime dukeshin paradoksale. Po detyra që m'u ngarkua nuk më lejonte të hyja në qorrsokakë që mund të dëmtonin çështjen. Armiku i klasës duhej të thyhej me çdo kusht. Më shkonte mendja te populli që po terrorizohej nga bandat, te shokët që po luftonin orë e çast me armiqtë, e, mbi të gjitha kujtoja shokun tonë që endej maleve fill i vetëm. E ç'ishte një plagë fiktive para gjithë këtyre? Po ky mendim, të them të drejtën, nuk m'u qartësua menjëherë. Nuk më linin të qetë ato dreq paragjykime profesionale; sikur më pëlqente t'u jepesha ndjenjave të vockla. Kisha arritur deri në atë shkallë, sa të mendoja se më takonte mua t'i mbroja parimet e humanizmit tonë, por harroja, për një çast, se shokët tanë këto parime kishin vite të tëra që i mbronin me gjak e sakrificë.

E vërteta është se unë në fillim u hutova dhe isha i pavendosur. Këtë e kuptova mirë të nesërmen, në ballafaqimin e dytë me Faredinin. Ne të dy njiheshim prej kohësh, po në rrethanat që po takoheshim, më ngjante sikur po shihesha për herë të parë me të. Megjithatë, përzemërsia me të cilën më priti kësaj here, më bëri ta ndieja veten më të qetë se në takimin e parë.

— Hë, Kristaq, ç'bëre? Të futa në telashe, — m'u drejtua me buzë në gaz, kur u ulëm krah njëri-tjetrit në një kolltuk të gjerë.

— Mendova, — i thashë, — bile mendova gjatë.

— Shumë mirë atëherë, — ia priti ai me një zë të ngrohtë dhe më la të vazhdoja.

— Mund t'ia hapim një plagë... them t'ia hapim... në pjesën gluteale... në të ndenjurit...

Dhe mora të ndizja një cigare, i bindur se me ato që thashë, kisha gjetur të vetmen zgjidhje të mundshme. Tani ndihesha i lehtësuar nga tërë ajo barrë që më kish-te shtypur e sflitur, prandaj pritja që ai ta miratonte menjëherë. Po ai, për çudinë time të madhe, nuk foli fare. Për më tepër, iu zhduk gazi nga fytyra, vetullat iu mblodhën dhe thithi disa herë cigaren. Unë, sado që u stepa pak nga kjo, prapë nuk vonova t'i shpjegoja më gjerë idenë time.

— Nuk di si ju duket juve, po unë do të thosha se glutealet janë pjesa më e sigurtë për të kryer atë që kërkoni ju... Në këtë pjesë ka pak enë gjaku dhe akoma më pak nerva. Pra, dhe rreziqet janë më të vogla dhe dhembja është më e paktë...

Po ndërsa mundohesha të shpjegoja atë që kisha menduar gjithë natën, nuk di se si lexova papritur në fytyrën e tij pakënaqësi dhe një lloj shpotie për ato që po thosha.

— Jo, jo, doktor, — tha ai me një ton të prerë, gati të rreptë, — nuk e ke menduar mirë. Ke parë vetëm anën profesionale... Shoku ynë nuk do ta pranonte kurrrë këtë zgjidhje.

— Si? — u hodha unë i habitur e i prekur njëkohësisht. — E pse, ç'të keqe ka këtu?

— Kjo është menduar e tëra keq, — ma ktheu ai i vendosur, megjithëse u përpoq ta zbuste pak tonin. — Prit, mos u ngut, ta shpjegoj unë. Pikësëpari, duhet ta dish se zgjidhja që propozon ti, do të thotë t'i hapim shokut tonë një plagë turpi. Pa mendo njëherë se ç'te-lashe do t'i krijonte një plagë në një vend të tillë! Kjo do ta prezantonte si frikacak. Burri goditet ballë për ballë me armikun, dhe jo duke i kthyer kurrizin. E kupton, pra, se ç'pasoja të këqija morale mund të sillte?! Bile, mund të ngjallë dhe dyshime, kur ai ka kaq nevojë për prestigj dhe besim. Pra, ai duhet të shkojë tek ata si njeri që është armiqësuar e gjakosur keqas me ne, me një plagë që ta mbush mendjen vërtet e jo në prapanica!

Pas këtyre arsyetimeve, unë e humba dhe për një kohë kujtova se nuk do të kishte rrugëdalje. Të gjitha ato që thoshte Faredini ishin të drejta, po nuk e merrja dot me mend se, veç glutealeve, në ç'vend tjetër mund të hapej një plagë pa rreziqe.

— Nuk di ç'të them, — ngrita supet duke u përpjekur të mposhtja nervozizmin që më kapi në befasi. Dhe, të them të drejtën, nuk di si do të isha sjellë, po të mos më qëndronte përballë aq e qetë dhe besimplotë fytyra e tij.

— Unë të kuptoj shumë mirë, doktor, — tha ai pas një heshtjeje. — E ke pasur të vështirë... Vështirë e kemi dhe ne, s'do mend! Duhet që armiku të mos dyshojë për asgjë dhe, njëkohësisht, shokun tonë ta lehtësojmë sa më shumë në detyrën e rëndë!

— E si mund ta lehtësojmë? — shpërtheva unë padashur. — Plaga mbetet plagë, kudo qoftë në trup. Po rreziku më i vogël paraqitet aty ku thashë unë.

Ai më buzëqeshi me pamjen e një njeriu që ka bindje në mendimin e tij dhe më tha me zë të qetë:

— Atë zgjidhje e hodhëm poshtë, apo jo? E thamë, që në lojën që po bëjmë ka shumë rëndësi se në ç'objekt të trupit është plaga. Ja, për shembull një plagë në gjoks, do të ishte një ndihmë e madhe për Martinin. Kjo do ta nderonte para armiqtve, do të ngjallte besimin e tyre...

— Po kjo është krejtësisht e pamundur, — qesha unë, jo pa një farë triumfi. — Plaga në gjoks do të thotë ta vrasësh me dorën tënde!

Megjithatë entuziazmi im nuk e pati të gjatë. Shpejt e kujtova se kisha marrë për kot. Faredini ndezi cigaren që i ishte shuar në mes të gishtërinjve dhe e thithi i menduar.

— Edhe ne jemi shqetësuar gjithë këto ditë, — tha ai, i tërhequr nga një mendim i rëndësishëm. — po shkuam me shpresë se mos gjeje ti ndonjë zgjidhje më të mirë. Jam i bindur se, po të të linim kohë, do ta gjeje këtë zgjidhje, po koha s'na premtion fare. Mendo që ai baret nëpër male dhe pret përgjigjen tonë.

Faredini lëshoi cigaren në tavëll dhe u ngrit më këmbë duke bërë ecejake nëpër dhomën e gjatë. Unë e ndiqja me sy, pa lëvizur nga kolltuku.

— Varianti ynë është ky, — filloi ai të shpjegonte me kujdes, thujse demonstronte ndonjë plan në hartë. — Mund ta kemi edhe gabim. Nuk është e thënë ta aprovosh medoemos. Ne, pa aprovimin tënd, nuk bëjmë asgjë. Siç ta thashë, ne duam që plani i qendrës të zbatohet, por dhe shoku ynë të mos dëmtohet ose të dëmtohet sa më pak. Për këtë të jeni realist. Ne themi kështu: të tërhiqet lëkura 5-6 gishta nën sjetull dhe të qëllohet mbi të me kujdes, në mënyrë që, kur të lëshohet lëkura, njëra plagë të bjerë në gjoks e tjetra në shpatull. Natyrisht, kjo është një plagë lëkure dhe ti si mjek do t'i marrësh të gjitha masat, sidomos në konditat që ndodhet ai si komit nëpër male. Si thua, a ka mundësi të bëhet?

Unë nuk u nxitova të përgjigjesha, dhe, sikur të isha vonuar akoma, ai me siguri do të kujtonte se isha prekur në sedër. Po në të vërtetë unë isha shtangur nga ideja e saktë dhe praktike që ai ma paraqiti aq thjeshtë e qartë. Në ato çaste më erdhi mendimi se zgjidhjen që nuk e kishin gjetur studimet e mia e kishte arritur mendja e hollë e shokëve me përvojë luftime kundër armiqve.

— Ka mundësi... posi! — thashë unë më në fund, pas një heshtjeje të shkurtër, që Faredini e mori si mëdyshje dhe shtoi menjëherë:

— Doktor, ti i di më mirë këto punë, prandaj thuaj të gjitha rezervat, që t'i kemi parasysh.

— Jo, jo, — nxitova unë. — zgjidhja juaj paraqit më pak rreziqe... Sigurisht, do kujdes dhe kuptohet se do ta bëjnë njerëz me përvojë dhe gjakftohtë...

— Përvojë për këto gjëra nuk kemi, — shpjegoi ai, — kjo është hera e parë...

— Përveç kësaj, — shtova unë, — që të kryhet kjo, kërkon disa kushte minimale.

Faredini, që rrinte më këmbë para meje, mblodhi buzët i pakënaqur dhe mua kjo m'u duk pak tallëse.

— Them, në rast se ka mundësi ta sillni këtu, ose

të paktën të bëhet në qendrën më të afërt, që, sido që të vijë puna, ta kemi afër spitalin.

Ai u ul dhe, si ndezi cigaren, mori një pamje serioze dhe tha:

— Rrethanat janë të atilla, doktor, që jo vetëm nuk mund ta sjellim këtu, por as në qendrën më të afërt nuk e shpium dot.

— Po si i bëhet, atëherë? — thirra i çuditur.

— Do të shkoni ta bëni në vend, në Malin e Kaçiles!

Ai foli në një mënyrë të prerë, duke më dhënë të kuptoja se për këtë gjë nuk kishte si të diskutohej. Dhe, ndërsa unë heshta, ai u mundua të më vinte përpara një argument tjetër:

— Kristaq, më thuaj, si do të veproje ti, sikur kjo të ndodhte dje në luftë?

Unë tunda kokën dhe, në vend që t'i përgjigjesha, bëra gjyq me vete. Në luftë, luftova si gjithë të tjerët, mjekova me dhjetëra partizanë, me aq sa dija, por asnjëherë nuk u ndodha para një situatë të tillë. Shkoja e i mjekoja shokët atje ku ishte rreziku më i madh, i mbaja në krahë, rrija vetë i uritur e u jepja atyre kafshatën e gojës, hiqja rrobat e këpucët e mia, bile edhe qelbin u kisha thithur, kur e kishte dashur nevoja, po kështu si sot nuk më është shtruar asnjë detyrë...

Është e tepërt të tregoj si vazhdoi më tej biseda jonë. Ishte e qartë se unë akoma zvaritesha dhe, nëse u shkunda nga paragjykimet e u ngrita në lartësinë e detyrës, këtë ua kam borxh shokëve, e në radhë të parë Martinit. Them Martinit, se në qëndrimin e tij pashë se ç'fytyrë të madhërishtme ka heroizmi i njeriut tonë në luftë.

III

Dhe tani që Faredini i jepte direktivat e qendrës me atë zërin e tij të shtruar, unë s'ia ndaja sytë Martinit. Ai vazhdonte të hante, po jo me atë vrullin e parë. Du-

kej i qetë, thujse nuk mendonte fare për atë që e priste. Po unë që mendoja vetëm për këtë, me gjithë vendosmërinë që kisha për t'ia dalë në krye detyrës, prapë, në atë çast, ndërsa vështroja nifullat e tij të dala, ballin e zbetë, duart e thata, më kapte papritur një dyshim që më trondiste. Bile, nuk di se si u gjenda një hop bosh dhe ai vështroi ngultas, aq sa m'u bë sikur m'i bleu mendimet dhe i buzëqesha pa qenë nevoja.

— Nënë dhe vëllezërit i ke mirë, — tha Xheloja kur mbaroi Faredini.

Martini tundi kokën dhe nuk tha asnjë fjalë. Pastaj mbylli çantën e ushqimeve duke mbajtur sytë përdhe dhe pyeti:

— Po ajo ç'bën?

Kaloi një hop në heshtje dhe pastaj Faredini tha:
— Është mërzitur, domosdo.

Martini bëri një gjest me dorë që unë nuk e mora vesh. Pas kësaj sikur u çel në fytyrë. Tani vështrimi i tij lëvizte lirisht.

— Keni ardhur tamam në kohë, — tha ai. — Situatat nuk duron më. U përpoqa, siç e dini, po qe e pamundur. Prandaj ju shkrova. Pa dhënë provën e gjakut, ata nuk më pranojnë.

— Dakord, — tha Faredini. — Qendra e aprovoi. Doktor Kristaqi për këtë qëllim ka ardhur. Çdo gjë do të bëhet me kujdes. Mos ki merak nga asnjë telash.

Shpella gjëmoi papritur nga gazi i Martinit.

— Telashi më i madh ka qenë ai që hoqa. Kjo që thoni ju, do të jetë shpëtim për mua. Doktorit të mos ketë frikë që më shikon kështu të hollë. Kështu jemi tërë familja, po jemi të fortë. Im vëlla kaloi gjithë Operacionin e Dimrit me plagë në trup dhe nuk e gjeti gjë. Apo s'ka të bëjë kjo, si thoni, doktor?

Kjo pyetje më zuri krejt në befasi dhe nuk arrita t'i përgjigjesha. Dëgjova Xhelon që tha:

— Doktorit s'po i dëgjohet zëri sontë!

— Kushedi ç'thotë me mendje: ku më sollën kështu këta shokë! — shtoi Martini.

— As në ëndërr nuk e ka parë këtë shpellë, — tha Xhehoja.

— Shpella ka parë plot, — shpjegoi Faredini, — se në këto shpella ka mjekuar të sëmurët gjatë luftës.

— Mund të fillojmë nga puna? — ndërpreva bisedën unë. — Si thoni?

— Unë gati jam, kur të doni, — u hodh Martini.

Faredini dhe Xhehoja lëvizën dhe filluan të rregullojnë vendin. Hoqën disa gurë dhe shtruan xhaketat në she-shin plot lagështirë.

Pastaj Xhehoja vendosi dritën më lart, në mënyrë që të ndriçonte sheshin e hapur. Unë nxora të gjitha sendet e nevojshme nga çanta sanitare. Martinit nuk i shpëtonte asgjë.

— Zhvishuni dhe shtrihuni, — thashë, me një zë që më tingëlloi i huaj.

Ai u zhvesh nga brezi e lart dhe unë i tregova se në ç'vend do t'ia hapnim plagën. Tani e kisha marrë veten mirë dhe këtë e ndieja nga mënyra se si flitja.

E nisa punën nga gjilpëra. I bëra gjilpërën e parë dhe i kapa pastaj me dorë atë pjesë të lëkurës që bie nën sqetull. Ai ishte mjaft i lirë dhe dukej fare i qetë. Për më tepër, ndieja se kishte qejf të bisedonte. Ndoshta nga- që kishte kohë pa biseduar me njeri!

— I çova fjalë kapobandës për të tretën herë, — tregonte ai, — po prapë nuk më besoi. Kishte thënë: «Le të shkojë te komunistët, se bukën e tyre ka ngrënë deri ta-shiti».

— Nuk i hanë kollaj djallëzitë ata, jo, — u hodh Xhehoja. — Ata janë djallëzia vetë.

Faredini, që rrinte prapa nesh, kishte nxjerrë revolverin e vogël që fekste nga drita dhe e fshinte me shami. Martini vazhdonte të tregonte si pa të keq:

— Isha te Shpella e Lopës, kur ata ranë në përleshje me forcat tona. I shikoja dhe luftoja me veten. E pra, nuk ma kishte marrë mendja që të rrija ashtu...

Kur ai fliste, unë vazhdoja punën time. Bëja pastri-min e vendit ku do të hapej plaga dhe provoja të tërhiqja lëkurën. Faredini kishte lënë revolverin mënjanë dhe

më ndihmonte mua. Xheloja i rrinte Martinit te koka dhe e mbante me muhabet.

— Nuk e merrni me mend sa të poshtër janë, — thoshte ai, gjithë mllef. — Unë i pashë në sy, kur i vunë zjarr depos së bereqetit në Vril. Ishin po ata që vranë cucat në stan e i vunë thikat Ndoc Markut. Nuk di se ç'më ishte mbledhur këtu në gjoks.

— Ke të drejtë, — tha Xheloja, — vërtet nuk durohen...

— Fillojmë, atëherë! — foli unë.

— Gati, kur të doni! — tha ai me buzë në gaz.

Në këto fjalë nuk kishte asgjë të shtirë. Unë isha i bindur se në gjendjen që ndodhej ai, më mirë do të qe t'i nënshtrohej një sakrifice si kjo, sesa të bënte një jetë me sakrificat të pafund.

— Jo, jo, tërhiqeni, se e duroj, — tha Martini kur zura t'i tërhiqja lëkurën me pinca. Dhe fillova ta tërhiqja fort, po e dija se, sado që e kisha mpirë vendin rreth e qark, ajo me siguri dhimbte. Po fytyra e tij nuk tregonte asnjë shenjë shqetësimi. Përkundrazi, e shihja se kishte dëshirë të fliste akoma. Deshi, bile, t'i tregonte prapë diçka Xhelos, po unë ndërhyra:

— Shtrihuni në kurriz, asnjë lëvizje, ju lutem!
Ai nuk foli më. U shtri i tëri mbi xhaketat e shtruarara përdhe, ndërsa kokën e mbështeti në një gur, ku Xheloja kishte vënë kapelën.

Para se të filloja nga operacioni, i mata pulsën dhe, t'ju them të drejtën nuk besova se ishte dora e tij. Kjo gjë më dha akoma më shumë zemër.

— Mbaje këtu, — iu drejtova Xhelos, duke i dhënë pincat në dorë. — Tërhiqe tani, tërhiqe dhe pak... Mirë, lëshoje.

Pastaj vështrova nga shokët, duke u dhënë të kuptonin se po fillonte çasti më delikat.

— Prit, — u hodh Faredini i menduar. — Kështu nuk është mirë, ka rrezik që flaka e plumbit të djegë lëkurën. Ata do ta kuptojnë dhe do t'i nxjerrin telashe. Të vëmë më mirë një shami para pincave.

Kjo që thoshte ai ishte me vend, po atë kohë më er-



dhi krejt e papritur. Vërtet, unë kisha marrë përsipër të qëlloja, po punën e shamisë as që e kisha menduar. Kjo që arsyeya që u vura në pozitë të vështirë dhe qeshë gati t'i kerkoja ndihmë. Faredinit, kur dëgjova zërin e Martinit:

— Ma jepni mua, doktor, të qëlloj.

Nuk e mora vesh pse i tha këto fjalë: Vërtet i që mbushur mendja të qëllonte, apo donte të na nxiste ne që po vonoheshim. Këtë e mendova më vonë, sepse atë çast, ato fjalë më bënë të mblidhja menjëherë veten. Nxora me të shpejtë nga çanta sanitare një copë garzë të gjerë dhe urdhërova me zë të prerë:

— Afrohu, Faredin. Nëm revolverin. Ti, Xhelo, rri gati.

Unë i dhashë Faredinit të mbante garzën dhe vetë mora revolverin. Martini, edhe në këtë çast, nuk jepte asnjë shenjë shqetësimi. Bile, nuk shtrëngonte asnjë muskul. Vetëm një damar i dridhej në cep të syrit të djathtë.

Erdhi çasti që isha çliruar nga urdhrat dhe kujdesiet. Të gjithë pritnin që unë të filloja. Vështroja garzën dhe mundohesha ta matja largësinë me sy, po ndërkaq vërtitja revolverin në dorë për të dëbuar shqetësimet e fundit. Më ishte ngulur në mendje ideja që kurrë nuk isha shquar si qitës. Vërtet do të qëlloja në largësi të vogël, po rreziku ishte i madh. Për një qime mund të prekja në brinjë dhe atëherë situata do të ndërlikohej keq. Ç'mund të bëja unë atëherë, futur në këtë shpellë plot lagështi? Me siguri aksioni do të dështonte ose do të shtyhej për më vonë, me pasoja të rrezikshme.

— Nuk është mirë t'ju zërë dita këtu, shoku doktor, — më gjëmoi zëri i Martinit në vesh.

Unë mblodha forcat dhe, duke i shpëtuar vështtrimin vetëtitës që më vinte nga poshtë, thashë:

— Asnjë lëvizje!

Ngrita dorën dhe mata për herë të fundit largësinë me njërin sy. Kishte ardhur ai çast që s'priste më. Si u ngopa me frymë, fiksova dorën në largësinë që m'u duk e përshtatshme dhe vura gishtin tregues në këm-

bëz. Ndjeva që isha shkarkuar krejt nga dridhjet dhe atëherë kuptova se sa gjë e madhe është të përmbajturit në çaste të tilla. Mbjaj mend se ajo copë garzë m'u zgjerua para syve sa një çarçaf, ndërsa unë mundohesha më kot të shquaja atë që fshihej pas saj. Nuk di sa zgjati ky çast që m'u duk pa mbarim. Po që vështrimi vetëtitës i Martinit, që më erdhi nga poshtë, ai që më dha sinjalin të shtija. Unë nuk dëgjova krismën, po gjëmimin e shpellës. Pashë flakën e kuqe dhe ndjeva të më mbyste era e athët e barutit. Pastaj më kapi veshi mbyturazi thirrjen «Të lumtë!» Pashë që Faredini i kishte duart të lira dhe u ngrit e afroi dritën. Për mua nuk ekzistonte atë kohë asgjë në botë, veç atij rrethi të vogël, ku skuqte si trëndafil plaga e hapur e shokut tonë. Plumbi në goditjen e parë kishte kaluar tej e tej lëkurës, pikërisht nëpër ato pjesë që kishim parashikuar. Për fat të mirë, gjaku që aq i paktë, sa unë nga gëzimi harrova të kujdesesha. Kjo erdhi edhe sepse Martini, jo vetëm që nuk u ndie fare por dhe, pasi kisha qëlluar, nuk tregoi asnjë kujdes për vete.

Xheloja hapi pincat dhe lëkura e tërhequr u lëshua në vendin ku ishte më parë. Unë i dhashë dorën Martinit dhe ai u ngrit ndenjor. Përshtypja tani u bë e plotë. Plumbi kishte «hyrë» përpara në gjoks dhe kishte «dalë» prapa në shpatull.

— Të dhembti? — e pyeta.

— Pak.

— Do ta ndiesh më vonë, kur të ftohet, — tha Xheloja.

Martini kishte ulur sytë në gjoks, sikur të shikonte aty një qëndisje e jo një plagë të hapur.

— Në shenjë i paske rënë, doktor! Të falemmnderit! — tha dhe më vuri dorën në qafë e ma shtrëngoi fort pas vetes. Unë, që e kujtoja veten aq të përmbajtur, ndjeva të më ngroheshin sytë. Po asnjëri nuk më vuri re, sepse të gjithë i kishte hutuar gëzimi dhe përqafoheshin.

Kur unë zura të merresha me mjekimin e plagës, Faredini dhe Xheloja, sipas planit, dolën në sheshin e

vogël para shpellës dhe shkrehën armë në ajër. Për disa minuta u bë një betejë e vërtetë: gjithë vendi shungulloi nga krisma pushkësh e automatikësh, nga bomba të llojeve të ndryshme. Shpella jonë lëkundej e buçiste, sa thamë se do të na zinte brenda nga gurët e vegjël që binin orë e çast. Po unë e vazhdova punën i qetë. Pasi i bëra gjilpërën e dytë, u kujdesova për plagën. Për fat të mirë, gjaku sa vinte i pakësohej dhe kjo s'kishte si të mos më qetësonte. Veç kësaj, Martini nuk jepte asnjë shenjë lodhjeje. Përkundrazi, sytë i xixëllonin dhe shikonte gjithë gaz nga hyrja e shpellës, nga vinte batareja e armëve.

— Dëgjo, Martin, — nisi t'i jepte këshillat e fundit Faredini, ndërsa unë, pasi ia kisha mjekuar plagën, po e ndihmoja të vishej. — Plagën nuk do ta ngasësh, derisa të të jepet rasti ta lash me raki, ose me ujë të zier. Kështu, doktor? Kur të vesh në mes të tyre, mundohu të kollitësh, gjoja se të ka kapur plumbi në mushkëri. Pësh-tyj gjak, duke gërvishur pak mishrat e dhëmbëve. Këmi-shën do ta mbash kështu të gjakosur.

Dola jashtë shpellës dhe nga era që më ra, ndjeva se isha dërsitur. Pas disa orësh, për herë të parë mora frymë në tërë qenien time. Tani më ishte zhdukur ai ankth që më kishte kapërthyer gjoksën.

Dëgjova zërin e Faredinit që urdhëronte për nisje dhe hodha sytë përpara. Turbull horizonti po rrethonte në lindje.

Kur hyra brenda, ata qenë ngritur. Xheloja mban-te dritën në dorë.

— Ma bëni hallall, shokë, — tha Martini. — Ju mundova gjer këtu dhe ju futa në merak të madh, sidomos doktorin, — dhe më shtrëngoi fort dorën.

— Mos fol kështu, — ia priti Xheloja, — po thuaj, më dhatë plumbin dhe tani po ikni...

Na kapi gazi të gjithëve dhe unë nuk di të them a ishte gaz i vërtetë apo bënim ashtu që të fshihnim pikëllimin që na kishte kapur para ndarjes.

— Kjo qe një detyrë e vështirë që e kryem me sukses bashkarisht, — tha Faredini pas heshtjes që pasoi. — Po merita e parë të takon ty, Martin. Tani që do të ikim

ne, shtrihu dhe fli ca orë. Trupi yt ka nevojë për pushim.

Kur morëm të iknim, u përqaftuam me radhë me shokun tonë por kësaj here ndryshe nga hera e parë, lëvizjet e tij ishin më të kujdesshme...

— Të fala, — i murmuriti ai Faredinit me një zë që mua më tingëlloi në vesh drithërues. Kjo që e vetmja herë që atë e tradhtoi diçka.

I fundit mbeti Xhelejoja. Ai shoi dritën dhe shpella u zhyt e tëra në errësirë.

Ne filluam të zbritnim shkëmbinjtë ngadalë njëri pas tjetrit. Pylli poshtë këmbëve tona qëndronte si një egër-sirë e fjetur. Unë çapitesha pas shokëve në heshtje. Më kishte kaplluar një ndjenjë e fortë që s'di se pse më përtërinte kohën e luftës. Ndieja sikur po kthehesha nga një betejë e rreptë në prapavijë, ndërsa shokët luftonin akoma në vijën e parë të zjarrit.

Disa ditë më vonë Faredini më njoftoi se Martinin e kishin pranuar në bandë dhe se ishte fare mirë nga shëndeti.

PEISAZHI

Është e guditshme se si lidhen ndonjëherë gjërat. Tek shikoja një ditë një peisazh të një mikut tim piktor, padashur m'u kujtua një ngjarje që ndodhi kësaj pranvere në kantierin tonë.

Në vështrimin e parë, duket sikur nuk ka asnjë lidhje në mes zanatit tonë dhe punës së piktorit, e migjithatë kur vjen rasti për të gjykuar një vepër arti, dashur padashur kërkon të gjesh në art atë që ke parë dhe provuar vetë në jetë. Kështu ndodhi edhe me mua atë ditë, kur rrija e soditja peisazhin e mikut tim. Shikoja atë vepër dhe sillja ndër mend ato pamje të natyrës sonë që më ka rastisur të shoh.

Peisazhi i tij paraqiste një qafë mali që hapej në mes, sikur t'i kishte rënë dikush me shpatë dhe që andej të kishin shpërthyer lule plot ngjyra. Lulet ngjiteshin gjer lart, duke përhapur në dy krahët e tablosë një dritë të ëmbël dhe qetësuese. Kjo ishte një bukuri delikate dhe e egër njëkohësisht, bukuria e natyrës shqiptare në një ditë të kthjellët prilli, që ne njerëzit e kantiereve e kemi parë sa e sa herë, po që dora e piktorit e kishte hedhur me mjeshtëri në pëlhurë dhe e kishte përmbyllur në një kornizë. Peisazhi aty për aty më pëlqeu; më tërhoqën e më bënë për vete tonet e çelëta të ngjyrave, ajo atmosferë plot dritë. Po nuk kaloi shumë dhe përshtypja ime sikur filloi të zbehej. Ndieva një pakënaqësi të lehtë. Në fillim ia vura fajin syrit tim të pastërvitur, shijes

sime akoma të paformuar për të ndier plotësisht një vepër arti. Po me sa kuptova më vonë, s'ishte vetëm kjo arsyeja. Pakënaqësia tek unë vinte duke u shtuar. Dhe kjo ndodhi sidomos kur nisa ta gjykoja veprën e mikut tim përmes përshtypjeve e kujtimeve që kisha nga jeta ime nëpër kantiere. Syri s'më gjente qetësi dhe ashtu, i shqetësuar, diç kërkonte dhe s'e gjente gjëkund. Pikërisht në këtë çast më erdhi ndër mend ngjarja që ndodhi kësaj pranvere te ne.

Ne punonim prej disa vjetësh për ngritjen e një hidrocentrali. Në kohën kur ndodhi ngjarja, puna në hidrocentral ishte në mbarim e sipër dhe kantierit tonë i duhej të largohej prej aty. Pritnim me ditë urdhrin që të shkonim në një vepër tjetër të pesëvjeçarit, sado që nuk na vinte mirë, sepse dëshira e të gjithëve ishte që të qëndronim deri në fund e të merrnim pjesë në inaugurim. Po, për çudinë tonë, ndërsa pritnim këtë urdher, papritur na thanë të qëndronim gjer në fund. Më thirrën mua si përgjegjës kantieri në drejtori dhe më udhëzuan për detyrën e re. Punëtorët e kantierit tonë duhej të hapnin një rrugë që do të kalonte përmes një qafe, që quhej Qafa e Vetëtimës. Rruga duhej të përfundonte sa më parë. Unë, me të marrë detyrën e re, u ktheva në kantier dhe u fola punëtorëve. Natyrisht ata u gëzuan dhe mezi pritnin të fillonin nga puna. Sipas planit që kisha bërë me inxhinier Nikon, ditën e parë do të punonte një ekskavator dhe disa nga punëtorët. Më vonë do të hidhnim forcat e tjera. Në mbledhje caktuam punëtorët, por, kur erdhi puna tek ekskavatoristi, nuk e patëm kollaj. Ekskavatoristët tanë janë të gjithë çapajeva dhe unë e Nikoja e kishim vështirë të bënim dallim. Po më në fund këtë gështje ata e zgjidhën vetë në mes tyre. U ngrit Ademi, ai ekskavatoristi zeshkan dhe propozoi xha Petron, Petro Kadenë. Petroja nuk ishte i vjetër, i kishte apo s'i kishte të pesëdhjetat, po në mes të punëtorëve të rinj, ai dukej i moshuar. Kur e shikoje nuk ta mbushte svrin: një trupvogël, me ca duar të mëdha, me vtullat kaleshe, që i mbulonin sytë e vegjël e të thellë, me një palë mustaqe të shkurtër, të thinjura pothuajse si flokët. Mbante ve-

shur gjithnjë një palë kominoshe të arnuara në dy shpatullat dhe bërrylet. Thashë, nuk ta mbushte syrin në të parë, po punën e tij s'e bënte njeri në kantier. Prandaj më erdhi mirë që e propozuan vetë shokët.

— Do ta marrësh përsipër, o Petro? — i thashë.

Ai ngriti kokën dhe, me atë zërin e tij të trashë, m'u përgjigj:

— E marr, shoku drejtor, si të mos e marr. Fjalë është ajo!

Shokët e tij të rinj rrahën shuplakat. Xha Petros i qeshën sytë. Unë vështrova nga punëtorët dhe, para se ta mbyllja mbledhjen, dhashë porosinë e fundit:

— Ekskavatorin ta çoni atje, nesër që pa gdhirë. Për këtë ngarkohet Lamja që të ndihmojë me skuadrën e tij.

Të nesërmen, pasi bëra mbledhjen e mëngjesit me këshillin teknik, së bashku me inxhinier Nikon u nisëm për të vendi ku do të hapej rruga. Qafa binte pak si larg hidrocentralit. Duhej të kaloje nëpër fshat, pa të arrije atje. Ishte një vend disi i mënjanuar nga gjithë ajo lëvizje e madhe që kishte nisur prej vitesh atyre anëve. Fshatarët, nuk di pse, e quanin Qafa e Vetëtimave. Vendi ishte shumë i bukur e, ngado që të hidhje sytë, të mbys-te gjelbërimi. Pastaj përreth kishte burime të freskëta. Mëngjesi i bukur i asaj dite pranvere të ftonte të soditje natyrën e ringjallur. Po ne, njerëzit e kantiereve, që punojmë në gji të saj e jemi mësuar, si të thuash, me agimet, me diellin dhe shiun, e kemi vështirë të përqëndrohem gjithnjë e të soditim bukurinë që mund t'ia kapë menjëherë njeriu që punon në zyrë a në studio. Shpeshherë neve na rri mendja të puna që na pret. Kështu dhe unë atë ditë. Mendjen e kisha të puna që duhej të kishte filluar. Ndaj në vend që të soditja horizontin e pastër e të kthjellët që humbiste në pafundësi, më mbetën sytë nga Qafa. Shihja nga larg, atje përtej, ekskavatorin e Petros me kokën përpjetë si një lejlek që s'lëviz nga vendi. Toka sa ishte kafshuar pak. Punëtorët ishin shpërndarë në të dy krahët e ekskavatorit. Shquaja vetëm Llazon e gjatë, që ulte e ngrinte trupin herë pas here. Diçka të tillë bënin

dhe të tjerët. Makina gjigante nuk dëgjohej fare. Unë e Nikoja pamë njëri-tjetrin në sy dhe ngritëm supet. «Ç'bëjnë ata? Puna duhej të kishte filluar me kohë, kurse ata akoma rrinë. Ç'mund të ketë ngjarë? Po, edhe sikur t'u kishte ngjarë ndonjë avari, duhej të na kishin çuar fjalë.»

Pyeta inxhinierin i shqetësuar:

— Më bëjnë sytë mua, apo punojnë ata atje?

— As unë s'po marr vesh, — ma ktheu Nikoja. —
— Diçka kanë ata ashtu...

E lamë fjalën me aq dhe nxituam hapin. Morëm me vrap të përpjetën që na kishte mbetur dhe dolëm menjëherë përballë punëtorëve. Prapë unë nuk po kuptoja gjë se ç'bëhej. Të gjithë kishin ulur kokat dhe seç kërkonin përdhe, në mes të barit. «Mos u ka humbur ndonjë vegël, — mendova, — dhe janë vënë të gjithë për ta kërkuar. Ekskavatori, shyqyr, është edhe alamet makine, po ja, që dhe për një vidë të vogël të lë në baltë!» Ju afroam punëtorëve të heshtur, pa ditur nga t'ia fillonim. Disa prej tyre, si na panë, drejtuan trupin dhe vunë buzën në gaz. Unë shtrëngova nofullat. Më është bërë zakon, një gjë të mos shkojë mirë dhe... Dëgjoja punëtorët që më përshëndetnin dhe s'më jepej t'u përgjigjesha. Po, kur pashë Petron që m'u afroa dhe më zgjati dorën, atëherë s'e përmbajta dot veten dhe i thashë me zë të rreptë:

— Ç'është kjo që po bëni, o Petro? Pse nuk keni filluar akoma?

Ai më buzëqeshi, ndërsa sytë sikur iu ndezën menjëherë prapa vetullave kaleshe dhe më tha:

— Po punojmë, shoku drejtor, nuk po rrimë. Atëherë unë, jo pa habi, ia ktheva.

— Si, mor, po punoni, ekskavatori po fle!..

Ndërkaq punëtorët u mblodhën përqark nesh.

Petroja gjithnjë i qetë vazhdoi:

— Punë është dhe kjo që bëjmë, shoku drejtor.

— Ç'punë është kjo? — ia pres unë. — Ju sikur keni dalë për piknik.

Në mes nesh për një çast u ndeh një heshtje e çuditshme. Mua pothuaj m'u mjegulluan sytë.

— Është gjynah, shoku drejtor, — dëgjoj Petron të thotë.

— Çfarë gjynahu, — ndërhyj unë, që mezi mbaja zemërimin. — Edhe tokë vakëf të ishte kjo, s'kishit pse të trembeshit!

— Po vakëf është e shkuar vakëfit, shoku drejtor! Gjynah t'i prishësh me hekur.

— Cilat të prishësh, more Petro?

— Po ja këto, shoku drejtor, lulet. Nuk i shikoni?

Unë u përpoqa të mblidhja veten dhe sikur të për-mendesha nga një dremetje e lehtë, rrudha sytë dhe pashë me vëmendje përreth. Gjithë vendi përçark ishte mbushur me manushaqe. Kaq vura re unë dhe mjaftoi kjo që ta ndieja veten ngushtë. Mbete për një çast i nemitur.

Petroja vazhdonte të arsyetonte:

— Thashë, të mos vejë dëm gjithë kjo bukuri, shoku drejtor. Manushaqja është lule e bukur, paçka se është më e druajtura nga të gjitha shoqet. S'na bëri zemra t'i biem me hekur. Thashë t'i mbledhim njëherë, po pastaj në dorë e kemi. Punojmë sot një çikë më shumë, se s'bëhet qameti...

Ai heshti, unë ngrita sytë dhe pashë në duart e tij një tufë me manushaqe të freskëta. Pastaj vura re manushaqe nëpër duart e punëtorëve, vënë nëpër xhaketat e tyre, pranë veglave të punës, në dritaren e ekskavatorit... Kudo manushaqe më zuri syri. Pashë fytyrat e qeshura të punëtorëve dhe m'u duk vetja për një çast si i huaj në mes tyre. Nuk dija ç'të thosha. Ndjeva të më dehte era e manushaqes. Një punëtor më zgjati një tufë me lule. E mora pa fjalë. Më vinte turp nga vetja për atë që ndodhi. Megjithatë, Petroja përpiqej të më qetësonte. Ai akoma pandehte se unë, me heshtien time, doja ta qortoja për manushaqet.

— Mos e prishni gjakun, shoku drejtor, ja, i mblo-dhëm këto dhe tashti do të fillojmë nga puna...

Unë për herë të parë vura buzën në gaz dhe i thashë Petros:

— Nuk ka gajle, o Petro!

Po ai s'e dëgjoi zërin tim. Në këtë kohë Lamja kishte ndezur motorin e ekskavatorit. Zhurma e makinës mbyti të gjithë zërat. Petroja u drejtua për nga ekskavatori. Punëtorët morën veglat dhe secili filloi nga puna. Mbetëm vetëm me Nikon.

— S'kam parë ndonjëherë kaq shumë manushaqe. Sikur t'i kishte mbjellë njeri me dorë. Dëgjon çfarë po të them, apo jo?

Unë e kam gjithnjë mendjen tek ajo që ngjau, Nikoja më vuri krahun dhe të dy filluam të ecnim.

— Kam dhjetë vjet — i thashë, — që punoj nëpër kantiere, në mes të punëtorëve, natë e ditë, po kjo që ndodhi sot s'më ka ngjarë ndonjëherë. Të ma thoshte njeri, s'do ta besoja, po e pashë vetë.

Biseda që hapa me inxhinierin vazhdoi pothuaj gjithë atë paradite. Ndenjëm në Qafë deri afër drekës. Në pushim bëmë një mbledhje të vogël, ku unë u dhashë disa porosi lidhur me punën dhe në fund e hodha fjalën te manushaqet. Tërthorazi u kërkova punëtorëve falje për atë që ndodhi. Desha ta mbyllja me aq. Po Petroja, si ta kishte kuptuar brengën time, u ngrit nga vendi dhe tha:

— Mos e thuaj atë fjalë. Ti ishe në të drejtën tënde, puna është punë. Po e kisha gjetkë hallin. T'i thoni Kolit, drejtorit tonë të përgjithshëm, që punëtorëve të kantierit të gjashtë ua do zemra ta pagëzojnë vetë këtë rrugë. Duam ta thërrasim Rruga e Manushaqeve.

Unë nuk u mendova shumë që t'i përgjigjesha. Për të larë, si të thuash, atë që bëra, i veshja vetes të drejta që s'më përkitnin dhe ua miratova propozimin aty për aty. Punëtorët u gëzuan pa masë dhe rrahën duart të kënaqur.

Tërë atë ditë dhe disa ditë më vonë, s'm'u largua nga mendja kjo. Kaluan disa kohë dhe kjo ngjarje m'u kujtua, siç ju thashë në fillim, rastësisht, kur shikoja peisazhin e mikut tim. Nuk di, sa pata të drejtë të isha i pakënaqur nga ajo që pashë. Po për një gjë jam i bindur: Po ta kishte parë miku im atë që ndodhi në Qafën e Vetëtimës, ku punonin punëtorët tanë, nuk do ta kishte lënë

peisazhin e tij vetëm me qiell, tokë e lule. Me siguri do të vinte aty Petron, në mos atë, shokun e tij, e në mos ata vetë, pa tjetër punën e duarve të tyre. Atëherë syri im, që është mësuar gjithë këta vjet ta shohë peisazhin shqiptar gjithnjë në ndryshim, nuk do të shqetësohej sic u shqetësua, po përkundrazi do të kënaqej.

BETEJA E HESHTJES

Natën e parë ata u mblodhën në shtëpinë e Hajredinit. Ishin të gjithë shokë të një çete, që kishin ardhur në fshat një ditë përpara festës lokale, me përjashtim të Rizait, që ishte ndodhur rastësisht në fshat dhe të teto Shanijes, nënës së një dëshmori.

Çeta e tyre kishte qenë e vogël, e, veç kësaj, një pjesë kishte rënë në luftë bashkë me komisarin dhe komandantin. Këta që kishin mbetur mbushnin dhomën e zjarrit të Hajredinit. Ishin të tërë burra të pjekur, të rrahur nga jeta, po takimi me njëri-tjetrin i kishte tronditur dhe i kishte bërë shumë të ndjeshëm. Atmosferën e gjallëronte edhe më shumë rakia, ndërsa nata e freskët e majit hynte përmes dritareve. Nga larg, herë pas here dëgjohej zhurma e makinave, që shkonin e vinin në minierën e re.

Hajredini dukej shumë i mallëngjyer dhe nuk dinte si t'i gëzonte shokët. Bile, që tërhequr aq tepër pas kujtimeve të çetës, sa gati e kishte harruar Rizanë. Po Rizai nuk e ndiente fare, sepse edhe ai ishte i prekur nga gjithçka që ndodhte përçark. Karshi kishte një mesoburrë, me mustaqe të dendura, me një dorë të cunguar, që e thërritnin Çelo. Në krahun e djathtë, kishte zënë vend teto Shanija, veshur me rrobat e krahinës, me një trup të drejtë e fytyrë shumë të rrudhur, me ca sy të vegjël, që i regëtinin orë e çast. Ajo mbante në prehër dorën e një burri që i rrinte në krah dhe, me sa mori vesh Rizai, ai që shok i ngushtë i të birit të vvarë. Gjithë të tjerët pas-

taj vinin me radhë njëri pas tjetrit, rreth një tavoline të gjatë.

Rizai pothuaj nuk fliste fare, dëgjonte me vëmendje dhe ngrinte dolli sa herë e donte rasti. Dhe kjo vinte jo sepse ai e quante veten të huaj aty, përkundrazi i dukej se tërë ata ishin shokë të tij, megjithëse nuk ua dinte alkoma të gjithëve emrin. Po ç'është e vërteta, nuk i bënte zemra ta ndërpriste bisedën e luftëtarëve për çetën e tyre. Të gjithë ata që flitnin e tregonin, ishin fshatarë të një krahine, që e kishin filluar së bashku rrugën e luftës dhe këto kujtime i kishin lidhur për jetë me njëri-tjetrin.

Ndoshta, Rizai nuk do të qe ndier fare atë natë, sepse asnjëri nga të ardhurit nuk e njihte dhe nuk ia dinte të kaluarën. I vetmi që e njihte ishte i zoti i shtëpisë, po dhe ai nuk u kujtua për një kohë të gjatë. Dukej se në tërë atë histori për çetën, nuk kishte vend për Rizanë.

Vetëm në të thyer të natës, kur u duk sikur ra pak flaka e bisedës, Hajredini u tha shokëve:

— Edhe shoku Riza është këtu! — dhe tregoi me gisht mesin e pëllëmbës së tij që donte të thoshte, në gjuhën figurative të krahinës, se edhe Rizai kishte marrë pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare.

Atëherë të gjithë mysafirët luajtën nga vendi dhe hapën sytë, duke vështruar nga Rizai, sikur ai të kishte hyrë atë çast në dhomë.

— Po ti fol, mor i uruar! Pse s'thua që është dora jonë? — thirri dikush nga krahu i tryezës.

Rizai papritur e ndjeu veten ngushtë, iu lidh gjuha, thua jse ishte djalë i ri dhe buzëqeshi, gati i turpëruar. Dhe ndërsa teto Shanija i mori dorën në prehër, Hajredini zuri të tregonte se kishin qenë bashkë me Rizanë, në një brigadë dhe atij ia detyronte jetën, kur qe plagosur në Operacionin e Qershorit. Rizai kishte qenë mjeku i partizanëve.

Po të ftuarit nuk u kënaqën vetëm me këto që tha Hajredini. Filluan pastaj të pyetnin me imtësi për të kaluarën, aq sa doktori padashur u bëri biografinë e tij partizane, duke treguar se si ishte lidhur me Lëvizjen,

kur kishte hyrë në Parti e kur kishte dalë partizan, se kë kishte pasur komandant e kë komisar...

Si dha tërë këto sqarime, ai vuri re se vështrimi i të gjithëve u bë më i përzemërt, për më tepër që atë kohë ndjeu se kishte fituar plotësisht të drejtën të qëndronte në mesin e luftëtarëve të çetës dhe këtë e vërtetoi pas pak Çeloja, me fjalët që tha kur ngriti dollinë për të.

— Tregoj, doktor, atë që na ngjau në malet e Martaneshit, — thirri Hajredini, i entuziazmuar, kur kthyen gotat me fund.

— Thujna, doktor, për kokën tënde, thujna se gjithë nata sonte jona është, — ia priti ai që i kishte mbajtur dorën teto Shanija në prehër.

— Ta thotë, ta thotë, posi, se edhe doktorët kanë luftuar atëherë!

— Si nuk kanë luftuar, fjalë është ajo!

— Rrëfena, more bir, — tha me një fije zëri teto Shanija.

Doktor Rizait i kishte mbetur vështrimi te Çeloja ose më saktë te dora e tij e cinguar, sikur ajo dorë t'i ndilte kujtimet e luftës. Ai nuk foli një hop dhe në këtë kohë zërat në dhomë reshtën. Të gjithë e kuptuan se doktori po përgatitej të tregonte.

— E madhe ka qenë trimëria e partizanëve karshi armikut, — tha ai, — po nuk ishte më e vogël trimëria që ata treguan ndaj plagëve dhe dhembjeve. Për të parën folët ju, për të dytën do të them unë diçka. Ju folët shumë sonte për luftën partizane, për trimëritë e shokëve e shoqëve, po asnjërit nuk iu bë mbarë ta hapë këtë faqe që dua të nis unë. Unë e kuptoj pse e bëtë këtë; ju druheni, vëllezër, ta përzieni heroizmin, guximin e shokëve me vuajtjet dhe dhembjet. Po kujt i takon më shumë se mua që kam qenë mjek i një spitali partizan të tregojë për trimërinë e të plagosurve, për atë trimëri që ta di vetëm shpirti ose shumë-shumë, ai që të mjekon! E pra, kjo më takon mua ta kujtoj.

Dhe nuk do t'i ngas të tjerat, po do të tregoj vetëm për atë ngjarje që më solli ndër mend sonte Hajredini.

Ishte koha kur Divizioni I kishte kaluar në Veri dhe po u jepte pushtesve goditjen e fundit. Brigadat tona nuk kishin shumë kohë që kishin dalë nga Operacioni i Qershorit. Dhe ç'është e drejta, qemë dëmtuar, kishim mjaft të plagosur dhe, kur u dha urdhri të marshonim drejt Veriut, partizanët e plagosur nuk pranuan kurrësi të mbeteshin në Jug. Ata donin të shkonin, tok me brigadën, në ndjekjen e fundit që po i bëhej armikut, donin të marshonin, ashtu siç qenë, me plagë në trup, me duar e pa duar, të çalë e të sëmurë. Komanda s'kishte ç'të bënte. Kjo ishte dëshira e të gjithë partizanëve. Ata nuk donin të ndaheshin nga njëri-tjetri.

Në këto rrethana, u detyruam të niseshim të gjithë së bashku, të shëndoshë e të sëmurë në një kolonë. Brigadat përpara, ne pas. Dhe mendoni se ne që vinim prapa brigadave nuk ishim pak. Bëheshim afro njëqind e ca vetë, ku, veç të plagosurve, ishin dhe personeli e toga e sigurimit.

Sa kaluam Shkumbinin, të plagosurit erdhën dhe u shtuan. Pas çdo përpjekjeje spitali ynë lëvizës vinte e rritej; po, megjithatë, asnjëherë ai nuk mbetej pas. Gjithë kohën spitali ishte në udhëtim, ditën dhe natën. Të sëmurët ishin aq lart moralisht, nga gëzimi i fitoreve të përditshme, sa harronin plagët dhe lehtësoheshin nga dhembjet. Dhe ndodhi që ne asnjë ditë të mos mbeteshim prapa. Shokët herë pas here na thoshin të mos vazhdonim më tej. Po s'qe e mundur. Partizanët s'pranonin. Madje ngaqë nuk dëgjonin partizanët, tërë fajin ma vinin mua. Po ç't'u bëja unë, asnjëri nga ata nuk donte ta jepte veten, sado që shumica ecnin më këmbë dhe vetëm të sëmurët rëndë i kishim hipur nëpër kafshë. Për më tepër, nuk ecnim nëpër rrugë të zakonshme, po andej nga shkonin brigadat, maleve dhe gërxheve, në rrugë e pa rrugë.

Më në fund, kishim mbërritur në një zonë të lirë, ku na pritën krahëhapur partizanët e Baba Fajës. Për disa ditë do të ishim larg rrezikut të armiqve. Prandaj kishim vendosur të çlodheshim mirë dhe të merrnim disa masa për të sëmurët rëndë. Dhe kjo ishte e arsyeshme:

gemë nisur nga këmbët e Tomorrit dhe një marshim i tillë i jashtëzakonshëm nuk mund të mos ndikonte në gjendjen e të sëmurëve.

Forcat e divizionit vazhduan marshimin më tutje dhe ne na lanë aty të merrnim veten dhe do të bashkoheshim pas disa ditësh në Dibër.

Po lufta si gjithnjë ka të papriturat e saj dhe ndodh që, pikërisht atëherë kur ti je i bindur se ndodhesh jashtë rrezikut, befas gjendesh i kërcënuar nga një rrezik i ri, ndoshta më i madh se i pari.

Isha duke mjekuar partizanët e sëmurë në fushë, atje ku kishim ngritur spitalin tonë, kur më vjen Jordani, komisari i spitalit, e më sjell lajmin. Nga të dhënat që kishin ardhur, forcat armike qenë nisur në drejtim të Martaneshit. U krijua kështu një situatë që vinte në rrezik jetën e të plagosurve dhe vetë jetën tonë.

Si do t'ia bënim? Ky ishte një problem shumë i vështirë. Mund të lëviznin të plagosurit me shpejtësinë që duhej për të arritur brenda disa orëve forcat e divizionit në marshim? Kjo ishte krejtësisht e pamundur, jashtë fuqive të tyre. Bile, edhe sikur për një çast të donin ata, nuk do t'i lejoja unë si mjek, që i merrja me mend të gjitha pasojat që mund të vinin.

Menduam njëherë që, për t'u lidhur me shokët, të përdornim kafshët. Kafshët që kishim, natyrisht nuk na mjaftonin për këtë gjë. Atëherë thamë t'u kërkonim fshatarëve ndihmë. Neve na duheshin afro njëqind kafshë ngarkese, pra nuk ishin pak. Le pastaj që fshatrat qenë larg nga njëri-tjetri, e shtëpitë ishin të shpërndara kodër më kodër, ashtu siç janë në krahinat mallore. Dhe le të pranojmë se vendosëm që do t'ua lypnim fshatarëve, pa llogaritur mundësitë e tyre, po a priste koha, për të organizuar një fushatë të tillë?

Meqenëse s'po gjenim rrugëdalje tjetër, mua si mjek, m'u duk për një çast e arsyeshme t'i shpërndanim të plagosurit, në mos të gjithë, të paktën ata më të sëmurët nëpër baza. Po dhe këtë ide ma hodhi poshtë me të drejtë Jordani, sepse kjo fshihte një rrezik serioz: kishte mundësi që armiqtë të diktonin një, që të

rrezikoheshin pastaj gjithë të tjerët, mbasi nuk përjash-tohej rasti që të gjendej një i poshtër nga fshatrat për-qark e të tregonte dhe shokët të na venin të gjithë dëm. Kjo do të thoshte t'ua dorëzonim armiqve me do-rën tonë. Pra, ky arsytim i thjeshtë, po i drejtë hidhte poshtë dhe këtë zgjidhje.

Atëherë si do të vepronim? Vështronim njëri-tjetrin në sy unë e komisar Jordani dhe përpiqeshim t'u bënim ballë mendimeve qetësuese që na vinin valë-valë.

Po sikur të shkonim në rrugën e shokëve të divi-zionit ashtu siç ishim, duke ecur çalë-çalë, me sa të mundnim duke marrë me vete dhe përforcime të tjera, ndoshta dhe një kompani tjetër sigurimi që ta kishim në ndihmë?

Te ky mendim qëndruam gjatë. Bile, njëherë mend e kandisëm njëri me tjetrin dhe qemë gati të ngriheshim, kur në çastin e fundit na u kthye mendja. Ishte për-gjegjësi e madhe që, duke pasur me vete dy kompani partizanësh të shëndoshë, t'i bëje ballë me sukses një skote ujqish të tërbuar. Lufta tani ishte në fund, ne ishim në prag të fitores dhe armiqtë qenë bërë më të egër, më barbarë. Kishte të ngjarë që gjithë vrerin e disfatave ta shfrynin mbi një spital partizan!

Kuptohet se hoqëm dorë, sado që me vështirësi dhe nga ky mendim.

Po nuk na ndahej pyetja: «Ç'do të bënim atëherë me spitalin?»

Do t'i linim shokët të rrezikoheshin që të binin në duart e armikut?

Kjo as që na shkonte ndër mend. Këtë gjë ne nuk e kishim bërë as në Operacionin e Dimrit e jo tani që ndodheshim në prag të fitores.

U mblodhëm prapë kokë më kokë me Jordanin dhe, pasi diskutuam gjatë e gjerë, vendosëm që njëherë për njëherë ta shpërngulnim spitalin në pyll. Të këtij men-dimi ishin dhe partizanët vendas. Pylli nuk qe larg, po ishte për fat të keq i vogël, e për më tepër, anash tij kalonte rruga që merrte pastaj përprjetë një mali të zhveshur.

Të plagosurit e kishin marrë vesh situatën e re para se të shkonim e t'ua tregonim ne. Është e tepërt të them se nuk pati asnjë shenjë alarmi, përkundrazi, në një formë a në një tjetër po përsëritej ajo që na ndodhi në këmbët e Tomorrit. Ata nuk donin të shkëputeshin nga shokët, qoftë dhe me sakrificë.

Por, kur u mblodhëm në mes të pyllit dhe Jordani u foli haptazi mbi situatën e rëndë, për një kohë pllakosi heshtja. Kjo tregonte se të gjithë e ndienim përgjegjësinë e situatës. Po kjo që punë sekondash, sepse papritur u dëgjuan thirrjet: «Do të luftojmë, do të luftojmë». — I gjithë pylli atëherë zuri të ushtonte nga kori i të plagosurve, aq sa ne e patëm të vështirë t'i detyronim të heshtnin. Bile unë u nxeha keq për pak dhe u desh buzëqeshja e Jordanit të më qetësonte. Ajo që po bënin partizanët ishte një shpërthim i natyrshëm, që tregonte për shpirtin e tyre të gjallë në ato trupa të drobitur. Këtë e kuptova pak më vonë, kur ata u qetësuan dhe zunë të dëgjonin me vëmendje fjalën e komisarit.

Filloi pastaj një diskutim në mes të partizanëve që i dha shkas me qëllim Jordani. Gjithë puna ishte si të dilnim nga situata në të cilën ndodheshim. Secili e ndiente mbi vete rrezikun që kërcënonte spitalin tonë dhe një gjë e tillë i bënte të mateshin mirë para se të flitnin.

Unë isha mjek i vjetër i partizanëve, kisha kaluar me ta Operacionin e Dimrit dhe aso kohe pati plot ngjarje heroike në spitalet partizane, po atë skenë që më panë sytë asaj dite nuk e kisha jetuar asnjëherë. Të më besoni, u ngritën ndenjtur nga barrelat dhe partizanët e plagosur rëndë. Njëri prej tyre, një Xhaferr Skëndi, këndej nga amët tuaja, që deri atë kohë kishte humbur vetëdijen, kur mori vesh se ç'bëhej, hapi sytë e u tha shokëve: «Më sillni pushkën!»

«Sido që të vijë puna, shoku komisar, — tha xha Loni, një partizan i vjetër nga Myzeqeja, — më mirë të na vrisni me dorën tuaj, sesa të na vrasin ata qena!»

Unë nuk flitja, shikoja partizanët dhe herë pas here

ktheja kokën nga Jordani. Ai qëndronte më mirë se unë, po prapë dhe ai ishte i prekur, sado që mundahej të mos e jepte veten.

Ne ishim gati që atë çast të vriteshim duke luftuar për të mbrojtur shokët tanë të sëmurë!

Dhe kështu do të kishte ndodhur me siguri, po të mos ishte ngritur të fliste Sefer Aliu, një partizan i plagosur në shpatull, që nuk kishte pranuar kurrsesi të hipte në kafshë gjatë tërë marshimit.

«Do ta them dhe unë një fjalë, o shoku komisar, — tha ai me një zë të ftohur. — Në daç ma pranoni, në daç jo, po unë do ta them.»

«Ta thuash, posi!» i dha zemër Jordani.

«Ne në fshatin tonë, — tregoi ai, — kur na erdhën sefte gjermanët, i morëm fëmijët dhe plakat dhe i mbuluam me bar. Ky marifet i shpëtoi!»

Përnjëherë i gjithë pylli ushtoi nga një e qeshur e papërmbajtur. Pas shqetësimit që na kishte kapur, ai gaz që një lehtësim i ardhur në kohë. Unë dhe Jordani përfituam nga kjo dhe u pamë në sy. Edhe neve na u duk e çuditshme ajo që po na dëgjonin veshët. Për më tepër, ajo e qeshura që erdhi më pas, tregonte se partizanët nuk ishin të një mendjeje me Seferin. Megjithatë, Seferi nuk u tërhoq nga e tija dhe, si ra gazi, ai vazhdoi me seriozitet:

«Unë them kështu, shokë. E shihni atë përrua që kalon nëpër pyll? — Ne kthyem kokën nga ia bënte me dorë Seferi. Unë, të them të drejtën, nga telashet që kisha mbi kokë, as që e kisha vënë re përroin. Ai ishte një përrua i thatë malor që vende-vende vinte i thellë, duke dredhuar herë brenda, herë jashtë pyllit. — Unë them që të shtrihemi pranë e pranë, të mbulohemi me gjethe dhe degë... nga këto, shyqyr, ka plot këndeje...»

Ideja e Seferit shkrepri si vetëtimë në mendjen tonë të trubulluar dhe, në qoftë se në fillim fjalët e tij i kisha dëgjuar me qesëndi, tani po i merrja seriozisht. Këtë gjë e vura re dhe te të tjerët. Shumica nuk qeshte më, po e ndiqte me vëmendje. Kur Seferi mbaroi, Jordani nuk foli fare. Nuk folën as edhe partizanët. Vetëm

në mes tyre u ndez një stuhi murmuritjesh dhe shpër-
thyen ca zëra të fortë:

— S'na the gjë, o Sefer!

— Mbajti për vete këto! Nuk jemi dakord!

— Ku ke parë ti të fshihen kështu partizanët!

Zërat vinin duke u shtuar, po unë mora fjalën
shpejt dhe nuk i lashë. Bile, pa u marrë vesh me Jor-
danin fare, shfaqta mendimin tim të hapur:

«Seferi, më duket se ka të drejtë, — thashë me
vendosmëri. — Ajo që thotë ai është një mënyrë mas-
kimi që mund të japë rezultat. Përroi është i thellë,
gjethe ka plot...»

«Ne akoma nuk jemi bërë për gropë, o shoku dok-
tor, — më ndërpreu një partizan me paterica, që më
rrinte karshi e që fliste për herë të parë.»

Mua më qëlluan keq këto fjalë dhe qeshë gati t'i
përgjigjesha hidhur, po e përmbajta zemërimin dhe i
thashë qetë atij:

— Nuk ka asgjë të keqe të maskohesh, shok i da-
shur. Mjafton të gënjesh armikun. Po thuaj, je i zoti
të qëndrosh ashtu?

— Pritni, mos u ngutni, — ndërhyri Jordani me
taksin e tij. — Pse të mos e diskutojmë?

Atëherë u ndez prapë diskutimi në mes partizanëve,
që shkoi gjatë, derisa u sheshuan mendimet dhe erdhën
e u bashkuan shumica me Seferin e me mua, që u bëra
ndjekësi i parë i tij.

Partizanët pranuan më në fund të maskoheshin në
shtratin e përroit, po me kusht që të qëndronin edhe
atje në gatishmëri luftarake, domethënë me pushkën
pranë, në mënyrë që, sido që të vinte puna, të luftonim
të gjithë së bashku. Veç kësaj, ishte vendosur që par-
tizanët e Baba Fajës të zinin vend prapa Qafës dhe t'u
binin forcave gjermane.

Tani na mbeti të fillonim menjëherë nga përgatitjet.
Gjëja e parë që bëmë, vajtëm zgjodhëm vendin, har-
tuam planin se si do t'i vendosnim njerëzit, studjuam të
gjitha mundësitë dhe pastaj sollëm të plagosurit.

Zgjodhëm tamam vendin ku përroi bënte një bërri!

brenda pyllit, ndërsa rruga kalonte 200-300 metra më tutje. Shtrati i përroit ishte i thellë e i thatë dhe në të dyja anët ngriheshin drurë gjysmë të zhveshur. Nga kjo, vendi që zgjodhëm ishte mbushur plot me gjethe të thata, ashtu siç që mbushur dhe pjesa tjetër e shtratit të përroit. Dhe mendoni, që gjithë atë masë njerëzish e shtrimë në bërrylin e përroit. I vumë të plagosurit kokë më kokë, duke pasur në kufi vetëm armën dhe i mbuluan përsipër me gjethe e degë.

Këtë detyrë e kryem plot kujdes me të tjerët, po megjithatë unë e Jordani nuk ndiheshim të qetë, sepse nuk mund të harronim për asnjë çast se ata kishin plagë në trup dhe dhembja i torturonte. Le pastaj që ata qenë të ftohur dhe kolla i ngacmonte e s'i linte rehat. Po situata lypte nga secili disiplinë, bindje të plotë, duke u vënë të gjithë për një e një për të gjithë. Tani nuk ishte puna t'i hidheshe në grykë armikut. Detyra e kërkonte të qëndroje shtrirë në shtratin e ftohtë të përroit, mos të lëvizje e mos të jepje asnjë shenjë jete. Kjo detyrë mund të zgjaste disa minuta, po mund të shkonte edhe disa orë.

Pas porosive që dhamë dhe si caktuam parullat me anë sinjalesh, ne u tërhoqëm thellë në pyll duke lënë me të plagosurit vetëm infermierët. Në thellësi, morëm të gjitha masat për të mbrojtur shokët, në rast se armiqtë do t'i diktonin. Unë e Jordani e tok me ne dhe toga e sigurimit, hipëm në disa pisha të larta. Prej andej dukej rruga e gjarpëruar nga pritej të kalonte armiku. Në mes kurorave të dendura të pishave ne vendosëm dhe dy mitraloza të lehtë. Nga ana tjetër, partizanët e Baba Fajës larguan kafshët tona dhe morën përsipër të patrullonin vendin rreth e qark.

Nuk mund të them me siguri se sa kohë qëndruam ashtu, në pritje. Di vetëm të them se gjatë kësaj kohe isha shumë i shqetësuar. Nëse pa ardhur armiqtë, të plagosurit lëviznin nga pak, kolliteshin apo dhe rënkonin, kur u dha parulla me një lehje qensh, gjë që tregonte se armiqtë po vinin, atëherë çdo gjë heshti.

1. Po sa do të vazhdonte kështu?

Pararoja e tyre ishte larg, kur ne e pamë nga lart. Pritnim që të afroheshin, po gjithnjë na hante merakun, vallë, a do të duronin dot shokët tanë? Kjo do të që prova e parë. Unë isha mjek dhe kujtoja se e njihja mirë psikologjinë e të sëmurit. Dhe sado besim që ata më kishin frymëzuar, prapë nxirrte kokë mendimi se i sëmuri mbetet gjithnjë i sëmurë, ai nuk e ka veten në dorë kur dhembja e vë poshtë. Mund të ndodhte që në tërë atë masë njerëzish të ishte një i plagosur që të lëndohej papritmas nga ndonjë dhembje tinzare e ta lëshonte veten. Atëherë me siguri do të rënkonte ose do të lëvizte. Se ç'mund të bëhej atë çast, e keni të qartë!

Me këtë frikë në zemër shikoja pararojën gjermane që ngjitej përpjetë, nëpër rrugën që vinte paralel me përroit. Për mua ishte e qartë se armiqët qenë të tronditur e të hutuar nga goditjet tona, po kjo, nga ana tjetër, i kishte bërë të kishin frikë nga hija e tyre, të dyshonin për gjënë më të vogël.

Në një heshtje varri pararoja kaloi buzë përroit. Neve atje lart sa nuk na dilte zemra jashtë. Nuk guxonim të shihnim njëri-tjetrin në sy. Po kur ata e kapërcyen atë copë rrugë dhe dolën në qafë, ne morëm frymë lirisht dhe ishim gati të përqafoheshim me shoku-shokun, po atë kohë bënë ballë kolonat e gjata të armiqve. Në të vërtetë tani po vinte rreziku më i madh, po ne, me atë që kaloi, sikur kishim marrë pak zemër.

Kolona e gjatë e gjermanëve dhe e ballistëve kalonte para syve tanë e lodhur dhe e çoroditur si një bollë e zezë që zvaritej bri përroit e ngjitej dalngadalë malit përpjetë. Ata marshonin në heshtje, shumica më këmbë e disa kaluar, pa u kthyer as majtas, as djathtas. Ne i ndiqnim në çdo hap, herë me sy, herë me dylbi, ndërsa përçark mbretëronte një qetësi djallëzore, e pabesë. Në këto çaste, koha na dukej sikur kishte mbetur në vend ose më mirë zvaritej si ajo bolla e zezë atje përtej që ngjitej malit përpjetë. Po nuk mjaftonte kjo. Ne ndiqnim me zemër në dorë çdo lëvizje të armikut. Sa herë që trembej ndonjë kafshë e mbetej prapa ndonjë prej tyre, ne vështronim të vrenjtur shoku-shokun,

kurse Jordani, si përherë, pa e prishur gjakun, vinte dylbitë dhe shikonte. Pastaj, kur rreziku largohej, ne buzëqeshnim në heshtje. Po rreziqet nuk kishin të mbaruar sa kohë që bolla vazhdonte të zvaritej. Dhe ndodhi që tamam nga fundi, kur po kalonte bishti i kolonës, na zuri syri një tufë qensh të mëdhenj që i mbante lidhur një skuadër e tërë gjermane. Atëherë dhe Jordanit i iku gjaku nga fytyra, por, që të mos e bënte veten, nuk i hiqte dylbitë nga sytë. Ai që një çast shumë i rrezikshëm sepse, megjithëse forcat armike ishin krejt në kalim, prapë kush na siguronte ne se qentë me nuhatjen e tyre të sprovuar nuk do të diktonin që aty përreth kishte njerëz të fshehur. Po ne me sa duket, u trembëm pa qenë nevoja, mbasi ata, si u mor vesh më vonë, kishin hall të largoheshin sa më parë dhe nuk ia kishin ngenë t'i nxirrnin vetes telashe në mes të këtyre maleve.

E kam të vështirë t'juaj them me saktësi se sa zgjati ky «parakalim» ogurzi. Po edhe vetëm disa minuta të kishte zgjatur, prapë nuk ishte gjë e vogël për shokët tanë të sëmurë. Këtë, më shumë se asnjeri e kuptonim ne që kishim përgjegjësi për jetën e tyre. Prandaj, kur pika e zezë e kolonës u zhduk nga sytë tanë, ne mezi pritnim sinjalin e patrullës. Patrulla i ndoqi armiqtë deri larg, përtej Qafës dhe, vetëm pasi u sigurua se qemë jashtë rrezikut, na dha shenjë të zbritnim.

As ne nuk dimë se si zbritëm. Mbaj mend që nga gëzimi nuk flitja dot. Ecnim gati duke rendur dhe dëgjonim këmbët tona që shkelnin nëpër gjethet e thata të pyllit.

Kur u gjendëm pranë shokëve, se si na erdhi ashtu të gjithëve tek i pamë të mbuluar nga heshtja dhe gjethet. Ata nuk ndiheshin fare dhe kjo më tronditi. U desh që t'u thërriste komisar; «Çohuni, shokë», që ata të bëheshin të gjallë dhe të zbuloheshin. Atëherë gjithë vendi u mbush me partizanë, sikur të kishin mbirë nga shkëmbinjtë përqark. Po, ndërsa partizanët jepnin e merrnin me njëri-tjetrin, unë fillova menjëherë të kontrolloja shpejt e shpejt të plagosurit në gjendje të rëndë.

Ata ishin krejt të mpirë. Bile njëri kishte humbur dhe vetëdijen. Kishte të tjerë që, nga temperatura e lartë, i kishin bërë gjak grushtat, vetëm e vetëm që të mos nxirrnin zë.

Unë, që isha aq i durueshëm dhe nuk prekesha kolloj, tani, pas asaj që ndodhi e që dikush e quajti «be-teja e heshtjes», tek shikoja shokët e mi që kishin munduar vetveten për të arritur fitoren, mezi mbahesha. Edhe të sëmurë për vdekje, kishin bërë aq shumë për fitoren!

Kur partizanët e Baba Fajës i ranë kolonës matanë Qafës, ne ishim ulur në pyll dhe aty pritëm në gatisshmëri derisa ata u kthyen që andej. Gjermanët kishin pësuar humbje të rënda dhe, ashtu siç qenë, si ato bi-shat e gjakosura, kishin vazhduar rrugën për më tej.

Ne qëndruam në Martanesh dhe disa ditë dhe u nisëm vetëm pasi u siguruam se forcat e armikut kishin dalë nga krahina. Kësaj here e kishim pak më të lehtë, sepse veç kafshëve tona patëm dhe kafshë të tjera, që na i sollën partizanët e fshatarët e Baba Fajës.

Në këtë mënyrë i arritëm më shpejt shokët e divizionit dhe kjo qe fitorja e dytë që spitali ynë partizan shënoi atë vjeshtë, në vjeshtën e fundit të robërisë.

Kur Rizai e mbaroi tregimin, në dhomë po hynte mëngjesi i ditës së re. Në rrugë vazhdonte të dëgjohej zhurma e makinave që venin e vinin në minierë.

NJE LEGJENDË E KOHËS SONË

Natën e parë ajo na u duk mjaft e druajtur, ndonëse ne të shtëpisë përpiqeshim të tregoheshim të përzemërt dhe të lirë. Pothuajse nuk e hapi gojën fare, rrinte ulur buzë minderit, me shikim të shpërndarë dhe ngafërronte gishtat në gërshtetin e gjatë. Ndoshta dhe emrin e saj, Diella, nuk do ta kishim mësuar aq shpejt, po qe se nuk do të kishte hyrë në bisedë vajza jonë pesëvjeçare, Edita. Kjo e lehtësoi mjaft mysafiren e re dhe me fjalë të kursyera na kallëzoi se mësonte në qytetin tonë në një kurs për mami, ardhur nga një fshat i thellë i malësisë. Më pas, me givsmë zëri na pyeti dhe ajo, siç është zakoni, për emrin dhe punën që kryenim, po biseda mbeti me aq dhe ne, si hëngrëm darkë, ramë të flinim shpejt.

Të nesërmen nuk u pamë gjithë ditën. Vetëm në darkë u mblodhëm prapë në kuzhinë. Ajo prapë kishte ndenjtur buzë minderit, gishtat i ngatërronte nëpër gërshtetin e gjatë, po shikimin kësaj here e kishte të përmbledhur dhe dukej më pak e druajtur. Vajza jonë rrinte gjithë kohën pranë saj dhe jepte e merrte me të sikur të ishte njohur qyshkur. Unë e gruaja i vështrojmë tek luanin dhe herë pas here qeshnim tok me to. Fytyra e mysafires shkëlqente nga një gaz i përmbajtur. Ajo kishte një fytyrë çuditërisht të pastër e të bardhë, thuajse nuk e zinin fare rrezet e diellit. Nga trupi vinte e gjatë dhe e brishtë si pishë e re. Flokët e zinj e të

drejtë i lëshoheshin në të dyja anët dhe nga larg ngjanin të ashpër, po vetullat e holla i bënë një vijë të hijshme e delikate sipër syve të larmë. Rrobat i vinin pak të lira në trup dhe kjo sikur ndikonte në qëndrimin e saj. Në fillim ne nuk e kuptuam arsyen, po më vonë morëm vesh se Diella gjer pa ardhur në kurs, mbante veshjen e rëndë malësore. Ishte hera e parë që ajo vishesh si qytetare. Kështu mund të shpjegohej deri në një farë mase dhe shqetësimi që manifestonte ajo herë pas here, pasiguria dhe drojtja që rrethonte qenien e saj. Dhe neve të shtëpisë, tek e shihnim mysafiren ashtu, nuk na vinte mirë dhe donim si e si ta shpërndanim atë mjegull që ishte nderë në mes nesh dhe të afroheshim. Për këtë, deri diku na ndihmoi prapë vajza, e cila ia nxori, si të thuash, Diellës turpin me zor, herë duke i kënduar e recituar, herë duke i treguar lojërat e saj apo duke i thënë «sekretet» e shtëpisë. Nga kjo Diella tani e ndiente veten më mirë dhe filloi dhe ajo të kallëzonte për fshatin e saj të largët, për malet dhe pyjet, për kafshët e shpendët që jetonin atyre anëve. Edita sa nuk fluturonte nga gëzimi dhe, po të mos e çonim ne me zor për të fjetur, mund të rrinte gjithë natën me mysafiren. Kur binte ajo në gjumë, ne mbe-teshim vetëm dhe atëherë na duhej të bisedonim vetë. Më shumë, natyrisht, fliste gruaja. Me të ajo bisedonte më lirshëm. Pastaj, ime shoqe e ndiente për detyrë ta ndihmonte Diellën për gjëra që ajo s'i dinte. Bile ky është dhe qëllimi që organizata e gruas i kishte shpërndarë vajzat e kursit nëpër lagjen tonë.

Ime shoqe çdo natë përgatiste gjellën për të nesërmen dhe me këtë rast i shpjegonte mënyrën e të gatuarit, ose i tregonte për rregullimin e shtëpisë, po më gjatë ato u morën me të qepura. Diella e mësoi shpejt zanatin e të prerit e të qepurit. Gruaja i bleu dhe një basme të bukur dhe i preu një fustan të ri. Diella u prek aq shumë nga kjo gjë, saqë nuk dinte si ta tregonte mirënjohjen e saj. Bëri ç'bëri dhe natën e fundit, para se të largohej prej nesh, i solli Editës një kukull dhe ca ëmbëlsira. Dhe pikërisht natën e fundit

ne hapëm një bisedë që nuk e kishim hapur ndonjëherë. Dinim vetëm që Diella ishte e pamartuar dhe meqenëse nga natyra vinte e turpshme, nuk shtyheshim më gjatë. Po për çudinë tonë të madhe këtë muhabet ajo e hapi vetë dhe shkak u bë emisioni i radiopostës. Rrinim atë natë si zakonisht në kuzhinë, bisedonim e dëgjonim muzikë, kur papritur Diella u çua me vull nga minderi dhe ngriti zërin e radios. Kuzhina u mbush me tingujt e gëzuar të një kënge të re fshatare. Biseda që kishim nisur u pre menjëherë në mes. Vajza mbeti më këmbë dhe padashur lëshoi një thirrje të lehtë që nuk di si ta cilësoj. Ishte kjo një thirrje krejt e vetvetishme, që nuk e kishim dëgjuar ndonjëherë. Ajo në mënyrë të pandërgjegjshme po na zbulonte një anë të panjohur. Muzika po bënte atë që ne s'do ta kishim bërë dot. Gjithë kohën sa vazhdoi kënga neve na dukej sikur nuk merrte frymë. Sytë i kishin ndërruar ngjyrë dhe shkëlqenin nga një dritë e hareshme. Unë e ime shoqe bënim sikur dëgjonim këngën, po në të vërtetë vështronim Diellën e hutuar nga muzika. Ajo kishte harruar se ku ndodhej, na kishte harruar ne, me siguri kishte harruar çdo gjë. Gjithë jeta atë çast për malësoren e re ishte përmbledhur në atë këngë të thjeshtë, por kuptimplote. Ajo bënte fjalë për një vajzë që nuk mori burrin që i kishin zgjedhur prindët, po atë që kishte dashur vetë.

Ndërkaq, ne s'i hiqnim sytë nga Diella dhe erdhi një çast që dhe ne kënga na preku aq shumë, sa është vështirë të thuash se ç'bënim atë kohë; vështronim fytyrën e vajzës, apo dëgjonim këngën. Dhe nuk e teproj po të them se ato qenë shkrirë në një të vetme, sepse si pamja e saj ashtu dhe tingujt shprehnin të njëjtën gjë: gëzim, brengë e shpresë bashkë.

Kur kënga mbaroi, dhe kjo na u duk se erdhi krejt papritur, Diellës prapë i shpëtoi një thirrje e lehtë që përsëri nuk di si ta cilësoj. Ajo u kthye nga ne me një pamje të hutuar e plot turp, aq sa harroi të ulej. Ne i buzëqeshëm, po prapë dhe nuk ndiheshim të lirë si më parë.

Ime shoqe tha:

— Ulu, Diella, mos rri më këmbë.

Ajo u ul e bindur si fëmijë, ndërsa unë shtova:

— Këngë e bukur.

— Shumë e bukur! — ia priti vajza menjëherë, sikur ta priste fjalën time.

Papritur ra heshtja dhe të gjithëve na mbërtheu një ngathësi e çuditshme. Vështirë ta them se nga erdhi kjo. Ndoshta qe efekti i këngës, ndoshta për shkak të mirësjelljes sonë që pritnim vajzën të mernte veten.

Dhe vërtet, Diella dalngadalë sikur erdhi e u qetësua. Ngriti kokën, vështroi nga ime shoqe dhe buzëqeshi. Sytë i morën pamjen e parë. Ajo shikonte tani pa ndonjë gajle, sado që ne tërthorazi e ndienim brengën që e shqetësonte përbrenda.

Për herë të parë prita në heshtje të fliste Diella vetë. Ajo diçka donte të thoshte dhe kisha bindjen se do ta thoshte domosdo.

Nuk kaloj shumë dhe ajo, me një zë të pasigurtë tha:

— Thonë se janë të vërteta këto...

— Si?... — pyeti ime shoqe që ishte tërhequr shumë pas Diellës.

— Ja, këto që tregojnë këngët, — tha vajza.

— Ka shumë të ngjarë, — thashë unë. — Me këto mundësira që u janë krijuar vajzave sot, çdo gjë mund të ndodhë.

Diella mori zemër dhe sikur deshi të kundërshtonte një mendim që nuk ekzistonte, tha:

— Jo, jo, është e vërtetë. Unë e kam dëgjuar vetë sa herë.

— Çfarë ke dëgjuar? — u bë kureshtare gruaja ime dhe vajti e u ul pranë vajzës.

Atë kohë mbaroi muzika dhe unë mbylla radion. Diella nuk e priste si duket interesimin tonë, prandaj u step njëherë, po shpejt e ndjeu veten të çlirët dhe tha:

«Kjo që do t'ju them ka ndodhur me gjithë mend. Në fshatin tonë e kanë marrë vesh të gjitha vajzat. Nuk tallem, për besë. Thonë se kjo ka bërë vaki në një nga fshatrat e fushës. Në fillim nuk e besuam, sepse

aq e bukur është sa nuk të besohet, po kur e tregoi dhe Qibrija, (kjo është një vajzë nga qyteti që ka ardhur vullnetare në fshatin tonë) atëherë thamë se është e vërtetë. Lum ato që e rojtën dhe e gëzuan këtë histori, se ç'nuk bëhet sot për të mirën e vajzave!...

Diella mori frymë thellë dhe vështroi nga ne, me sytë që i vetëtinin. Ajo ishte me tërë mend e tronditur, po kjo qe një tronditje gazmore, që shfaqej jo vetëm në sytë e shkëlqyer, në zërin e butë, në lëvizjet e hirshme, po në tërë qenien e saj:

«Si ta tregoj unë historinë e atyre të dyve. Andej nga anët tona, kur shohim një thëllëzë që fluturon, themi: «Sa bukur!» Po vetëm kaq themi, po hë, tregoje, po deshe! Kështu dhe puna e atyre të dyve. Ai ishte ushtar dhe kishte ardhur me leje në shtëpi për t'u martuar. Ajo ishte në fshat, punonte në kooperativë. Thonë se i kishin fejuar sipas zakoneve të vjetra. Ishin nga një fshat, po s'kishin të drejtë as të takoheshin e as të flitnin. U bënë kësisoj dy vjet dhe gjithë bota kujtonin se kjo krushqi ishte lidhur me tërë mend si sa e sa krushqi të tjera. Po puna e tyre nuk u thur si e gjithë të tjerëve. Ajo në të vërtetë u shthur dhe u bë shumë mirë, sepse secili thuri fatin e vet, ashtu siç ia donte zemra. **Po dasma u bë, si i thonë fjalës,** me krushq e me aheng. Gëzuan prindët, gëzoi fshati, vetëm të zot e punës nuk u gëzuan. Të them që ua di emrin atyre, nuk ua di. Po prapë, në të rejat e fshatit u kemi vënë emër të ri, djalit Reshat e vajzës Merushe. Merushja thonë ishte e bukur shumë, e gjatë, me sy të mëdhenj sa një filxhan, disa duan të thonë se ishte dhe brigadiere në kooperativë. Reshati s'ishte i keq në të parë, po zemrën ama e kishte xhevahir. Kishte një shpirt nuk di si të them, edhe vëllai s't'u gjendka si të gjindet ai!

Thashë se u bë dasmë e madhe e këtë s'e them unë nga vetja, po e kam me të dëgjuar. Reshati na ishte djalë i vetëm po ca të tjerë duan të thonë se i vetëm nuk ishte, po ishte më i madhi i fëmijëve. Nejse... kjo s'don të thotë gjë, se fjalën e kisha gjetkë. Dasma zgjati

nuk di se sa, pastaj erdhi vakti t'i mbyllnin ata në një konak. Nusen e futën përpara, dhëndri vajti më pas. Njerëzia jashtë konakut bënë qejf.

Kur hyri ai brenda në konak, nusja rrinte ulur në fund të krevatit. Sipas zakonit, ajo duhej të ngrihej më këmbë, po ajo s'u ngrit. Atij kjo s'i pëlqeu hiç, po bëri sikur nuk e vuri re. Tha me vete: «mbase e ka nga turpi», dhe ndenji më këmbë para saj. Rrinte, rrinte e priste, po ajo jo vetëm që nuk u ngrit, po as kokën nuk e çoi. Atëherë, duan të thonë se ai e kuptoi se ajo diç kishte një hall, pa rrinte ashtu. I thotë ai:

— Ç'ke, moj, që rri kështu?!

Ajo flet sa po flitni ju tashti. Rri dhe ai një kohë e i flet, pret e pret po ajo e mban gojën kyçur. I thotë prapë ai:

— Ti, a ke gojë, ta marrim vesh? Thuaj një fjalë, se nuk u bë kiameti!

Po përsëri ajo nuk flet, veç kur papritur ia jep vajit. Qan e qan si fëmijë. Atëherë ai fillon t'i bjerë më të. Kishte një hall të madh në këtë mes. Mendon e mendon, po gjë nuk nxjerr me kokë të tij. I vete afër dhe pa e prekur me dorë i thërret në emër:

— Merushe, — i thotë. Ajo çon kokën, po në sy nuk e shikon. Ndenji kështu pa folur nuk di se sa, pastaj fshiu lotët dhe si e mori pak veten, thotë me pak zë:

— Më kanë marrë më qafë.

Kaq tha ajo, se e mbytën lotët.

— Si, si?! — çuditet ai — Të kanë marrë më qafë?!
Po kush të ka marrë në qafë?! Unë?!

— Jo, jo, — thotë ajo, — ti nuk ke faj. Fajin e kam vetë.

Ai atëherë e merr vesh se ku donte të dilte ajo e nuk priti më gjatë dhe i tha:

— Ma thuaj, si e ke hallin?

Ajo nuk duroi më, se mjaft kishte duruar, ndaj i hapet:

— Unë dua një tjetër. Tashti ti bëj ç'të duash!

Atij thonë sikur i ra shtëpia mbi kokë kur dëgjoji këto fjalë.

— Po cili është ai tjetri, a mund të ma thuash?

— Ta them, po të më japësh fjalën se nuk do t'i bësh gjë.

— E ç'do t'i bëj?! — thotë ai. — Unë jam ushtar!

— Ti ke pushkë, — i thotë ajo me zë të vogël.

Ai zemërohet nga këto fjalë dhe i thotë:

— Pushkën nuk e kam për ato budallallëqe që të shkon mendja ty, po për armiqtë. E more vesh? Po hajt më thuaj, kush është ai që do?

Ajo deshi s'deshi ia tha:

— Është Hasani i Kamber Calës në Zall-Drer.

Kështu duan të thonë se i thoshin atij. Reshati, sapo i dëgjoi, nuk pyeti më gjatë, po i tha vajzës të mbathte këpuçat. Ajo nuk po e merrte vesh, atëherë ai ia thotë shqip:

— Ngrehu të shkojmë në shtëpinë e Hasanit.

As ajo nuk e mori vesh se si u bë gati, si u hodhën nga dritarja e konakut, si kapërcyen gardhin e morën rrugën për në Zall-Drer. Dasma s'kishte sosur, sazet binin akoma.

Fshati i Hasanit thonë nuk ishte afër. Do të kapërcije gjer një mal, pa të arrije gjer atje. Disa thonë se ai ecte përpara e ajo i shkonte pas, po të tjerë tregojnë se ata nuk e kishin për gjë t'i jepnin dorën njëri-tjetrit kur u dilnin pengesa përpara. Thonë se atë natë hëna ishte e plotë. Merushja e shikonte hënën dhe i vinte t'i fliste. Zemra përbrenda i qe bërë lëmsh. Si do t'i vinte filli kësaj pune që kishte nisur? Si do ta priste ai tjetri?

Kur vajtën në Zall-Drer mezi e gjetën shtëpinë e Hasanit. Ajo e dinte, po i vinte turp t'ia thoshte. Ai s'e dinte, po s'e kishte kollaj ta pyeste. Ia kishte treguar bariu i kooperativës që po nxirrte bagëtinë. Nata atë kohë ishte në të thyer. Shtëpia e Hasanit kishte qenë fare afër dhe ata i binin rrotull si kali në lëmë.

Ai kishte vajtur te gardhi dhe i kishte thirrur të zotit të shtëpisë. Thirr e thirr gjersa kishte dëgjuar dhe kishte dalë në dritare. Pastaj kishte zbritur me kandil në oborr. U kishte dhënë dorën, po për t'i njohur s'i

kishte njohur. Merushja mezi rrinte më këmbë, dridhej si fletë plepi, Reshati, thonë, nuk e kishte bërë veten fare. As kur kishte dalë Hasani. Bile Hasani s'u kishte besuar syve kur kishte parë Merushen në dritën e kandilit. Aq shumë e kishte humbur pusullën, sa nuk kishte folur asnjë fjalë për be.

— Hë, — thotë xha Kamberi, — ç'e mirë ju solli në këtë orë?

Ushtari, thonë, ishte treguar prapë burrë e s'kishte dashur fare t'ia dinte.

— Na fal, o xha Kamber, — thotë ai, — që ta pri-shëm gjumin, po gëzimi na pruri gjer këtu.

— Gëzim paçi, mor bir, — thotë plaku.

Ai ia kishte thënë bram menjëherë:

— Të kam sjellë nusen e Hasanit!

Plaku kishte luajtur nga vendi e sa s'i kishte rënë kandili nga dora.

— Po, po, nusen e Hasanit, — i thotë prapë ai dhe ia tregon pastaj historinë pikë për pikë.

Plaku e dëgjon dhe s'u beson veshëve dhe syve. Dëgjon dhe Hasanin aty pranë dhe i ngjan vetja si në ëndërr.

Merushja rri kokulur dhe ku nuk i vete mendja. Po sikur të mos dojë plaku? Po sikur të mos pranojë Hasani, se nusja vinte nga shtëpia e dhëndrit dhe jo nga shtëpia e saj?

Si e dëgjon deri në fund tërë historinë, xha Kamberi e pyet të birin:

— E vërtetë është kjo që thotë ky miku?

— E vërtetë, — thotë Hasani.

Xha Kamberi shikon vajzën në sy, shikon dhe mikun dhe sado që nuk i pëlqen tërë ajo që i dëgjojnë veshët, thotë:

— Kur qenka kështu, nuk kemi se ç'bëjmë. Se këto punë e kanë ndryshe. Po këtë punë që ke bërë ti, nuk e ka bërë njeri, mor bir. Unë për vete s'e bëja dot.

Reshati nuk flet, vetëm sa i qesh pak buza. Ata të dy aty pranë rrinë si pisha të ngrira në mes të oborrit.

Po historia nuk mbaroi me kaq. Plakut s'i hiqet nga mendja ajo që bëri ai ushtari dhe duan të thonë se pas muhabetit në oborr e kishte futur brenda, kishte zgjuar

gjithë njerëzit e shtëpisë dhe si që gdhirë mirë, kishte shtruar rakinë e kishin ardhur pastaj dhe fqinjët. Xha Kamberi kishte ngritur dollinë i pari:

— Dëgjo, more djalë, — dhe kishte përsëritur atë që i kishte thënë në oborr, — këtë që bëre ti, nuk e ka bërë njeri. Ne pleqtë nuk i honepsim kollaj këto, po riria fiton sot dhe fitoftë gjithmonë.

Dhe si e kishte përqafuar ushtarin, i kishte thënë një fjalë që ai s'e kishte pritur:

— Ti, mor djalë, më fute në një borxh të madh, që nuk di si të ta laj. Kam tri vajza. të tria për te burri. Ti shikoi dhe zgjidh një! Si thua?

Ushtari kishte qeshur. Kishin qeshur dhe Hasani me Merushen.

— Faleminderit, xha Kamber, po nuk ta plotësoj dot se u dogja një herë e kam frikë se mos më ngjasë prapë si me nusen e parë.

— Këtu s'fole drejt, o baba, — që hedhur Hasani, dhe për herë të parë që shikuar në sy me Reshatin.

Plaku nuk që ndër më, po derisa kishte ndejtur mi-ku, dorën s'ia kishte hequr nga krahët.

Thonë se kur kishte marrë të ikte Reshati, Merushes, tek i kishte dhënë dorën, i kishin shpëtuar lotë nga sytë. Hasani e kishte përqafuar si vëlla dhe e kishte përcjellë deri në të dalë të fshatit të tij.

Kështu është historia e atij ushtari. Dhe kjo është e vërtetë, po se ku ka ndodhur tamam, nuk di t'ju them, as vajzat e kursit tonë, që e kanë dëgjuar të gjithë këtë histori nuk e dinë vendin.

Sa herë them, ah, sikur të nxjerrin për këtë një këngë të bukur! Pse, a nuk e meriton një këngë si ajo që dëgjuam, ai ushtari?»

Ne atë natë fjetëm vonë, biseduam e diskutuam s'iatë dhe nuk na u hoq nga mendja ngjarja që na tregoi Diella.

Të nesërmen, kur u gdhi, mysafirja na u duk edhe më e afërt, po kjo nuk zgjati shumë, sepse atë ditë ajo u largua për në fshatin e saj dhe që atëherë nuk jemi takuar më. Po megjithatë, mund të them se nuk e kemi harruar, as unë, as gruaja, as vajza. Dhe për këtë na

ndihmon ai kujtimi i bukur që ajo na la natën e fundit. Na duket se në tregimin e saj janë përmbledhur shumë nga ato ëndrra e dëshira të zjarrta që zgjon te vajzat e reja jeta jonë.

Prej asaj nate kanë kaluar shumë kohë e megjithatë mua e sime shoqeje, sa herë flitet për vajzat e fshatit na vete mendja përnjëherë te Diella. Na pëlqen të mendojmë dhe jo pa arsye, se edhe ajo do t'i ketë hyrë me guxim rrugës së jetës, për ta ngritur lumturinë e saj ashtu si njerëzit për të cilët na tregoi.

NË MES TË TË GJALLËVE

Nënës Katerina Bego

Udhëtonim me kamionin e ekspeditës sonë nga malësia për në qytet. Isha unë, inxhinier Gaqoja dhe shoferi. Ata të dy rrinin përpara, kurse unë, si më i ri, kisha zënë vend prapa, në karroceri. Rrija gjysmë i shtrirë sipër ca thasëve të mbushur që kishte hedhur aty magazinieri i ekspeditës. Nuk e di, po këtë udhëtim e kisha marrë pa qejf. Kjo vinte ndoshta ngaqë kohët e fundit kisha udhëtuar shumë dhe rruga që do të bënim ishte e largët. Pastaj, isha i detyruar të udhëtoja pothuajse vetëm, në një ditë të freskët vjeshte, me mendjen gjithnjë te puna që kisha lënë përgjysmë.

Ishim nisur që pa gdhirë dhe dielli na zuri në udhë e sipër. Rruga kalonte nëpër shtigje malesh e pyjesh, zbriste në fusha e lugina, që unë i kisha përshkuar kusshedi sa herë. I njihja këto vende mirë, i dija me emër grykat e qafat, kisha qëndruar pothuaj në çdo fshat e nuk më bënin më përshtypje pamjet që dukeshin dhe zhdukeshin para syve të mi. Makina ecte me të shpejtë dhe rruga humbiste nën rrota. Unë s'kisha ç'të bëja dhe kohë pas kohe shikoja nga dritarja e pasme e kabinës. Shikoja herë hundën e gjelbër të makinës, që çante përpara, herë Hasanin tek shtrëngonte fort timonin, me një bisht cigareje në këndin e buzëve; herë inxhinier Gaqon kokulur, që lexonte një libër të trashë. Po ndodhte që

harrohesha dhe, kur përmendesha, më dilte përpara xhamit vetja. Atëherë shikoja fytyrën time të lodhur e të vrarë nga pagjumësia, mustaqet e holla, kasketën e zezë të rrasur deri në vetullat.

Hasani e ngiste makinën me të madhe dhe këtë e ndieja nga era që më fishkullonte egër në vesh. Para xhamit uleshin e ngriheshin duar fshatarësh, që pritnin në rrugë dhe fill pas tyre dukej kurrizi i dorës stërmadhe të Hasanit. Kjo do të thoshte se makina jonë nuk ndalonte gjëkund. Atëherë fillova të mërzitesha. Më vinte t'i thërritja Hasanit që ta ndalonte makinën dhe të merrte ndonjë udhëtar. Të kisha të paktën një shok rruge. Me siguri nuk do ta ndieja aq të gjatë rrugën. Po me sa shihej, rasti më kishte dënuar që atë ditë të udhëtoja fill vetëm. Hasani as që kishte ndër mend të qëndronte e të merrte njeri. Si ai dhe inxhinieri donin të arrinin sa më parë në qytet. Inxhinier Gajoja kishte një mbledhje të rëndësishme dhe kërkonte patjetër të arrinte në kohë. Hasani, porsa qe fejuar dhe e kishte mbushur muajin këtyre maleve, pa zbritur në fushë. Kështu që unë pak nga pak e humba shpresën. Atëherë, ç'të bëja? Ndava mendje të filija dhe mbështeta kokën te thasët që kisha përçark, Nuk di sa fjeta, veç kur u zgjova papritur. Ndjeva frenat e forta që stopuan rrotat e pasme dhe trupi më shkoi i tëri përpara. Hapa menjëherë sytë dhe u ngrita përgjysmë. Rruga gjarpëronte para meje e shkretë, bri një kodre shkëmbore. Dëgjova të përplasej vetëm dera e kabinës. Hasani zbriti dhe mori nga prapa. Pashë që tundi dorën e djathtë lart dhe pastaj dëgjova që thirri:

— Hajde, Teto, hajde!

Padashur u bëra kureshtar. U çova flakërim më këmbë dhe vështrova rrugën që kishim lënë prapa. Një fshatar me bustinë ushtarake në kokë dhe me një bohçe në duar vinte në drejtimin tonë. Pas tij ecte nxitimthi një grua, që s'ja shquaja dot fytyrën. Të dy të panjohurit u afruan dhe i dhanë dorën Hasanit. Hasani buzëqeshte tërë përzëmërsi, tamam si ai i zoti i shtëpisë që del e i pret miqtë te pragu i derës. Gruaja ishte një plakë e imtë nga fytyra dhe trupi, me shtat çuditërisht të drejtë, veshur si

qytetare, e me shami të zezë hedhur kokës. Ai, një burrë i ri, i gjatë, me rroba shajaku, me një palë mustaqe të hijshme, që të kujtonte komisarët e luftës. Unë rrija më këmbë, sipër në karroceri dhe vështroja i heshtur. Fshatari, që mezi merrte frymë nga të rendurit, tha:

— Do e marrësh një çikë, o shoku shofer, Teto Gjenën në gjer në qytet?

Hasani, në vend që t'i përgjigjej, nxori paqetën dhe ia zgjati përpara. I panjohuri u hutua. Shoferi ktheu kokën nga unë dhe më shkeli syrin;

— Na ndize njëherë, pa për Teto Gjenën mos u bëj merak.

— Hëë, të falem nderit, o byrazer, — ia bëri i panjohuri, — se helbete, grua e shkuar e nuk ka takat të ecë.

Fytyra e fshatarit tani u çel, dhe sytë e gëzuar i lëviznin sa nga shoferi, sa nga gruaja. Por plaka, tek rrinte mes dy burrave të gjatë, sikur s'e vinte re gëzimin e fshatarit. Shikimi i saj i qe ngulur shoferit. Mua më dukej sikur e kishte hutuar bujaria e tij e papritur, po kjo nuk zgjati shumë, sepse plaka, pasi e kundroi mirë Hasenin, u kthye nga ai dhe gati sa s'thirri:

— Mos je Hasani i Mahmudesë ti, mor bir? Po fol, de, të shkretën, fol. Unë thashë se kush është ky. Ti qenke Hasani! Po e di që s'të njoha fare?...

Hasani qëndronte tani kokulur, si një fëmijë e drujtur, ndërsa plaka zuri të fliste lirisht. I tha se kishte dalë në xhade që menatë dhe tërë mëngjesin nuk qe dukur një makinë për be. Pastaj shtoi me keqardhje :

— E lashë dhe Veliun pa punë, pa lëre të tjerat. Fshatari ja priti menjëherë:

— Mos e thuaj atë fjalë, Teto, po thuaj shyqyr që na u gjet ky shoku që e njihke dhe të njihka, se do të mbeteshim këtu gjithë ditën. Kështu e ka kjo e flamosur rrugë, veç kamionëve të ekspeditës zor se kalojnë të tjera. Jemi larg nga qyteti, o byrazer...

U hap një bisedë e shpejtë për rrugët e makinat dhe pastaj Hasani u kthye nga plaka. Unë gjithnjë rrija majë kamionit dhe dëgjoja:

— Po ti, Teto, ç'do këndeje maleve? Mirë ne, na e kërkon puna.

— Kam Kolin këndeja, mor bir! — ja ktheu plaka, duke parë nga fshatari.

— Kolin?! — pyeti i habitur Hasani, duke lënë pa thithur cigaren. — Pse, këndeje e ke akoma? Nuk e ke prurë në qytet?

Teto Gjena vështroi prapë fshatarin. Shikimi i saj diçka desh të thoshte, po unë nuk kuptova gjë.

— Këndeje e kam, këndeje, — tha ajo e menduar. — Po s'ma lënë këta të fshatit ta marr. Ja, Veliu, kryetari e ka në dorë. Po të dojë ai, e bie afër!

Hasani ngriti sytë, i habitur nga unë. Unë padashur ngrita supet. Nuk mora vesh se ç'pati ai që më shikoi ashtu!

— Koli s'është vetëm yti, Teto — dëgjova të thotë ai burri që e quanin Veli. — Është edhe i fshatit.

— Ashtu, mor bir, ashtu është, si thua ti. Po tashti u plaka dhe dua ta kem pranë.

Ndërkaq unë, padashur, tek rrija ulur në bisht të karrocerisë, zura të arsyetoja me hamendje. Dëgjoja dhe me zemër i jepja të drejtë plakës. Ajo thosha me mendjen time, do të qe nëna e ndonjë mësuesit që punonte prej vitesh këtyre anëve dhe fshati s'donte t'ia lëshonte. Plaka, që ndoshta e kishte të vetëm atë djalë, kishte ardhur si dukej t'i lutej kryetarit të këshillit që ta merrte të birin në qytet. Dhe me sa dëgjova, Veliu nuk donte t'ia linte dhe kjo, për shkak, mendoja unë atë çast, sepse shkolla i shkante mbarë dhe kryetarit nuk ia kishte qejfi t'i nxirrte vetes telashe duke marrë një mësues të ri. Po megjithatë plaka nuk hiqte dorë nga e saja dhe vinte kohë më kohë e i lutej Veliut.

Ja, dëgjoj kryetarin që i thotë, me një buzëqeshje që mua më duket e çuditshme;

— Mirë, teto, s'ta prishim qejfin. Po ne u mësua me të. Bile, po më pyete mua, ai te ne e ka vendin...

Plaka nuk foli. Papritur u ndër një heshtje e rëndë. Unë këtë e ndieja mirë, sado që unë isha lart, e ata poshtë në xhade. Asnjërit, me sa dukej nuk i jepej të fliste.

Nuk foli as Hasani, për çudi. Atëherë u mata unë t'i thosha fshatarit: «O shoku kryetar, mos e mundo a derëbardhë, këtë plakë të mirë. Lërja djalin!», po zëri i inxhinier Gaqos nuk më la. Ai i fshirri Hasanit dhe hesh-tja e rëndë u prish menjëherë.

— Erdha, inxhinier, erdha!

Hasani iu afrua kabinës, po atë kohë inxhinieri zbriti me librin nën sjetull dhe përshëndeti me kokë të panjohurit. Dëgjova Hasanin që tha me zë të ulët:

— Inxhinier, po shkon ti prapa?

Gaqoja tundi kokën, pa thënë asnjë fjalë. Unë mendova: «Çudi, e pashë edhe Hasanin njëherë të vihet në telashe për pasagjerët».

— E, byrazer, ta hipim tani teton? — pyet fshatari, që rrinte si i ngulur në një vend bashkë me plakën.

— Teto Gjena do të hipë përpara, — tha Hasani me zë të lartë e të prerë.

— Përpara the?! — u habit fshatari dhe pa menjëherë nga inxhinieri. Gaqoja në këtë kohë që larguar ca nga makina dhe kundronte vendin përçark. Plaka rrinte si e hutuar dhe, kur Hasani e ftoi përpara në kabinë, ajo ia preu me zë të lartë:

— Jo, të keqen, hyp prapa unë, brenda nuk e duroj dot erën e benzinës. Lëre djalin atje, se po mëson. Behar është sot, nuk ka gjale!

Gaqoja dëgjoi fjalët dhe u kthye nga ne:

Nënë, urdhëro përpara, të lutem...

— Jo, jo, shiko punën ti. Nëna e ka vendin prapa, bukuri.

Hasani u afrua ta merrte për krahu, por ajo zgjati duart e saj të shkurtra nga karrocëria, si një fëmijë dhe i lutej fshatarit:

— Veli, më ngri një çikë, mor bir.

Në këtë kohë, padashur u futa dhe unë në valle. Po nuk dija ç'të bëja: anën e kujt të merrja? Për mua s'kishte rëndësi se kush do të më vinte sipër. Njësoj ishte, si ajo plakë, që s'e njihja fare, si inxhinier Gaqoja, që rrugës s'e ke për muhabet. Ai ka shok vetëm librin.

Thashë:

— Teto, shkoni më mirë përpara.

Po ajo, ndërkaq kishte zgjatur duart drejt meje dhe me një rën këmbë mbështetur te rrota qëndronte gati havadan. Atëherë unë u zura ngushtë. E kapa menjëherë për duarsh dhe tek e tërhiqja m'u duk sikur plakës i kërceu shtati i hollë e delikat. Po ajo s'donte t'ia dinte: i jepte trupit lart dhe veç kur u gjend ulur mbi thasë. Të tre burrat poshtë shikonin nga ne, pa bërë zë. Plaka tha e kënaqur:

— Mos më ngani tashti. S'ka ku të vejë më mirë Hasan, nise!

Hasani nuk u përgjigj, po u fut në kabinë. Inxhinier Gajoja para se të hipte i tha plakës:

— Nënë, s'e bëtë mirë kështu.

Fshatari na dha dorën të gjithëve.

— Udhë e mbarë dhe mirë ardhsh, teto!

Plaka u kthye mbarë nga ai dhe filloi t'i jepte porosi, me një ton familjar, që mua prapë më tërhoqi vëmendjen.

— More vesh, dërgoma me domosdo nusen javën tjetër, përndryshe nuk të shkel më në shtëpi.

Unë sërish dëgjoja dhe sikur ngatërrohesha më keq. Aty për aty fillova të arsyetoj: «Kur paska kaq afërsi, atëherë si nuk ia lëshon të birin?!»

Hasani nuk u ndje më, veç kur përplasi derën e kabinës.

Kur makina mori udhë, fshatari qëndroi në vend dhe tundte në ajër një shkop të gjatë. Plaka mbeti me sytë nga ai, gjersa kamioni ynë u fut në një kthesë dhe Veliu humbi prapa kodrës. Dalngadalë në fytyrën e saj gazi i lehtë erdhi duke u shuar ndërsa rrudhat iu shtuan. Pastaj plaka u kthye e tëra nga unë dhe, duke më vësh-truar përmes syzeve të saj, më tha:

— Të shtrëngova dhe ty, mor bir!

Unë buzëqesha, po s'më jepej t'i përgjigjesha. Kamioni prapa qe fare bosh. Vetëm ngrita ca thasë që t'i bëja një vend afër meje. Ajo, si u rehatua mirë, rregulloi shaminë në kokë dhe mori frymë thellë. Era përçark jehonte me një kumbim të çuditshëm. Nga fytyra iu zhduk gjallëria e parë. Këtë e vura re mirë, se ajo ishte kundruall

meje, me kokën gjithnjë lart. Të them të drejtën, nuk kam parë plakë të moshës së saj që ta mbajë kokën ashtu lart, si ajo. Sytë i kishin mbetur si të ngrira, nga ana e malit të Leshanit. S'di, po mua më shkoi mendja përnjëherë tek i biri. Ndoshta, ai punonte në ndonjë nga ato fshatrat, atje përtej, mes malesh, prej të cilave ne po largoheshim gjithnjë e më shumë. Atëherë, sepse më dhimsej ajo plakë e mirë.

Mendoja sa gjë e madhe është dashuria e nënës.

Po, ndërsa më vërtiteshin në kokë këto mendime, makina jonë i kishte rënë përçark brezit të malit të Sukut dhe po kalonte nëpër Luginën e Luleve. Ne akoma nuk kishim shkëmbyer ndonjë fjalë. Mua më vinte keq ta trazoja tek rrinte ashtu e menduar. Hasani përpara lëviste, me të dyja duart timonin dhe herë pas herë kthente kokën nga ne.

Unë rrija i menduar, kur era më solli në vesh fjalë të tjera:

— Me Hasanin e ke punën dhe ti, mor bir?

Unë iu afrova.

— Po, me Hasanin. Kërkojmë mademe këtyre ma-
Ajo ngriti zërin dhe unë dëgjova qartë:

— Punë të zorçme kini, po me shëndet njeriu i kalon të gjitha.

I thashë:

— Të zorshme pak, se bredhim maleve, po është e bukur...

Plaka e la bisedën me kaq. Pas një grimë here veshi më kapi, kalimthi, një psherëtimë të lehtë, që mezi e shquajta nga era. Pastaj ajo tha:

— Kështu ka bredhur dhe ai imi, më këmbë, këtyre anëve.

— Pse, ke ndonjë djalë këndeje? — e pyeta me kast për t'u dhënë fund dyshimeve që më qenë grumbulluar.

— Kam Kolin, mor bir, djalin e madh!

— Ai që kini tek Veliu?

— E kush tjetër! Atij i kanë rënë këmbët nëpër këta gurë!

Me sa dukej djali i saj nuk qenka mësues, si pande-

ha unë. Do të ketë punuar edhe ai me ndonjë ekspeditë, sepse ekspeditat tona kanë vite që sillen këtyre anëve.

— Me cilën ekspeditë ka punuar? — i thashë.

— Me atë të Llazit..., — m'u përgjigjajo pa u menduar

Përnjëherë unë solla ndër mend me radhë shokët e qendrës sonë gjeologjike dhe m'u kujtua inxhinier Llazi.

— Mos ka qenë me Llazi Koçin? — e pyeta.

— Jo, jo, me Llazi Shukun, është vrarë, dimrin e madh.

Prapë u ngatërruam dhe nuk po merreshim vesh. Ajo fliste për një Llazi që qe vrarë, unë për Llazin tonë, inxhinierin e ekspeditës së tretë.

U përpoqa të sqarohem. Kujtoja se e ka fajin era, që s'po kuptoheshim dhe e pyeta me zë të lartë:

— Ç'punë bënte Koli këndeje, teto?

— Partizan, mor bir, ç'punë mund të bënte ai asokohe këndeje!

Unë hapa sytë dhe i thashë i habitur:

— Partizan! Po ashtu thoni, se nuk po ju kuptoja.

— Po nëna ta tha. Ka qenë me çetën e Llazit. Një Llaz ka pasur atëherë këtyre maleve. Ai ishte komandant me nam!

— Po tani ku e ke djalin?

— E ku ta kem tjetër, në Lezhan, te Veliu.

Zëri i plakës më tingëllonte i zvergur, po megjithatë nuk ia vura veshin kësaj gjëje. Nisa të mendoj sërish për fatin e birit të saj.

— «Çudi», — thashë me vete, po ndërkaq më i çuditshëm po më dukej vështrimi i saj prapa syzeve që vetëtinin sikur t'u kishte rënë një rreze dielli. U stepa një çast dhe thashë vetëm kaq:

— Si i paska qëlluar të punojë këndeje, edhe gjatë luftës, edhe tashti?

— Po mbeti, mor bir, që atëherë kur hyri Partia dhe nuk e mora që s'e mora. Ç't'i bëja fshatit!

Unë u lëkunda tani në mes keqardhjes dhe habitës.

— Shumë larg e keni djalin. Mundoheni deri këtu...

— Po ç'të bëj, më mundon malli, pa s'e merrja gjithë këtë udhë...

E pyeta:

— Po pse nuk vjen djali më shpesh në shtëpi?

Ajo çapëloi sytë dhe lëvizi nga vendi:

— Cili djalë?

— Djali juaj, Koli, që keni në Lezhan?

Plaka kafshoi gishtat dhe tha me zë të lartë:

— Po ai ka vdekur, mor bir!

— Ka vdekur?! — ia prita unë me zë të lartë.

— Po! — tha pastaj nëna e qetë. Dhe heshti, sikur të kishte thënë një gjë të zakonshme, kurse unë rrija me gojë të hapur, duke e vështruar i habitur.

— Po që kur kështu?

— Ohu... u bënë mote plot që m'u rrëzua e s'u ngrit më, trimi i nënës... **Ja fala Partisë**, se kjo Parti me djemtë e nënave mbahet e përparon... Koli, atëherë, vërtet u vra, po bëri borxhli një fshat të tërë. Ishte kumandar i një tabori me **partizanë dhe sëra** ia solli që të shpëtonte Lezhanin nga gjermani. Tabori i tij, dhe ai tok me ta, nuk e lanë gjermanin të hynte në fshat. Shpëtoi fshati, shpëtuan fëmijët e gratë. Në Lezhan ai ishte bërë i shtëpisë. E njihnin dhe fëmija. Kjo mesele ka shumë vjet të shkuar. Si zbritën atëherë çunat nga malet dhe zunë t'i mblidhnin një nga një tërë jetëshkurtrit, erdhën këta të Lezhanit në shtëpi dhe ma kërkuan. Më thanë se ti e ke djalë, po edhe ne djalë e kemi. Ai ka bërë shumë për ne, prandaj të na e japësh, pa derman. Do ta mbajmë tok me djemtë e fshatit, më thanë. Unë u mendova dhe thashë me atë timen: Arbëri këtu, Arbëri atje, njësoj është. Po ku ia dinë më shumë, ku më ka çuni me shumë nder? U mendova dhe s'e bëra të gjatë. Mbajeni, ju goftë falë, — u thashë dhe s'e ngava më. Fundi, në dhë të vatanit është.

Më dukej, tek fliste ashtu, sikur po më ngushëllonte ajo mua, në vend që ta ngushëlloja unë. Zëri i saj pa asnjë luhatje, ai vështrim vetëtitës i syve, ajo qetësi e madhërishtme, sikur e shndërronin Teto Gjenën në mendjen time në njeri tjetër. Pata harruar tashmë se ajo ishte plaka e panjohur, që hipi rastësisht në kamionin tonë...

BREDHI I BARDHË

Shoku im K. më tregoi:

Ekzistonte ndonjëherë mendimi sikur puna jonë kryhej në një rreth të mbyllur, nga njerëz të veçantë, brenda disa cazeve të rrepta. Natyrisht, ky është një përfytyrim i gabuar, për më tepër i huaj, se karakteri i detyrës sonë ndryshon krejt nga ajo e armiqve. Tanimë është bërë një praktikë e zakonshme që punët tona nuk mund t'i kryejmë pa ndihmën e njerëzve. Dhe këtu, s'është fjala për disa njerëz, po për qindra e mijëra të tillë, që ndërgjegjja qytetare i lidh e i bashkon orë e çast me ne. Është fjala për tërë popullin. Dhe populli është si ai kolosi i gjallë që nuk e duron të keqen në trup të tij, po shqetësohet dhe kundërvepron menjëherë.

Ne, sado të pregatitur të jemi, sado fantazi të kemi, sado që të punojmë, prapë s'mund të arrijmë atë që bëjnë qindra e mijëra njerëz veças ose tok. Ky është çelësi i të gjitha enigmave të përditshme, me të cilat është mbushur puna jonë. Zakonisht e nisin vetë njerëzit që s'punojnë te ne dhe çështja kalon si stafetë dorë më dorë, deri sa arrihet qëllimi. Ne vetëm organizojmë dhe drejtojmë.

Ndodhi njëherë kështu:

Një mëngjes herët punëtori Skënder L. po shkonte si zakonisht për në punë. Ecte më këmbë, nëpër rrugën që vjen paralel me bregun e liqenit. Ai punonte në një ndërmarrje jashtë qytetit dhe këtë rrugë e bënte përditë. Ecte i shkujdesur, me merakun që të arrinte në kohë. Po atë ditë, tek vështronte nga liqeni, padashur i tërhoqi vëmendjen një varkë që lëkundej lehtë mbi valët e mëngjesit. Varka ishte fare bosh dhe, sidoqë ai qëndroi në vend dhe shikoi me kujdes, nuk i zuri syri ndonjë njeri në të. Ndërkaq, era e veriut e shtynte varkën gjithnjë e më tutje në thellësi të liqenit. Kjo pamje jo e zakonitë e bëri të mendohej. Thua ta kenë harruar peshkatarët pa lidhur? Po ai e dinte sa kujdesen peshkatarët për varkat e tyre. Të jetë shkëputur vetë? Edhe kjo s'ishte për t'u besuar: nata e kaluar kishte qenë e qetë, pa erë e pa dallgë. Atëherë Skënderi nuk humbi më kohë me arsyetime, po vajti në breg, u zhvesh me të shpejtë dhe u hodh në ujë. Ishte ditë dhjetori dhe ai burrë shëndetpakët mezi e çante ujin e ftohtë. Varka që larguar goxha, po kjo s'e pengoi atë ta arrinte e ta kapte. Duke notuar me një dorë, ai e shtyu varkën derisa e afroi në breg. Pastaj, me shumë mundime e nxori nga uji dhe e përmbysi sipër disa shkurreve, duke fshehur poshtë varkës dhe një lopatë që gjeti më të.

Punëtori u vesh dhe mori prapë rrugën për në qytet. Fundi, mungesën në punë do ta justifikonte. Atë e shqetësonte seriozisht një dyshim.

Ai erdhi drejt e në zyrën time. Ne nuk njiheshim dhe s'ka si të njiheshim. Në zyrat tona hyjnë e dalin me dhjetëra njerëz të panjohur në ditë.

Ai foli shkurt, tregoi ç'i kishte ndodhur, ç'kishte bërë dhe paraqiti dyshimet e tij. Unë, si zakonisht në këto raste, e dëgjova me vëmendje, mbajta shënime të hollësishme. Para se të largohej ai tha se ishte gati të ndihmonte prapë në rast nevojë.

Kur qytetari Skënder L. mbylli derën, unë mblodha dekumentet dhe, pa humbur kohë, u ngrita e vajta i raportova shefit tim.

— Po, — më tha shefi, — tani sapo na njoftoi njësi-ti kufitar i postës R. Gjatë kontrollit të mëngjesit është gjetur në bregun e djathtë një varkë hedhur mbi shkurre...

«Të dhënat qëkan njëlloj, — mendova. — Qytetari ka arritur në kohë».

Pastaj ne heshtëm, duke qëndruar ballë njëri-tjetrit. Shefi vështronte nga dritarja që binte nga ana e liqenit e hërë pas here thithte cigaren. Për ne, që punonim me të. kjo pamje kishte kuptim të qartë: çështja ishte shumë e rëndësishme dhe meritonte vëmendje të madhe. Në këto raste, ai nuk dinte të mendonte gjatë. Shefi ynë vendoste në çast e në veprim e sipër lindnin dhe mendimet...

— Mirë, — foli ai, si me vete. — Tani merr grupin operativ dhe shko në vend!

3

Grupi hipi në makinë dhe ajo mori drejtimin nga bregu i djathtë i liqenit. Mua akoma më vërtitej në kokë pyetja: ç'mund të ishte ajo varkë e braktisur, disa qindra metra larg kufirit?

Kjo pyetje s'm'u nda gjatë tërë rrugës.

Zbritëm nga makina dhe u drejtuam për në vendin e ngjarjes. Varkën e gjetëm mbështetur mbi disa shkurre të dendura. E kundruam me kujdes e pastaj e kthyem mbarë. Para nesh ishte një varkë e rëndomtë, e ndërtuar rishtazi, e lyer me bojë të bardhë, me përjashtim të fundit të saj që ishte në ngjyrë gri. Në të dy krahët e varkës qëndronin dy doreza, lyer dhe këto me bojë të bardhë. E kontrolluam më pas me imtësi se mos gjenim ndonjë send apo ndonjë gjurmë, po s'doli gjë. E vetmja provë materiale, veç varkës, ishte lopata. Me vështrimin e parë vumë re që ajo s'ishte lopatë e zakonshme vozitjeje, po

lopatë lëmi, nga ato që përdorin fshatarët kur shijnë grurë. Qe punuar trashë dhe në dy vende, ndonjë metër larg njëra-tjetrës, ishte ngrënë e gërvishur.

«Si duket, me këtë lopatë, — mendova atë çast dhe e mora atë në dorë, — e kanë bartur varkën deri këtu!»

Shokët e grupit gjithë vëmendjen e tyre e përqëndruan në disa gjurmë që kishin mbetur në sheshin përgjatë bregut. Njëpër rërën e lagur dukeshin qartë gjurmë këmbësh të huaja e vende-vende shenja të varkës, të cilën, siç dukej, e kishin zvaritur, kishte shumë të ngjarë, nga sa tregonin gjurmët, që të panojhurit të qenë nxituar tepër në veprimet e tyre. Ne fotografuam gjurmët gjer në një farë vendi, se më tej ato humbisnin njëpër gëmushat e shkurret, në largësi të gjolit. Kështu që na u desh të thërritnim në ndihmë Jankën, qenin e grupit. Janka i nuhati shpejt gjurmët dhe pasi kapërceu zonën e shkurreve, doli në rrugën automobilistike. Këtu, ai u vërtit sa andej-këndej, sepse terreni ishte i fortë dhe gjurmët e të paniohurve ishin prishur nga lëvizjet e ditës. Megjithatë, qeni shkoi më tutje dhe, ne, duke vajtur pas tij, u gjendëm në një qendër të banuar. Aty ishin oficina e ndërmarrjes gjeologjike, fjetorja e punëtorëve, magazinat dhe disa shtëpi banimi.

Janka u soll disa herë vërdallë, e pastaj, pa bërë asnjë dredhë, hyri drejt e në një shtëpi që vinte pak si veç shoqeve. Unë e njihja mirë atë shtëpi dhe hetimet e qenit më ngjallën në çast një dyshim të vjetër...

Pas kësaj, ne u kthyem, duke marrë me vete varkën dhe lopatën. Unë vajta në zyrë me bindjen se kisha rënë në gjurmë. Pasi mendova variante të ndryshme, u përqëndrova te njëri prej tyre dhe me këto mendime trokita në derën e shefit. I raportova gjatë e gjerë për punën e grupit. Ai, si gjithnjë, më dëgjoji pa më ndërprerë e pastaj tha i menduar:

— Vështirë ta pranosh atë që thua ti... S'mjaftojnë vetëm arsyetimet...

Unë luajta nga vendi dhe, sado që isha i ri në detyrë, u përpoqa t'i mbushja mendjen:

— Ju e dini se djali i madh i kësaj familje, Agroni, është thirrur disa herë nga ne, për sjelljet e tij të këqija. Kohët e fundit është këshilluar rëndë për faktin se është kapur në zonën e kufirit.

Shefi më dëgjonte me vëmendje dhe këtë gjë e kuptova akoma më mirë, kur ra zilha e telefonit dhe ai nuk e ngriti fare dorezën.

— Ashtu është, si thua ti, — tha ai i qetë. — Po këto janë vetëm dyshime. Rëndësi ka ç'thonë provat materiale. . .

Atë çast ndjeva që në gjoks zemra më rrahu me vrull, e duke u munduar të mos e tregoja gëzimin tim të papritur, shpjgova:

— Gjatë kontrollit personal që bëmë në shtëpi, gjetëm në teshat e Agronit njolla boje të bardhë, krejtësisht të ngjashme me bojën e bardhë të barkut të varkës.

Eprori im më vështroi në sy, me një mënyrë të tillë, sa unë aty për aty e kuptova se isha nxituar.

— Megjithatë, — tha ai, — e kemi vështirë akoma të konkludojmë. Bëni njëherë analizën kimike të bojës. Studjoni sjelljet e Agronit, pa vënë dorë mbi të. Tërthorazi mbajeni në mbikëqyrje.

Dola nga zyra e shefit i menduar e i pakënaqur nga puna ime. Çështja ishte më e ndërlikuar nga sa pandehja unë.

4

Pa humbur kohë, bëmë analizën kimike të bojës. Analiza na tregoi se boja e bardhë e teshave të Agronit kishte përbërje të ndryshme nga ajo e barkës. Veç kësaj, duke vazhduar hetimet në vend, doli se Agroni bojën e bardhë e kishte marrë në magazinën e ndërmarrjes ku punonte. Kjo u vërtetua dhe nga magazinieri. Me atë bojë ai kishte lyer një dollap të shtëpisë. Këto fakte të papritura, nuk di se pse më tingëlluan si një tallje

për besimin naiv që kisha pasur se vetëm me nuhatjen e Jankës mund të ishte zgjidhur enigma.

Çështja kështu hyri prapë në errësirë. Shokët e punës më kritikuan në mbledhje për veprime të nxituara e të pasakta. Pas kësaj, pata një bisedë të gjatë me shefin. Tani çdo gjë duhej filluar nga e para. Të dhënat nga jashtë mungonin krejtësisht. Kishim një dispozicion vetëm një varkë e një lopatë lëmi! Nga t'ia fillonim? Grupi operativ priste udhëzimet e mia. Tek e fundit vendosëm të ktheheshim prapë te vendi i ngjarjes. Vajtëm dhe e kontrolluam vendin pëllëmbë për pëllëmbë në një periferi më të gjerë. Kësaj here gjetëm një lopatë tjetër të fshehur në mes të busheve. Edhe kjo, nuk ishte lopatë varke, po lopatë furre. Për një çast na xixëlloi një shkëndijë shprese, kur diktua në dorezën e saj diçka të shënuar me laps plumbi, po këtë nuk arritëm ta shquanim, pasi lagështira e kishte prishur. Lopata në vendin ku u gjet, rrëfente tërthorazi se tentatorët e kishin marrë me vete deri në një farë vendi dhe pastaj, për të mos rënë në sy, e kishin fshehur. Por vetëm kaq. Cilët ishin këta dhe ç'kishin ndër mend të bënin, mbetej gjithnjë një pyetje që kërkonte përgjigje.

Përsëri përpara kishim varkën po tani, jo me një, po me dy lopata. Sa mund të na flitnin këto me gjuhën e tyre të heshtur, kjo ishte pyetja që ngrihej para nesh. Në mungesë të burimeve të tjera, ne duhej t'i bënim ato të tregonin, të flitnin. Po para se t'ia arrinim kësaj, shkëmbyem mendime me disa peshkatarë, duke shpresuar se ndonjë fjalë e tyre do të na ndihmonte, po në të vërtetë ata pohuan po ato gjëra të panjohura. Thanë se varka sapo ishte ndërtuar dhe se një varkë të tillë nuk ua kishte zënë syri. Atyre u erdhi shumë keq që nuk mundën të na ndihmonin, ndërsa mua më mbetej të vazhdoja në heshtje dialogun me vete. Mbetej sërish varka me dy lopatat, me të cilat duhej të zgjidhnim nyjen e enigmës.

Pasi u mendova gjatë, i bëra vetes këtë pyetje: Ç'dija unë për ndërtimin e varkave? Nuk dija asgjë.

Atëherë u ngrita dhe shkova tek ata që ndërtojnë varka; pashë, pyeta, dëgjova dhe që atje më lindi ideja e zbërthimit të varkës. Mblodha shokët dhe u propozova:

— Sikur ta zbërthenim njëherë varkën. Kushedi, mund të zbulojmë ndonjë gjë brenda saj.

Shokët ranë dakord dhe ndërkaq filluam nga puna. E zbërthyem copë-copë, duke ndarë mënjanë dërrasat nga pjesët e tjera. Tek bënim këtë, vura re se në mes të dërrasave nuk ishin vënë fije liri, siç vepronin ndër-tuesit e varkave zakonisht, po copa të gjata leckash. Në fillim na u duk sikur nuk gjetëm asnjë gjurmë, po kur pamë që mbetëm pa gjë, atëherë e drejtuam vëmendjen të leckat. Ç'ishin këto leckat? A mund t'i ndihmonin punës sonë? Puna e parë që bëmë, i mblodhëm tok, i lamë e i pastruam dhe u munduam të shihnim nëse kishin ndonjë lidhje në mes tyre. Për çudinë tonë, kur i bashkuam njëra me tjetrën, u sajua papritur një këmishë gruaje. Këmisha, në pjesën e përparme ishte qëndisur me motive popullore, që neve aty për aty na ngjanë të njohura. Po prapë, na u duk shpejt për t'u gëzuar. Leckat i qepëm njëra me tjetrën dhe me këmishën në dorë hyra në zyrën e shefit.

Ai priste që unë t'i raportoja, ndaj kur vajta më priti me interes të veçantë:

— Hë, c'kemi?

Unë nuk iu përgjigja nga emocioni që më kapi befas, po i ndëra këmishën mbi tryezë. Të them të drejtën druhesha se mos ai e quante prapë të parakohshëm gëzimin tim.

Ai hapi sytë pak i habitur.

— Ç'është kjo këmishë?

— E gjetëm në mes të dërrasave të varkës. — i shpjegova, duke vështruar ngultas këmishën.

— Gjynah që e paskan prishur këtë këmishë të bukur! — tha shefi me një ton, që unë s'e kuptova aty për aty, sepse për mua bukuria qëndronte gjetkë. Gjetkë qëndronte edhe për shefin tim. Po ai e tha këtë fialë dhe pastaj pyeti duke parë nga dritarja:

— Ç'mendon të bësh?

Unë e kisha menduar mirë përgjigjen:

— Them të gjejmë se në ç'zonë të krahinës sonë veshin këmishë me këto lloj qëndizdash. Kjo do të na ndihmojë për lokalizimin e hetimeve...

Shefi më dëgjonte me vëmendie.

— Mirë e keni menduar si fillim, — tha në fund ai. — po ti e di se ky aksion s'ka si kryhet me sukses, pa ndihmën e njerëzve. Vetëm ju s'e bëni dot. Shkoni takohuni me ta...

5

Të nesërmen vajta në një fshat buzë liqenit, duke menduar, nga sa ë njihja Unë etnografinë e krahinës, se këmishë me qëndizma të tilla mbajnë vetëm asaj ane. Dhe këtë gjë, më mirë së gratë, s'kishte kush të ma sqaronte. Hyra në bisedë me disa gra dhe pastaj u tregova këmishën.

— S'është nga anët toña, — thanë ato në një zë. — Ne nuk qëndisim nga këto lule.

— Këto qëndizma, mor bir, — shtoi një plakë, — i bëjnë në fshatrat matanë kufirit...

Mua m'u duk sikur ma morën këmishën nga duart e ma hodhën në tokë, si një plakë pa vlerë. U gjenda para një dilemë të re. Këmishat të bënte të mendoje tani se varka kishte mundësi të ishte ndërtuar matanë kufirit. Mos kjo varkë u takonte peshkatarëve të huaj dhe ndonjë erë e fortë e kishte këputur dhe e kishte sjellë në viset tona? Ky ishte arsyetimi i parë, po arsyetime të tjerë e rrezonin poshtë. Ç'ishin ato gjurmë në breg? Ç'donte ajo lopatë, fshehur në mës busheve? Në këto rrethana, hëpërhë, këmisha nuk na shërbente.

U duk sikur u kthyem prapë atje ku ishim. Po besimin nuk e kishim humbur. Pa këtë besim nuk bën dot në detyrën tonë. Duhet të dilnim medoemos nga ai rreth ku kishim hyrë. Puna jonë i shëmbëllen asaj që

thoshte një natyralist i famshëm: «më jepni një koskë, t'ju jap skeletin.» Kështu dhe ne, kishim përpara varkën bashkë me dy lopatat dhe me to duhej të punonim.

— Nuk jemi fare pa mbështetje, — na tha shefi në një mbledhje. — Varka nuk ka rënë nga Hëna!

Vërtet, nuk kishte rënë nga Hëna, ishte ndërtuar në tokë, në rrethin tonë, ndoshta në qytetin tonë. Ky ishte mendimi që më shqetësoi për disa ditë me radhë. Mora dërrasat e varkës dhe i pastrova nga boja e lëndët e huaja. Dërrasat m'u dukën se ishin nga i njejtë dru, po se nga çfarë druri, këtë e kisha vështirë ta përcaktoja. Vështirë e patën edhe shokët e mi ta thoshin. Këtë mund ta përcaktonin sharrëxhinjtë e Pyllit të Plisës.

Kur vajta te sharrëxhinjtë, ata po bënëin pushimin e drekës. Njihesha me përgjegjësin e tyre dhe nuk hoqa keq të hyja në bisedë. Ndezëm nga një cigare dhe fjala nxori fjalën, derisa dolëm te dërrasat e mia, dy nga të cilat i kisha me vete. Atyre as që u shkoi mendja se për çfarë mund të kishin shërbyer ato dhe për ç'arsye i kisha sjellë gjer atje.

— Prej ç'druri mund të jenë këto dërrasa? — i pyeta.

— Këto?! — tha një nga punëtorët, i habitur që unë nuk e dija. — Bredh, është, more shok, bredh i bardhë...

Unë tunda kokën, duke mos ia vënë veshin habitës së tij.

— Bredhi i bardhë nuk rritet në pyllin tonë, — tha përgjegjësi, — rritet në vende të larta malore.

— Ke shkuar ndonjëherë në fshatrat e M.? — pyeti një druvar plak. — Atie do ta gjesh bredhin e bardhë. Në tjetër vend s'e gjen!

Mua atë çast m'u ngroh zemra. Sharrëxhinjtë nuk e kuptonin dhe s'kishin si ta kuptonin gëzimin tim të fshehtë.

— Tani po, — tha shefi, kur i raportova për bisedën që bëra me sharrëxhinjtë, — mund të them se e kemi futur çështjen në rrugë...

Dhe që atë natë u nisa për në fshatrat e zonës së

bredhit të bardhë. Kisha në dorë një çelës që do të më ndihmonte. Harrova të them se sharrëxhinjtë më thanë gjithashtu se dërrasat qenë prerë me sharrë dore dhe se nga forma nuk i përmbaheshin standartit shtetëror. Kjo më bëri të mendoja se kishte shumë të ngjarë që druri i dërrasave të varkës të qe prerë në pyll me leje. Prandaj, puna e parë që bëra, shtiva në dorë listën e emrave të atyre që kishin marrë leje për të prerë dru në pyllin e bredhit të bardhë. Lista ishte e gjatë, po unë s'e pata të vështirë t'i identifikoja njerëzit. Për këtë më erdhën në ndihmë shokët e fshatit. Kur arrita te numri i tri-dhjetepetë i listës dhe dëgjova mendimet e shokëve për një bashkëfshatarin e tyre, mendova të qëndroja aty. Ishte kulaku Sadik V. Mendova të përqëndrohesha te ky person dhe kështu veprova. Po, nga hetimi që bëra nuk më doli ndonjë gjë e rëndësishme. Prapë nuk kisha qëlluar në shenjë si duhej.

6

E lashë njëherë mënjanë çështjen e dërrasave dhe u mora me lopatat. Ku mund të ishin punuar ato? Në bisedë e sipër me fshatarët u informova se lopata të tilla bënte vetëm një mjeshtër plak nga fshati P.

Mora lopatat dhe në mbrëmje vajta te plaku. Ia tregova dhe ai, sapa i pa, e njohu njërën prej tyre.

— Këtë e kam bërë me dorën time, — tha plaku. — Vetëm tri lopata furre kam punuar kështu. Kjo është lopata e Sadik V. E sheh shenjë që është prishur? Ka qenë emri i tij. Sadiku është familje e madhe dhe përdor furrë në shtëpi.

Unë qesha me vete që e ndesha sërish emrin e Sadik V.

Mjeshtri plak e kuptoi se diçka e rëndësishme luan-te në këtë mes dhe priste fjalën time.

— A nuk çon djalin njëherë t'ia kërkojë lopatën Sadikut? — i thashë, i menduar.

— Posi, që tashti!

Kur u kthye djali nga shtëpia e Sadikut, tha:

— Lopatën Sadiku nuk e ka në shtëpi. Ja ka marrë hua Todi K. dhe s'ia ka kthyer akoma.

Tani më doli një emër i ri. Duke parë listën e fshatarëve që kishin prerë dru bredhi me leje, vura re se ishte dhe ky emër. Fillova të studjoja se kush ishte Todi K. dhe doli se ai kishte qenë burgosur si agjent i UDB-së. Fshatarët më thanë se Todi nuk kishte hyrë në kooperativë e se jetonte vetëm me punën e së shoqes. Fshati e njihte për njeri dinak dhe tinzar. Bile, ai kishte hapur fjalë se do të shpërngulej që aty dhe do të zinte punë në qytet. Të gjitha këto flitnin në favor të dyshimeve të mia, po nuk kisha asnjë argument lidhur me çështjen për të cilën kisha ardhur. Puna duhej hetuar më afër. Prandaj dërgova nipin e mjeshtrit plak në shtëpinë e Todit. Ai shkoi dhe, sipas porosisë që i dhashë, i kërkoj lopatën e Sadikut.

— Ik, more djalë, se e ke gabim! Ç'më duhet mua lopata e furrës!

Nyja e enigmës sa vinte e po zgjidhej. Për këtë ndihmuan vetë fshatarët. Unë u bëra i shtëpisë në fshat. Njerëzit e thjeshtë kanë nuhatje të çuditshme. Ata vetë vinin e më jepnin të dhëna të ndryshme. Një fshatar erdli e më tha se në gardhin që rrethonte shtëpinë e Todit kishte parë gjurmë boje të bardhë. Dhe me të vërtetë, unë i pashë vetë me sytë e mi njollat e bardha të bojës. Një tjetër më tregoi me hollësi se para disa ditësh i kishte zënë syri, duke u kthyer për në shtëpi, Todin të lagur në gjysmën e trupit, sado që atë ditë nuk kishte rënë shi. Interessant se si syrit të popullit nuk i shpëton asgjë.

Tani çdo gjë u bë e qartë. Shkuam në shtëpinë e Todit K. Trokitëm disa herë, po të zotët e shtëpisë për një kohë nuk u ndien të gjallë. Vetëm kur trokitëm fort e thirrëm, atëherë doli e shoqja.

— Todin doni? — pyeti ajo, duke u munduar të na vononte.

— Todin duam, po hapu, — i tha njëri nga fshatarët dhe desh të futej brenda, po gruaja dinake i doli përpara.

— Ai po hidhet nga muri, prapa shtëpisë...

— Mos u mërzit, së ka kush e pret dhe andej, — tha Ganiu, një nga shokët tanë dhe hyri në korridor. Gruaja u mundua prapë të luante rolin e saj, po më kot. Todin e kapëm në dhomën e vogël, tek po digjte në zjarr dokumentet e fundit... Bashkë me të kapëm edhe agjentin e huaj, i cili me ndihmën e Todit kishte pregatitur varkën për t'u hedhur matanë kufirit...

7

Kur shkova e i raportova shefit, ai u ngrit më këmbë dhe më rroku. Ne qëndronim përballë njëri-tjetrit dhe sytë na ndritnin nga një gëzim i përmbajtur.

— Të lumtë! — tha ai dhe, si heshti një hop, shtoi: — Ju lumtë të gjithëve, i lumtë atij punëtorit, u lumtë sharrëxhinjve, grave, fshatarëve dhe, tok me ta edhe ty që e udhëhoqe këtë aksion të vështirë. Çështja, siç e di, ka rëndësi të madhe. Todi K. bashkë me Ethem R. ishin agjentë të rregullt të UDB-së dhe kërkoheshin nga qendra e tyre me këmbëngulje. Operacioni i tyre pra dështoi plotësisht.

Kur u ndava nga shefi, shkova të flija. Gjithë ajo tendosje nervore, ai shqetësim i vazhdueshëm, më kishin lodhur. Dhe këtë e ndieja tani, kur të gjitha telashet i kisha lënë prapa.

Kjo është detyra jonë, që duket sikur kryhet nga një rreth i mbyllur njerëzish, po që në të vërtetë është vepër e të gjithëve, e vetë popullit.

NJË NATË SHIU

Një vetëtimë tjetër gjarpëroi nëpër qiellin e errët dhe drita e saj verdhoshe zbuloi dhe një herë faqen e kodrës. Pastaj gjëmuar malet me potere të madhe e sakaq toka u lëkund, sikur të kishte hyrë në luftë artileria e rëndë. Shiu që vazhdonte të binte litar e shtoi vrullin.

— Prit, — thirri ai me zë të ulët dhe mbajti këmbët.
— Ja shtëpia!

Tjetri për pak u rrëzua, se aty vendi vinte tatëpjetë dhe ai desh të qëndronte njëherësh.

— Çohu! — vazhdoi i pari, që pandehi se shoku u rrëzua. — Mbërritëm tani. Nuk të thashë se këndeji i dilet më shkurt...

Ai u çapit pa folur. Shoku e priti, i zgjati dorën dhe ashtu siç ishin, të ngarkuar, zunë përsëri të ecnin. Pasi kaluan një vijë uji, rruga bënte përpjetë. Drita e vetëtimave ua tregonte tani sheshazi shtëpinë që ngrihej në faqe të kodrës.

Të përpjetën ata e morën pothuaj të kapur për krahu. Këpuçët e tyre të rënda mezi çanin baltën e madhe. Uji rridhte tëposhtë si një përrua që zbret nga mali.

Kur dolën sipër në breg, të dy burrat ndaluan. Në dritën e vetëtimave ata panë fytyrat e çelura të njëri-tjetrit.

— Erdhëm! — tha prapë i pari dhe mori të ecte më tutje. Shoku e ndoqi pas, gjersa u gjendën përpara një shtëpie, rrethuar me gardh. Aty shiu ia dha me të madhe.

Burrat hoqën ngarkesat që kishin në kurriz dhe i lëshuan përtokë.

— Çfarë gameti! — foli ai që s'kishte hapur gojë. Tjetri nuk ia vuri veshin, se atë kohë po kërkonte ballin e shtëpisë që nxinte në errësirë.

— Hajde, — tha ai pas pak, — se i kemi dalë nga prapa.

Ata i ranë rrotull shtëpisë dhe, pasi kaluan portën prej lese, hynë në oborr. Një qen hungroi diku në errësirë, po nuk guxoi të lehte. Nga dritarja, në oborrin mbushur me ujë binte një katror i madh drite, që praronte shiun litar. Burrat, që deri atë çast kishin nxituar, tani sikur u stepën. Qëndronin në shi të heshtur dhe vështronin dritën e shtëpisë.

— Ç'do të bëjmë, Xhemal? — foli gjithnjë ai i pari. Xhemali ngriti supet:

— Ti e di, Feti, që na prure deri këtu.

— Pse, unë t'i bëj të gjitha? — u nxeh Feti. — Hë, thirr, të dëgjojnë ata brenda!

— Thirri ti, më mirë. Nuk dëgjon si jam ngjirur?

Feti u prish në fytyrë, po shoku i tij nuk e vuri re, sado që e ndjeu këtë gjë. Të dy burrat rrinin të ngulur në një vend. Shiu u rridhte rrëke nëpër rroba. Era e lagur u rrihte fytyrat e mardhura. Veshët u shungullonin nga gjëmimet e shpeshta të bubullimave.

Brenda në shtëpi u dëgjuan zëra fëmijësh. Pas pak, u duk sikur diçka u rrëzua. Dikush qau. Burrat s'lëviznin nga vendi.

— E, ç'do të bëjmë? — theu heshtjen Xhemali. — Të kthehemi më mirë te shokët.

Feti, në vend që të përgjigjej, bëri disa hapa përpara dhe thirri:

— O i zoti i shtëpisë!

Zhurma e potershme e bubullimës, që erdhi befas, e mbyti thirrjen e burrit.

— O i zoti i shtëpisë! — thirri sërish ai, duke vënë gojën në mes të shuplakave të duarve.

Në dritaren e vogël, sipër derës së shtëpisë, u ndez

një dritë. Brenda u ndien zhurma hapash, zëra të paqartë. Burrat u afruan. Pastaj një zë gruaje:

— Kush është?!

Të ardhurit u nemitën një çast. Në dritën e vetëtimsës ata panë njëri-tjetrin në sy. «S'paska burrë kjo shtëpi!»

— Hape pak, moj motër! — thirri Feti u dhe bëri përpara.

— Kush je ti? — u përsërit zëri i gruas, që në veshët e burrave tingëlloi pak kërcënues.

Xhemali i vajti pranë shokut e i tha me zë të ulët:

— Hajde ikim, Feti, se s'është punë kjo!

— Ti s'di ç'flet! — ia priti Feti u, duke u kthyer nga ai. — Erdhëm deri këtu dhe të ikim. — Pastaj, duke ndërruar tonin, iu drejtua së zonjës së shtëpisë:

— Jemi dy jabanxhi që na ka zënë shiu udhës.

Një varg gjëmimesh u shkrehën njëri pas tjetrit. Pas kësaj, u ndeh heshtja dhe shushurinte vetëm zhurma e shiut. Nga shtëpia erdhi e qara e thekshme e një fëmije. Feti u mat të thërrasë prapë, po papritur çelësi kërciti në derë. Burrat s'lëvizën nga vendi. Dera u hap dhe drita ra në këmbët e tyre. Një grua e moshuar, me shami të zezë në kokë bëri ballë. Ajo vuri dorën strehë mbi sy dhe u mundua t'i shquante të panjohurit. Në të majtë e në të djathtë të saj zgjatëshin koka fëmijësh. Burrat hodhën ngarkesat në kurriz dhe u afruan.

— Mirëmbërma, moj nënë! — thanë ata pothuaj me një gojë.

— Mirëmbërma! — u përgjigj gruaja, pak e ndruajtur, tek vuri re burrat e armatosur. Ata i zgjatën dorën dhe ajo ua ndëri me radhë. Pastaj u largua nga dera, ndërsa fëmijët rendën brenda.

— Dëshëm të strehohemi, sa të pushojë një çikë shiu, — tha Feti u, tek hyri në hajatin e shtëpisë.

— Urdhëroni, posi! — thirri plaka, që u gjallërua menjëherë, kur i pa të ardhurit mirë në dritë. Ata ishin të veshur ushtarë. Uji u rrëshqiste nëpër fytyrë. Nga rrobat binin nëpër tullat e kuqe të hajatit rrëkeza uji.

Hajati vinte i gjatë e i ngushtë, pa tavan. Sipër du-

keshin trarët e rinj, ku qenë varur vargje qepësh e spe-cash të kuq. Në fund hapeshin dy dyer, më të djathtë e më të majtë.

— Lirohuni, more djema, — ia bëri plaka tek rrinte më këmbë në mes dy burrave. — Hiqini palltot e hajdeni brenda. Sonte po rrjedhin qiejt. E ka kohën, vjeshtë!

Mysafirët e panjohur, sado që nga pamja dukeshin pothuaj njëlloj, veshur ashtu me rroba ushtarake, prapë sytë e plakës i shquan mirë: njëri vinte pak i shëndoshë, fytyrërrumbullakët me flokë të dendur, me ca sy të vegjël që i lëviznin orë e çast; dhe ky ishte ai që foli i pari dhe që sillej sikur të ishte mik i shtëpisë; kurse tjetri, që rrinte ca si mënjanë, i druajtur, me sytë lëshuar përdhe e që s'liste, ngjante i ri, me trup të drejtë, i hequr në fytyrë, me mustaqe të holla e flokë të pakët.

Burrat morën të zhvishen, ndërsa plaka u fut diku brenda. Ata varen pushkët ndër ca gozhdë të mëdha, ku ndoshta të zotët e shtëpisë vinin veglat e punës. Lëshuan përtokë trastat, kundrëgazin, hoqën kapotat dhe u ulën të zgjidhnin këpucët.

Kur u ngritën më këmbë, e zonja e shtëpisë u solli nga një peshqir.

— Fshihuni mirë, — u tha ajo dhe u priu mysafirëve përpara. — Urdhëroni, këndeje.

Ushtarët shkuan pas saj dhe hynë në dhomën e zjarrit.

— Hë, ikni që aty, — u tha plaka fëmijëve, që kishin zënë vend në një anë të vatrës. — Uluni, djema.

— Mos i ngit fëmijët, se ka vend për të gjithë, — ia priti Fetiu dhe u doli të vegjëlive përpara, për t'i kthyer prapë te qoshja. — Këtu, mos luani prej këndeje. Do të rrini me xhaxhin.

Të vegjlit zunë vend atje ku ishin, duke vënë mysafirin në mes.

Zjarri kuqëlonte në vatër. Dhoma e madhe, me mure të bardha, ishte shtruar me rrogoza e qilima. Më të djathtë shtrihej një krevat hekuri, kurse në fund të dhomës gjendeshin dy sepete të vjetra, me lule të dala boje.

Xhemali kishte ndenjur në këmbë para oxhakut, i

tërhequr pas një fotografie të madhe, që ishte varur sipër në një kornizë prej kashte.

— Djali? — pyeti ai plakën, që hynte e dilte orë e cast në dhomë.

— Hasani, të keqen! — psherëtiu plaka dhe qëndroi në krah të mysafirit. — U vra me monarkot në kufi.

Mysafiri e vështroi me vërejtje dhe pastaj me sytë ulur zuri vend pranë vatrës, përkundrejt shokut.

— Ke tjetër veç këtij? — pyeti Fetiu që merrej me fëmijët, po që e dëgjoji përgjigjen e së zonjës së shtëpisë.

— Kam, kam shyqyr dhe një! — tha plaka, tek vështronte akoma djalin në fotografi. — Kam të atin e këtyre fëmijëve, Kamberin. — Pastaj, duke drejtuar trupin foli me të psherëtirë: — Hasan, e shikon, të kanë ardhur shokët. Janë edhe ata ushtarë, si ishe ti!

Fëmijët shikonin nga e gjyshja të nemitur, me sy të xixëlluar, ndërsa flaka e zjarrit lodronte në fytyrat e burrave. Fetiu nuk i pëlqeu kjo heshtje që-ra ashtu papritur.

— Po Kamberin, ku e ke? — pyeti Fetiu me zë të lartë.

Plaka shkëputi vështrimin nga fotografia dhe u ul buzë vatrës.

— E kanë thirrur tok me nusen në luftë! — tha ajo, duke ulur kokën për t'i fryrë zjarrit.

— Në luftë!? — vuri buzën në gaz Fetiu.

— Jo në luftë, gjyshe, po në zbor! — tha djali i vogël, që rrinte në prehrin e mysafirit dhe vështronte me ca sy të pastër e kureshtarë.

Burrat qeshën dhe bashkë me ta dhe dy vajzat e djali.

— Bravo! — ia bëri Fetiu, duke i fërkuar djalit kokën e qethur. — Sot s'ka luftë, por zbor. Shkon në shkollë ti?

— Shkoj! — u mburr i vogli.

— Luftë s'ka, — tha plaka, duke ngritur kokën nga vatra, — po si luftë është kjo, mor djema, kur njeriu vishet e ngjishet me pishqollë, bashkohet me shokët, i bie vendit në të katër anët, hap istikame dhe stërvitet në shi

e në qamet. I di Partia këto punë më mirë se ne, more djema, apo s'e kam mirë?

— Jo, kush tha! — u hodh menjëherë Xhemali. — Ashtu është. Partia thotë të përgatitemi në paqe, që ta kemi më lehtë në luftë.

— Kështu, të keqen! — u kthye plaka nga Xhemali. — Se jemi në gojën e ujkut...

Papritmas drita e llambës elektrike u pakësua dhe fill pas kësaj diku u shkreh një rrufë me të madhe. Njëra nga vajzat vuri gishtat në veshë. Plaka rrinte e qetë sikur s'po ndodhte asgjë. Xhemali vështronte nga xhamet e errëta të dritares, që ndizeshin herë pas here.

— Si të quajnë? — e pyeti Fetiu më të voglin e fëmijëve.

— Hasan!

— E paske gjallë Hasanin! — tha mysafiri, që mbante djalin në prehër.

Plakës iu bë qejfi dhe tundi kokën.

— Gjallë e kam, gjallë. Po zotrote, i ke të rritur?

— Unë s'kam, jam beqar akoma, po Xhemali ka dy! Xhemali buzëqeshi dhe miratoi me kokë. Ai deshi pastaj të shpjegonte, po s'e la Fetiu:

— Këtë e do më shumë se vajzat, besoj.

Vajzat qeshën, duke vështruar nga gjyshja.

— Evlati njësoj duhet. Si djali, vajza, sot një janë. Drita, ngrihu, sill dru! Ti, Hasan, mos e bezdis xhaxhin...

— Jo, jo, s'ka gjë, — tha Fetiu.

Vajza u ngrit e doli nga dhoma. Pas pak u çua dhe e motra.

— I kam të mbara në shkollë, — tha gjyshja. — Ky shejtani sivjet shkoi për herë të parë.

Xhemali rrinte me sytë ngulur te zjarri që ishte bërë shpuzë.

— Mos të dhemb gjë koka, mor bir? — e pyeti plaka.

Burri lëvizi, thuajsë nuk e priste këtë pyetje.

— Jo, po jam ca i lodhur, — tha ai dhe pa me bisht të syrit nga shoku.

— Ka fjalë pak Xhemua, — shtoi shoku e zgjati duart t'i merrte drutë vajzës që iu afrua vatrës.

— Kush e do më shumë gjyshen nga ju?

Vajza fytyrëvezake, me gërsheta të shkurtër, vari kokën duke buzëqeshur dhe u ul pranë gjyshes. Tjetra u ngjesh pas së motrës. Ajo vinte e imtë, me flokë të drejtë dhe shumë e turpshme.

Pas pak, plaka u ngrit, hapi njëren sepete dhe nxori dy gota me raki, vënë në një pjatë alumini. Burrat morën gotat, uruan dhe i kthyen me fund.

— Nga ju kemi? — pyeti plaka, si u ul rishtaz në vendin e parë.

— Nga qyteti, — u përgjigj Xhemali me vonesë.

— Ti je më e madhja? — u hodh papritur Feti, duke parë nga vajza me fytyrë vezake.

— Jo, — tha ajo e druajtur, — unë vij pas Bardhës.

— I ka bërë e ëma të dyja në krye të motit, — s'pjegoi plaka.

— T'ju rrojnë!

Plaka s'arriti t'i përgjigjej, se dy rrufe plasën njëra pas tjetrës dhe shtëpia u lëkund si nga tërmeti. Asnjëri nuk bënte zë. Dëgjohej shiu që binte me rrëshekë, duke trokitur me të fortë në dritare.

— Po ju, xhaxhi, ushtarë jeni? — tha djali, tek u kthye me fytyrë nga mysafiri që e mbante në prehër.

— Ushtarë jemi, ushtarë të Republikës, — i mëshoi zërit Xhemali.

— Dhe sa ju kanë mbetur? — pyeti plaka, duke u munduar t'i vështronte të dy burrat njëherazi.

— Ne jemi si yt bir, — u hodh menjëherë Xhemali. — Na kanë thirrur në zbor.

Plaka u gjallërua e tëra dhe deshi të thoshte diçka. Kjo dukej në sytë, që i morën vetiu një shkëlqim të lehtë.

— Mos e patë gjë Kamberin andej? Është me ata të fermës!

— Ne jemi në një batalion tjetër, — tha Feti. — Është gjithë dynjaja andej, se po bëhet lojë e madhe ushtarake.

— Këndej rrotull do të jetë, — tha Xhemali për të qetësuar plakën.

— Mos u bëj merak, — arsyetoi Fetiu. — Do të jetë futur dhe ai në ndonjë shtëpi.

Nëna e Kamberit ngriti kokën dhe e shikoi me çudi.

— Pse, dhe ju kështu ju shpërndanë? Ju thanë të shkoni nëpër shtëpira?

— Jo, jo, — nxitoi të përgjigjej Fetiu. — Ne ishim me punë këndeje. Qëlloi që na zuri ky qameti dhe kthyem këtu. Shokët janë të gjithë në detyrë. Dhe ne në detyrë jemi.

Plakës iu largua ajo gjallëria e parë.

— Kështu them dhe unë, — tha ajo si e menduar. — S'ma merr mendja që komandantët t'ju lëshojnë kaq kallaj. Ushtria pse është ushtri. Ushitari s'pyet as për shi, as për furtunë.

Sakaq burrat u panë në sy. Fëmijët sikur u tulatën. Të mëdhenjve u ra një hije. Heshtja tani u bë më e qartë. Bubullimat qenë larguar dhe kohë më kohë shkrepëtinte dobët. Po shiu s'kishte pushuar akoma.

— Qëparë, në mëngjes, këndeje, — tha plaka, — kaloi një ushtri e madhe... shokët tuaj do të kenë qenë... Ca ikën tutje, matanë Kanalit të Lurit, po një pjesë qëndruan ja, atje poshtë, te mulliri i Lames. Më thanë se atje do të hapin istikame.

Xhemali u kollit dhe lëvizi vendit, po Fetiu nuk i ngriti sytë. Ai i kishte kthyer një pjesë të kurrizit zjarrit e shikonte nga plaka.

— Fluturuan dhe aeroplanë, — tha vajza, që s'kishte hapur asnjëherë gojë, po që, me të thënë këto fjalë, u çel në fytyrë.

— Kaluan dhe tanke! — gati sa s'thirri djali i gëzuar.

— Ashtu! — tha duke qeshur Fetiu.

— Ke tans ti, xhaxhi? — pyeti i vogli.

— Jo, unë, s'kam, po ushtria jonë i ka të gjitha.

Fetiu fliste, kurse shoku i tij s'ishte më qejf.

Plakës i pëlqyen fjalët e mikut.

— Ashtu është, mor bir, — tha ajo dhe pastaj shtoi me zë të plotë. — S'është Shqipëria si një herë. Në këmbë janë gjithë bijtë e nënave.

Fetiu u kthye ashtu siç ishte më parë dhe, tek ndeshi

vështrimin serioz të Xhemalit, i shkeli syrin. Djali i vogël e pa dhe qeshi.

— Një gotë ujë desha! — tha Feti u.

Bardha u mat të ngrihej nga vendi, po gjyshja s'e la:

— Rri ti, se shkoj unë!

Plaka doli nga dhoma. Burrat mbetën vetëm me fëmijët. Vështrimet e tyre u përpoqën rishtaz, po prapë s'po merreshin vesh.

— Sikur reshti pak shiu, — foli Xhemali.

— S'ka ndër mend të pushojë ky sonte! — Zëri i Fetiut tingëlloi i vendosur. Pastaj shtoi me ngut:

— Po ti, Hasan, çfarë do të bëhesh?

— Unë do të bëhem pilot! — tha djali me mburrje.

Burri, që e mbante në prehër, në vend që t'u vinte veshin atyre që i tha i vogli, i foli shokut përkundrejt:

— Ti mos më rri sikur të janë mbytur gjemitë! —

Dhe duke u kthyer nga djali shtoi: — Domethënë do të bëhesh pilot, bravo!

Vështrimi kureshtar i fëmijëve lëvizte sa te njëri, te tjetri. Mysafirët rrinin sikur të ishin të zemëruar. Të vegjlit druheshin t'i shqetësonin. Xhemali u mat të fliste, po plaka hyri me gotën e ujit në dorë.

— A pushoi ndopak shiu? — pyeti Xhemali.

E zonja e shtëpisë i zgjati gotën mysafirët dhe shikonte nga dera:

— Jo, jo, s'ka pushuar! Po do të hani një çikë?

— Faleminderit, — tha Xhemali. — Kemi ngrënë...

— Ka dërhava plot! — ia priti Feti u duke qeshur.

Xhemali u ngrit më këmbë e iu afrua dritares. Mbështolli sytë me dorë dhe u mundua të shihte jashtë. Shiu vijonte të binte si gjithnjë. Ai ngriti kokën, duke qëndruar më këmbë në mëdyshje.

Plaka e vështronte me vëmendje dhe si vuri re shqetësimin e Xhemalit tha:

— Po qetë në detyrë, more djema, nxitoni. Të gjithë burrat jashtë janë sonte!

— Ashtu do të bëjmë, — tha i menduar Xhemali e zuri të kopsiste xhakëtën ushtarake.

Në dhomë u nder sërish qetësia. Asnjë nuk fliste.

Zhurma e shiut ndihej me një shushurimë të zgjatur e monotone. Feti u kishte marrë mashën e trazonte hirin e vatrës.

— Si mund të zbresim më shkurt tek ura e Baçit? — pyeti Xhemali që tanimë ishte ngritur më këmbë.

— Dilet kollaj, — tha plaka. — Merrni krahun e majtë dhe mbani rrugës tatëpjetë...

Xhemali doli në hajat dhe si veshi këpucët, hyri prapë në dhomë. Shoku i tij tundte mashën dhe e ndiqte me bisht të syrit.

— Çohu, Feti, se u vonuam e na presin shokët! — thirri Xhemali duke u kopsitur. — Shiu s'don të pushojë.

Plaka menjëherë u çel në fytyrë, kurse Feti u rrudh e tha si pa qejf:

— Shi bie edhe atje ku janë shokët. Ata e dinë se s'po rrimë kot!

— Shiu ka punën e tij, ne kemi tonën, — tha Xhemali duke dalë në hajat.

Plakës i qeshën sytë e me shikim nga miku që po dilte, tha:

— Ashtu, bir i nënës, ashtu! Shihni detyrën ju, se hasmi këtë kohë pret. Kështu thotë nëna, por ju i dini më mirë këto punë.

Feti nuk donte të ngrikej nga qoshja e ngrohtë, po kur pa që Xhemali po vishej me gjithë mend në hajat e plaka me ato fjalë zu të qëllonte larg, largoi djalin nga prehri dhe u çua. Të vegjlit i hapën rrugën dhe ai iu qas dritares.

— Bie, xhaxhi, bie! — tha Hasani.

Burri s'foli, po hapi gojën dhe u shtriq.

— Shko merri xhaxhit këpucët, — tha ai dhe u ul mbi sepete.

Fëmijët u turrën të tre dhe, kur u kthyen, i sollën jo vetëm këpucët po dhe kapotën e plaçkat e tjera që kullonin akoma ujë.

— Xhaxhi, kur e vë maskën, të zihet fryma? — pyeti djali duke rrotulluar nëpër duar zorrën e saj prej llastiku.

Feti mbathte këpucët ngadalë e me përtesë.

— Të zihet the? Të zihet, ore çun, të zihet...

— Po nuk vdes? — pyeti vajza me fytyrë vezake.

Mysafiri ngriti kokën. Vështrimi i habitur i vajzës e detyroi ta korrigjonte përgjigjen:

— Jo, jo nuk vdes... Kush tha?

Atë çast Xhemali hyri i veshur e me pushkë në krah. Ai i dëgjoji pyetjet e fëmijëve.

— Maska, — shpjegoi ai, — i shërben ushtarit për të shpëtuar jetën, kur armiku helmatis ajrin.

Ai zbërtheu trastën e tij, mori maskën dhe e vuri në fytyrë. Fëmijët qeshën. Hasani përplaste duart.

— Hasmi është i lig shumë, — ia bëri plaka nga dera, ku rrinte mbështetur. — Ç'nuk bëri gjermani sa ishte këtu! Po ata amerikanët atje në Vietnam?

Kur u bë gati dhe Feti, të gjithë dolën në hajat. Plaka shkoi përpara dhe, para se miqtë të kapërcenin pragun, u futi në xhep nga një grusht arra.

— Të falemi nderit, — tha Xhemali, tek u fërkonte kokën fëmijëve. — Na e bëj hallall, se të bezdisëm ca...

Feti tundte kokën për të miratuar fjalët e shokut, ndërse sytë i qenë zvogëluar.

— S'kemi ç'të bëjmë! I ka ushtria këto, — tha Feti, kur i zgjati dorën zonjës së shtëpisë.

— Nënës i vjen keq që s'ju mban dot, po ju jeni në detyrë. Derën hapur e keni, kur të doni. Kushedi takoni ardej dhe Kamberin e vini tok me të.

Ajo bëri përpara dhe çeli derën. Era e ftohtë e vjesh-tës u dynd vrulltas brenda. Jashtë, në dritën që ra në oborr, shiu i dendur ngjante si një rrjetë që e tundte era. Djali i vogël doli te pragu i derës e zgjati duart.

— Hapi rrugën xhaxhit, — foli plaka. — Hyni brenda, se do të plevitoseni.

Po fëmijët nuk lëvizën nga vendi. Ata panë se si mysafirët i shtrënguan dorën gjyshes dhe kapërcyen një pellg uji në mes të oborrit. Plaka për t'u bërë dritë e mbajti derën hapur. Fëmijët herë pas here zgjatnin kokën të shikonin miqtë tek largoheshin.

Burrat, si kapërcyen derën prej lese të gardhit të shtëpisë, morën në të majtë rrugën tatëpjetë dhe u zhdukën në errësirën e pafund.

Në krye printe Xhemali. Ai i hidhte hapat me nxitim, ndërsa Feti u ecte sikur e shtynte njeri nga pas. Rrugatani ishte më e vështirë dhe e errët. Ujë rrudhte nga të gjitha anët si lumë. Vetëtimat qenë rralluar dhe drita e tyre e zbetë s'u ndihmonte më. Ata ecnin me hame ndje, duke u munduar të mos humbnin drejtimin e të mos binin në ndonjë rrëzomë.

Kur zbritën poshtë faqes së kodrës, në rrugë, afër mullirit të Lames, ku qenë vendosur shokët e tyre nëpër llogore, Xhemali i ngadalësoi hapat. Prej andej vinin jonet e një kënge të fuqishme burrash.

— Akoma në pritje janë, — tha Feti u, — kot u nxituam...

— Sidoqoftë, — ia ktheu Xhemali, — ne nuk bëmë mirë që u larguam pa leje...

Feti u vinte pas tij, duke marrë frymë rëndë, ndërsa këpucët i zhyteshin nëpër ujë e baltë.

— E ç'i gjeti shokët? Asgjë, — arsyetonte si me vetë Xhemali. — Më mirë të ishim lagur si të gjithë...

Befas tjetri qëndroi në vend dhe seç murmuriti me zemërim.

— Të ishte për mua, — u dëgjua pastaj qartë zëri i tij, — kisha ndenj ur dhe ca, se s'u bë qameti. Po ç'të të bëj ty!

Xhemali u kthee nga ai.

— Pse s'ndenje atëherë? Unë s'të mora me zor.

Feti u në vend që të përgjigjej, filloi të ecte. Xhemali e ndoqi pas. Ata hidhnin hapat në heshtje, duke çarë errësirën e natës që ngrihej si perde e zezë.

— Fol, de! — thirri rishtaz i pari.

Tjetri nuk u përgjigj papë.

Ata vazhdonin të çapiteshin.

— Unë them t'i dalim nga prapa e jo nga xhadeja, — ia bëri pas pak Feti u. — Kështu nuk na shohin shokët.

— Përsëri ti më këto! — ia priti i vendosur Xhemali.

— Jo, do të vemi drejt e te komandanti e t'ia themi të gjitha... T'i themi se nuk duruam dot...

— Thuaja ti, unë s'ia them... Fundi kohë pushimi ishte...

— Vërtet kohë pushimi, po ne s'kemi ardhur këndeje për shëtitje. Si duket nuk na mjaftuan porositë e komandantëve tanë. Patëm nevojë të dëgjonim fjalët e asaj nënës atje.

Në zërin e Xhemalit ndihej një notë zemërimi e dhembjeje. Atij i bëhej sikur dikush i kishte lidhur një nyje në grykë dhe ai mezi priste të shkonte te komandanti e të zgjidhte atë nyjë.

Ata çanin baltën pa folur, të rrethuar nga rrjeta e hollë e shiut. Nga ana e detit ndizej e fikej kohë pas kohe drita e dobët e vetëtimave. Matanë, nga xhadeja vinte uturima e një autokolone. Përtej shquante në errësi të mulliri i vogël.

Papritmas shkrepri në qiell një fishekzar jeshil. «Sa mirë, erdhëm në kohë», mendoi Xhemali dhe nxitoi hapin.

Ata u qenë afruar transheve. Kënga e ushtarëve tani dëgjohej edhe më qartë. Zërat e shokëve në krahët e këngës u gjëmonin fort në vesh.

Xhemali dhe Fetiu hidhnin hapat e fundit.

ZEMERIMI

— 1 —

Lagjja jonë e vogël ishte porta e qytetit, një portë e ulët dhe e varfër. Shtëpitë e saj përdhese shtriheshin në të dyja anët e rrugës që ndante qytetin në mes. Kush hynte në qytet, do të kalonte pa tjetër nga lagjja jonë. Neve të vegjëlve, që luanim tërë ditën në rrugë, nuk na shpëtonte asgjë. Ne ishim të parët që shikonim të gjithë ata që hynin e dilnin. Prej këndeje zë fill dhe tregimi ynë.

Atë ditë vere ne po luanim me top lecke kur në rrugën tonë dëgjuam ushtimën e një gjëmimi të largët. Menjëherë ngritëm kokën lart, po qielli ishte krejtësisht i kaltër. Gjëmimi vinte duke u shtuar nga çasti në çast dhe nuk kaluan as disa minuta dhe ndiem të na tronditej rruga nën këmbë. Gjithçka uturinte përçark. Ajri u bë i rëndë. Zogjtë fluturonin të trembur.

Ne lamë lojën dhe qëndruam në pritje. Asnjëri nuk kuptonte se ç'po ndodhte. Në fillim kujtuam se po bombardohej diku matanë maleve, po shpejt ndërruam mendje. Vlasi që i kishte ngulur sytë rrugës, thirri:

— Autokolona!

Dhe vërtet, në krye të rrugës që humbiste në horizont u duk një shenjë e zezë. Shenja e zezë u zgjat para syve tanë dhe mori një ngjyrë të papërcaktuar. Ajo vinte

me shpejtësi e potere drejt nesh. Ne mbetëm për një çast të hutuar. Kur makina e parë kaloi urën me dërrasa, ne hipëm me vrap nëpër degët e manit të xha Todit dhe që aty e pamë tërë autokolonën që hyri në qytet.

Nuk ishte hera e parë që në qytetin tonë vinte një autokolonë fashiste. Ne kishim parë kaq herë makina e karro të pushtuesve që hynin e dilnin varg, ditën dhe natën. Ata na e prishnin dhe na e ndynin keq rrugën, aq sa për disa ditë mezi luanim me top. Po kësaj here, autokolona ishte më e gjata dhe më e rënda që kishte kaluar nëpër qytetin tonë. Ishte një karvan i pafund makinash e karrosh, motoçikletash e kafshësh të ngarkuara deri në majë, po më shumë binin në sy tanket e autobлиндat, të mbyllura nga të gjitha anët me hekura. Kur kalonin këta, rruga jonë uturinte nga zhurma e rëndë dhe nxinte nga tymi.

Ne rrinim të shpërndarë nëpër degët e manit, me buzë të lëshuara e me këmbë të varura poshtë dhe vështronim gjithë sa po ndodhte në rrugë. Asnjë nuk fliste. Për një çast harruam gazet e lodrat tona.

Kjo zgjati pothuajse tërë mëngjesin. Kur kaloi topi i fundit dhe mori kthesën te muri me bark i shtëpisë së Tomkës, ne fëmijët u hodhëm nga mani poshtë dhe iu vumë pas.

Më të dalë të qytetit qëndruam dhe aty e ndoqëm me sy derisa kapërceu Qafën e Kolovicës. Pas pak, gjithë autokolona u zhduk matanë maleve duke lënë në rrugën tonë gropa të mëdha e të vogla, shtëllunga tymi e pluhuri.

Në fillim, ne nuk e morëm vesh se për ku shkonte gjithë kjo ushtri e madhe. Po kur kaluam nga berberhania e vëllait të Tomorrit dhe ndenjëm pak te dera, atëherë çdo gjë u bë e qartë.

— Pisk e kanë tani partizanët, — tha një burrë me mustaqe që po e rruante atë kohë vëllai i Tomorrit.

Ne ngritëm veshët dhe padashur futëm një këmbë në dyqan. I vëllai i Tomorrit nuk foli, po ne e vumë re se ai mori inat, sepse e hodhi shkumën e sapunit me forcë përtokë.

— Ku pyesin zogjtë nga qentë! — tha Shabani, por-

tieri i skuadrës së futbollit të qytetit, ndërsa rrinte te qoshja e dyqanit dhe pinte paprerë cigare. Burri me mustaqe u hodhi faqeve kolonjë dhe foli nëpër dhëmbë diçka që ne nuk e morëm vesh. Të tjerët nuk u ndien.

— Ikni, çuna, — thirri i vëllai i Tomorrit me zë të lartë.

— Na këta peshqirë, çoi në shtëpi t'i lajnë, — i tha pastaj Tomorrit dhe ne, pa e zgjatur u larguam. E ndiem se ai dhe shokët e tij që qenë mbledhur në dyqan ishin të mërzitur dhe ne nuk duhej t'i shqetësonim.

Po dhe në na kapi papritur një pikëllim i çuditshëm. Ecnim dhe nuk flitnim. Kaluam përmes pazarit dhe nuk na tërhoqi asgjë. Më i mërzitur nga të gjithë ishte Hasanit. Ai ë kishte babanë partizan. Tomka e dinte këtë, prandaj zuri të fishkëllente një këngë të demonstratave dhe heshtja u prish. Tomka tha:

— Ku pyesin partizanët! Ata fshihen mirë dhe hajde gjeji po deshe!

Pas këtyrë fjalëve, ne filluam të gjithë të bisedonim për partizanët. Asnjëherë nuk kishim biseduar kështu. Këtë e bëmë, në radhë të parë, për t'i hequr merakun Hasanit, po në të njëjtën kohë t'i jepnim kurajë dhe vetes.

Në krye biseduam për çështjen se a kanë shtëpi partizanët.

— Partizanët kanë shtëpi, po asnjë nuk i di. Janë sekret, — tha Vlasi.

— Partizanët s'kanë shtëpi. — tha Agimi. — Ata rrinë nëpër malet e larta. E di mirë unë këtë.

— Kush tha që rrinë vetëm nëpër male, — u hodh Tomorri. — Një fshatar që na solli dru një ditë tha se i kishte parë partizanët tek ura e Zekës, pranë xhadesë.

— Shtëpitë e partizanëve janë kudo, — tha Tomka. — Edhe në mal, edhe në fushë, edhe në fshat, edhe në qytet.

— Si, edhe në qytet!? — u habit Vlasi.

— Pse, s'janë partizanë ata që vrasin spiunët, — shpjegoi Tomka me zë të ulët dhe i vuri dorën në qafë Hasanit, që nuk ia ndante sytë.

Ne e dëgjonim Tomkën, jo vetëm se ishte më i madhi prej nesh, po dhe sepse të gjithë e dinim se ishte

i vëllai i Tomkës ai, që në demonstratë kishte mbajtur flamurin dhe që plagosur duke luftuar me grushta me fashistët.

2

Në mbrëmje, kur ne kishim marrë nga një copë bukë në dorë dhe kishim dalë në rrugë, dëgjuam të gjëmonin topat. Menjëherë vështruam njëri-tjetrin në sy dhe kafshata sa s'na mbeti në fyt. Toka u drodh nën këmbët tona. Zemra na rrihte si krah zogu.

— Po qëllojnë katilët! — foli Tomorri.

Ne të tjerët nuk folëm.

— Punë e madhe, — ia bëri Tomka. — Partizanët janë shpërndarë me kohë e me vakt.

Dhe kafshoi copën e bukës, po ne e kuptuam se e hante pa qejf. Kafshuam dhe ne të tjerët me radhë. Vetëm Hasani e mbante bukën në dorë dhe rrinte i hutuar me sytë drejtuar nga Qafa e Kolovicës.

Topat gjëmonin njëri pas tjetrit dhe sa herë gjëmonin, neve na mbeteshin dhëmbët në bukë. Hasani e kishte harruar bukën fare, bile, kur buçitën disa topa njëherësh, ai e hodhi copën e tij në hendek dhe u prish krejt në fytyrë.

Ne u hutuam fare dhe nuk di ç'do të kishim bërë, po të mos kishte folur Tomka:

— Mos u bëj budalla. Partizanët kanë ikur para se të vinin fashistët. Nuk gënjej, për kokën e babit!

Sytë e Hasanit ishin ngulur përpara dhe kishin marrë një shkëlqim që s'e kishim vënë re ndonjëherë. Tomka këputi gjysmën e bukës së tij me gjizë dhe ia zgjati Hasanit.

— Na!

— Nuk e dua, jo!

— Haje, mos u bëj budalla!

— Po nuk më hahet!

— Po nuk e hëngre, do të thotë se ke frikë nga fashistët!

- Nuk kam frikë.
- Atëherë, haje!
- Do të ha bukën time!

Hasani u përkul mbi hendek dhe mori copën e bukës së tij.

— Lëre atë, — tha me një ton urdhërues Tomka. — Është tërë pluhur!

— Lëre, lëre, — thamë ne.

— Jo, këtë do ta ha, — thirri me zë të vendosur Hasani dhe e kafshoi menjëherë copën e bukës.

— Mirë, le ta hajë, — tha Tomka. — Haje!

Dhe Hasani zuri ta gëlltiste bukën me pluhur, ndër-
sa toka vazhdonte të lëkundej gjithnjë e më tepër nga gjëmimi i topave.

3.

Atë natë në lagjen tonë nuk fjeti njeri. Dritat qenë shuar kudo dhe njerëzit rrinin e bisedonin në errësirë. Në të thyer të natës, gjëmimi i topave pushoi dhe veshët na ranë në qetësi. Po nuk kaloi shumë dhe nëna, që hynte e dilte në shtëpi, thirri:

— Ç'më shohin sytë, kështu?

Papritur errësira e dhomës ku rrinim u zbeh dhe ne pamë nga dritarja qiellin të ndezur nga flakët:

— Të poshtrit, — tha babai. — U kanë vënë zjarr fshatrave!

Këtë e pamë më mirë kur u gdhi. Gjithë faqja e maleve që i rrinin qytetit nga jugu, qe mbushur me zjarre e tym.

Ne të vegjlit, kishim hipur nëpër mure dhe me sy të çakërritur vështronim zjarret dhe tymin e zi që sillte era mbi qytetin tonë. Zjarret ishin të shpërndara gjithandej, lart e poshtë faqes së maleve, ca të mëdha e ca të vogla, dhe neve na dukeshin si egërsira, që kishin dalë nga dheu e po përpinin me flakën e tyre çdo gjë të gjallë.

Ne ua dinim emrat të gjitha atyre fshatrave, sepse kishim shkuar me raste të ndryshme. Ndonjë kishte dhe farefis të tij. Po ç'të bënim? Fashistët qenë më të këqij

se egërsirat e pyllit. Ne shtrëngonim dhëmbët, mblidhnim grushtet dhe ishim gati të shanim me fjalët më të rënda, po sytë i kishim të rëmbushur dhe nuk guxonim të hapnim gojë, se na shpëtonin lotë dhe ne nuk donim t'ia tregonim lotët njëri-tjetrit. «Pse ishin mundur partizanët? Jo, nuk ishin mundur. Partizanët nuk mundën kurrë. Ata s'i mundnin dot, as topat, as plumbat e as zjarri!» Sa bukur, tha Tomka:

— Fashistët s'kanë ç'u bëjnë partizanëve dhe djegin kasollet e fshatarëve!

— Çuna, — dëgjuam zërin e Tomorrit në rrugë, — hajdeni shpejt, hajdeni!

Ne u hodhëm nga muri dhe zbritëm në rrugë, ashtu siç qemë zbathur.

— Ç'është? — pyetëm me një gojë.

Tomorri ishte prerë në fytyrë dhe mezi merrte frymë:

— Bobo, sa njerëz po vijnë!

— Ç'njerëz, more? — pyeti Tomka.

— Ata që u janë djegur shtëpitë.

Ne kaluam nëpër qytet. Përpara shkonte Tomka. Njerëzit kudo ishin të shqetësuar. Një pjesë e tregut qe mbyllur. Në rrugë kalonin fashistë me fytyra të egërsuara. Ata i ngitnin makinat e motoçikletat si me inat dhe ishin gati të shtypnin çdo njeri që u dilte përpara.

Ne ecnim gati me vrap. Donim sa më parë të takonim vargun e fshatarëve refugjatë. Po kur arritëm te sheshi i gjësë së gjallë, na dolën përpara dy makina me fashistë që këndonin një marsh të rreptë ushtarak.

Makinat ndaluan dhe fashistët zbritën menjëherë. Në fillim zbritën vetë, pastaj hapën kapakët e karrocërisë së makinave dhe zunë të shkarkonin plaçka. Ne mezi u besuam syve. Brenda disa minutave sheshi u mbush plot me plaçka të ndryshme: me samarë e me parmenda, me kazma e plugje, me kusi e sëpata, me guna e me opinga.

Menjëherë ushtarët u kthyen në tregtarë dhe zunë të reklamnin me gjuhën e tyre llafazane plaçkat e vjedhura. Po njerëzit nuk afroheshin të blinin. Atyre u dhembnin sytë tek shikonin gjithë këtë mënxyrë.

Ne ishim shpërndarë sa andej-këndeje nëpër shesh, po

herë pas herë mblihdeshim rreth Tomkës. Pritnim që ai të sajonte ndonjë marifet, që ta nxirrnim një pjesë të mllëfit që na ishte mbledhur në gjoks.

Dhe ndodhi kështu: më në fund u gjend një njeri që filloi të blinte. Ky ishte njeriu i Muço Lëngut, tregtarit të lëkurëve në qytetin tonë. Muçoja nuk kishte guxuar të vinte vetë dhe kishte dërguar karrocierin e bashkisë.

— More Zabit, ç'bën ashtu, more Zabit..., — i thoshte xha Stathi, një burrë që pastronte pusët. — Po është gjynah, more... Këto janë të vëllezërve tanë, more Zabit.

— S'di gjë unë, s'di gjë, — ia priste Zabiti me zërin e tij të trashë pa ngritur sytë.

Neve se si na dukej ashtu ai Zabiti, si një kafshë e ndyrë, që s'kishte të ngopur.

Zabiti bleu plot sende dhe këto i mori e i vendosi në karron që kishte sjellë me vetë. Njerëzit përqark pëshpëritnin njëri me tjetrin. Ne u mblohdëm rreth Tomkës. Tomka nxori nga xhepi bizën dhe na tregoi kalin që rrinte kokulur disa hapa më tutje.

Zabiti në këtë kohë po u jepte paratë fashistëve. Tomka dhe Tomorri iu afruan kalit nga prapa dhe e shpuan në vithe. Ai ngriti këmbët përpjetë dhe maja e plaçkave mbi karrocë u rrëzua. Njerëzit përqark lëshuan një thirrje të gëzuar. Tomka mori më shumë guxim dhe faqe të gjithëve i futi majën e bizës në të ndenjtur. Atëherë ngjau ajo që nuk pritej. Kali u hodh gati i tëri përpjetë dhe ia dha vrapit duke kaluar mbi fashistët që jepnin e marrnin me Zabitin. Kafsha e egërsuar shkeli trupat e tyre dhe mori vrull për nga pazari. Tërë plaçkat zunë të bien dhe rruga u mbush me samarë e guna, me lopata e kusi. Në mes zhurmës së karrocës u dëgjuan thirrje plot lebetitje. Fashistët kërkonin ndihmë. Po asnjëri nuk afrohej. Të gjithë iknin nga sheshi për në pazar, dhe ne vraponim pas tyre.

Ishim të gëzuar. Vërtet ishim të gëzuar. S'di si ta themi ndryshe. Qemë hakmarrë dhe tërë ajo dhembje që na mundonte në gjoks, sikur na u zhduk. Fashistët e kishin pësuar. Me këtë gëzim i dolën përpara vargut të pafund të fshatarëve që po zbritnin në qytetin tonë për t'u strehuar.

LUFTA E KLASAVE

Shoku im ndofta nuk do të ma kishte treguar këtë ngjarje, në qoftë se nuk do të qemë hasur në rrugë me Polon.

— Sado që kanë kaluar shumë vjet, — zuri të më kallëzonte ai, — prapë, kur takohem me të, kujtoj një mësim që mora prej tij.

As unë nuk e di si e bëra atë hap të pamatur atëherë, por, ç'është e vërteta, isha fort i ri, akoma s'isha «i rrahur me jetën».

Ishte viti i parë a i dytë i Çlirimit; unë punoja me rininë.

Besoj të kujtohen tatimet e jashtëzakonshme që u viheshin atëherë tregtarëve. Kjo ishte një ngjarje e rëndësishme në qytetin tonë. Mendo, të shikosh me sytë e tu si shfuqizohen dita-ditës ata që deri dje kanë shtypur e sunduar. Të shikosh t'u shtetëzohen dyqanet e fabrikat, t'u merret floriri, të zbriten nga pallatet... Me hir e me pahir ata duhet t'i dorëzonin pushtetit, popullit, pasurinë që kishin ngritur me gjakun e djersën tonë.

Mua të gjitha këto më gëzonin pa masë. Por, thashë, isha akoma i ri, i parrahur mirë me jetën dhe s'do të tregoj të vërtetën po të thosha se domethënien e atyre që ndodhën atëherë i kuptova thellë menjëherë. M'u desh të rrezohesha një herë, dy, pa të mësoja disa të vërteta që hodhën bazën e botëkuptimit tim.

Ne atëherë ishim fqinjë me familjen e një tregtari.

Gjatë luftës ai kishte bërë para të madhe dhe sapo erdhi Çlirimi e tatuan me të drejtë. Mbaj mend që të gjithë u gëzuan në shtëpi kur i vajti tatimi i parë. Dhe ai e pagoi menjëherë. Por pas këtij erdhën tatime të tjera — i dyti, i treti, i katërti. Dhe ai, megjithëse me qarje e naze, prapë i pagoi. Kur i vajti i gjashti, gjyshja, që kishte qenë ca kohë shërbëtoare tek ai dhe akoma s'i kishte dalë hija e tij, m'u betua se ai ç'kish i kishte dorëzuar dhe tani veç të dorëzonte rrobat e trupit. Por ndodhi që ai e pagoi tatimin për të gjashtë herë. Tha se tani iu mbaruan taksi-ratatet, se populli hante bar e s'ia dinte. Dhe ndodhi që i vajti tatimi për të shtatën herë. Atëherë nuk mjaftoi gjyshja, por erdhi e m'u qa dhe e shoqja e tregtarit. Ajo qante e betohej, qante edhe gjyshja me të (kjo me «ungjill» në dorë). Mua se si më dukej vetja. Të them të drejtën, m'u përkëdhel sedra. Kujtoja se isha diçka dhe kisha në dorë. Këtu gabova. Heshta para ankesave të saj, u lëkunda, si të thuash, dhe pa u dhënë përgjigje dola nga shtëpia.

Pa u thelluar, duke sjellë nëpër kokë arsyetimet e dy plakave, ngjita shkallët e komitetit. Në komitet unë hyja si në shtëpinë time.

Para zyrës së shokut Jorgji kishte shumë njerëz që pritnin. Prita derisa u hap dera.

— Po ti? — ia bëri shoku Jorgji me buzë në gaz kur më pa. — Hë, ç'kishe? Hajde brenda!

Mua m'u duk sikur mora krahë dhe, si hyra brenda, u zbraz. Me një fjalë, mora nën mbrojtje tregtarin dhe garantova se thoshte të vërtetën, po ndërkaq vura re se sekretari, që e kuptoi që në krye ku desha të dilja, erdhi një çast e u bë serioz.

Kur mbarova, pashë se në bisedë e sipër hyri në dhomë një njeri i panjohur. Në këtë kohë shoku Jorgji, në vend që të më jepte përgjigje mua, i zgjati dorën të panjohurit dhe duke i hedhur një vështrim pamjes së tij, tha:

— Si je, Polo? A u lodhe ndopak?

Unë u hutova, papritur e ndjeva veten të tepërt. Shoku Jorgji sikur nuk po shqetësohej për ato që i thashë. Menjëherë e kuptova se nuk i kisha punët mirë.

— Paske rënë në rrjetën e arsytetimeve të tregtarëve,
— tha shoku Jorgji dhe, si heshti një grimë, shtoi: —
Ç'të të them unë ty, më mirë shiko Polon...

Unë mekanikisht ktheva sytë nga Poloja, po mendjen s'e kisha në vend dhe sekretari sikur e kuptoi e më tha:

— E shikon si jetojnë dhe luftojnë shokët tanë të terrenit të zbatshur e të zhveshur?...

Vura re se i panjohuri ishte veshur me një xhaka-vento të vjetër partizane, me pantallona të arnuara e në vend të këpucëve kishte vetëm çorape me lëkurë poshtë në shputat.

— Ky vjen nga fshati, — vazhdoi shoku Jorgji, — lufton atje t'u ndajë tokën e bejlerëve fshatarëve dhe nuk shqetësohet për tregtarët. Ti më mirë bëhu merak për shokët tanë. Shko tani me Polon në magazinën e sendeve të shtetëzuara dhe ndihmoje të vishet e të mbathet. Të pres pastaj.

Nuk di a ia dhashë dorën sekretarit, vetëm mbaj mend që dola me Polon. Më vonë mora vesh që Poloja ishte komunist. Duke ecur rrugës, ai më vazhdoi bisedën që kishte lënë në mes shoku Jorgji. Bile më tregoi ngjarje si luftonte armiku për të penguar Reformën Agrare. Për herë të parë dëgjova se masat që po merrte e do të merrte pushteti do të ndesheshin me një luftë të ashpër klase dhe se ne nuk duhet të zbrapseshim para qarjeve e ankimeve të tregtarëve e të kulakëve.

— Ti je i ri, — më tha, — po të takon t'i dish mirë. Mos u tremb nga lotët e tyre...

Kur vajtëm në magazinë, para nesh u hap një garderobë e pafund. Padashur vura re se sytë e Polos shndritën nga gazi. Mendova se ai u gëzua që po i jepej mundësia të vishej e të mbathej mirë. Po gabova edhe këtë herë. Dhe gabova keq.

— Ç'është kjo, more, ç'është kjo? — ia bënte Poloja sikur fliste me vete dhe s'dinte si t'i gëzohej pamjes që i shihnin sytë. Në të vërtetë gëzimin e tij unë nuk e kuptova menjëherë. Ai kishte qenë punëtor në fabrikën e lëkurëve, kishte provuar mbi kurriz të tij shtypjen e

padrejtësinë dhe ndiente një gëzim të patreguar tani që shihje një pjesë të rekuizitës së parësisë të qytetit, atë rekuizitë që i kishte shërbyer një klase e që tani po dilte nga skena e historisë, dhe fytyra e tij, tërë qenia e tij mernte një pamje që nuk përshkruhet. Kjo ishte ndofta, një ndjenjë triumfi, triumfi i popullit të çliruar mbi të pasurit, që e kishin munduar tërë jetën. Dhe këtë e pasqyronte sa s'ka më mirë fytyra e Polos punëtor. Këtë pamje unë e mora më vete për tërë jetën.

Në fund nuk dua të lë pa kujtuar që fqinji im jo vetëm që e pagoi tatimin e shtatë, po pagoi edhe të tjera. Nxori edhe floririn që kishte fshehur në kopshtin që ndante shtëpitë tona.

1911

ËNDRRA DHE PLAGË

NOVELË

Kujtimit

të Heroinës së Popullit *Liri Gero*

1977

NJE

Ajo natë maji i bëhej Ramizit sikur nuk do të mbaronte kurrë. Errësira i verbonte sytë. Hënë s'kishte dhe drita e largët e yjeve nuk arrinte deri tek ai. Partizani priste tërë ankth të gdhinte. Dhembja e hidhur e plagës ia kishte dëbuar qetësinë. Ai rrinte shtrirë në kurriz, i anuar pak majtas, me duar të lidhura mbi zverk. Rrinte ashtu, pa lëvizur, me vështrimin mbërthyer te çatia e vjetër. Sytë e lodhur herë i vagëlloheshin, herë i ndiente se i kishte të hapur. Një kllapi e lehtë ia kishte mpirë trupin dhe ia kishte hutuar fare vetëdijen. I bëhej sikur që shtrirë mbi një gur mulliri që lëvizte e qëndronte me një ritëm të çuditshëm. Sa kohë që guri vërtitej, atë e merrte gjumi dhe atëherë këpuste çdo lidhje me botën përqark; po kur guri qëndronte, ai zgjohej dhe me mundim të madh vinte në vete. Topitja e gjumit e linte ngadalë dhe ai me zor niste e kuptonte se ku ndodhej. Atëherë donte të ngrihej ndenjtur, po nuk ngrihej dot, se të gjitha fuqitë e kishin lënë. Ndiente se plaga në kofshën e djathtë e kishte vënë poshtë dhe e mundonte pa mëshirë.

Në të thyer të natës, kllapia e lëshoi. Dhembja, që deri atë kohë ia kishte sfilitur trupin, i mbeti vetëm te plaga. Partizani tundi kokën, si të desh të dëbonte ndonjë ëndërr të ligë dhe çakarriti sytë në errësirë. Errësira po zvarisej ngadalë, ashtu si zvariset mjegulla sipër një honi. Këtë ai nuk e shihte, por e ndiente, siç ndiente tani se i kishte ndodhur dhe një dyzim i vetes. Asnjëherë s'i

qe dukur trupi kaq i huaj, kaq i rëndë, kaq i tepërt. Vetëm mendimet s'e kishin braktisur. Ato prapë kishin mbetur të tijat, të afërta e të dashura. Pra, ishte ai dhe trupi i tij lënë në atë guvë të errët. Të ishte vërtet kështu?! Ramizi e mblodhi veten. Mbështeti duart dhe bëri të ngrihej. Oh... Gati sa nuk u zalis: u luhat disa herë derisa u kap pas një trari. Mezi u ngrit ndenjtur. Koka i gumëzhinte si zgjua bletësh. Trupi i qe kthyer në një barrë që e shtypte pa mëshirë. Rrinte ashtu i trubulluar dhe iu desh kohë derisa ta merrte veten dhe të kuptonte se ku ndodhej. Me sy të çapëlyer zuri të vështronte përfaqark. Po a shquante gjë në të vërtetë? Errësira prapë e hutonte dhe e sfiliste. Në atë perde të errët plasat dhe vrimat e çatisë se si i faniteshin ashtu: herë si sy kukuvojke, herë si yje që feksnin larg. Binarët dhe trarët, të ngatërruar me njëri-tjetrin, shndërroheshin në sytë e tij në qenie të gjalla. Sado që përpiquej dhe mundonte shqisat, ai s'arrinte dot t'i shquante se ç'ishin ato hije në trajta fantastike: qenie përrallore, që hiqnin valle të heshtura aty përreth, apo shokët e batalionit, që i kishin ardhur në ndihmë?!

Ramizi shqyente sytë në errësirë, po mundim i kotë! Hijet silleshin e përsilleshin përpara tij dhe ai s'ishte në gjendje as t'i qaste, as t'i dëbonte.

Partizani u përpoq sërish ta mblidhte veten. Po mendimet i rrëshqisnin dhe s'i kapte dot. Ai makth që e kishte sfilatur tërë natën i binte prapë më qafë. Mbeti ashtu për një kohë, pa i dhënë udhë vetes...

— Ëhh!

Rënkimi qe i thekshëm. Ai jehoi në veshët e Ramizit si një zë që vinte së thelli. Në fillim nuk qe në gjendje ta dallonte. I kujt ishte ai rënkim, i tij apo i asaj? Pas pak, rënkimi u përsërit. Atëherë e kuptoi. Shkundi kokën, fërkoj sytë, që i xixëlluan sapo i hapi dhe vështroi përpara. Errësira tani qe shpërndarë dhe një dritë bardhëllore hynte përmes plasave të çatisë. Tavani, ku ai kishte kaluar natën, zgjatej tani përpara tij si një korridor i ngushtë. Aty-këtu binarët dhe trarët kryqëzoheshin me njëri-tjetrin.

Vetëm një binar i hollë e ndante atë nga Kristina,

shoqja e plagosur. Ajo qëndronte në atë mënyrë, siç e kishte lënë ai disa orë më parë: e shtrirë sipër tavanit, e mbuluar me xhaketën e tij të madhe, me gërshetat e zez të mbetur jashtë, me këmbë të fshehura nën një palë pantallona ushtarake. Ramizi zgjati kokën nga binari dhe iu afrua të sëmurës. E plagosura lëvizi dhe xhaketa i rrëshqiti prapa kurrizit. Ai nuk deshë ta shqetësonte. U mbështet pas një trari dhe zuri ta sodiste që andej.

Vallë si e ndiente veten tani Kristina? Ramizi kishte hequr shumë gjersa ia kishte ndaluar gjakun. E vështron-te tani me kujdes dhe i bëhej se atë kohë diçka e sëmbonte në gjoks. Ku i kishte vajtur gjithë ajo hijeshi e gjithë ai shëndet brenda një nate? Apo mos e kishin fajin sytë e tij të lodhur nga pagjumësia? Prapë nuk i besohej dhe bënte çudi: sa që zverdhur dhe ligur, e shkreta vajzë! Qepallat dhe lama e syve i qenë nxirë. Po ajo fytyrë ashtu, me buzë të zbeta, të puthitura fort, me ato vetulla të mbledhura. Ku i kishte gropëzat e hijshme të faqeve? Çdo trajtë e fytyrës së saj rrëfente dhembje e mundim.

— Eëh... eëh...

Ajo u kollit disa herë dhe gjoksi i lëvizi nga zori. Ramizit i pikoi në zemër dhe mendimet iu këputën në mes. Ai u afrua e më drojtje u përkul mbi të.

— Kristinë, ç'ke?

Ndjeu t'i gjemonte zëri i tij në vesh. Ajo lëvizi buzët si foshnja në gjumë, po s'tha asnjë fjalë. Ai e kaloi dorën nëpër ballë dhe mollëzat e gishtave iu dogjën. E nxehta s'ishte shenjë e mirë për të plagosurën. Ky mendim e solli në vete menjëherë. Zbërtheu mëngën e këmishës së tij, grisi një copë, e lagu me ujin e pagures dhe ngadalë e me kujdes ia vuri mbi ballë. Ajo ndërkaq u drodh, po ai nuk ia hoqi. Këtë gjë e përsëriti disa herë me radhë. Dhe vetëm kur rrezet e para të diellit hynë në tavan, atij i erdhi zemra në vend: fytyra e saj tani dukej e qetë, rrudhat i qenë rralluar!

Ramizin e sulmuan sërish mendimet: a thua kjo të ishte Kristina, partizania e batalionit të tretë? Atë çast, në kokën e lodhur e të hutuar të Ramizit faniteshin dy

fytyra: njëra ishte ajo që shihte, një fytyrë me tipare të zvogëluara, të zverdhura, thujse pa jetë, me ato gërshetat e trashë, që i rrinin mbledhur mbi kokë si kurorë e zezë dhe i jepnin një pamje të rëndë, kurse tjetra, (kujtesa atë s'e gënjente) ishte fytyra e saj e vërtetë, me atë ballë të pastër, me ata sy të mëdhenj plot dritë që atij i dukeshin sikur shkëlqenin nga larg, me ato gropëzat e faqeve që i jepnin fytyrës një pamje të qeshur e të hijshme, me...

— Hiqma... — u dëgjua zëri i saj i zvergur e i dridhëruar. Ramizi ia hoqi leckën e lagur nga balli dhe mendonte: zëri i saj të qe ky, ai zë që buçiste aq fort dje në përpjekjen me gjermanët?

— Kristinë, si je?

Këtë pyetje ai e shqiptoi me zë të ulët, si të kishte frikë se mos e shqetësonte. Ajo nuk iu përgjigj menjëherë. Ky çast për Ramizin qe i rëndë. Mos nuk e dëgjoji, apo ishte aq e ligështuar sa nuk arrinte dot t'i përgjigjej? E sëmura u përcoll disa herë dhe pastaj, pa i ngritur qepallat, me zë gati të shuar, tha:

— Mirë... jaam...

Ramizi mori frymë thellë dhe fytyra pak nga pak i ndriti nga një gaz i brendshëm. Gjithë ai mundim nuk i kishte shkuar kot!

— Ku jemi këtu? — pëshpëriti ajo me një fije zëri.

Ai ngurroi një çast: si t'ia shpjegonte këtë të sëmurës?

— Jemi mbi një tavan...

Partizani u mundua të buzëqeshte, sado që ajo i kishte sytë të mbyllur.

— Ku? — Ajo për herë të parë hapi sytë.

— Mbi tavanin e një shkolle fshati.

Këto fjalë ai i tha si me ngut dhe nuk shpjegoi më gjatë. Vështrimi i saj, që i erdhi papritur, diç e trubulloi. Ajo e shikonte me miratim e kureshtje, por ai i shmangej kësaj. Mirë thonë që sytë njeriut nuk i prishen kollaj, sado të mundohet ai, ata s'humbasin. Këtë mendim, që Ramizit i kaloi nëpër kokë vetëtimthi, ia zgjuan sytë e saj të zez e të lëngëzuar. Lodhja dhe vija mavi anës nuk

ia kishin prekur bukurinë syve. Sytë e partizanes kishin atë shkëlqim të vetëtitor që merr uji i burimeve kur bie drita e parë e mëngjesit. Nuk dinte ç't'i thoshte vetes: a qenë lotë ata, apo i kishte ashtu vetvetiu?! Ç'sy ishin ata ashtu?! Vetëm tani ai e besoi me gjithë mend se ajo ishte Kristina, partizania e bukur e batalionit të tretë!

Në fytyrën e saj rrezëlliu një buzëqeshje e zbetë, që i lëvizte nga buzët te sytë.

— Po si ndodhi kjo?

Ramizi nuk i përgjigj menjëherë. U largua ca nga e sëmura dhe shpiu pak trupin.

— Një histori e tërë, Kristinë...

— Si?

— Histori e gjatë thashë...

Ai donte të vazhdonte më tej, po i mbeti fjala në gojë. Padashur e lëndoi plagën keq. Ajo i kishte pulitur sytë atë çast dhe nuk e vuri re.

— Unë s'mbaj mend asgjë!

Ai kafshoi buzën e poshtme dhe nuk e dha veten. Kristinës nuk i pritej derisa ai t'ia tregonte.

— Ndodhi fare papritur. Kur ti u plagose dhe humbe ndjenjat, komandanti më urdhëroi të të tërhiqja nga vija e zjarrit...

Ai zuri të tregonte dhe Kristinës iu kujtuan me radhë të gjitha si kishin ngjarë para se të plagosej...

...Urdhrin e kishin marrë që në darkë. Do të goditnin një autokolonë që vinte nga jugu. Këtë aksion do ta kryenin partizanët e batalionit të tretë. Një natë përpara, atyre u kishin dhënë detyrën. Kristina gjithë atë natë pothuaj nuk kishte fjetur. Nuk i thoshin shaka. Ajo do të merrte pjesë për herë të parë në një betejë!

Të nesërmen qenë nisur me yje. Nuk kishte aguar ende, kur mbërritën në vendin e caktuar. Vendi që zunë shtrihej në dy shpate kodrinash. Xhadeja gjarpëronte në mes si shtrat lumi. Pa humbur kohë, partizanët qenë ndarë nëpër pozicione. Kristinën komandanti e kishte vendosur pas një shkëmbi të madh. Ky shkëmb ishte kufiri në mes kompanisë së saj dhe kompanisë së dytë. Përbri ajo kishte pozicionin e Ramizit. Atë ditë u kishin caktuar

të dyve një detyrë të përbashkët. Do të qëllonin para-
rojnë e autokolonës. Kjo do të jepte shenjën e goditjes së
përgjithshme. Shenja që një bombë e tri të shtëna pushke.
Të shtënat do t'i bënte Kristina. Bombën do ta hidhte
Ramizi.

Kishin pritur më shumë se sa mendonin. Autokolona
që vonuar. Kishte mbërritur vetëm aty nga dreka. Dhe
këtë sikur ta kishte bërë për inat të Kristinës që s'i pri-
tej. Ishte beteja e saj e parë!

Kristina e kishte vënë re që larg armikun. Autokolona
rrëshqiste nëpër xhade, duke u përdredhur si një bollë
gjigante. Ajo po afrohej, dhe sa më shumë afrohej, aq
më tepër ushtonin kodrat përreth nga rrapëllima e mo-
torave. Mbi të gjitha dëgjohej zhaurima e tankeve, një
zhurmë, si të thyheshin qiejtë copë. Padashur ajo mbylli
veshët me duar. Ramizi e vuri re dhe buzëqeshi. Hoqi dyl-
bitë nga qafa dhe ia dha. Ajo i shtrëngoi në sy dhe zuri
të shikonte përtej. Në krye printe një makinë e hapur,
e mbushur me ushtarë që rrinin më këmbë. Përpara, mbi
kabinën e shoferit, nxinte një mitraloz. Kristina i hoqi
dylbitë menjëherë. As ajo s'e kuptoi pse e bëri këtë, uli
kockën dhe kërrusi trupin. Ndoshta u tremb. Ndoshta pan-
dehu se humbi kohë. Po ai që një çast, një e marrur
frymë. Po tamam atë çast ajo e pa armikun të gjallë, fare
pranë vetes. E pa ashtu siç ishte: të egër, të armatosur
deri në dhëmbë!

Kur makinat u afruan, ajo mbylli sytë. Ndiante se
diçka e shtrëngonte në grykë. Për një çast nuk mori frymë,
u mpi, si t'i qenë sulur një tufë grerëzash. Po kjo kishte
ndodhur në fillim fare. Ramizi e kuptoi gjendjen e saj.
Dhe i dha kurajë. Kurajë si partizan i vjetër e i stërvitur
në këto punë. Ndërkaq, ajo e mori veten shpejt. Solli
ndër mend shumë gjëra dhe i erdhën forca. Forca për ta
parë armikun në sy. Forca për të shtrënguar armën. Forca
për t'u ndeshur me vdekjen. Çasti i hutimit kishte marrë
fund.

Atë kohë autokolona kishte hyrë e gjitha në kurthin
partizan. Kristina ndiqte me sy Ramizin. Ai vështronte
gjithnjë përpara. Sytë sa nuk i lëshonin xixa. Vetullat e

buzët i qenë shtrënguar fort. Një damar i kaltëryer i rrihte me hov në gushë. Kishte ardhur çasti vendimtar. Partizanët, të shtrirë nëpër pozicione, ishin gati. Këtë e kuptoi menjëherë Kristina. U dëgjua urdhri i komandantit. Atëherë ajo s'priti më. Gjaku i vërshoi në kokë. Lëvizi pushkën, e ngriti përpjetë dhe shtiu tri herë. Sakaq dëgjoi krismat. Vërtet ishin të sajat?! Pastaj bomba e e Ramizit. Fill pas kësaj, nisi beteja. Zjarri partizan u derdh me furi nga të gjitha anët. Diellin atë çast e mbuloi tymi i predhave dhe pluhuri. Kristina vuri re se tërë ai vargua çeliku i motorizuar qëndroi në vend. Këtë ajo e pa mirë, sidomos kur plasën minat që kishin vënë shokët në rrugë. Po më mirë akoma pa gjermanët që hidheshin të lemerisur nga makinat. Dëgjoi zëra, thirrje e klithma të egra. Ata u shpërndanë si një lukuni ujqish. Nga të katër anët shungullonin bombat, kërkëllinin mitralozët, fishkëllenin plumbat e pushkëve, jehonte zhurma e makinave. Kristina qëllonte pareshtur nga prapa shkëmbit. Nuk kishte kohë as të përcillej. Nuk ia vinte veshin as këshillës së Ramizit që i thoshte herë pas here: «Mos iu zbulo armikut!» I dukej sikur kishte përpara një kope egërsirash. Asgjë s'i bënin më përshtypje as plumbat që i fishkëllenin në vesh, as zjarri i makinave që kishte marrë qiellin, as tymi e as era e athët e barutit... E ndiente veten tamam partizane... Ishte ballë për ballë me armiqtë. Dhe luftonte. luftonte si gjithë të tjerët...

Kështu Kristina kishte hyrë në betejën e parë. Dhe mjafton të hysh. Pastaj, urrejtja për armikun të shtyn përpara. Partizanët u hodhën në sulm. Po Kristina nuk mund të shkonte bashkë me ta. Papritur ndjeu një dhembje të hidhur në shpatullën e majtë. Dhe, kundër dëshirës, u rrëzua. E mbyti gjaku. Sytë iu errën. Pastaj dikush e ngriti. Vetëm kaq. Se ç'ndodhi më pas, Kristina nuk e mori vesh...

— Në fillim i kundërshtova komandantit — tregonte Ramizi. — Doja të luftoja gjer në fund. Më ishte ndezur gjaku dhe, kur të ndizet gjaku, s'e mban dot veten. Po ti e njuh komandantin tonë. Ai i ka fjalët të pakta. M'u desh të zbatoja urdhrin. Rrëshqita barkas dhe t'u afrova.

Kur të pashë ashtu të shtrirë e të gjakosur pas atij shkëmbi, e kuptova menjëherë se ai kishte të drejtë. Të mora në kurriz dhe zvarë-zvarë zura të largohesha nga vija e zjarrit. Kur pandeha se e kishim kaluar rrezikun, papritur më kapi një plumb qorr në kofshë. U inatosa po s'kisha ç'të bëja. Vazhdova tërheqjen. Në fillim vendi na ndihmoi, se vinte tatëpjetë dhe e pata lehtë të të mbaja. Po pastaj toka ishte e dystë dhe m'u desh të të merrja në krahë. S'kisha ç'të bëja. Dhe sa më shumë kalonte koha, aq më tepër rëndohej trupi yt. S'më linte rehat dhe plaga ime. Në një farë vendi qëndrova. Mora ca bar fushe dhe ta vura te plaga, që të ndalej gjaku...

Kristina kishte hapur sytë. Ai e ndërpreu tregimin një hop dhe u përcooll disa herë. Asaj sepse nofullat e tij iu dukën më të mëdha se ç'i kishte.

— Më mendoj shumë një gardh, më besdisnin shkurret — vijonte ai me një zë të lodhur. — Kisha edhe armët me vete, që peshonin dhe ato... Pastaj edhe plaga sa vinte e më ftohej. Shtyhesha me shpirt ndër dhëmbë. Kur mbërritëm buzë fshatit, tek jemi tani, aty s'munda më. Të lëshova në lëndinë dhe u shtriva të merrja veten...

Ramizi qëndroi prapë dhe nxori një psherëtimë të rëndë. Ajo që tërhequr pas tregimit dhe nuk vinte re se ç'po i ndodhte shokut të saj. Sytë herë i hapte përgjysmë, herë i mbyllte.

— Po pastaj?

— Pastaj... shyqyr takuam një plakë... — Ai tani bënte pauza dhe përpiquej të mos e lëshonte veten. — Kishte dalë... të merrte kalin... Ta merrte, se lufta që bëhej në xhade... Unë s'e pandeha... Ajo u tremb... Po pastaj na njohu... Të vumë ty sipër kalit, pastaj erdhëm në fshat... Erdhëm... ja këtu... Eë, pastaj plakës i vajti mendja... po, i vajti mirë... Në kasolle mund të na gjenin... — Tani ai gati sa s'i rrokëzonte fjalët. — Pastaj u ngjitëm... në... tavan... Na... ngjiti ajo... plaka... se ku gjeti një shkallë.

— Po ç'është ajo grua? — e pyeti Kristina, që donte të dinte atë çast çdo gjë.

Ai mbështeti mjekrën në gjoks, po ajo nuk e pa.

— Një grua... nga... fshati. — Fjalët e tij tani dilnin si psherëtimë. Sytë i koteshin dhe nuk ngopej dot me frymë.

— Nëna e ndonjë partizani, ëë?

— Mbase ...— Ai deshi të thoshte më shumë, po atë çast iu bë sikur i qe sosur zëri.

Ajo vazhdonte ta pyeste pa të keq, me një zë të dhembshur:

— Po shokët si do të jenë ndarë?

Ramizi s'mundi të përgjigjej menjëherë: qiellza i qe tharë dhe i digjte. Në vend të tij, u përgjigj ajo gjithë duf: — Me siguri autokolona do t'i ketë lënë koskat në xhade!

Ra një heshtje e rëndë. Po, ndërsa fytyra e tij qe zverdhur dhe qe vrenjtur, Kristina qe çelur pak.

Ai mblodhi forcat e fundit që i kishin mbetur, si të shkëpuste një pjesë nga vetja, nxori vetëm një fjalë:

— Doo të presim...

— Këtu do të presim?

— Ëëë...

Ramizi lëshoi një tingull të trubullt, si të ishte vu-
vosur papritur. Ajo prapë s'po i binte më të. Por ai s'ishte hiç mirë. Ndiante se gjuha dhe buzët i qenë trashur. Zëri i vinte deri te qiellza dhe aty i shuhej. Një darë sikur ia shtrëngonte pa mëshirë trupin, koskat. Koken s'e kishte të vetën. Veshët i bubullonin dhe i buçisnin. Sytë i qenë mbyllur si me zamkë..

— Ramiz!

— ...

— Ramiz!

Prapë heshtje. Ajo ngriti qepallat dhe u drodh menjëherë. Ç'po shihte ashtu? Ramizi po flinte ndenjuri: koka i qe rrëzuar në gjoks dhe flokët i kishin rënë mbi ballë. Ajo shqeu sytë dhe klithi e lebetitur:

— Ramiz, ç'ke kështu?

Pa mbaruar mirë fjalën Kristina, ai menjëherë u rrëzua. Për pak sa nuk ra mbi të. Ra me gjoks përpara. Ajo u drodh e tëra. Provoi të ngrihej, po nuk ishte kollaj.

Atëherë luftoi me ato forca që i kishin mbetur. Luftoi me veten, me dobësinë, me dhembjen. Mezi u çua përgjysmë dhe iu qas shokut. Një rreze dielli, që hynte nga një e çarë e tavanit, hodhi dritë mbi fytyrën e partizanit. Ajo vuri re ballin e tij të djersitur, buzët e zhuritura, tiparet e reshkura. Ai ishte i parruar, me nofulla pak të dala, me mustaqe të zeza, që i mbulonin buzën e sipërme. E gjithë kjo pamje e pikëlloi vajzën. Mendoi vetëm një gjë: sa qe munduar ai për ta mbajtur veten! Po ajo ç'të bënte? Ja ngriti me kujdes kokën që i kishte rënë gati përtokë dhe ia vuri mbi gjerdanin e fishekëve, pastaj i preku fytyrën, i rregulloi flokët dhe zuri ta vështronte e hutuar...

— Ramiz, ç'pate, vëlla?

Ai kërveshi fytyrën, po s'foli. Ajo dëgjoi frymëmarrjen e tij të vështirë dhe u tremb. Diçka e shtrëngoi në gjoks.

«Unë e kam fajin... — arsyetonte ajo me vete. — Tërë natën ai ngeli pa gjumë për mua... Dhe, unë bu-dallaqja su kujtova fare...»

Ai qëndronte shtrirë gati pa ndjenja, me qillota të gjakosura, me këmishë të grisur. Cirkat e gjakut, tani të thara, të përhapura nëpër rrobat e tij e ngatërronin vajzën. Ajo akoma nuk e dinte mirë se në ç'vend qe plagosur ai. Përkulte trupin mbi të dhe hetonte nga afër. E prekte lehtë me gishtërinj, si të qe e verbër. Vetëm gjaku që kishte rënë përtokë e bëri ta diktonte vendin e plagës. Lecka me të cilën kishte lidhur vendin e plagosur i qe mbledhur shuk në kofshën e djathtë. Ajo kafshoi buzën e poshtme dhe rrudhi sytë. Vështronte plagën dhe s'dinte nga t'ia fillonte. Rrinte si e shastisur, me fytyrë të çoroditur, e pikëlluar, si t'i qe hapur edhe një plagë tjetër në trup.

— Ramiz!

Kjo thirrje asaj i shpëtoi, i doli vetvetiu.

Ai rënkoi mbyturazi dhe buzët i fërshëllyen.

Kristina i vuri dorën në ballë dhe zuri ta fërkonte lehtë e lehtë. Frymëmarrja e tij e rëndë i kumbonte në vesh. As ajo nuk dinte sa do të qëndronte kështu, po

të mos qe dëgjuar nga jashtë një zhurmë. Ishte zhurmë e shurdhër. Ajo s'e mori vesh menjëherë. Vetëm kur u afrua, dalloj mirë hapat e një njeriu. Dikush po vinte!

— Ramiz! — thirri ajo, ndërsa me dorën e djathtë kapi automatikun.

Partizani lëvizi lehtë. Vetëm kaq. Sepse as kokën s'e ngriti, as sytë s'i hapi. Kristinës i mbeti automatiku në dorë. Ç'të bënte më parë? Të kujdesej për shokun, të pregatiste automatikun, apo të vështronte jashtë. Dora e majtë s'i punonte. Po atëherë?

— Ramiz! — i thirri me zë të ulët nga afër.

Sa ngriti sytë Kristina, nga e hapura e tavanit u duk një kokë gruaje, lidhur me shami të zezë. Pastaj u dëgjua zëri i saj:

— Ç'bëni, bijtë e nënës?

Partizanes për një çast i ngeli vështrimi i mbërthyer në fund të tavanit. Sytë e saj rrëfenin më shumë habi se sa frikë. Plaka mbështeti dorën pas një binari, i dha trupit përpjetë dhe me një shkathësi që s'i shkante moshës së saj, u ngjit sipër. Kristina nuk e kishte parë ndonjëherë këtë grua të shkurtër e të imtë, veshur në të zeza, që vinte drejt saj me një shportë në dorë.

Plaka e rroku vajzën më qafë dhe zuri ta përkëdhelte si të qe një fëmijë e mitur.

— Po si je, moj bijë, si je? — përsëriste ajo me dhembisuri.

Kristina u ngror dhe u çel.

— Ramizi s'është mirë, nënë! Se ç'pati tani në mëngjes.

Plaka, e qetë, iu afrua të sëmurit dhe e ktheu mbarë. Rregulloi vendin për qark dhe zuri t'i fërkonte ballin e qafën. Ndërkohë bisedonte:

— Gjithë natën e natës te ju e kam pasur mendjen. Thosha: si do të jenë bijtë e nënës?... Po ju mirë qenki, shyqyr!...

Kristina e shikonte drejt e në sy.

— Jemi mirë, sepse na u gjende ti, nënë. Ne nuk do të të harrojmë kurrë...

— U, ç'kam bërë unë? Ju bëtë, mojë bijë, gjithë atë

luftë të madhe. I vutë zjarrin tërë asaj lubie... Na marçin të keqen, na marçin... dushmanët e djallit!... Po na prishin lulen e rinisë, po na prishin vatanin...

Në fytyrën e vajzës u shua drita dhe ra një hije e lehtë.

— Po nuk e kanë të gjatë, nënë!

— Ashtu, xhan, ashtu... Luftojnë trimat.

Heshtën të dyja për një çast. Plaka mendonte për trimërinë e partizanëve, vajza për bujarinë e kësaj gruaje të thjeshtë. Pastaj Kristina e ktheu bisedën:

— Ramizi s'është mirë. Gjithë natën është marrë me mua dhe s'ka pasur kujdes fare për vete...

Plaka nuk bëri zë. Hoqi dorën nga i sëmuri dhe afroi shportën që kishte sjellë me vete.

— Ju ka prurë nëna ç'i ndodhej. Të kisha gjë më të mirë, s'e lija pa jua prurë. Po ka ardhur kohë e keqe. I gjithë fshati ka marrë pyllin. Kam mbetur vetëm unë këtu. Më lanë ata të këshillit. «Rri ti, Dafinë», më thanë. Dhe unë ndenja.

Pastaj ajo zuri të zbrazte shportën:

— Ja, moj vajzë, ca misërnike e djathë, ca pala fiku... një çikë raki, pak mullagë që mos t'ju majisen plagët... Këto m'u ndodhën...

Kristina rrinte dhe e vështronte e pikëlluar atë nënë partizane. Ajo sepse i nxirrte mallin e gjyshes. E mallëngjente kujdesi i saj. I dukej sikur atë çast gjithë dashuria e nënave ishte mbledhur në fytyrën plot rrudha të asaj gruaje të imtë.

Plaka u kthye nga Ramizi dhe zuri t'i zbulonte plagën. Ai ende s'ishte përmendur. Dukej që ishte i munduar tej masës.

— Ç'ka bërë kështu, i bekuari, që e ka lënë veten? I ka ecur gjak shumë, prandaj është bërë behot...

Ajo i çori pantallonat të plagosurit, aty ku e kishte zënë plumbi. Ramizi s'bënte zë fare, vetëm kohë pas kohe lëvizte lehtas trupin dhe shtrëngonte fytyrën. Kristina shihte herë shokun e saj, herë atë grua të mirë dhe rrinte mënjanë, e druajtur.

Plaka çdo gjë e bënte me gjakftohtësinë e njeriut të

mësuar në këto punë. Pasi ia pastroi plagën, ia lau me raki, ia mbuloi me mullaga e ia lidhi me kujdes. Kristina bënte çudi me Ramizin që nuk rënkoi asnjëherë.

— Tani shtrihu ti. Edhe me ty kam avaze... — iu drejtua vajzës plaka, duke i vënë dorën në sup.

Ajo u zhvesh pjesërisht, hoqi njerën mëngë të këmishës dhe u shtri anësh, më të djathtë:

«Po kjo qenka më keq, i duken brinjët», mendoi plaka.

Kristina rrinte me kurriz të kthyer, pak e përkulur dhe nuk shihte se çfarë bënte plaka. Ndiante vetëm dhembjen që i derdhej nëpër trup si një lëng i zjarrtë. Plaka ia prekte plagën me dorë dhe vajzës i ngjante sikur një egërsirë e kafshonte pa mëshirë në shpatull. Po ajo e mbyllte dhembjen në zemër dhe nuk e jepte veten. Ç'do të thoshte ajo grua, sikur Kristina të ankohej? Prandaj duronte, duke copëtuar buzët dhe gishtërinjtë e duarve.

Kur plaka filloi t'ia lidhte plagën, atëherë e ndjeu veten të lehtësuar.

— Mos ki gajle... Do të shërohesh, të keqen nëna... Njeriu është i fortë...

Kristina u kthye mbarë e u shtri. Një buzëqeshje e lodhur iu ndeh në fytyrë. Rrinte dhe vështronte plot mirënjohje. Për një çast sytë i vetëtinë. Diçka kishte ndryshuar. Plaka e kuptoi këtë dhe e pyeti enkas:

— Të dukem e re kështu, ë?

Vajzës i erdhi e papritur kjo pyetje dhe qeshi me zë, ndërsa në faqet iu sajuan dy gropëza.

— Se si më dukesh...

— Si të dukem?

— E gjeta! — i a bëri vajza tërë gaz. — Ku e paske shaminë?

— Shaminë ta fala ty, moj bijë.

Kristina ktheu sytë nga vetja dhe pa shaminë e zezë të plakës të lidhur në gjoksin e saj. U mallëngjye, po s'gjeti asnjë fjalë aty për aty që t'ia thoshte. Ndjeu sikur i gjithë dielli kishte hyrë nën atë tavan të vogël. Tundi kokën dhe e vështroi gjatë, plot miratim.

— Nënë, ne do të të mundojmë prapë!

Plaka hapi sytë.

— Do të më mundoni? Po ku ta gjej. Fol, bijë ç'keni?

— Ky është mundimi i fundit. Do t'u thuash atyre të këshillit të fshatit të venë të lajmërojnë shokët tanë e t'u thonë ku gjendemi.

— Posi, moj bijë, posi. Fjalë është ajo! Unë u dërgova fjalë, po do të vete dhe vetë.

Pastaj plaka s'foli më. I dukej sikur do ta mundonte vajzën e plagosur. Rrinte kundrejt saj e heshtur dhe e menduar, me duar të lidhura në prehër, e kërrusur. Fytyra e rrudhur, sytë e vegjël, po të ndritshëm, flokët e zbardhur e të prishur pak thoshin shumë gjëra. Kristina e shikonte dhe një mendim i bukur i sillej nëpër kokë:

«Populli kurrë s'na lë rrugëve, populli na do me shpirt... Kështu dhe vdekja të bëhet e lehtë, shoku komisar!»

Kaq mundi të mendonte ajo. Pas mjekimit, për herë të parë trupi i saj i lodhur po qetësohej. I bëhej sikur një dorë e përkëdhelte. Qepallat iu rënduan. Sytë zunë t'i mjegulloheshin. Fytyra e plakës iu ngatërrua me fytyra të tjera. Ndjeu se nuk e kishte më veten në dorë. Nuk vonoi dhe e kapi gjumi.

Plaka u ngrit ngadalë, i mbuloi të sëmuret, u vuri shportën te koka dhe lehtë e me kujdes, si të shkelte mbi kashtë, kaloi nëpër tavan dhe zbriti poshtë.

DY

Aty nga pasdreka ata u zgjuan. Në fillim sekush e dinte shokun në gjumë. Në të vërtetë të dy qenë zgjuar thujse në një kohë dhe rrinin e prisnin. Ramizi s'kishte ç'të bënte dhe dashur padashur numëronte tjegullat e çatisë. Kristina, ashtu e shtrirë, me kurriz kthyer nga ai, përpiquej të shihte nga strehët e hapura. Dukej vetëm një copë e oborrit të shkollës, ku gjelbëronte bari. Nga jashtë vinin zhurma të lehta. Dëgjohej fëshfëritja e gjetheve të reja dhe zërat e shpendve. Diku larg gagërinin patat dhe rosat. Një fillad i ëmbël i sillte kundërmimin e luleve. Pranvera nusëronte jashtë plot stoli. Po brenda, në atë tavan gjysmë të errët, ajo e kishte vështirë të hynte. Këtë ngazëllim të natyrës Kristina e kundronte vetëm nga larg. Afër ndiente vetëm një harabel që vërtitej nëpër strehët duke cicëruar. Ajo e dëgjonte zogun, po nuk e vinte re dhe kjo e mundonte. Shpendi i vogël fshihej nëpër hatullat e çatisë, nëpër vrimat dhe të çarat e strehës, nëpër tjegullat. Dukej sikur këtë e bënte enkas!

Ramizi dëgjoi që ajo lëvizi dhe ktheu kokën. Ajo ishte ngritur përgjysmë. Sytë i lëshonin dritë. Ai nuk po merrte vesh se ç'po ndodhte.

— Kristinë!

Ramizi i foli në çastin kur ajo e vuri re mirë zogun. Vajza, pa kthyer kokën, thërriste si fëmijë e gëzuar:

— Ja, shikoje, shikoje, atje!... Sa bukur!... E sheh, Ramiz?

— E shoh... — iu gjegj ai i habitur, jo aq nga zogu,

sa nga gëzimi i papritur i Kristinës. Gëzimi ia hijeshonte gropëzat e faqeve. Zogu kërcente nëpër tavan, përplaste krahët, tundte kokën, fluturonte andej-këndej. Kristina e ndiqte gjithë gaz e kërshtëri:

— Tani s'del dot... E sheh, e harroi rrugën...

Zogu vërtet s'po e gjente rrugën për të dalë. Sulej sa në një anë në tjetrën dhe kthehej përsëri mbrapsht.

— Po le të qëndrojnë këtu, të bëhemi tre shokë... — ia pat Ramizi. Ajo qeshi, po mendjen e kishte prapë te shpendi. Partizani mendonte për gazin e Kristinës: «Sa i zbukuron gazi disa njerëz!»

Kur harabeli u largua vajza u shtri si më parë. Pastaj ktheu fytyrën nga Ramizi dhe foli e menduar:

— M'u kujtuan pëllumbat e shtëpisë sime, Ramiz... Nuk di sa çifte kanë mbetur tani. Po kur isha unë, kishim nja dhjetë. Na i ka lënë babai, ndjesë pastë. Ai i kishte shumë qejf, po dhe ne fëmijët i deshëm pa masë. Unë për veten time i dua shumë zogjtë, sidomos... — Një kollë e thatë e ndërpreu vajzën — ...pëllumbat. Ti nuk e beson, Ramiz, sa zog i mirë është pëllumbi... Sa i dashur, sa i kuptueshëm!... Asnjë shpend nuk afrohet sa afrohet pëllumbi. — Heshti një hop. — Kur isha në shtëpi, çdo mëngjes u jepja për të ngrënë. Kisha kënaqësi të madhe kur e bëja këtë. Ata s'kishin hiç frikë nga unë. E di, sa dilja në oborr, më turreshin të gjithë dhe më qëndronin nëpër duar, në sup, në kokë... Unë i shtrëngoja në gushë, i përkëdhelja... i puthja, vërtet i puthja... mos qesh! Ata gugatnin, më zgjasnin sqepin, donin të thoshin diçka, po ja që unë s'i merrja vesh...

Ramizi rrinte mbështetur, me kokën në pëllëmbën e dorës së djathtë e, tek e dëgjonte, kafshonte herë pas here një fije kashte.

— Po ti, Ramiz, a i ke qejf pëllumbat?

«A i ke qejf pëllumbat?» — Ramizi u zu ngushtë.

Ai kishte kaq kohë maleve dhe s'i kishte shkuar ndonjëherë mendja te pëllumbat. Të tjera dëshira e tërhiqnin tani atë. Mendimet e tij në këtë kohë kishin të bënin me njerëzit dhe jo me zogjtë.

— Si të të them... — tha ai mëdyshas. — Nuk më ka

rastisur ndonjëherë të merrem me pëllumba... po me gjithë mend është shpend i bukur. Edhe mua më pëlqen. Bile më kujtohet një ngjarje nga koha e shkollës. Ca shokë të mi vranë dy pëllumba dhe i hëngrën. Nuk e mbaj mend mirë, a ishin pëllumba të butë a të egër...

— Ii... sa keq! — ia priti menjëherë Kristina e prekur. — Babai thoshte se pëllumbi zog është, po nga shpirti është njeri. Ti, do ta haje?

Ramizi nuk iu përgjigj menjëherë. Deshi të mos ia prishte e t'i thoshte: «Jo, nuk do ta haja», po prapë iu përgjigj drejt:

— Shokët e mi ndoshta s'bënë mirë që i hëngrën pëllumbat atëherë. Po tani është ndryshe. Lufta e ha edhe pëllumbin...

— Si e ha? — u hodh ajo e habitur me gjithë mend.

Pas përgjigjes së parë, tani partizani i vjetër e kishte më lehtë. Ai ngriti pak trupin dhe u mbështet me bërryl përtokë.

— E ha si hahen gjithë shpendët. Njerëzit nga nevoja mund t'i hanë edhe pëllumbat. Mjafton të mbeten gjallë.

— Unë them se s'duhen ngrënë, Ramiz — kundërshtoi ajo. — Ja ti, për shembull do t'i haje?

— Unë?

— Po, ti...

— Unë të thashë që nuk e ha, sepse s'e kam provuar ndonjëherë. Po s'e kam fjalën te vetja. Ti ke të drejtë që flet kështu. Je e re në batalion, e paargasur mirë me vështirësitë... Pa pyet të tjerët, që kanë kaluar Operacionin e Dimrit! — Ramizi mori hov. E hodhi fijen e kashës që mbante në mes të dhëmbëve dhe ngriti zërin: — Gjatë Operacionit mezi gjenim të hanim. Bie fjala, në të batalionit atëherë kemi ndenjor me nga një javë pa bukë dhe jemi detyruar të hanim mish kali. Kemi therur kuajt tanë, se nuk kishim ç'të bënim. E si të mos hanim mish pëllumbi!? Po thuaj që ishim në mal, qe dimër dhe s'kishte pëllumba atyre anëve, pa edhe ata do t'i kishim ngrënë që të mos vdisnim...

Ai kishte folur aq i bindur, sa Kristina e ndiente tani veten të pafuqishme për ta kundërshtuar. Vrulli i saj

i parë dalngadalë erdhi e u fashit. Ajo puliti sytë dhe s'foli më. Heshtën të dy. Ishte biseda e parë që bënin dhe sikur nuk qenë të një mendjeje. Ai vështronte me bisht të syrit, kurse ajo sikur nuk merrte guximin t'i ngrinte sytë. Secili nuk donte ta prekte shokun.

Papritur, Kristina filloi të gulçonte nga lemza. Ramizi buzëqeshi. Tani mund ta lidhte fare mirë bisedën e këputur në mes.

— Se kush të kujton, Kristinë! — tha ai pa e ngritur kokën dhe vështroi sërish nga ajo.

— E kush tjetër, veç shokëve!... — ia priti vajza.

— Ata, ndoshta na kërkojnë — tha partizani i menduar — dhe s'u vete mendja që ne jemi fshehur mbi këtë tavan...

— Unë i thashë prapë plakës, Ramiz. Mbase arrin t'i lajmërojë shpejt.

— Mirë bëre, po me sa shoh unë, tani është shumë e vështirë. Si duket batalioni e ka ndërruar drejtimin. Urdhri ishte që t'i shmangeshim armikut pas goditjes. Kushedi ç'pengesa kanë dalë. Ndoshta, gjermanët janë vendosur në këto anë...

— Po shokët, si thua, a janë vënë për të na kërkuar?

— Sigurisht. Po druhem mos pandehin se kemi dalë jashtë rrezikut dhe derisa ta marrin vesh nga shokët e këshillit do të kalojnë dy-tri ditë...

— Dy-tri ditë?!

— Po, pse, shumë të duken?

— Jo — tha ajo me gjysmë zëri, sikur të kishte bërë gabim që e pyeti ashtu.

Përsëri u ndeh heshtja në mes tyre. Ramizi nuk qe mësuar të heshtte ashtu, e aq më tepër të qëndronte shtrirë. Kjo bile e nervozonte.

Nuk iu durua më shtrirë dhe u ngrit përgjysmë. Nxori nga brezi revolen, një nagant të ri me dorezë fildishë dhe nisi ta zbërthente. Ajo e vuri re:

— Ç'bën ashtu? — e pyeti.

— Prgatitem... — u përgjigj ai kokulur.

— Për çfarë?

— Për luftë.

— Për luftë?!

— Pse, të duket çudi!? — qeshi Ramizi duke ngritur sytë. — Jemi në prapavijat e armikut. Ne edhe këtu mbetemi partizanë.

Kristina nuk foli. U kthye nga shoku dhe zuri ta vështronte. Ai e kishte zbërthyer armën dhe po e pas-tronte me kujdes. Rrinte ca i kërrusur, me kaçurrelat e zez të rënë mbi ballë, me buzën e poshtme pak të dalë. Sytë e gjallë e të shkëlqyer sikur xixëllonin në gjysmë-mugëtirën e tavanit. Ajo e vështronte me vëmendje, ndër-sa ai vazhdonte punën i menduar. Në fillim, Kristina ndoqi veprimet e tij, lëvizjet e shpejta e të sigurta, po pastaj, pa u kuptuar, u tërhoq nga pamja. Iu duk për një çast sikur po e shihte Ramizin për herë të parë. Dhe kjo ngjan në jetë. Mundet që një njeri ta shohësh çdo ditë nga larg, po nuk ke rast të rrish pranë me të dhe atë-herë ndodh që, kur e sheh nga afër, të duket si një fytyrë e re. Një njeri tjetër i dukej tani Kristinës Ramizi. E kishte parë sa herë në batalion, veçse rrallë e tek i kishte qëlluar të rrinte e të bisedonte me të. Ata përshëndete-shin nga larg, ashtu si mund të përshëndeten dy të njo-hur. Po a mund të njihet njeriu vetëm me kaq? Kurse tani ata ishin nën një çati, pranë njëri-tjetrit. Ishin kaq afër, dhe s'kishte si të mos e shikonte mirë. Trupi i tij i madh e i lartë, gjoksi i dalë pak përpara, shpatullat e gjera, këmbët e gjata, të gjitha këto, që binin menjë-herë në sy, e preknin Kristinën. I dukej vetja e vogël para tij, si të qe vajzë e mitur. Po në të njëjtën kohë, pranë Ramizit ajo bëhej trime. A nuk ishte Ramizi ai që i shpëtoi jetën? E kush mund të sakrifikonte kështu, veç shokut të Luftës? Ja pra, se çfarë shoku kishte Kris-tina: një njeri të fortë e me zemër të madhe!

Fytyra e tij pak e hequr, me atë hundën kosore, sado e parruar dhe me flokë të pakrehur, e tërhiqte. Dukej sikur tek ai ishin bashkuar burrëria dhe rinia, që ajo nuk dinte t'i shquante mirë nga njëra-tjetra. Aty ngjante pak i ashpër, aty dukej i butë. Sytë i kishte të gjallë e të bu-kur, po vështrimi i tyre i mprehtë dhe hetues nuk e linte Kristinën t'i shihte nga afër. Ajo nuk e dinte se ç'ngjyrë

i kishte sytë: të zez, apo gështenjë, dhe megjithatë i pëlqenin. Siç i pëlqenin edhe flokët kaçurrelë të zez që i mbulonin ballin, lëkura e zeshkët, mollëzat pak të kërcyera, vetullat kaleshe, trajta e shquar e buzëve, qerpikët e gjatë si të një vajze, mustaqet e holla. Me një fjalë, ajo nuk shikonte tek ai asnjë cen.

Kur ai mbërtheu armën dhe e futi në këllëf, ajo tha:

— Ku e ke marrë këtë revole kaq të bukur?

— Ja kam marrë një spiuni...

— Një spiuni?

— Po.

Kristinës iu ndez kureshtja:

— Si ia ke marrë? Kam qejf ta di...

Zëri i saj tingëlloi si zë fëmije. Ai zgjati dorën dhe, pa lëvizur nga vendi, mori pushkën e Kristinës.

— Këto gjëra nuk tregohen. Ti e di konspiracionin e luftës, po mua sepse më pëlqen të ta tregoj ty — nisi të fliste Ramizi i vrenjtur në fytyrë, ndërsa zbërthente armën. — Po ta them që në fillim se për mua ka qenë edhe është një histori e hidhur kjo, veç ty nuk dua të ta mbaj të fshehtë. Që ta dish ti, kjo revole u bë shkak që më nisën për në çetë. Atëherë punoja me njisitin guerril të qytetit, qëronim tradhtarët, spiunët. Ia kam marrë Daut Kolit, atij spiunit të poshtër, që na mori më qafë aq shokë.

Kristina lëvizi nga vendi, ndërsa bebëzat e syve i vezulluan.

— Po pse, ti e vrave atë?

— E vrau njësitit! — ia ktheu ai me të shpejtë, duke i bërë bisht përgjigjes.

— Jo, jo, ti e ke vrarë, ma thuaj...

Asaj nuk i durohej tani.

— Po dëgjomë, njëherë, Kristinë. Do të t'i them të gjitha.

— Hë, po të m'i thuash, ama! — ia priti ajo, ndërsa sytë i lëshonin xixa gazi dhe dyshimi.

— Atë natë nuk na vajti puna mbarë. — Ai e la armën të zbërthyer mënjanë. — Gabimin në fakt e pata unë. Sec më kishte hipur në kokë t'ia merrja revolen

atij të poshtri. Sipas planit duhej që, pasi ta vrisnim, të largoheshim menjëherë. Drejtimet ishin caktuar mirë që përpara. Qemë dy vetë. Unë dhe Luani, Luan Avniu, ti nuk e njeh. Është në terren tani. Djalë trim, po edhe i urtë, ama. Ai, me të mbaruar punë, u largua me të shpejtë. Kurse unë mbeta aty. U përkula mbi spiunin, i mora revolverin dhe dokumentat. Kjo që punë minutash. Po kjo më vonoi dhe për pak desh e pësova. Shokët u bënë merak. Kujtuan se më kishte ngjarë gjë. Në fakt, unë mbërrita shëndoshë e mirë. Vetëm u vonova, sepse më dolën përpara milicë e karabinierë... M'u desh t'i bija gjatë... Dredhova nëpër rrugica, kalova nëpër bahçe, u hodha nga një mur në tjetrin, derisa mbërrita në vend.

Pastaj Ramizi përfundoi tregimin si pa qejf:

— Pas ca ditësh, më nisën për në çetë...

Uli kokën dhe zuri të merrej sërish me revolverin. Kristina sa nuk fluturonte nga gëzimi. I dukej fat i madh që dëgjonte ato fjalë nga goja e tij. Ky të ishte vërtet një nga atentatorët e qytetit të saj? Ç'dëshirë të marrë kishte pasur Kristina për të njohur ndonjë prej tyre! S'i thonin shaka! Këta njerëz të guximshëm dhe misteriozë ishin bërë tmerr për armikun. Ata s'i dinte njeri, veç Partisë. E pra, Ramizi ishte njëri prej tyre dhe s'kishte asgjë të jashtëzakonshme. Fytyra e tij nuk kishte ndonjë shenjë të veçantë që të tregonte se kishte qenë atentator! Ai ishte një partizan, si gjithë partizanët e tjerë dhe ja tani ajo e kishte pranë, e kishte shok.

Atentati që ai tregoi kishte ndodhur pikërisht në qytetin e saj, dhe kjo e preku Kristinën.

— Mos ka ngjarë parvjet në pranverë?

— Po, tamam në atë kohë.

— Tani më kujtohet — ia pat vajza me të shpejtë, e rrëmbyer nga një kujtim që iu zgjua papritur. — Atë natë ne kishim mbledhjen e aktivitetit. Ishim mbledhur në shtëpinë time. Ka qenë afër darkës, pas shtettrrethimit. Bile shoqet fjetën tek unë atë natë. Kur dëgjuaam krismat, përnjëherë e ndërpreme punën... dhe heshtëm... U trembëm, të them të drejtën...

Ramizi ngriti menjëherë kokën:

— U trembët, the?

— U trembëm, posi! Po jo për vete. Kishim merak për ju shokët e njësitit — dhe vuri buzën në gaz. — Për ty, si duket, u bëmë aq merak atë natë. Sado që nuk e dinim se kush ishte, prapë ishte yni, ishte shoku ynë!

— Më vjen mirë që ju paskam shtënë në merak atë natë — e ngacmoi Ramizi, po ajo s'ia vuri veshin dhe tha:

— Sa më pëlqen guximi yt! Të kam zili! Sot duhet shumë guximi.

— Të gjithë partizanët janë trima — ia priti ai. — Edhe ti e tillë je.

— Unë?

— Po.

— Thua ti.

— Këtë e tregove dje. Unë s'them asgjë!

— Jo, jo, Ramiz, unë nuk jam argasur akoma...

Harabeli, që deri atë kohë që zhdukur, hyri përsëri në tavan. Ishte bashkë me një zog tjetër. Ata fluturonin nëpër trarët dhe luanin. Cicërimet e tyre mbushën hesh-tjen e gjatë. Po këtë herë Kristinën nuk e tërhoqën zogjtë. Mendja e saj tani rrihte gjetkë. Ramizi mori prapë armën.

— Çudi — ia bëri vajza. — Si nuk të kam njohur unë, që njihja shumë nga shokët ilegalë që punonin në qytet! Në çfarë baze fshiheshe ti?

— Në baza të ndryshme. Si të të them... ku gdhiesha, nuk ngrysesha.

— Po ku ke ndenjtur më shumë?

— Në lagjen «Kastriot».

— Te kush?

— Te Sila Taku.

Ajo u mendua një të marrur fryme.

— Ëhë! E mora vesh... Në atë bazë nuk më kishte qëlluar të veja. Shkoja më shumë këndeje nga Shkoza... Çudi, si nuk më ka rastisur... Me siguri do të qemë njohur, ë?

— Kushedi. Po nuk u bë qameti. U njohëm më vonë. Ja, po njihemi dhe këtu.

Ramizi zuri të zbërthente shulin. Kjo punë e mun-

donte pak, po më shumë e mundonte biseda që kishin filluar. Kristina e mori prapë fjalën dhe tha me duf:

— Më vjen plasja. Nuk e mbaj mend kur të kam parë për të parën herë. Më duket sikur të njoh prej shumë kohësh... Ë? Çudi!

Në pakënaqësinë e saj kishte shumë keqardhje. Kjo ia largoi për një çast partizanit vëmendjen nga arma. Befas susta e shulit kërceu nga piruni dhe vajti e ra te Kristina. Ata qeshën me zë, si dy fëmijë dhe pa dashur vështrimet u takuan në një pikë vetëtitëse.

— Kurse unë e mbaj mend mirë — u hodh Ramizi në gaz e sipër. — Të kam parë që atë natë kur erdhe. Mos erdhe me korrierin e batalionit të dytë?

— Po, me Zoin.

— E sheh që e mbaj mend?

— Çudi, si e mbajtke mend!

Ai ngriti supet:

— As unë nuk di si më ka ngelur...

Pas këtyre fjalëve Ramizi nuk merrte dot guximin ta shihte shoqen e tij drejtpërdrejt. Vinte syrin te tyta dhe e vështronte që andej. Ajo rrinte e menduar dhe kafshonte buzën e poshtme.

Ai, për të larguar çdo keqkuptim, tha me shpoti:

— Po kjo qenka e pastër, sikur nuk ke qëlluar fare!

Ajo vari buzët:

— Sa i keq bëhesh! Ti e di sa pak shtiva me të. Po automatikun tënd, harrove që ta mora?

— Të punoi mirë?

— Shumë mirë. Po në fillim hoqa ca. Nuk e kuptoja merrja nishan apo zbrazja më tym. Sytë më lëshonin xixa dhe dridhesha. Pastaj u mësova dhe...

Vajzën e kapi prapë kolla dhe nuk mundi të fliste.

— Qenke ftohur keq!

Ajo priti sa u mbush me frymë dhe tha me zë të mekur:

— E kam më shumë nga plaga se sa nga e ftohura. Diçka më gërvish këtu përbrenda.

— Rri atëherë, mos fol — e këshilloi ai.

Dëgjohej vetëm tringëllitja e pjesëve të armës që mbërthente Ramizi.

Pasi mbaroi punë me pushkën e saj, ai mori automatikun.

— Kurse unë e mbaj mend si u njohëm për herë të parë... — e lidhi ajo fillin e bisedës së ndërprerë dhe vështrroi nga ai.

— Ashtu?! — ia bëri Ramizi i habitur jo aq nga fjalët që tha ajo...

— Besoj të kujtohet? Kemi qenë në një bazë në Peshtan. Na kishin caktuar...

— ...bashkë me komisarin dhe Zoin — plotësoi ai gjithë gaz, ndërsa me vete mendoi: «Sa mirë e mban mend!»

— Po, bashkë me ta. Tamam ashtu është. Më duket se ti erdhe pak më vonë se ne... Unë pyeta Zoin si ta thoshin emrin.

— Vërtet erdha vonë, sepse shpërndava shokët në për baza dhe vetë ngela jashtë.

— Kur u ulëm pranë zjarrit, ishim karshi, të kujtohet?

Ramizit i mbeti automatiku në dorë dhe mendoi:

«Kur i kujtohet kësaj, si të mos më kujtohet mua...»
Padashur partizani nënqeshi, po nuk foli. Kristinës dalngadalë iu fanitën me radhë kujtimet.

— Të kujtohet si shkëmbyem fjalët e para?

— Posi s'më kujtohet! Ty atë natë të kishin hipur të dridhurat...

— Dhe ti më dhe kapötën tënde...

— Kurse ti nuk e pranove...

Ajo kukurisi nga gazi.

— Po në fund e more, ama...

— E mora se më urdhëroi komisar...!

Ai mbështeti mjekrën te tyta e automatikut dhe e ngacmoi buzagaz:

— Të vinte ndoht, si duket!

— Pse bëhesh i keq, Ramiz?

— Po ç'kishe atëherë, që nuk e merrje?

— Do të ta them të vërtetën? Nuk më pëlqenin ato

kujdesje. Më dukej sikur më përkëdhelnit. Po edhe unë isha partizane si të gjithë të tjerët. Pse të më mbanit me hatër? S'isha e vogël.

Kësaj here u gajas ai, kurse ajo papritur u vrenjt.

— Pse qesh?

— Kot!

— Jo, ti nuk qesh kot.

— Pse, thua?

— Ku ta di unë!

— Më kujtohet prapë ajo kapota! Ja, sikur të kam tani parasysh, veshur me të. Të rrinte e madhe si qyrk!

— Për këtë qeshe?

Po, për këtë — tha ai ashtu kot, për t'iu shmangur përgjigjes së vërtetë.

Ajo sikur u qetësua dhe u përpoq ta lidhte veten prapë me kujtimet.

Ramizi e hoqi fare automatikun nga duart. Biseda që kishin filluar ia rëndonte ato që kishte në dorë.

— Ti kishe ardhur ato ditë, Kristinë, dhe mua më vinte keq. Se si më vinte ashtu... Më dukeshë e druajtur...

— Vërtet, atëherë nuk njihja pothuaj asnjë. Nuriën, shoqen time, e çuan në batalionin e parë. Isha e vetmja partizane në kompani. Tani, shyqyr, jemi dy.

— Kurse unë desha të të merrja në skuadër...

— Pse s'më more? Gabim ke bërë.

— Nuk deshi komandanti i kompanisë...

— Po pse s'deshi?

— Nuk e di... — ngriti supet i menduar.

Befas ra një heshtje e padëshiruar për të dy.

— Ti je komandant i mirë, më kanë thënë.

— Tani po talle, Kristinë...

— E kam me të vërtetë. Sa mirë do të kishte qenë sikur të isha në skuadrën tënde!

— Më mirë të mos ishe...

— Pse e thua këtë?

— E them se nuk do të bëheshim shokë si jemi tani.

Do të qëndroja larg... Helbete, komandant....

— Kurse mua, e di, më pëlqen të më komandos ti...

Ai nuk pati guxim ta ngacmonte bisedën më tej.

U duk sikur ajo i tha të gjitha. Të dy nuk e donin heshtjen atë çast, po tamam kur nuk e do, ajo vazhdon si me kast. Ai kapì automatikun dhe filloi të merrej për-sëri me të. Ndjeu se gjuha i qe lidhur. Diçka e pengonte të fliste lirisht.

— Po kur hodhëm valle? — e pyeti Kristina, duke ndjellur kujtimet rishtaz. — Të kujtohet, në fushën e Bezhanit, rreth zjarrit? Edhe atje ishim bashkë...

Ramizi, sado që ishte i zënë me zbrëthimin e automatikut, gjeti kohë të thoshte me vete: «Edhe këtë s'e paska harruar!»

— Kishe veshur një palë këpucë të mëdha me gozh-dë. Sa i përplasje, kur kërcenim vallen e Ballit!

— T'u kujtoka mirë! — ia ktheu ai vetiu dhe e la një çast armën.

— Më kujtohet, posi! Sa bukur e hidhje vallen!

— Aha, sa për valle e për këngë s'ma del dot njeri. Kur isha një herë i sëmurë shtrirë në spitalin partizan dhe shokët kërcenin jashtë, s'më rrihej dhe lëvizja këmbët nën jorgan. Po ti kërcen?

— Unë s'kisha kërcyer kurrë, veç në shkollë. Këtu mësova dhe më doli turpi.

Ramizi, që zakonisht nuk u jepej aq kollaj kujtimeve, pas atyre që tha ajo, ndjeu se dikush po e tërhiqte në të kaluarën... I dukej sikur ashtu, siç ishin tani, afër njëri-tjetrit kishin qenë pranë edhe dikur, po pa e ditur. Ai e la automatikun dhe e mori fjalën:

— Tani më kujtohen dhe mua ca gjëra. Më kujtohet ajo ditë kur ju të porsaardhurat ju kishte mbledhur Haxhiu, te Koriya e Dushkut dhe po ju mësonte armët...

Ramizi nisi të tregonte, po ajo e ndaloi me dorë:

— E di ç'do të thuash, e di... Mos e thuaj — qeshte me zë dhe me gazin e saj sikur donte ta zbuste shakanë e tij.

— Ti nuk e di ç'po të them...

— Jo, mos e thuaj, e di, e di...

— Ja, e kyça gojën...

Po gazi iu ngjit edhe atij dhe atëherë filluan të dy të qeshnin.

— Mirë, thuaje, thuaje.

— Ta them? Po mos m'u zemëro!

— Jo, nuk të zemërohem...

— Po nuk është ndonjë gjë kushedi se çfarë. Të gjithë e kemi kaluar këtë. Ti atëherë nuk dije të shkelje syrin, të kujtohet? Përdorje kapelën...

Asaj i mbeti gazi në buzë e tha:

— Haxhiu i shkretë u mundua, po unë s'e mësova që s'e mësova atëherë. Edhe sot nuk e mbyll dot mirë syrin e majtë...

Partizani mori frymë thellë, sikur gjithë ai gaz i përmbajtur ta kishte lodhur dhe i tha:

— Nuk prish punë. Mjafton të luash gishtin, pa syri rregullohet...

Ai nuk e kuptoi logjikën e dobët të fjalëve të tij, po ajo e kapi aty për aty:

— Nuk është ashtu, Ramiz. Syri ka të bëjë shumë.

— Po kur është kështu, pse nuk e ke mësuar atëherë? — e ngacmoi sërish ai.

— Më ka ngelur ky zakon prej kohësh. Kur mësoja në shkollë, një djalë nga klasa e pestë bënte ç'bënte më shkelte syrin. Më vinte për të qeshur. Isha e vogël atëherë, në klasë të katërt. Zbavitesha kur e shihja, po nuk afrohesha, sepse kisha frikë...

— Domethënë që e vogël paske pasur frikë nga djemtë...

— Unë për vete s'kam pasur, po në shtëpi më këshillonin të mos trazohesha me ta, pastaj mësuesi na ndante veç në klasë. Ne vajzat s'kemi faj. Kështu na kishin mësuar. Pse, a nuk jemi ne, që kemi dalë partizane?

— Ashtu është, bëra shaka — tha Ramizi, kur pa se ajo i mori me seriozitet fjalët e tij. — Hë, se qenka shumë interesante, po pastaj?

— Prit të mendohem, se më ngatërrove — tha ajo dhe ngriti sytë lart. — Një ditë, tek isha vetëm me nënën në shtëpi, thashë pse të mos ia thosha asaj. Dhe ia thashë, bile me hollësira. Po ajo, në vend që të qeshte, u inatos dhe më foli rëndë. Që atëherë, e mora të shke-

lurit e syrit si gjë të turpshme. Dhe, do ti që nuk e mësova për shumë kohë. Ku e dija unë e shkreta, se do të më duhej një ditë...

Ata s'arritën dot të qeshnin. Një zhurmë e paqartë erdhi nga jashtë. Padashur vështruan nga njëri-tjetri. Zhurma u përsërit. Ai largoi sytë prej saj dhe vuri vesh të dëgjonte. Prapë po ajo zhurmë. Vinte si tringëllima e një teneqeje që e qëllonë me këmbë. Pastaj disa hapa fare të lehtë. Ai kapi menjëherë automatikun. Ajo mbeti me sy të hapur.

— Mos është ndonjë nga shokët! — pëshpëriti Kristina.

Ramizi nuk iu përgjigj, po u zvarris brinjas me këmbën e shëndoshë, duke e tërhequr pas automatikun. Heshtja e tij e shqetësoi pak vajzën dhe asaj i shkuan sytë menjëherë te bombat. Ai u ndal në fund të tavanit. Që andej i ngjante se po u vinte rreziku. Aty zhurma e teneqesë dëgjohej shquar. Brenda zotëronte një heshtje e nderë. Ai zgjati kokën dhe u mundua të shihte përmes një vrime të strehës. Oborri ishte i shkretë. Dikush po vinte. Ai priste me sy të shqyer. E mundonte më shumë padurimi se sa frika e rastit. «Kush do të jetë ky njeri? Ç'do ky i panjohur që sillet këtu përçark? Mos është ballist? Apo ndonjë gjerman? Apo është ndonjë nga shokët e batalionit që na kërkon.» — Kështu mendonte dhe Kristina. Po më shumë i vinte mendja për keq. «Armiku, vetëm armiku mund të vijë në këto anë tani për tani. Shokët janë larg, shumë larg që këndejl!»

— Ha, ha, ha...

Një e qeshur me gjithë shpirt i buçiti në vesh Kristinës. Ramizi, tek rrinte shtrirë, i kthyer nga ajo, fërkonte sytë dhe gulqonte nga gazi. Ajo në fillim u habit: ngriti supet dhe mblodhi buzët. Po kur ai vijoi të qeshte, zuri edhe ajo të qeshte lehtë, pa ditur se përse.

Ndërsa ai po kthehej në vend duke u zvarisur, ajo e pyeti:

— Po kush ishte? Kush?

Ramizi tundte kokën, sikur qesëdiste veten dhe thoshte:

— Lëre, lëre...

Asaj nuk i pritej dhe tha me zë lutës:

— Aman, ç'qe ajo zhurmë?

— Ishte... — Ramizin nuk e linte e qeshura të fliste
— një qen që luante me një kuti teneqeje...

Ata qeshnin tani të dy së bashku, pa ia vënë veshin zhurmës së teneqesë që vazhdonte akoma.

— Ama, u trembe, Kristinë!

— Po si nuk u tremba. Erdhi fare papandehur!

— Po armiku dhe papandehur vjen...

Qeshën prapë... Pastaj gazi erdhi e u shua dalngadalë dhe në mes tyre u ndeh qetësia e parë. Ramizi s'dinte ç'të bënte dhe mori përsëri automatikun. Kristina tërhoqi gërshetat përpara dhe me gishtat e njëjës dorë zuri t'i shplekste. Ai merrej me armën, ndërsa e ndiqte vajzën me bisht të syrit. Flokët e saj të gjatë e të dendur iu derdhën gjoksit dhe supeve. Tiparet në fytyrën e bardhë spikatnin më mirë pas flokëve të errët.

«Sa e bukur!...»

Ramizi u përpoq t'i dëbonte këto mendime tunduese.

«Ç'bëj unë kështu!?...» — qortoi menjëherë veten. Po ky mendim iu duk jetim në mes mendimeve të tjera të vrullshme. E pse ta gënjente veten? Pamja e saj gjithnjë e kishte tërhequr. Nën dritën e syve të saj nuk mund të bisedonte më i qetë.

— Ramiz, më duket vetja si në ëndërr, kur mendoj se jemi në tavanin e një shkolle.

— Të vjen çudi, ë?

— Me gjithë mend e kam. Të luftosh me batalionin kudo goftë, në mal, në fushë, ose me njësitin në qytet, këtë e kuptoj, po të qëndrosh mbyllur në tavan! Se si më vjen për të qeshur...

Ai nuk e pa nëse qeshi apo jo. Flokët e rënë e kishin zënë gjithë fytyrën.

— Pse, mos të vjen gjë rëndë?

— Jo, as e mendoj këtë. Ne jemi shokë!

Ajo zbuloi fytyrën. Ramizit iu përpoqën qepallat.

— Dëgjo këtu — zuri të fliste ajo me një ton gazmor — diç m'u kujtua... Vjet në këtë kohë po pregati-

tesha të dilja partizane. Tjetër punë që dola më vonë. Atëherë punonim bashkë me Nuriën. Mblidhnim rroba për ju të maleve dhe i fshihnim në tavanin e shtëpisë sime. Është më i vogël se ky ku jemi në tani. Nëna nuk na vinte re se ç'bënim sepse s'e linin hallet e shtëpisë! Pastaj, ne vajza të reja. Ia prishnim mendjen. Po megjithatë, në fund na doli shejtanllëku në shesh. E di ç'na ndodhi? Një pasdite, kur po vendosja në tavan ca çorape, që kishin bërë gratë e lagjes, papandehur m'u fundos këmba në kallamat e tavanit. Nëna përposh po pregatiste atë kohë darkën. Kur pa që po binin copa gëlqereje, e mori për tërmet. Ngriti sytë, po ç'të shihte! Këmba ime varej sipër kokës së saj...

Tavani jehoi nga një gaz rinor.

— S'do mend që nëna e kuptoi. Të nesërmen na i gjeti të gjitha plaçkat bashkë me ca bomba e fishekë që kishim fshehur. Më erdhi plasja, sido që ajo s'më tha gjë. Po e shihja që përlotej fshehurazi meje... Kushedi ç'thoshte me mendje të saj. Kishte shumë frikë se mos pësoja ndonjë gjë. Unë asnjëherë s'i fola hapur për punët tona.

Papritur balli i vajzës u rruadh.

— Pas ca kohe ika... Tani, kur e kujtoj, më vjen keq që s'ia thashë. Ajo, në fund të fundit, nuk do të më pengonte...

— Ç'njerëz ke në shtëpi? — e pyeti ai.

— Nënë dhe tri motra. Unë jam më e madhja. Më rre me mend sa vuajnë. Babai na ka lënë të vogla. Ka qenë rrobaqepës, u qepte shajakë fshatarëve, po vdiq shpejt. Nëna hyri në fabrikën e cigareve. Unë mbaja shtëpinë... Jemi të këputur fare, Ramiz!

Partizani u prek dhe për herë të parë psherëtiu:

— Sa mirë, ti paska nënë!

Vajza ngriti menjëherë kokën.

— Pse, ti s'ke?

Ai vuri re qerpikët e saj të ndritur.

— Jo — iu përgjigj duke marrë frymë thellë — as nënë, as baba...

— Fare, fare? — tha ajo me një pafajësi miturake.

Ramizi tundi kokën dhe mbylli sytë në shenjë mohimi.

— Po si kështu?

— Kam ngelur jetim që i vogël. Im atë u vra në Lëvizjen e Fierit. Ishte me ata që ngritën krye kundër Zogut. Babanë e mbaj mend mirë, ndërsa nënën jo. Ajo vdiq sapo më lindi mua. Një motër që kam, ajo është e martuar. Me një fjalë, jam rritur jetim. Dhe do të kisha ngelur rrugëve, po m'u gjendën ca farefis dhe më çuan në «Strehën Vorfnore». Atje mësova zanat, u bëra marangoz. Me këtë jam marrë derisa dola partizan.

Kristinës i dridh damari i kaltër në gushë.

— Kurse unë të kam pandehur student...

— Student?! — hapi sytë ai i habitur. — Ku të paska shkuar mendja?

— Ku ta di unë... Ndoshta, sepse nëpër mbledhje flet bukur. Ajo ngriti supet. — As unë nuk e di, po gjithnjë kam menduar se je njeri me shkollë të madhe!

— Ah, të kisha shkollë të madhe — tha ai me dhembje — sa mirë do të kishte qenë. Po s'është ashtu si ke pandehur ti. S'kam ndonjë shkollë kushedi se çfarë. Vetëm filloren kam, atë që ke dhe ti. Po shumë gjëra i kam mësuar në luftë. M'i kanë mësuar shokët...

Kristina e shikonte e përqëndruar, me buzët gjysmë të hapura.

— Ti di shumë, Ramiz — u ankua ajo pas pak — unë nuk di fare...

— Kush tha që s'di? Dhe ti di plot...

— Jo, mos ma bëj qejfin. Shumë gjëra unë nuk i di mirë...

— Çfarë nuk di, bie fjala?

Ajo u mendua një grimë. Pasaj foli me drojtje:

— Nganjëherë, kur rri e mendohem, më vete mendja të koha e pasluftës. Them me vete: «Si do të jetë vallë, ajo kohë?» Sigurisht nuk do të jetë, siç ishte koha e Zogut. As siç është sot. Po si do të jetë tamam-tamam nuk e di.

Ai u bë pak serioz. Mendime të shumta i buçitën në kokë. Iu kujtuan bisadat e komisarit, broshurat që

kishte lexuar. Po a do të ishte në gjendje t'ia shpjegonte?

— Ti dike goxha. Kryesoren e dike! — arsyetoi Ramizi. — Puna është të fitojmë njëherë, Kristinë. T'i dëbojmë fashistët. Pastaj dimë se si të rregullohemi në shtëpinë tonë.

— E di pse të pyes, Ramiz? — tha ajo me një zë të çiltër, ku ndihej më shumë sinqeritet se sa drojtje. — Ka gjëra që më duken të zorshme. Se kush tha njëherë në një mbledhje se ne po bëjmë revolucion. Si thua ti, po bëjmë luftë, apo revolucion?

Ai vuri buzën në gaz.

— Të dyja bashkë. Edhe luftë, edhe revolucion...

— Ëhë...

Ajo ngeli një hop.

— Po mirë, ç'do të thotë revolucion?

— Si të ta them unë ty...

Atij i erdhi fare e papritur kjo pyetje. Kujtesa atë kohë s'e ndihmoi, po e ndihmoi logjika prej partizani.

— E di ç'do të thotë? — Ai nuk u përgjigj menjëherë. — Fabrika ku punon nëna jote sot, të bëhet nesër e popullit...

Ajo rrinte si e hutuar. Akoma kishte hije në shikimin e saj.

— Po fabrika, a nuk është e të zot?

Ramizit i erdhi inat me veten që s'po arrinte t'ia shpjegonte qartë.

— Jo, s'ka si të jetë e tij. Ajo është ngritur me gjakun e punëtorëve. Prandaj e merr revolucionin.

— Cili revolucion?

— Ne, unë, ti... shokët...

Kristina pyetjet sikur i kishte në majë të gjuhës:

— Po kush do t'i drejtojë këto punë të zorshme?

— Ne, kush tjetër?

— Ne?!

Në sytë e saj nuk kishte më hije. Partizania gëzohej si fëmija kur ka gjetur zgjidhjen e një gjëze të vështirë.

— Sa mirë, Ramiz! Sa mirë që i paskan menduar të gjitha!...

Ai pandehu se mbaroi provimi, po ajo e pyeti për-
sëri:

— Po kur do të arrihen të gjitha këto?

— Shpejt, besoj!

— Sa shpejt?

— Me të dëbuar gjermanët...

Kaq qenë pyetjet e Kristinës, pastaj i ndërruan rolet:

— Thuaj të drejtën, të ka marrë malli për nënën?

Ajo puliti qerpikët e gjatë dhe tha me ngadalë:

— Më ka marrë, si nuk më ka marrë. Pse të gënjej!

Më dhimbset, besomë. Ajo ka vuajtur shumë për të na rritur.

Vajza shtriu trupin dhe heshti.

Ai e vështroi me miratim. Çdo vijëzë e fytyrës së saj ishte e hijshme.

— Të dhëmb gjë, Kristinë?

— Jo, po u lodha pak.

Atëherë u mbështet edhe Ramizi. Sikur të mos ia kishte përmendur ajo lodhjen, ai nuk do ta ndiente ndo-
shta fare. Po ajo ia kujtoi dhe ai e ndjeu. Ishte vërtet i lodhur.

— Kristinë, ç'mendon të bësh pas lufte? — pyeti ai siç qe shtrirë.

Ajo nuk iu përgjigj menjëherë. Ai pandehu se nuk e dëgjoji dhe ngriti kokën.

— Si të ta them... — ia priti vajza. — Nuk e kam menduar ndonjëherë. Qejf kam të mësoj, po kur shoh që jam e rritur, më vjen rëndë ta nis shkollën prapë.

Tani Ramizi mund ta bënte atë pyetje që e kishte patur ndër mend sa herë:

— Pse, sa vjeçe je?

— Tetëmbëdhjetë.

— Edhe ankohe?

— Pse, pak të duket?

— Po unë që jam njëzet e një?

Heshtën një çast. Të dy mendonin për moshën e njëri-tjetrit.

— Mund të mësosh, s'ka ndonjë gjë të keqe! — e këshilloi ai.

— Jo, Ramiz, dua të bëhem modhistër...

— Modhistre?! Rrobaqepëse?!

— Po. Pse, a s'është punë e bukur t'u qepësh një-rëzve rroba?... E di si mendoj unë budallaqja?... Më dë-gjo njëherë! Kam menduar kështu. Pas luftës do të hap bashkë me motrat një dyqan me emrin rrobaqepësia «Partizani». Ëë? Si thua ti?

Ai kafshonte buzët për ta mbajtur gazin.

— Po pastaj?

— Jo, ti më duket po qesh... Nuk ta them...

— Fol, fol, nuk e kam me ty...

Ajo nuk i zuri besë, po megjithatë vijoi të fliste e nxitur nga mendimet e bukura që i lindën atë kohë:

— Ti nuk më lë rehat. Ja, ma ngatërron, ku e kisha fjalën?

— Te rrobaqepësia «Partizani».

— Po. Në rrobaqepësinë tonë do t'u qepim rroba vetëm shoqeve dhe shokëve të Luftës...

Ata bisedonin me sytë në tavan. Asnjëri s'e shihte tjetrin.

— Po mirë, para do të na marrësh?

Ajo e kuptoi shpotinë e tij dhe sikur i mbeti qejfi.

— Kam faj unë që t'i them ato që mendoj...

Ramizi nuk donte kurrsesi ta zemëronte. Lëvizi sa-kaq dhe i vajti pranë.

— Mos ma merr për të keq — i tha me të lutur. — Do të bëjmë edhe shaka nganjëherë, apo jo?

Ajo kafshonte me dhëmbë gërshetin.

— Po, shaka... Ti talle...

— Për ideal, s'tallem... Dhe ja ku po ta them, për hesap tim, ti nuk mendon ashtu si duhet. Qeveria jonë do të ketë nevojë edhe për ty, edhe për mua... Pse, si të duket, kollaj është të mbash një shtet? Atë do ta drejtojmë në radhë të parë ne të Luftës. Dhe nuk do të ketë vend as për bejlerët, as për tregtarët, as për tradhtarët e sotshëm. Do të jetë në fuqi populli, e kupton? Prandaj them se e ke gabim që mendon kështu. Ti do të merresh me punë shteti dhe s'ke pse bëhesh rrobaqepëse.

Papritur u ngrysën të dy, sikur i bënë hije njëri-tjetrit. Nuk folën një copë herë. Pastaj ajo theu heshtjen:

— Po ti, Ramiz, ç'do të bësh?

Ai kishte harruar të kthehej në vend.

— Unë ç'do të bëj? — tha ai, sikur të pyeste veten. — Do të lë zanatin dhe do të bëhem ushtarak. U bë kaq kohë që u mësova me armët...

— Po atëherë Lufta do të mbarojë dhe nuk do të ketë më fashistë?

— Lufta për ne nuk do të mbarojë me kaq, Kristinë. Neve do të na duhet t'i mbrojmë ato që fituam, si dhe të fitojmë gjëra të tjera...

Përsëri Kristina po ngatërrohej. Gjithnjë koha e pasluftës e ngatërronte, kurse luftën e kishte të qartë... Po sepse e tërhiqte aq shumë e ardhmja! Prapë e ngacmonte një pyetje:

— Si thua, Ramiz, do të takohemi përsëri ne?

Ai buzëqeshi, po ndërkohë sytë i vezulluan nga një pikëllim i lehtë.

— Pa tjetër, pa tjetër... do të takohemi!

Ramizi uli sytë. Një hije mendimesh i ra në fytyrë.

— Po luftë është kjo, moj Kristinë... Ne që e zgjodhëm këtë rrugë, i kemi marrë parasysh të gjitha...

Tani asnjëri nuk merrte guximin ta shihte shokun në sy.

— Jo — tha ajo e bindur. — Unë them se do të rrojmë... Ke për ta parë, gjallë do të jemi, po s'u poqëm e po s'e kujtuam këtë tavan. Sa keq që ti s'ke besim!

Ramizit sikur ia ngriti kokën njeri me dorë.

— Unë kam besim, po...

— **Po atëherë, pse flet kështu?**

Pse fliste kështu? As ai nuk e dinte. Asnjëherë nuk e kishte parë veten në këtë gjendje. Asnjëherë nuk i kishte lënduar kaq shumë ndjenjat e veta. Nga vinte kjo atëherë? Nga dobësia fizike? Nga izolimi? Apo nga ai mendimi që i rrinte diku i fshehur dhe e nxiste herë pas here? «Po atëherë, pse flet kështu?» — i kumboi rishtaz në vesh zëri i panjohur. Po Ramizi prapë nuk iu përgjigj këtij zëri, që nuk e dallonte dot tani në ishte i tij apo i saj. E vështroi ëmbël, plot miratim dhe vazhdoi të heshtte. Një rreze drite dilte nga sytë e saj ve-

zullues dhe e therte djaloshin. Vërtet, e therte diçka në kraharror. Po ç'të bënte? Të fliste? Fjala tani s'kishte fuqi. Po edhe ashtu s'mund të rrinte. Donte të bënte diçka. Të paktën të lëvizte. Në këto çaste lëvizja ka gjuhën e saj të qartë. Vuri re se asaj i kishte rënë palltoja. Zgjati dorën dhe e mbuloi. Pastaj i rregulloi gjerdanin të koka dhe i largoi automatikun.

Ngeli një hop. Ajo kishte pulitur sytë. Jashtë nata dalngadalë po nderte krahët. Brenda qe errësuar. Nëpër plasat e tavanit zunë të vezullonin yjet. Ramizi u kthye në vendin e tij.

— As sot nuk erdhën shokët... — përshpëriti ajo.

— Natën e mirë! — shtoi pas pak.

Atij iu përqeth trupi. Nga mënyra se si i shqiptoi fjalët ajo, ai sikur ndjeu dridhjen e buzëve të saj.

— Natën e mirë, Kristinë...

Vetëm kaq dhe u mbështet me kurriz pas një trari. Ndenji kështu një copë herë. Vështronte Kristinën dhe ndiente se diçka e sëmbonte përbrenda. Ajo lëvizi disa herë lehtëzi. Pastaj u dëgjua frymëmarrja e saj karakteristike. Vajzën e zuri gjumi.

Ai mbeti fill i vetëm në errësirë. Një rreth mendimesh e kishte vënë në mes. E kush mund ta ndihmonte atë çast? Filluan të dëgjoheshin bulkthit dhe më pas guakja e bretkosave. Mendja e partizanit tani trapiste larg. Bridhte rrugëve të Luftës, ku ai kishte kaluar tok me shokët. Po ja, papritur u gjend në këtë tavan me një shoqe! Dhe me cilën? Me Kristinën! Ç'ishte kjo kështu?

Sa më shumë mendonte Ramizi, aq më tepër rrethi i mendimeve shqetësuese vinte e ngushtohej. Ishte vetëm në errësirë dhe i duhej të luftonte. Po kundër kujt? Armikun nuk e kishte aty. Kundër kujt atëherë? Kundër vetes?

Padashur sytë i mbetën te plasat e çatisë. Në qiell kishin dalë plot yje. Yjet e majit, që ndrisnin si pika zjarri në honin e natës. Ai rrinte me fytyrë kthyer nga qielli i belluztë. Rrinte ashtu dhe mendonte. Sa vite kishin kaluar që nuk i kishte parë kështu yjet! Ja, kështu, siç po i shihte sonte, me një vështrim të qetë e ëndë-

rrimtar, me një ndjenjë të ëmbël në shpirt, me një mall të pashpjegueshëm në gjoks. Këto yje i kujtonin atë kohë të largët të fëmijërisë, që ai s'e afronte dot, ashtu si nuk i afronte dot edhe ato yje, si nuk mund t'i shkoqiste edhe mendimet që e kishin kaplluar. Rrinte dhe vështronte yjet dhe ato i dukeshin aq të bukura, aq të ndritshme, aq të mistershme! Dhe kjo e prekte, e prekte aq, sa zemra i përpëlitej në kraharor dhe vegime të panumërta i dilnin para syve.

Papritur partizanit iu vagëlluan sytë. Kuadri lart në qiell u prish. Drita e yjeve u zbe. Ramizi tundi kokën sikur të zgjohej nga gjumi. Një flakë e zjarrtë u var nëpër qiell. Pastaj një flakë jeshile. Ai shqeu sytë. Raketa të armikut kaq afër?! Përnjëherë tërë ato vegime e ëndrra iu davaritën. Në kokën e partizanit mbetën mendimet, vetëm mendime të qarta. Diku, lart në qiell, u kryqëzuan dy shigjeta drite. Plasat e çatisë shkëlqyen. Nën çati u zbut errësira. Ramizi vështroi nga Kristina. Ajo flinte e qetë, me buzët gjysmë të hapura, me gërshetat mbi gjoks. Pastaj dritat u shuan. Ai mbeti prapë vetëm në errësi. U mundua të kthehej në gjendjen e parë. Po yjet tani e kishin humbur shkëlqimin dhe bukurinë e tyre. Mendime të tjera buitën në kokën e partizanit...

TRE

Ditën e tretë Ramizi vendosi të shihte se ç'ndodhte përjashta. Poshtë, sigurisht nuk mund të zbriste. Nuk kishte kush ta ndihmonte. Plaka kushedi se përse nuk po vinte. Po edhe aty brenda nuk i rrihej. I dukej vetja shtrirë si në gropë. Tani ai e ndiente trupin pak më mirë. Vështronte qeprat dhe tjegullat e çatisë dhe kjo e nxiste. Donte të bënte diçka. Ku ishte mësuar Ramizi të qëndronte duarlidhur!

U ngrit dhe, sado ngadalë e me kujdes, trarët krëkëllitën. Kristina, me të dëgjuar zhurmën, hapi sytë:

— Pse ngrihesh, Ramiz?

— Të zgjova, më duket.

— Unë zgjuar isha, po ti ç'do të bësh kështu?

— Do të hap një dritare të vogël që të hyjë pak dritë...

Ramizi e vështronte nga lart gjysmë i kërrusur, duke rënduar mbi këmbën e majtë. Në fillim atij iu morën mendtë, sytë iu mjegulluan dhe plaga i theri. Po dalngadalë dhembja iu lehtësua dhe ajo marrje mendsh iu shpërnda. Që lart, ai vështroi shoqen e tij tek rrinte shtrirë, me sytë hapur, me duar të lëshuara. Për një çast iu duk sikur ajo qe rrëzuar aty poshtë dhe tani priste ndihmën e tij.

Sakaq filloi nga puna. Hoqi me bajonetën e pushkës një dërrasë të çatisë, nxori dorën jashtë dhe zuri të largonte një nga një tjegullat. Pastaj tërhoqi poshtë dy dë-

rrasa të tjera dhe hapi një vend sa për të nxjerrë gjysmën e trupit lart. Një pllackë e madhe drite plot diell ra mbi gjoksin e partizanes. Ajo menjëherë mbuloi fytyrën me dorë. Gjithë ai shkëlqim ia lëbyri sytë. Po kjo nuk zgjati shumë. Ramizi e zuri prapë diellin me trup. Ai tani shikonte jashtë. Kristina mezi priste t'i thoshte ndonjë gjë. Po ai heshtte për çudi.

Atëherë ajo i tha me zë lutës:

— Po hë, mor Ramiz, fol...

— Pamja është e mrekullueshme, Kristinë!

Zëri i tij i bëhej sikur vinte nga larg:

— Dëgjon?

— Dëgjoj, dëgjoj!

— Tamam ditë pranvere.... Toka kudo ka bleruar, natyra i ka nderur të gjitha ngjyrat, qielli është xham fare. Fshati qenka i bukur, po pak si larg që këndeje. Të gjitha shtëpitë janë afër njëra-tjetrës, rrëzë një kodre. Vetëm kjo jona qenka e veçuar. Jemi majë kodrës. Dëgjon? Djallo vend! Këndeje duket lepuri dhe jo më njeriu... Dëgjon?

— Posi s'dëgjoj!...

Ajo e dëgjonte pa i rrahur qepallat. Zëri i tij vinte si me jehonë, nga një botë tjetër, plot dritë e gaz.

— Po pastaj, Ramiz?

— Pastaj...? Ç'ke qejf të dish?

— Thuamë ç'të duash...

— Syri s'më sheh veçse fushë. Arat kanë ngelur pothuajse pa u punuar fare. Tek-tuk duket ndonjë arë e mbjellë me grurë. Tutje kalon lumi. Më tutje shtrihet një pyll i madh... Përtej fare vijnë malet varg...

Kureshtja nuk e linte të qetë Kristinën:

— Po njerëz, a sheh?

— Jo, nuk shoh. Fshati duket i shkretë. Pemët janë të mbushura plot me lule.

Kristinës nuk i shpëtonte asgjë. Përfytyronte ato që i thoshte ai dhe i ngjante sikur i kumbonin në vesh vargje nga ato të Naimit, që kishin mësuar në shkollë. Sa dëshirë kishte t'i shihte me sytë e saj!

Zëri i Ramizit kishte heshtur. Dëgjoheshin vetëm tri-

llet e shpendve. Për herë të parë ajo e ndjeu veten fill vetëm, të shkretë e të braktisur.

— Ramiz! — thirri vajza.

— Ç'ke?

— Pse nuk flet?

Atë e mundonte tani vonesa e tij.

— Shoh dy njerëz që lëvizin nëpër fshat...

Vajza e mblodhi veten.

— Ulu më mirë, se kushedi...

Ajo i tha këto fjalë me një ton lutës dhe urdhërues njëkohësisht.

Ramizi futi kokën brenda e bashkë me të hyri edhe dielli. Sipër gjoksit të Kristinës ranë disa pika vese. Tavani u mbush plot dritë. Sytë e saj shkrepëtinin nga shkëlqimi.

— Natyra s'do t'ia dijë fare nga Lufta — tha ai duke u ulur pranë saj. Ajo lëvizi për t'i bërë vend shokut.

— Ç'ishin ata që pe?

— Dreqi e di... Ishin larg prej këtej — tha ai me mendjen gjetkë.

Pastaj ra një heshtje e thellë.

— E dëgjon sa bukur këndon? — pyeti ajo.

— Kush?

— Bilbili, s'e njeh?

— Jo! Pse, zëri i bilbilit është ky?

Ajo nuk foli, po tundi kokën për të mos ia prishur këngën zogut të bukur. Vajza rrinte e dëgjonte gojëhapur dhe zemra i ndrydhej në gjoks. I dukej sikur i fliste pranvera përmes atyre tingujve të mrekullueshëm, sikur gjithë ai zgjim vinte deri aty ku rrinte shtrirë ajo.

— Ka bilbila, thonë, — foli Ramizi kur zogu pushoi — që këndojnë aq shumë, sa një ditë pëlçasin...

— Pëlçasin!? Ja dhe këtë s'e kisha dëgjuar!

— Thonë se pëlçasin nga dashuria, ngaqë nuk durojnë dot...

— Ha, ha, ha... Nga dashuria!

— Kështu thonë. Unë vetë, me sytë e mi, nuk kam parë gjë.

— Çudi!

— Po, po, edhe zogjtë dashurojnë!

— Me gjithë mend e ke?

— Kështu thonë. Unë vetë, me sytë e mi nuk kam parë gjë.

— Po e beson?

Ramizi qeshi dhe e pyeti:

— Po ti si thua?

— Mua s'më besohet. Ata dinë të këndojnë dhe s'ma merr mendja të dinë të dashurojnë...

— Edhe njerëzit nuk dinë, po dashuria i mëson vetë...

— Ku di unë nga këto gjëra.

Ajo uli sytë. Ai e ndjeu se biseda hyri në qorrsokak dhe u mundua të kthehej prapa.

— S'më pëlqen kjo qetësi, Kristinë.

— Si nuk na erdhi plaka! — tha e menduar vajza.

— Përderisa fshatarët nuk janë kthyer në shtëpitë e tyre, do të thotë se gjermanët janë këndej rrotull.

Ajo nuk foli. U duk për një çast sikur iu mbaruan fjalët. Edhe atij iu lidh gjuha. Ishte hera e parë që rrinin kaq afër njëri-tjetrit. Dhe këtë e vunë re të dy. E vunë re kur ra heshtja. Se heshtja në këso rastesh i bën më të qarta dëshirat dhe shqetësimet e njerëzve.

Ramizi vuri dorën mbi ballin e Kristinës. Ajo mbylli sytë. Ai largoi dorën.

— Sot je më mirë, më duket?

— Po...

Buzët e Kristinës prekën lehtë njëra-tjetrën.

— Nuk ndien gjë?

— Jo.

Buzët e saj nuk lëvizën fare.

— Hiç, hiç?

Ajo hapi sytë.

— Tani s'ndiej gjë, po natën...

Zëri i saj tingëlloi i zvergur.

— Mos më gënje!

Ajo e mori me gjithë mend.

— Për shpirt të babait...

Zëri i saj tingëlloi plot jetë.

Ai mori guxim dhe ia vuri rishtaz dorën në ballë.

— Po koka të dhemb?

— Pak.

Vajzën sikur e përmendi dikush:

— Po ti, si je sot?

— Unë mirë jam, po kam hallin tënd. Sa të përmirësohesh ti dhe të ikim që këndeje...

Dora e tij qëndronte ende mbi ballin e saj. Ajo e ndiente tronditjen e shokut dhe zuri ta vështronte. Ramizi e mblodhi sakaq veten dhe për t'i prapsur vështrimet e saj të dyshimta, e pyeti:

— Kristinë, duhet të ta ndërroj plagën. Ajo plaka s'po vjen. Si thua?

Vajzës i çërriti menjëherë në zemër dhe pas një dyshimi të shpejtë, tha me një fije zëri:

— Mirë...

Një hop ata qëndruan pa lëvizur. Pastaj ai afroi pranë vetes shportën. Ajo u ngrit ndenjurr, pa thënë asnjë fjalë. Ai bëri sikur pa shportën, po sytë sakaq i vanë te fytyra e saj lulëkuqe. Ajo i ktheu kurrizin. Ai vuri re gërshe-tat e gjatë. Mundohej të hiqte një-rën mëngë të xhaketës. Ai nuk merrte guxim ta ndihmonte. Ajo qëndroi pa lëvizur. Ai s'diti ç'të bënte. Ajo e pa me bisht të syrit. Ai mbeti e tha:

— Rri, të ndihmoj unë...

Kristina nuk u përgjigj, veç e la Ramizin ta zhvishte. Po, ta zhvishte, si mund ta zhvishte nëna, shoqja, vëllai, shoku i Luftës...

Ai i hoqi me kujdes xhaketën, duke bërë çdo lëvizje me ngadalë. Pastaj mori t'i hiqte këmishën. Ishte një këmishë burrash, ngjyrë mjalti, që nuk ndryshonte nga ajo e vetja. Po këtë hollësi ai nuk e vuri re fare. Padashur njëra dorë preku tek ajo dhe ai u drodh. Shqetësimi i djaloshit sa vinte e shtoej. Kur ia hoqi këmishën, atij gati sa s'iu mor fryma. Për një çast ai mbeti, kur e pa ashtu gjysmëzhveshur, me një këmishë të hollë të kaltër me cinka gjaku. Sytë e tij kaluan përshqitas nëpër të dhe në shpirt iu bë një rrëmujë. Zemra i rrihte me hov, një zjarr i hollë i gjarpëronte nëpër dej.

Kristina nuk shihte ç'po ndodhte prapa krahëve të

saj. Po megjithatë, tek rrinte e kërrusur, me fytyrë të përskuqur, e nemitur, ajo e ndiente shikimin e tij nga prapa, ashtu siç ndien njeriu diellin në shpinë.

Ramizi e mblodhi veten dhe filloi t'i zgjidhte plagën. Gishtërinjtë e tij preknin trupin e saj, me atë kujdes e frikë njëkohësisht, sikur po preknin krahët delikatë të një fluturë të bukur. Lëvizjet tani ai mendohej t'i bënte të shpejta, si të donte të fitonte kohën e humbur. Befas plaga skuqi si një trëndafil i madh.

— E ke më mirë sot, më duket!

Zëri i vet Ramizit i kumboi i huaj. Kristina nuk foli, po u mundua ta shihte tërthorazi.

Kaloi një hop në heshtje dhe kjo nuk i pëlqeu Ramizit. Prandaj, kur filloi t'i lidhte plagën, zuri ta padiste një zë nga brenda. Ky zë nuk iu nda edhe kur e vishte Kristinën, edhe kur ajo u kthye me fytyrë nga ai. Tani nuk guxonte ta shihte në sy. Dhe që ajo të mos dyshonte për asgjë, partizani uli kokën dhe nisi të merrej me plagën e tij.

— Ramiz, të të ndihmoj unë?

— Jo, falemnderit — tha ai pa i ngritur qepallat.

Vajza kishte qejf ta ndihmonte ndonëse zemra s'ia duronte. Dhe kur ai e hapi dhe zuri ta pastronte plagën, ajo herë mbyllte sytë, herë shtrëngonte buzët, herë rrudhte ballin, ndërsa damari i kaltër i rrihte në gushë.

— Sa duron ti, Ramiz... — tha ajo, kur ai mbaroi punë me këmbën e plagosur.

— Po dhe ti duron, ama...

Një nënqeshje e ëmbël përkuli vijën e buzëve të saj.

— Duroj, po kam zemër zogu...

— Do të mësohesh, mos ki gajle. Lufta të mëson vetë, si të...

— Prit, Ramiz — klithi ajo me zë të vogël dhe e kapi për dore.

— Ç'ke?

— Se kush po vjen!

Në qetësinë e tavanit u dëgjua shkoqur zhurma e disa hapave. Ishin hapa të rëndë, këmbë që shkelnin nëpër gurët e oborrit të shkollës.

Zhurma sa vinte e afrohej. Po Ramizi dhe Kristina nuk lëvizën fare. Kësaj radhe as armët s'i trazuan. Ndoshta pse qenë aq afër njëri-tjetrit. Ndoshta merrnin zemër tek vështroheshin në dritën e syrit. Zhurmës së hapave iu shtuan disa zëra. Të dy partizanët përpiqeshin të ishin të qetë. Sikur të qenë mësuar tani me të papriturat dhe rreziqet. Zërat u dëgjuan fare pranë. Partizanët nuk lëvizën. Në veshët e tyre erdhën fjalë të shkëputura.

«Cilët do të jenë këta?» — Këtë pyetje dukej sikur bënin sytë e tyre të ndezur, dora e saj që shtrëngonte dorën e tij, frymëmarrja e tyre e shkrirë në një!

Zërat filluan të shquheshin nga njëri-tjetri. «Sa vetë janë?» Ramizi shtrëngonte nofullat. Kristinës i rrihte damari i kaltër në gushë.

«Mos janë shokët që na kërkojnë? Apo janë armiq?!...»

Hapat e të panjohurve erdhën tani fare afër. Tamam sikur binin aty nën tavan. U dëgjua dera poshtë që u çel. Këta sipër u vështruan në sy. Zërat e huaj kumbuan poshtë. Prapë nuk po merrej vesh se ç'ishin ata njerëz. Kristina zgjati dorën drejt armës:

— Mos... — i pëshpëriti ai në vesh.

Ajo mblodhi dorën. Ai e përkëdheli me sy. Për një kohë u nemitën të dy palët. Ra një heshtje që i ngjante vdekjes. Ramizi qe kthyer i tëri në një qenie që vetëm hetonte. Partizanit nuk i shpëtonte asnjë zhurmë që vinte nga poshtë.

U dëgjuan përsëri zërat e huaj. Kësaj here nuk erdhi kumbimi i tyre, po fjalët vetë, të qarta sa asnjëherë:

Zëri i parë: Fukarallëk dynjaja.

Zëri i dytë: Po ti prapë nuk ngele pa gjë!

Zëri i parë: Unë?...

Zëri i dytë: Ti, po kush?

Zëri i parë: Çka bereqaversën. Gjynah të qahem. Po edhe ti s'u ndave keq.

Zëri i dytë: Kam frikë se mos na i zhvat Elmazi.

Zëri i parë: Për baba Alinë, iki që nesër!

Zëri i dytë: Po e ke komandant, mor qafir!

Zëri i parë: Paçka se e kam. Le të shkojë vetë, po ia mbajti...

— Ballistët! — murmuriti Ramizi duke shtrënguar fort nofullat.

Kristina tani e hetonte situatën vetëm nëpërmjet fytyrës së Ramizit. Qëndruan kështu për një copë herë të gjatë. Partizanët lart, ballistët poshtë.

Ata poshtë ishin shtruar këmbëkryq. Si duket hanin dhe bisedonin. Ata sipër ishin të detyruar t'i dëgjonin. T'i dëgjonin armiqtë e tyre, ashtu shtrirë, pa lëvizur fare nga vendi. Të dëgjonin sharjet, shpifjet, budallallëqet e tyre. «Sa i ndyrë është armiku!...» — mendonin të dy partizanët.

Ramizi skërmiste dhëmbët dhe psherëtinte ultazi:

— Ah, ç'të bëj... pa dija unë...

Kulmi i zemërimit arriti atëherë, kur erdhi sipër kjo copë bisede:

Zëri i parë: Për Baba Alinë, flenë me partizankat...

Zëri i dytë: Më qafsh!

Zëri i parë: Posi! Sidomos komisarët.

Zëri i dytë: Flenë si me gratë e tyre, ë?

Zëri i parë: Atë s'e di unë, se nuk u kam mbajtur pishën, po me ç'thonë.

Zëri i dytë: Ja kjo është luftë, byrazer. Jo si ne, të gjithë dervishë...

Zëri i parë: Mor dervishëve u qafsh hallin ti, po ne të varfërit...

Kristinës iu mbyllën sytë, sikur ia ngjiti njeri. Ramizi luftonte me jehonën e fjalëve të tyre që përhapej nëpër tavan. Zemërimi i therte gjoksin, po ç'të bënte?

Pas një ore ata u ngritën dhe ikën. Ramizi u çua dhe i ndoqi nga dritarja e çatisë. I vuri re nga prapa tek largoheshin. Ishin të dy njësoj: të shkurtër, me pushkë të gjata italiane, me qeleshe të bardha, me shallvare të gjera...

— Shpëtuam për një qime, se sikur të ishin ngjitur lart!... — tha Kristina e gëzuar, kur u kthye Ramizi në vend.

— Po atyre nuk u punon kungulli për asgjë, veçse për të vjedhur mendojnë...

— Po sikur të hipnin në tavan?

Ramizi u step. Vështrimi i saj i ra në sy përnjëherë.

— Sikur të hipnin, do t'i prisnim me plumb — tha ai pastaj.

— Ç'do të kenë dashur këndeje, thua? — pyeti ajo.

— Do të jetë ndonjë patrullë balliste. Po në vend që të patrollojë, del nëpër fshat dhe vjedh sepetet e nuseve.

— Unë kujtova se mos erdhën të na rrethonin ne...

Ai qeshi dhe e qeshura e tij që aq gazmore, sikur të mos kishte ndodhur asgjë para disa minutash.

— Po pse, a nuk është kështu rrethimi? — pyeti ajo me gjysmë zëri, si ajo fëmija që zihet në faj.

— Rrethimi... he... S'ke parë rrethim në dimër ti...

Gazi u zhduk nga fytyra e djaloshit.

— Pse, si është? — ia priti ajo me një kërshtëri miturake. — Ma thuaj, dua ta di!

— Po më lëndon një plagë të zemrës. Kjo që do të të tregoj ka ndodhur vetëm disa muaj përpara — nisi ai tregimin i menduar. — Ishim në malet e Skraparit. Ty s'të ka rastisur të shkosh andej... Janë male të egra ato në dimër. Merre me mend, afër Tomorrit. Ishte koha që sapo kishte filluar Operacioni. Grupi ynë që nga të parët që u godit. Patëm dëme të mëdha. Mbetëm gjysma e atij që qemë. Na u vra dhe komandanti. Ngelëm me Aliun, komisararin. Ti e njeh komisararin e batalionit të parë... Bënte një dimër që s'do ta harroj gjersa të vdes. Të përcëllonte e ftohta. Frynte një erë, brisk fare. Bora e madhe i kishte zënë të gjitha rrugët dhe shtigjet. Po neve na duhej të lëviznim për të gënjyer armikun. Ishim të lodhur e të veshur si mos më keq. Dy gishtat e këmbëve atëherë i humba. Më ngrinë e m'u kalbën në dëborë. Eh, sa i keq është rrethimi nganjëherë! Jo nganjëherë, po gjithnjë. Pabesia gjithnjë është e hidhur. Ja, si na ndodhi. Pasi kishim bërë një rrugë të gjatë, plot peripeçira, vendosëm të qëndronim në një fshat. Ishim shumë të lodhur. Sa mbërritëm, u shpërndamë nëpër shtëpia. Mua dhe Dhimitrit na ra të shkonim në një bazë.

Ti nuk e ke arritur Dhimitrin. Ç'djalë ka qenë ai! Nuk e bën më nëna një djalë të tillë... Më pikon në zemër kur e kujtoj... Shkuam në një bazë andej nga fundi i fshatit. Po nuk arritëm të çlodheshim sepse, sapo u ulëm, na erdhi urdhri të ngriheshim, se po vinin gjermanët e ballistët. Sa dolëm ne, ata mbërritën. Në fakt ishim rrethuar. Qe natë, një natë e keqe, e errët pus, me borë e me të ftohtë qamet. Megjithatë ne gjetëm njëri-tjetrin. Na tha disa fjalë komisari dhe u shpërndamë pastaj në drejtime të caktuara. Unë me Dhimitrin morëm anën e një përroi. Po ai që në të shtënat e para u plagos. M'u desh pra, të luftoja vetëm që në fillim. Mezi e çava rrethimin. Përfitova nga errësira se, po të kishte zbardhur, do të kisha mbetur në mes të ujçerve. Mora Dhimitrin në krah dhe hyra në pyll. U futa thellë pyllit, derisa gjeta një shpellë. Pa mendo, Kristinë, në mes të pyllit të rënduar nga bora, pa bukë e pa zjarr, me një të sëmurë për vdekje. Ai kërkonte ndihmë, rënkonte, thërriste, ankohej, dhe unë s'isha në gjendje të bëja asgjë. Mos harro se ishte dimër, jo si tani, behar fare. Haja veten me dhëmbë dhe sa s'qaja nga inati. Isha gati të bëja çdo sakrificë, vetëm të shpëtonte ai! Po gjendja e tij sa vinte e rëndohej. E kishte marrë plumbi keq. Të nesërmen dola nëpër pyll të kërkvoja shokët, po nuk i gjeta. Atëherë u ktheva në shpellë. U ktheva i mërzitur. Ai do të më kërkonte ndihmë dhe unë s'do të isha në gjendje t'i jepja asgjë. Po ai nuk u ndie sepse, sapo hyra në kasolle, rënkoi rëndë dhe u përpëliti. I vajta afër e i fola. Ai nuk m'u përgjigj. Psherëtiu thellë, si të donte të nxirrte jashtë gjithë frymën që e mbante gjallë dhe zbardhi sytë. Pas pak, më vdiq në duar. Kështu ngela vetëm, me Dhimitrin e vdekur, shokun tim më të ngushtë. Rrija e shikoja dhe nuk më besohej që s'ishte më gjallë. I flisja, e tundja, e fërkoja, i vija veshin nëpër trup. Po kot që i bëja të gjitha këto. Ai erdhi gjithnjë duke u ftohur. Nuk kisha pse të rrija më. Gati sa s'po mbaroja edhe unë. Isha i lodhur qamet, i uritur për vdekje, i nxirë nga të ftohtët. Mezi e binda veten se ai kishte vdekur. Vajta hapa një gropë në borë, rrëzë një dëllinje, e mora Dhimitrin në krah dhe

e vendosa aty. Para asaj grope nuk u mbajta dot... e putha në buzë, siç putheshim sa herë niseshim për ndonjë aksion dhe e mbulova me borë. M'u duk sikur varrosa atë kohë një pjesë të vetes sime. Pastaj u ktheva në shpellë, hodha armën dhe çantën e tij krahëve dhe u nisa për të kërkuar shokët... — Ai e sosi tregimin me mundim dhe pastaj shtoi: — E di ç'djalë ka qenë? Trim, i shkuar me të gjithë... Për një vit mbaronte shkollën normale. Bënte dhe vjersha. Eh, sa shokë na kanë ngelur mes atyre maleve!...

Kristina fshiu sytë me kurrizin e dorës dhe tha e ngashëryer:

— Sa keq, Ramiz! Më mirë të mos ma kishe treguar.

Partizani nuk foli.

— Tani po e kuptoj — tha ajo pas pak e lehtësuar — se kjo e jona nuk është asgjë para asaj që keni hequr ju...

— Ashtu është — foli ai i rënë në mendime. — Kanë ndryshuar shumë punët. Në tani i kemi lënë malet, kemi zbritur në fushë e jemi rreth qyteteve. Edhe pak na ka mbetur. Po sa kemi hequr për të ardhur gjer këtu!... Merr vetëm çetën time, ishim vetëm një grusht njërezish, kurse tani jemi bërë një brigadë e tërë...

Pastaj Ramizi i foli për shokët e çetës, për Ajetin, komisarin, që ishte plagosur disa herë e s'deshi t'ia dinte, për Haxhiun, shenjuesin e zot, që kishte vrarë me dhjetëra armiq, për Zoin, korrierin trim e për të tjerë që ajo s'i njihte, po që të gjithë tok, e bashkë me ta edhe Ramizi. kishin luftuar dhe kishin mbetur gjallë pas Operacionit të Dimrit. Biseduan edhe për markat e armëve, për llojet e fishekëve e sidomos për ata me helme, për efektin e bombave... Kështu kaloi e gjithë paraditja. Ata kishin folur aq shumë, sa Ramizi për një çast pandehu se nuk kishte mbetur gjë më për të biseduar. Po pasi hëngrën pak bukë dhe u shtrinë e pushuan, aty nga pasdrekja Kristina e pyeti për diçka që atij nuk i kishte shkuar ndonjëherë nëpër mend:

— Ramiz, a të pëlqejnë librat?

— Më pëlqejnë...

— A ke kënduar shumë?

— Pse, ti nuk ke kënduar?

— Kam kënduar, po mbase jo sa ti...

Ai qeshi nën hundë:

— Pse thua jo sa unë?

— E marr me mend...

— Po mendja mund të të gënjejë.

— Jo, për ty s'më gënjen...

Ajo foli me aq bindje, sa ai u trubullua dhe nuk mundi ta kundërshtonte. Kaloi një copë herë në heshtje. Pastaj ajo e ngau prapë bisedën e filluar:

— E ke kënduar romanin «Gjenovefa»?

— Jo.

— Është romanc i bukur... E shkreta Gjenovefë!.. Sa kam qarë për të... Unë qaj kur këndoj romanca. Po ti qan?

— Jo, nuk qaj...

Ramizi buzëqeshi, po ajo nuk e vuri re. Ai nuk e merrte me mend se si mund të ketë libra të tillë që ta bëjnë njeriun të qajë, siç kishte qarë ajo.

— Ju djemtë s'qani kollaj, po ne vajzat ndonjëherë, ato që s'i themi dot me fjalë, i shfrejme me lotë...

Ramizi deshi t'i thoshte se lotët tregojnë dobësi, se njeriu nuk duhet të qajë, po mënyra se si fliste ajo, zëri i ëmbël e i afërt e thyen padashur dhe e bënë të heshte. E ç'ishte nevoja të kundërshtonte. Ai e njihte tani natyrën e saj të butë. Më mirë t'i thoshte se ç'libra kishte lexuar, se sa ta rëndonte me këshilla e vërejtje. Nuk ishte tani as koha, as vendi. Ramizi solli nëpër mend me radhë ata pak libra, romanca, siç i quante ajo, që kishte lexuar dhe sepse i lindi dëshira papritur t'i fliste për njërin prej atyre.

— «Lulen e kujtimit» e ke kënduar ti? — e pyeti.

— Jo, dëgjuar e kam, po s'më ka rënë ndonjëherë në dorë. Është i bukur?

— I bukur është... Flet për kohën e çetave të lirisë... Është një libër patriotik, po se ç'ka një gjë: s'para është revolucionar...

— Ashtu?!

— Po...

Vajza bëri sikur e kuptoi mendimin e tij, po në të vërtetë nuk mori vesh se ku e kishte hallin. Një libër që është shumë i bukur, s'ka si të jetë edhe i keq. Këtë nuk e kuptonte Kristina.

— Po si qenka ky libër kështu?! — pyeti ajo me drojtje, duke u ngritur ndenjurr.

Ramizi s'dinte t'ia shpjegonte me pak fjalë, prandaj i tha:

— Do të ta them historinë?

— Posi, të ma thuash të gjithë. Unë i kam shumë qejf librat. Po e mban mend?

— Sikur e kam kënduar dje...

Ramizi kishte kohë që e kishte lexuar, ndoshta disa vjet, dhe megjithatë i tha se e mbante mend mirë. Po a e mbante mend vërtet? A do t'i kujtoheshin të gjitha ngjarjet me radhë? A do të dinte të shpjegohej mirë? Nuk ishte puna vetëm të kujtesa. Ai nuk do të tregonte një përrallë, që ta dëfrente Kristinën ose ta vinte në gjumë. Donte t'i rrëfente një histori që të kishte një kuptim. Po, një kuptim që të bartte një pjesë të mendimeve që i buçisnin në kokë.

Dhe kështu ai nisi të tregonte. E përmblodhi gjithë romanin në një tregim të tijin, në një tregim të gjatë e tërheqës, duke i paraqitur ngjarjet si të vërteta, tamam si t'i kishte jetuar vetë. Dashurinë e Dhimitrit me Olimbinë e tregoi jo ashtu siç është në libër, po ashtu siç ia thoshte mendja. Tregimi rridhte aq natyrshëm, sa as ai vetë nuk ishte në gjendje të dallonte se ç'gjë ishte e tija e çfarë mbante mend nga libri. Bile për ta bërë sa më të gjallë tregimin ndryshonte zërin sipas rasteve, jepte e merre me gjeste, e shoqëronte me mimikë të fytyrës. Ajo e ndiqte me gojë hapur dhe herë pas here e ndërpriste me pasthirrma ose e nxiste me fjalë.

Në fund, Ramizi mori një pamje të ngrysur dhe, duke tundur kokën, tha me keqardhje:

— Ah, Dhimitër, Dhimitër...

— Ç'ke me Dhimitrin? — ia bëri ajo e habitur.

— Si ç'kam? Po pse, mirë të duket që vajti e u lidh me zotin Kristo?

— Po pse, ç'bëri ai? — e kundërshtoi ajo, pa i shkuar mendja te ndonjë gjë e keqe. — Ai e donte Olimbinë dhe zoti Kristo ishte babai i saj.

Sytë e Ramizit xixëllonin nga një zemërim i përmbajtur. Ai ishte prekur nga ngjarjet e tregimit.

— Hë, babai i saj. Po tamam nga babai i saj ai dinte ç'kishte hequr... Zoti Kristo, kupton, i kishte marrë shpirtin... Bashkë me Nikon ai u përpoq ta zhdukte nga faqja e dheut... Kurse Dhimitri vajti e shpëtoi nga thonjtë e hajdutëve. E pse? Mos për të mirat që i kishte bërë? Mirë, këtë e lëmë mënjanë... Po pse vajti e u bë dhëndërr i zotit Kristo... — atij iu mor goja. — E di ç'do të thotë kjo? Dhimitri hyri në radhën e tregtarëve. Kështu është kur nuk mban qëndrim...

Ramizi ishte i inatosur me të vërtetë. Atij i mbahej goja dhe përsëriste shpesh fjalën «kupton». Kristina tani e kishte vështirë t'i dilte përpara vrullit të tij. Ndaj heshti, dhe kjo sikur ia fashiti ca zemërimin partizanit. Pas pak, ai zuri të fliste më i qetë:

— Të mos harrojmë se ai ishte shërbëtor, punëtor i varfër dhe një shërbëtor nuk duhet të bëhet borgjez. Të them të drejtën, për këtë nuk i besoj librit. Më duket i ujditur, bile i ujditur keq. Dashuria e tyre nuk është fort e rregullt. Ja, më thuaj, di ti ndonjë rast që një shërbëtor, siç ishte Dhimitri, të jetë martuar me ndonjë vajzë tregtari?

Ai nuk priti që ajo të përgjigjej. Bile as nuk pa që ajo ngriti supet, po iu përgjigj vetë pyetjes së tij:

— Asnjë, për ideal! S'ka ngjarë ndonjëherë që shërbëtori të bëhet dhëndërr i të zot!

Kristina mendonte vetëm për fatin e dashurisë së Dhimitrit me Olimbinë dhe as i shkante mendja fare për ato që i thoshte Ramizi.

Ajo rrinte e brengosur dhe e nemitur. Këtë Ramizi e vuri re kur i kaloi ai vrull i brendshëm që i kishte shpërthyer papritur.

— Ç'i ke ata sy ashtu? — pyeti ai si me qortim.

— Kot... — belbëzoi vajza dhe e mbuloi fytyrën me dorë.

— Të dhimbset Olimbia?

Vajza nuk diti t'i dredhonte dhe foli si t'i fliste vetes:

— Po, më dhimbset...

— Budallage, qan për higjë. Ne s'kemi qarë kur janë vrarë shokët.

Ajo u mundua të fshihej pas një buzëqeshjeje dhe tha me zë të lartë:

— Po si ta linte Dhimitri, kur ajo u çmend për të dhe vuajti aq shumë?

Ramizi u ndez rishtaz:

— Ç'i duhej, fundi, të trazohej me atë vajzë, apo donte të bëhej prapë shërbëtor i zotit Kristo?.. Po thuaj që atëherë ishte kohë tjetër, kupton? Tani njerëzit janë ndryshe dhe dinë t'i dallojnë këto gjëra. Sot nuk gjen Dhimitra dhe Olimbira...

Kristina rrinte gojëkuçur dhe habitej se si Ramizit, që ishte kaq i mirë e i kuptueshëm, nuk i vinte pak keq për Olimbinë dhe dashurinë e saj.

— E di si them unë? — tha ai, si u mendua një hop. — Më mirë të lidhesh me një njeri të radhës tënde, që të shkon dhe të kupton nga çdo pikëpamje. Ç'na duhet të trazohemi me bijtë e tregtarëve e të bejlerëve? Si thua ti, Kristinë?

— Ku ta di unë — ngriti supet ajo. — S'i kam menduar ndonjëherë këto gjëra...

— As unë nuk i kam menduar, po me që ra fjala...

Kristina uli sytë dhe sikur u mblodh në vetvete. Ramizi ishte i shqetësuar. Një mendim i gjallë i përpëlitej nëpër kokë. Ndiente që gjaku po i hipte në fytyrë. Matej të thoshte diçka, po një nyje i lidhej në grykë dhe s'e linte të fliste. Ishte si ai njeriu i pastërvitur, që merr hov të kapërcejë një pengesë dhe, kur vjen para saj, papritur mbetet. Dhe ai mori hov disa herë, disa herë iu lidh gjuha, po më në fund guxoi ta pyeste:

— Ti... Kristinë, ke dashuruar ndonjëherë?

Ajo hapi sytë:

— Si the?

— Ke dashuruar ndonjë djalë?

Kristina u skuq deri te veshët dhe tha me të shpejtë:

— Jo...

— As unë... — tha ai si për ta qetësuar.

Kristina tërhoqi përpara gërshetat dhe filloi të luante me to. Vështrimi i saj pulitej pas qerpikëve të ulur. Heshtja që pasoi, sikur rëndonte mbi gjoksin e partizanes së re. Tani ajo nuk merrte më frymë e qetë, e kuptoi mendimin e tij të pashprehur dhe, si për t'i dalë përpara, tha:

— E ku është ajo kohë tani, Ramiz...

Dhe tek tha këto fjalë, ajo mori një hije të rëndë, tamam sikur po thoshte ndonjë parullë a kundraparullë partizane. Uli kokën dhe nisi sërish të ngacmonte gërshetat, pa guxuar të ngrente sytë.

— Koha s'është vërtet... — ia ktheu Ramizi si t'i fliste vetes, duke u munduar ta shpërndante mjegullën që i errësonte mendimet. — Mirë thua ti, ters e kemi... Po nganjëherë, në kësi rastesh njeriu sikur nuk e ka veten në dorë. Mund ta urdhërosh veten në luftë, kupton... Po... nejtë... kupton... Moshë me zarrar kjo jona... Si thua? Apo e kam keq?

— Ç'të them unë e shkreta... mosha jonë ka andralla të tjera tani...

U krijua një pauzë e gjatë. Ramizin diçka e gërvishte në kraharor. Ajo nuk dinte ç'të bënte me gërshetat. Ai mendonte si ta zgjaste më tej këtë bisedë, kurse ajo lutej në heshtje që të mbyllej me kaq.

— E di si them unë? — tha Ramizi duke lëvizur trupin për ta larguar atë plogështi që e pengonte të fliste lirisht. — Sot nuk është koha, kupton, po nesër, kur të kthehemi në shtëpi, ë?... Ne do të martohemi doemos, kështu?

— Po... — pëshpëriti ajo me një fije zëri.

— Patjetër do të martohemi... — ngriti zërin ai, me qëllim që t'ia hiqte sado pak drojtjen vajzës dhe turpin që e kishin zënë atë çast. — Do të martohemi, ëë? Se

nuk kemi ndër mend të mbyllemi nëpër manastire... Si thua ti, të bëhemi murgjër?

Kristinës i erdhi për të qeshur. Ajo kafshoi buzën dhe s'u përgjigj.

— Do të martohemi patjetër — tha ai i vendosur.

— Po ç'do të ndodhë? Ja, ku ta kam fjalën, kupton... Nuk do të marrim bijat e zotërinjve, siç bëri Dhimitri, që mori të bijën e zotit Kristo, po... do të marrim shoqet tona të Luftës...

Kristina u drodh. Rreziku tani ishte fare afër.

— Mos të të vijë rëndë, kupton... po unë, fjala vjen, ë... vajzë më të mirë se ndonjë nga shoqet tona, ë, nuk do të gjeja kurrë... Pse, e paktë të duket gjithë kjo Luftë për ta njohur njeriun?... Kështu si unë, do të veprojnë edhe shokët e tjerë... Apo nuk mendoj drejt?

Ajo, në vend që t'i përgjigjej, hodhi gërshetat pas, pa i ngritur sytë nga prehri.

Ai ia pat prapë:

— Si thua, kam, apo s'kam të drejtë?

Ajo e vështrroi si me frikë dhe pa i ngritur qepallat pëshpëriti:

— Ku di unë...

— Po ti duhet ta dish...

— E nga ta di unë... Këto gjëra i dëgjoj për herë të parë... Nuk ma ka sjellë puna...

— Po mund të ta sjellë... Të rinj jemi...

Ramizit i ngjante sikur ecte kundër rrjedhës së një lumi të furishëm.

Ajo u mendua një çast dhe mori guxim e tha:

— Të rinj, vërtet, po jemi partizanë, Ramiz!

Atë sikur e shtrëngoi njeri në grykë. Sytë iu errësuan nga një zemërim i beftë. Ngriti dorën në drejtim të saj dhe thirri:

— Ti mos fol kështu, se dhe unë i di detyrat e mia...

Zëri i tij kësaj here tingëlloi i ashpër.

Ajo mbeti e nemitur, sikur ai ta kishte qëlluar me shuplakë. Ai u prish në fytyrë, sikur ajo t'ia kishte lënduar keq plagën.

Ramizit sakaq iu sulën qortimet:

«Mos kujton ajo se nuk e di unë përse kam dalë maleve? Pandej se kam dalë për qejf?... Unë nuk jam ndonjë djalkë mamaje...as ndonjë vagabond që dua të shfrytëzoj rastin! Unë jam shoku i saj i Luftës dhe shumë keq, në qoftë se ajo mendon ndryshe!...»

Qortimet i kalonin Ramizit si gjilpëra nëpër kokë. Balli iu mbush me bula djerse. Mjekra iu drodh. Vala e zemërimit i hipi në kokë dhe atëherë nuk mendoi më. U ngrit plot duf dhe, duke u mbajtur me një këmbë kaloi në vendin e tij. Ishte hera e parë që Ramizi shkelte kufirin e durimit.

Kristinës i dogjën sytë.

— Ramiz!

Ai ktheu kokën dhe e vështroi vëngër:

— Ç'pate kështu, Ramiz?

— Asgjë... — ia bëri ai prerazi.

Asaj iu pre balli nga rrudhat.

— Jo, ti ke diçka...

Ai uli sytë.

— Kam këtë që nuk dua të të bezdis...

— Mos ma thuaj atë fjalë, se do të zemërohem. Unë të kam si vëlla...

«Vëlla!» — përsëriti djaloshi me vetë dhe u vrenjt edhe më shumë.

Ajo e hetonte pa ia ndarë sytë. Ai mbante buzët të puthitura fort.

— Po ti, a më ke motër? — e pyeti ajo me një ton fëmijëror.

— Jo — tha ai i vendosur, ndërsa kapsalliste qepallat — të kam shoqe Luftë!

Biseda reshti papritur. Kristina tani s'dinte ç'të thoshte. Ai prapë e lidhi në fjalë. Ata prapë i ndau hesh-tja. Një grerëzë e verdhë kishte hyrë nën çati e vëzellonte përqark tyre.

— Ramiz, ngrehu të hamë bukë...

— Nuk më halet...

— Jo, do të hash!

— Me zor?

— Po, me zor!

Lutjet e saj sikur ia shtruan gjakun partizanit. Rrudhat në fytyrë iu rralluan.

— Po nuk më hahet, besomë.

— Atëherë as unë nuk ha...

Ajo u ngrys në fytyrë dhe Ramizit i erdhi keq. Nuk mjaftonte plaga e rëndë në trup, po duhej që edhe ai ta mërzhiste. Partizani i vjetër e mblodhi veten. E mposhti ndjenjën që atë çast e quajti të keqe dhe u kthye përsëri tek ajo. Po këtë herë i ndenji pak larg.

Ajo vendosi në mes misërniken dhe mori të hante vetë e para.

Ata hetonin njëri-tjetrin tinëz, pa shkëmbyer asnjë fjalë.

Ai kafshoi bukën. Nofullat i lëvizte me plogështi. Ajo përtypej dhe shikonte mustaqet e tij të zeza.

— Si të duket misërnikja, Ramiz?

— E mirë!

— Po djathi?

— I mirë!

— Po unë, si jam?

— E mirë!

— Jo — tha ajo e mallëngjyer — unë nuk jam e mirë, jam e keqe, përderisa të zemërova...

Ramizit iu drodhën buzët. Ajo tani ishte përtej cakut të vështrimit të tij.

— Kristinë, kuptoje se unë jam i keq dhe ti je e mirë...

Ata vështronin nofullat e njëri-tjetrit që lëviznin nën faqet e dobësuara. Ajo priti sa ai kapërceu kafshatën dhe tha:

— Mos të mbeti hatri?...

— Jo.

— Pse më gënjen?

Ai shtrëngoi sytë dhe s'foli.

— Eë? Pse më gënjen?

— Unë s'di të gënjej, aq më tepër ty nuk të gënjej dot.

— Po përse të mbeti hatri?

— Po njeri jam dhe unë. Më mbetet nganjëherë hatri...

— Po unë s'jam njeri?

— Njeri je!

— Po atëherë, nuk të vjen keq?

— Për çfarë?

Ajo s'u përgjigj. Biseda rishtaz hyri në qorrsockak. Tani ata e kishin lënë fare të ngrënë. Bukën, në vend që ta hanin, e thërrmonin nëpër duar.

— Ti më mundon, Ramiz!

— Si të mundoj?

Ajo kafshoi nyjen e gishtit tregues.

— Po, më mundon... Si të ta them unë ty...

Ai e vështronte drejt e në sy.

— Si? Ma thuaj, se nuk po të kuptoj.

Ajo uli kokën dhe u hutua fare.

— Po ne kuptoheshim shumë mirë. Si u ngatërruam kështu?

Fytyra e Ramizit u bë serioze.

— Kristinë, i lëmë më mirë këto muhabetë. Nuk merremi dot vesh. Ndoshta s'është koha.

Ai mezi e mbante dufin përbrenda.

— Për çfarë nuk merremi vesh? — pyeti ajo e tronditur, ndërsa sytë iu bënë qelq.

— Për asgjë nuk merremi vesh!

— Si për asgjë? Jemi partizanë dhe nuk u merrkemi vesh?

Ai shtrëngonte dhëmbët dhe merrte frymë rëndë.

— Ç'të të them... Ti flet me kokë, unë flas me zemër. S'di, për ideal...

Kristina mbeti për një çast. Një dhembje e fortë e mundonte përbrenda. I digjnin sytë e faqet. I fërgëllonin flegrat e hundëve. Fytyra iu vrenjt e tëra, sikur i ra një re e zezë.

— Ramiz, pse flet kështu, ti i di punët më mirë se unë.

Zëri i saj kësaj here tingëlloi i fortë. Ai padashur uli kokën si të ishte fajtor.

— I di, apo s'i di?

— I di... — belbëzoi ai.

— Po pse atëherë ma merr çdo gjë për keq dhe më mundon?

Ramizi ngriti kokën me një ngathësi të dhembshur. Më lehtë ishte për të tani t'u qëndronte plumbave të armikut se sa fjalëve të saj. Vështrimi nuk i arrinte tek ajo. Ai qëndronte aty si i mpirë, me fytyrë të çoroditur.

— Ndoshta — tha ai me zë të dridhur — s'kam të drejtë që flas kështu, po mua ka kohë që s'më hiqet mendja nga ti. As unë nuk di se çfarë dua...

Sytë e tij shihnin vetëm një njollë të zezë. Një mendim, që deri atëherë i rrinte struktur diku thellë në vetëdijë, i doli në sipërfaqe.

— Dua të jemi shokë sa më të ngushtë, kupton? — tha me zë të lartë.

— Po ne shokë të ngushtë jemi...

Ai qeshi me zor, duke tundur kokën:

— Si ta marrësh. Më parë më rastiste të të shihja rrallë, e lëre pastaj të rrija me ty. Kur të takoja, atëherë më shkonte e gjithë dita e gëzuar. Të më besosh, se edhe në përpjekje me armikun veja më zemër të ngrohtë. Nuk më hiqej mendja nga ti. Kur kthehesha, më hipte një dëshirë të të thosha diçka. Po ti më rrije larg dhe për këtë nuk kishe faj. Kurse tani ti je pranë meje, kupton... dhe, po të sillesha tjetërsoj, do të të gënjeja. Unë nuk dua të të gënjej, kupton, për gjakun e shokëve...

Ajo rrinte e brengosur. Buza e poshtme e lëshuar i skuqte si fletë lulekuqeje.

— Të besoj, po ti e di mirë se nuk është koha. Ne kemi pushkën në dorë.

Ramizi u ndez e mori zjarr rishtaz:

— Po, e di, pushkët në dorë i kemi dhe po luftojmë dhe nuk të kërkoj që për punë dashurie të lëmë Luftën, po...

— Ramiz, po ti kuptomë — e ndërpreu përnjëherësh ajo. — Të kemi durim. Lufta tani po mbaron dhe me të mbaruar do të vendosim për fatin tonë...

Atij iu varën këndet e buzëve. Papritur ai iu afrua vajzës dhe, duke zgjatur dorën e djathtë, i tha:

— Kristinë, më thuaj një gjë, s'më mbetet hatri, pse ma shtyn kështu? Mos...

Ajo sikur mori një shuplakë të dytë dhe fjalët i dolën mbyturazi:

— Unë?... Për shpirtin e babait, për ideal, nuk të gënjej...

Sytë e tij vezullonin nga dyshimi:

— Po pse, s'është e thënë të më duash mua medemos. Ka shokë të mirë plot në batalion...

Ajo sikur e mblodhi veten.

— Ku të shkon mendja dhe ty... Thuaj tani që s'je i keq...

— Po, i keq jam, ta thashë qëparë...

— Do, të ta them? — foli ajo si fëmijë.

Ai u drodh.

— Hë!

— Në rast se... jo, jo!

— Çfarë?

— Jo, jo nuk e them...

— Pse nuk e thua?

— Më vjen turp!

— Nga unë të vjen turp?

Ajo ngriti supet dhe uli sytë.

Ramizi luftonte me heshtjen, që të mos i humbiste filli i bisedës.

— Ma thuaj, tani!

— Po ti e kupton...

— Unë nuk kuptoj asgjë. Jam bërë i trashë sot...

— Mos ma merr për keq!

— Jo!

— Mos ia thuaj njeriu!

— Jo, po fol...

Padurimi po i zinte frymën Ramizit.

— Atë që ke bërë ti për mua, nuk do të ta harroj kurrë...

— Unë s'kam bërë asgjë.

Ajo nuk ua vuri veshin këtyre fjalëve dhe vazhdoi:

— Pas këtyre që na ndodhën, ne u bëmë shokë e shkuar shokëve.

Ai luhatej tani në mes të habitës dhe zemërimit.

— Prapë nuk të kuptoj.

— Tcë, ç'më gjeti mua, të shkretën!...

— Ç'do të thuash me të gjitha këto?

Ajo kafshoi gishtin tregues dhe tha e shqetësuar:

— Po ja, në rast se... unë do të zgjidhja, do të të zgjidhja ty...

Asaj iu duk sikur i rrëshqitën këto fjalë dhe jo sikur i shqiptoi.

— Mua?

— Po!

Atij i shkrepëtinë sytë shkëndija. Kristina përpigjej të tregohej e qetë. Vetëm një tik nervoz, që i dridhej në fytyrë, e tradhtonte.

— Kristinë, dua ta fle mendjen. Nesër ndoshta ikim që këndeje dhe në batalion s'do të bisedojmë dot kështu. Ma thuaj hapur, a lidhemi bashkë?

Ai e pati më lehtë ta thoshte atë gjë që e mundonte me fjalën «lidhemi». Fjalëve të tjera nuk u besonte, dru-hesh t'i thoshte. Kujtonte se kështu do të kishte më pak keqkuptime.

Asaj i qe zhdukur tani tërë gazi i parë. Buzët i rrinin të puthitura fort.

— Lidhemi, apo jo?

— Po si të them, unë e shkreta?

Zemra e saj lëkundej nëpër dallgë.

— Thuaj atë që mendon vërtet...

U bë një heshtje e gjatë, pastaj ajo foli kokulur:

— Lidhemi, Ramiz, po ç'do të thonë shokët po ta marrin vesh?

Atë çast dukej sikur dielli dhe retë luanin në fytyrën e partizanit.

— Ne s'po bëjmë ndonjë gjë... Vetëm po japim fjalën.

Në zërin e Ramizit kumbonte një notë gëzimi e përmbajtur.

Ajo nuk i qëndronte dot vështrimin të tij.

— Po pse të nxitohemi?

Ai lëshoi një ofshamë të thellë dhe ia pat me një ton të prerë:

— Më mirë, më thuaj s'të dua, se sa të luajmë me fjalë...

— Ramiz — u hodh vajza — unë s'di të luaj me fjalë. Atë që mendoj, ta them. Mos të të shkojë mendja për gjë tjetër... Ti...

Ajo deshi të vazhdonte akoma, po një nyje iu lidh në fyt. Ai u afrua dhe fytyrat e tyre sa nuk u takuan.

— Ne po luftojmë për një gjë të madhe — tha me një ton madhor partizani i tronditur — dhe dashuria jonë, ta dish, asaj i takon. Pa Luftën ne nuk do të qemë njohur e nuk do të qemë lidhur kështu. Për ne Lufta qëndron mbi të gjitha...

Ramizi ndiente një shtytje të brendshme që t'i thoshte këto gjëra, s'ka gjë, se ato që thoshte i dinte mirë si Kristina ashtu dhe ai.

— A më kupton tani?

— Të kuptoj — murmuriti ajo kokulur, me fytyrën lulëkuqe.

— Ma thua me gjithë shpirt këtë?

Ai e hetonte pa i shpëtuar asgjë.

— E si të të besoj për këtë?

— Ashtu si të besoj dhe unë!

— Si më beson ti?

Zemra e saj përpëlitej përbrenda si një zog në dorë.

— Eë? — vazhdoi të pyeste ai.

— Të besoj si veten time... më shumë se veten time...

— Dale të t'i shoh...

Ai i tha këto fjalë aq vetvetiu, sa ajo ngriti përnjëherësh kokën e habitur.

— Çfarë të shohësh?

— Sytë.

Ajo u turpërua dhe uli kokën sërish.

— Kristinë, ngrije kokën dhe vështrromë! Thonë që sytë janë dritaret e shpirtit. Ata nuk të gënjejnë. Ngriji, pra...

Dhe ajo i ngriti, po nuk i kishte ndier ndonjëherë gepallat aq të rëndë sa atë çast. Dhe kur i ngriti, vështrimi i saj i habitur e i përhumbur u bë i qartë dhe mori kuptim.

Atëherë vështrimet ua zunë vendin fjalëve. Dhe në çaste të tilla, vështrimet në sytë e njëri-tjetrit janë si xhama të pastër, përmes të cilëve mund të shohësh edhe fundin e detit. Kurse fjalët në këso rastesh u ngjajnë pasqyrave që tregojnë vetëm sipërfaqen, po jo thellësinë. Ata vështronin në thellësi të njëri-tjetrit dhe rrinin të nemitur. Për disa çaste koha mbeti në vend dhe ata harruan krejtësisht ku ndodheshin. Befas Ramizi e shkëputi vështrimin prej saj dhe u kthye e tërhoqi armët pranë vetes. Ajo e vështroi e habitur, pa kuptuar se ç'donte të bënte ai. Ramizi ia pat prapë me ton madhor:

— Kristinë, le t'i shkëmbejmë armët për kujtim të fjalës që dhamë. Na ti automatikun tim. Unë po mbaj pushkën tënde.

Ajo zgjati dorën e shëndoshë dhe e mori. Një copë herë ata mbetën të dy me armë në dorë dhe pastaj i vunë sekush pranë vetes.

Sipër çatisë atë kohë sa po binte mbrëmja. Po shuheshin dalngadalë zhurmat e ditës. Mugëtira hynte nga jashtë dhe e vishte hapësirën e tavanit bojë vjollcë. Qetësia sa vinte bëhej më e thellë. Zërat tani tingëllonin ëmbël e fuqishëm si muzikë. Kristinës i këndonte gazi përbrenda, po edhe diç e shqetësonte. Ramizin e kishte hutuar lumturia. Jeta u rridhte vrullshëm nëpër dejet rinore.

Po dashuria e tyre nuk i ngjante një dashurie të zakonshme. Ajo ishte larg nga ngasjet dhe nga lektisjet. Ajo ishte dashuri partizane. Prandaj Ramizi u ngrit dhe shkoi në vendin e tij. Prandaj Kristina e mbështeti e qetë kokën mbi gjerdanin e fishekëve. Në mes tyre tani qëndronte errësira. Ajo i ndante, po s'i pengonte të merreshin vesh. Në atë tyl të zi, sytë e tyre shndrisnin si yje. Ata shihnin sytë e njëri-tjetrit dhe ëndërronin.

— Kristinë, s'më flihet fare sonte!

— As mua s'më flihet, Ramiz!

Kristinës i vinin varg mendime dhe dëshira të bukura.

— Sa qejf kam të marr pjesë në çlirimin e qytetit tim! Si thua, do ta kem këtë fat?

— Pse mos ta kesh...

— Do të kërkoj vetë, po nuk më caktuan. Unë e njoh vendin me pëllëmbë, sidomos mëhallën e Shkozës...

— Ja, të caktuan, ç'do të bësh?

— Si ç'do të bëj? Do të hidhem në sulm e para. Pse, e paktë të duket të luftosh për çlirimin e qytetit tënd?... Veç të vijë ajo ditë! Më ka marrë malli edhe për gurët...

Ata tani nuk kishin frikë nga heshtja.

— Si thua, do të jemi bashkë tërë jetën?

— Po, Kristinë!

Ramizi donte që çasti të zgjatej pa mbarim. Luftonte dëshira e zjarrtë me kohën që ikte.

— Kot të pyes... Po për çfarë mendon?

— Mendoj për kohën kur do të mbarojë Lufta. Si thua ti, do dhe shumë të vijë?

— Do të vijë shpejt!

— Sa mirë! Ajo do të jetë një kohë e mrekullueshme! Populli është ngritur i gjithë më këmbë. Po bën sa e sa sakrifica... Dhe s'ka si të ndodhë ndryshe. Unë kam besim për këtë. Po ti, Ramiz?

— Dhe unë, Kristi... Ajo kohë do të vijë pa tjetër...

— Unë them se do t'ia arrijmë. Po ti, Ramiz, si thua?

— Edhe unë kështu them. —

Heshtën një copë herë. Heshtja tani bënte pjesë në bisedën e tyre. Pastaj Ramizi zuri të fliste për të ardhmen me fjalë të thjeshta, po që tingëllonin fuqishëm.

Kristina dëgjonte këto fjalë, mbyllte sytë e binte në ëndërrime. Nën qepallat e lëshuar i bëhej një fantazi dritash e ngjyrash që i ngashërente shpirtin dhe i tralliste mendjen. I dilte përpara, përmes ngjyrave të ylberit e ardhmja, jeta e saj dhe e Ramizit, ajo e shoqeve dhe e shokëve, jeta e gjithë popullit që ishte hedhur në Luftë. E joshur dhe e nemitur nga këto ëndrra e vegime, vajza e re dridhej në një dremitje të ëmbël dhe në ato çaste ndiente se Ramizin e kishte pranë...

Atë natë ata do ta gdhinin. Dashuria u kishte dhënë

gëzime e forca të reja. Atyre s'u kishte shkuar ndonjë-herë ndër mend se brenda një nate mund të thuheshin aq gjëra të bukura, mund të thuheshin aq ëndrra të zjarrra, mund t'i afroheshin aq shumë ditës së lirisë!

Disa herë ata thanë «natën e mirë» dhe disa herë e harruan këtë. Mendja e tyre gjithnjë trapiste larg. Po kur nata zuri të freskohej dhe Kristinën filloi ta mundonte lemza, Ramizi u ngrit, e mbuloi e i tha:

— Kristina, ti je lodhur. Më mirë të flemë. Nesër ndoshta vijnë shokët dhe kemi rrugë për të bërë. Natën e mirë!

— Natën e mirë, Ramiz!

Po prapë ndenjen zgjuar, sekush më vete. Kristina kishte vendosur të mos flinte gjithë natën. Harroi se ishte e plagosur. Trupi i sëmurë e i lodhur s'i qëndroi dot. Dhe e zuri gjumi shpejt. Ramizi si zakonisht ndenji më gjatë. Mbeti vetëm me mendimet e tij. Hëna hyri në kornizën e dritares mbi çati dhe lëshoi një dritë të zbetë. Ai rrinte në errësirë. Ajo flinte nën rrezet e praruar. Një gjëzim i shurdhër e mbajti zgjuar partizanin gjër në të thyer të natës. Pastaj po ajo zhurmë e largët e nanuriti dhe e vuri në gjumë.

K A T Ë R

Kristinës i doli gjumi shumë shpejt. Atëherë po agonte. Dalngadalë drita e ëmbël e mëngjesit hyri nën çati. Ajo hapi sytë dhe vështroi nga Ramizi. Ai flinte aty pranë. Flinte në krah të saj. Në mes qëndronin armët. Afër saj dhe afër tij njëkohësisht. Ato shkëlqenin e ndizeshin nën rrezet e dritës si një zjarr. Ai flinte i qetë, përtej këtij zjarri, me një dukje të ëmbël në fytyrë, ku çdo gjë i ngazëllente. Të ishte vërtet aq i lumtur, sa nuk e përmbante dot gazin as në gjumë? Kristinës nuk i shkoi nëpër mend ky mendim. Një gjë tjetër mendonte atë çast. Mendonte diçka më të thjeshtë: donte ta zgjonte dhe megjithatë i vinte keq... Ndoshta, ai kishte ndenjur natën pa gjumë. Ku ta dinte ajo! Po ai mëngjes i bukur pranvere e nxiste Kristinën dhe nuk e linte të qetë. Diçka e guduliste përbrenda. Drita e ditës së re i bëhej si një buzëqeshje e pafund. Çdo gjë përçark në sytë e saj kishte marrë ngjyrën e trëndafilit. Edhe tavani i bëhej si fole zogjsh, ngritur sipër një peme të gjelbëruar, në mes të një kopshti plot lule. E si mund të rrinte Kristina fillikat vetëm këtë mëngjes, mëngjesin e parë të dashurisë?! Tani ajo çuditej me veten e saj se si i kishte qëndruar dje ashtu. Ku i kishte gjetur gjithë ato fjalë e tërë atë durim për të kundërshtuar! Çuditej vërtet, se kjo ishte hera e parë që dashuronte. Ajo nuk e dinte se kjo ndodhë zakonisht në dashuri. Në fillim njëri pohon e tjetri mohon. Ata që duhen vërtet nuk merren vesh menjëherë. Njëri bindet më vonë se tjetri. Dhe i dyti gjithnjë

vuan më pas që nuk e pohoi kur duhej. Ai përpiqet pastaj të fitojë kohën e humbur. Kohën e humbur donte të fitonte edhe Kristina. Ajo sikur ishte tani tjetër njeri. Dhe ky ndryshim kishte ndodhur brenda një nate, pas shumë luhatjesh, pas gjithë atyre ëndrrave të liga që e kishin munduar natën. Tani keqkuptimet që e ndanin nga Ramizi i kishte lënë pas. Dita e djeshme i dukej këtë mëngjes Kristinës si një horizont me dritë e hije, prej të cilit ajo sa vinte e largohej duke iu afruar një horizonti tjetër që premtonte një ditë të bukur!

Papritur ajo ndjeu se një dritë e fortë vërshoi nga të gjitha anët. Dielli kishte hyrë nën çati. Ajo nuk e vuri re këtë, po e ndjeu. Ndjeu se dikush i gëzuar kishte hyrë aty. Pati ndjenjën e gjallë se i kishte ardhur një njeri i shtrenjtë dhe po e përqafonte. Oh, sa e lumtur ishte Kristina! Dielli po gëzonte bashkë me të! Çfarë mëngjesi!

Drita e diellit, që hynte nga baxha e çatisë, që shndërruar para syve të saj në një mirazh të çuditshëm, që ia afronte të ardhmen, atë horizont të purpurt që i premtonte një ditë të bukur pa fund! Në këto çaste, ëndrrat dhe vegimet plot dritë e gaz e kishin marrë me vete. Ajo fluturonte drejt së ardhmes mbi flatrat e dëshirave të zjarrta...

«...Po qëndro, Kristinë!... Mjaft fluturove, motër! Ku shkon kështu? Harrove se je në prapavijat e armikut? Nuk dëgjon se ç'po bëhet jashtë? Nuk ndien uturimën që po vjen nga larg?»

«...E dëgjon? Nuk është zhurmë nga xhadeja kjo. Xhadeja është larg prej këtu. Dëgjoje mirë! Mos e merr për gjëmim të qiellit. Qielli sot është i kthjellët...»

«...Shoqe, vëri veshin mirë zhurmës, kësaj zhurme të shurdhër. Ti je partizane. Ti duhet ta dallosh armikun... Pse të mbeti fryma kështu. E dëgjove? Është zhurma e armikut... Ai po vjen drejt jush...»

«...Ja, sytë të vanë tek armët. Mos harro se ato ju presin ju. Mjaft qëndruan aty varur. Presin duart tuaja, presin syrin tuaj, presin zemrën tuaj! S'ka gjë që jeni të plagosur dhe fill vetëm në mes të fushës. I lini tani ëndrrat dhe plagët. Kapni armët... Zgjoje shokun tënd, mjaft fjeti...»

Ai nuk di se ç'bëhet përjashta. Zgjoje, mos u habit! Zgjoje, pra, ai është komandanti yt!...»

— Ramiz!

«Nuk thirret kështu në Luftë, shoqe! Harrove ti? Thirr më fort! Ai nuk të dëgjoi. Mos u druaj. Mos të të vijë keq... Armiku po vjen dhe armiku nuk druhet. Atij nuk i vjen kurrë keq. Ai nuk ka zemër. E dëgjon? Është zhurma e tij. Armiku po afrohet. Afroju dhe ti shokut tënd. Thirri!...»

— Ramiz!

«...Prapë nuk të dëgjoi. Prapë nuk e kreve detyrën si duhet. Jo kështu, shoqe. Lufta kërkon zemër të fortë. Kërkon mendje të kthjellët. Kërkon shkathësi. Çasti është jeta. Po çasti mund të të sjellë dhe vdekjen. A e di këtë? Afroju shpejt! Kape nga krahu! Tunde nga vendi shokun! Jo aq lehtë... Ah, shoqe... Mos harro se je partizane... Ashtu, fort!

— Ç'ke, Kristinë?!

«...E sheh si u zgjua. Mësoje për tjetërherë. Po detyra jote s'ka mbaruar. Ai është akoma i përgjumur. Ai nuk kupton se ç'bëhet jashtë. Dhe ka të drejtë. Siç pate edhe ti të drejtë para pak çastesh. Është mëngjesi i parë i dashurisë. Po fashistët janë armiqtë e dashurisë. Ju këtë e harruat. Nuk bëtë mirë, shoqe. Nuk bëre mirë as ti, shok. Ti, si më i vjetër. Po megjithatë, s'ka gjë. Ju jeni partizanë. Ne ju besojmë...»

— Nuk e dëgjon zhurmën?

— Jo!

Ramizi fërkonte sytë dhe shtriqej pa u shqetësuar, sikur të mos ndodhte asgjë përjashta.

— Si nuk e dëgjon? Më duket se po vijnë...

— Kush? Cilët?

Ai mblodhi menjëherë veten dhe u përqëndrua. Një zhurmë e fortë i gjëmoi në kokë, thua jse dikush kishte hapur një derë prej nga vinte ajo. Partizani u vurcos në fytyrë. Gjaku i buçiti në tëmtha. Ajo e vështronte e topitur.

— Ç'do të bëjmë, Ramiz?

Ai nuk dinte si t'i përgjigjej. Ç'mund të thotë njeriu

i sapozgjuar nga gjumi?! Ajo e kuptoi se kishte bërë një pyetje të nxituar dhe tha:

— Pa çohu, e shih një herë!

Ramizi atëherë u përmend. E përmendën jo aq këto fjalë, se sa vështrimi i lënduar i syve të saj. U ngrit sakaq me vrull. Po harroi plagën e këmbës dhe kundër çdo gjëje u kthye prapa. Mbetën për një çast të dy. Ajo me duar të çuara drejt tij. Ai me trup të hepuar, gati në të rrëzuar. Nga dritarja e çatisë dielli vështronte si sy i çakarritur. Ai nuk priti t'i pushonte dhembja. Drejtoi trupin dhe nxori kokën mbi çati. Ajo e shikonte që poshtë dhe priste me ankth. Ramizi sa u ngrit, u ul. Po për Kristinën ai ishte vonuar.

— E?

— Gjermanët!

Vajzës iu zmadhuan bebëzat e syve.

— Gjermanët?!

— Po... Veç janë larg prej këndej...

Ai e detyronte veten të fliste i qetë, sado që përbrenda e therte një zemërim i mprehtë. Sytë i vetëtinin nga një shkëlqim i errët, si shkëlqimi i ujit të pastër ku pasqyrohen retë e zeza. Përpiqej të rrinte larg vorbullës së mendimeve që i vërtiteshin nëpër kokë. Ai e dinte nga përvoja se në këso çastesh mendimi duhet të jetë i qartë, i prerë, praktik. Ky mendim e prin luftëtarin në aksion.

— Janë shumë larg?

— Po, janë përtej, në fshat!

Ajo e vështronte me ngulm dhe nuk i shpëtonte asnjë lëvizje e tij. Ai mori automatikun varur. E përsolli disa herë nëpër duar dhe me mendjen gjetkë tha:

— Kanë ardhur me makina...

Ajo e kuptoi se ai po ia thoshte të vërtetën pak nga pak dhe nuk iu durua:

— Mos vijnë gjë këtu?

Koka e saj ziente tani nga pikëpyetje të panumërta.

— Nuk e besoj...

Vajza u mundua të hetonte sytë e Ramizit:

— Po sikur të vijnë?

Ai u mundua të buzëqeshte.

— Punë e madhe... Po këto përse i kemi... — dhe i tregoi me dorë armët.

Kristina nuk foli. Uli kokën dhe mbeti ashtu për disa çaste, në heshtje. Ai e vuri re këtë dhe u hutua një hop. Edhe atë e kishte kapur padashur hutimi i befasisë. Ç'të bënte? Gjermanët mund të vinin. Po asaj një herë për një herë duhej t'i thoshte se nuk do të vinin. Nuk kishte asnjë arsye të vinin deri aty!

— Me siguri — tha ai — do të jenë në kalim... Ndoshta shkojnë për në Brezhdan. Këndej është rrugë e keqe...

— Po plaka ç'na u bë? — pyeti Kristina.

— E ç'mund të bëjë plaka? Do të ketë shkuar te sho-kët për të kryer porosinë tonë ose e kanë zënë gjermanët në befasi...

Ajo ngriti kokën. Ai ngriti zërin.

— Ti e kupton se për të ikur, s'ikim dot. Do të qën-drojmë këtu... Si thua?

— Po, Ramiz!

Zemra e tij atë çast e kapi menjëherë dridhërimën e fjalëve të saj. Vajza rrotullonte gërshetat nëpër gishtat e dorës. Vështrimi i saj aq i qartë ishte shndërruar për Ra-mizin në një gjëzë të vështirë. Nuk kuptonte se ç'donin të thoshin tani ata sy. Vetëm një gjë kishte të qartë par-tizani: nga ata sy njeriu mund të merrte zemër për t'u sulur mbi armikun!

— Kristinë, ç'ke kështu?

— Asgjë nuk kam...

— Se si më dukesh...

Ajo nuk u përgjigj, po ngriti supet.

— Ata nuk e besoj të vijnë deri këtu... — foli Ramizi.
— Po edhe në ardhshin, nuk do t'u shkojë mendja se mund të jenë fshehur njerëz në tavan.

Ajo tha nëpër dhëmbë:

— E ç'rëndësi ka kjo... Mjafton që jemi bashkë...

Vështrimet e tyre u takuan. Ata nuk dinin tani t'i ul-nin qepallat. Hetonin mendimet në sytë e njëri-tjetrit dhe kuptoheshin...

Kështu, në heshtje, ata vendosën për fatin e përbashkët...

Pas kësaj, Ramizi e ndjeu veten të përtërirë. Koha nuk priste më. Ai u ngrit sërish më këmbë. Qëndroi një copë herë me kokë mbi çati. Po Kristina kësaj radhe priti. Priti në heshtje. Zemra i përpëlitej në gjoks. Ajo kishte detyrë të priste, siç e kishte për detyrë dhe ai të vëzhgonte. Ata i kishin ndarë që tani detyrat.

Ramizi futi kokën brenda, duke mbajtur dorën përpara. Ajo e vuri re fytyrën e tij me hije. Mbetën kështu të nemitur. Ai shtrëngonte nofullat. Ajo nuk guxonte të pyeste. Pastaj ai tha:

— Po djegin fshatin... Të poshtrit!

— Po e djegin? — ia bëri Kristina.

Ajo pyeti, po s'priti përgjigje. Fjalët e Ramizit i gjëmuuan me të madhe në vesh. Iu duk sikur rreziku i foli me gjuhën e tij mizore. Partizani nuk e la vajzën ta push-tonin mendimet e këqija. Zëri i tij i fortë e i vendosur e solli në vete:

— Ti e kupton situatën, Kristinë! Më mirë një vdekje me nder, se sa në duart e tyre...

Lëvizjet e Ramizit tani u bënë më të prera. Ajo e ndiqte me një vështrim guximplotë, tundte kokën dhe pëshpëriste me zë të dredhur:

— Po, Ramiz, po...

Partizani rrinte para saj, i thithur në mendime, me grushte mbledhur dhe me vetullat lëshuar. Ajo s'druhej ta vështronte në sy, ndonëse zemra i rrihte me forcë në gjoks.

Ai ishte komandanti i saj. Atij i përkiste të vendoste për fatin e të dyve tani që rreziku ishte afruar aq shumë.

Ramizi kafshonte një fije kashte dhe e sillte nëpër buzë. Ajo dëgjonte kërkëllitjen e dhëmbëve të tij. Pas kësaj pauze të rëndë, ai tha:

— Duhet të përgatitemi me kohë, sido që të vijë puna. Ti mos lëviz nga vendi. Çdo gjë do ta bëj vetë...

Ramizi mori armët, Kristinës iu përqeth trupi. Ai i vendosi ato në mes saj dhe vetes. Pastaj i kontrollloi dhe i mbushi me fishekë.

— Bombat po i mbaj unë...

— Të caktojme dhe vendet — shtoi ai dhe me sy të rrudhur zuri të vështronte përçark.

Pas pak, partizani u zvarit këmbadorës dhe vajti qëndroi në fund të tavanit. Atje, me qytën e pushkës hapi një të çarë që shihte në oborr dhe vendosi automatikun.

— Ja, ky është pozicioni yt, Kristinë!

Ajo nuk e pa fare vendin që i tregoi ai me dorë. Sytë i qenë ngulur fytyrës së tij të djersitur e të hequr, me kaçurrela të rënë mbi ballë. Gjithë ato lëvizje e kishin lodhur. Po ai u zvarit prapë dhe vajti hapi një të çarë tjetër nga kreu i tavanit. Kjo binte afër baxhës së çatisë. Aty vuri pushkën dhe dy bombat. Pastaj u kthye dhe me trup të rënduar filloi të zvaritej brinjas, me dorën dhe këmbën e shëndoshë. Kur arriti te vendi i tij, deshi të ngrihej ndenjtur, po nuk mundi. Forcat e lëshuan. Ai u platit për tokë. Ajo iu afrua, i vuri dorën në ballë e i fshiu djersët. Ai merrte frymë rëndë. Ajo zuri t'i ledhatonte flokët. Ai, me sy të pulitur, tha:

— Po tani, Kristinë, të vjen çudi që je mbi tavan?

— Pse më pyet kështu?

Zëri i saj kumbonte i përmallshëm.

— Të pyes, se pardje se si të vinte. Ndoshta s'të vinte mirë që ishe vetëm me një shok. Pate merak për pozicionin... Ja, edhe tavani u kthye në...

Po ajo nuk e la të vazhdonte. I vuri dorën te buzët dhe i pëshpëriti gati në vesh:

— Ramiz... mos kështu...

Buzët e tij prekën dorën e saj. Ai s'ishte në gjendje as të belbëzonte. Mbetën kështu një çast. Pastaj ai i kapi dorën. Në fillim ia shtrëngoi lehtë. E bëri këtë me frikë në zemër. Ndoshta ajo do të kundërshtonte. Po ajo nuk kundërshtoi. I dridheshin vetëm gjymtyrët e trupit.

Ai vështronte që poshtë. Fytyra e vajzës ishte trëndafiluar. Sytë i qenë mbyllur. Ajo nuk e shikonte. Atëherë ai ia mori dorën dhe ia puthi. Ishte dora e saj! Ai gjeti aq forca në vetvete sa të thoshte buzagaz:

— Kristinë, mos gabova gjë për së dyti?

Ai priti që ajo t'i thoshte ndonjë fjalë, po në vend të fjalëve dolën lotë. Lotë të nxehtë ranë nga qepallat e saj dhe riguan nëpër fytyrën e tij. Me kokën lart dhe gjoksin e gufmuar, ajo qëndronte përmbi të si një bust i gjallë. Ramizi rrinte zemërlënduar, tek ndiente dënesat e saj që mbyteshin në kraharor.

Uturima vinte valë-valë. Po ata tani nuk ia vinin veshin. Dashuria e tyre s'e përfillte vdekjen.

— Pse nuk flet, Kristinë, apo do të kesh kohë të flasësh?

Vajza papritur u përkul sipër tij:

— Ramiz, si u bë kështu?

Atë kohë ai ndjeu frymën e saj të ngrohtë, lotët e e njelmë, gërshetat e saj dhe kurmi i fërgëlloi... Zgjati duart dhe rroku në qafë, duke pëshpëritur:

— Jo me lotë, Kristinë, jo... Nuk bën...

Pastaj u ngrit ndenjtur dhe e mbështeti vajzën në gjoks. Ajo rrinte shtrënguar pas tij. Sytë e partizanit ishin një det në stuhi. Fytyra i qe skuqur e tendosur. Urrejtja sa vinte dhe e egërsonte.

Ajo e puthte lehtë e me drojtje dhe pëshpëriste diçka të pakuptuar. Ai e dëgjonte duke marrë thellë dhe i fshinte lotët me shputën e dorës.

— Ti ik, Ramiz, shpëto... Mua s'më vjen hiç keq... Lëmë të vdes për të dy!

Partizani u vrenjt dhe u drodh i tëri:

— Ne, o rrojmë, o vdesim të dy... Ç'thua kështu?

Atë e mbyti mallëngjimi.

— Ti duhet të rrosh, Ramiz,... dhe t'ua çosh ëndrrat tona shokëve...

— Po ti, të vdesësh? — thirri ai i zemëruar.

— S'ka gjë, unë le të vdes... Ti u duhesh më shumë shokëve. Unë jam partizane e re...

Fjalët e tjera iu shuan në gjoks.

Ai deshi ta kundërshtonte prapë, po diçka iu lidh në grykë. Ata heshtën një copë herë. Dëgjohej frymëmarrja e saj e rëndë dhe ajo zhurma e shurdhër...

— Ramiz — tha Kristina me sytë të mbërthyer në

fytyrën e tij — mos m'i merr për keq ato fjalë që të thashë dje... Unë gjithnjë të kam dashur... Besomë, Ramiz!

— Të besoj — pëshpëriti ai.

— Ti më pëlqeve sapo të njoha... Më dukeshe aq i mirë... Po ku dija unë e shkreta, nga këto gjëra... Vdekjen e mendoja, këtë gjë s'e mendoja...

Partizanit i dhimbte gjoksi, sikur ia shtrëngonte pa mëshirë një darë e padukshme. Ai i përmbante lotët sado që sytë i kishte të rrëmbushur.

Ajo vuri re se atij i shndritën mollëzat e reshkura, mustaqet, mjekra e zezë. Ai e ndjeu këtë dhe i sëmboi në zemër. Po nuk e fshehu fytyrën dhe nuk i erdhi turp nga Kristina. Ai tani dashuronte dhe urrente me të gjitha forcat. Këta ishin lotët e tij të parë dhe të fundit të dashurisë e të urrejtjes. Zemra e tij e ndezur flakë mund të fliste tani vetëm përmes lotëve. Fjala s'kishte fuqi...

Ata qëndruan kështu një copë herë përballë njëri-tjetrit, me fytyrë të tendosura, me sy që shkrepëtinin, me flokë të shprishur, me buzë të çelura. Ky qe një çast i shpejtë e i zjarrtë, si drita e yjeve të këputura një natë pranvere. Ky çast mbante gjithë dëshirat e një rinie që sapo kishte nisur të lulëzonte...

Po zhurma atje jashtë gjithnjë vazhdonte. Zërat e natyrës kishin heshtur. Nuk dëgjoheshin as zogjtë, as pemët, as njerëzit, asgjë. Dëgjohej vetëm ajo zhurmë shurdhuese...

— Kristinë, ndahemi tani!

Ramizi u mat të shkëputej, lëvizi pak nga vendi. Hoqi duart prej saj dhe i mbështeti mbi një tra. Fytyra i mori atë pamje që merr njeriu kur zgjohet nga një ëndërr e keqe. Partizania rrinte si e mpirë, me bebëza të rritura. Ajo nuk dinte të shkëputej. Po armiku kishte ardhur afër. Bujciste zhurma e makinave, dëgjoheshin mbyturazi thirrje... Ata ende nuk ishin ndarë...

— Po vijnë, Kristinë!

Ajo nuk u besonte veshëve të saj.

— Ashtu?!

— Nuk i dëgjon?

Në të vërtetë vajza nuk dëgjonte. Ajo mbështillej pas

gjoksit të tij dhe e puthte ku mundte. Ai përpiquej ta largonte me kujdes, duke i pëshpëritur me zë të dridhur:

— Mjaft, Kristinë, mjaft...

Zhurma gjëmonte me të madhe përjashta dhe atyre u dukej sikur e gjithë toka ulërinte. Ishte një ulërimë the-rëse. Gjëmonte tavanin dhe veshët e tyre shungullonin e buçisnin.

Ata u shkëputën nga njëri-tjetri dhe u bashkuan prapë. Prapë u ndanë dhe rishtaz u bashkuan. Vështroinin shoqi-shoqin në dritën e syve dhe rrokeshin fort me të dyja du-art, pa i ndier plagët në trup.

— Mjaft, erdhën!

Zëri i tij kumboi fort. Ai buçiti në veshët e saj si urdhër. Ata përnjëheresh u shkëputën. Ajo forcë e pushtet-shme që i bashkonte, ajo edhe i ndau. Dëgjohej zhaurima e makinave që ngjitnin të përpjetën. Dhe këtë e dallonin mirë të dy. Tani qëndronin të shkëputur.

Zhurma vinte valë-valë. Trarët e tavanit dridheshin. Dridhej dhe një zog që kishte hyrë aty e tulatej në një qoshe. Po asnjëri nga partizanët nuk dridhej. As ai, as ajo. Ramizi mbante vesh, i tendosur i tëri. Sytë i shndrisnin si teh thike. Shikimi i partizanit ishte ngarkuar me urrejtje. Kristina rrinte përballë tij me nofulla të shtrënguara. Ajo nuk përlotej më. Partizania priste vetëm urdhër. Gjithë pamja e Ramizit tregonte se ai nuk përfillte asgjë. Asnjë hije nuk e errësonte fytyrën e tij. Dhe kjo i jepte zemër Kristinës. Ajo nuk i trembej zhurmës që uturinte jashtë. Nuk ia kishte frikën armikut duke qenë pranë Ramizit... Këtë zhurmë e kishte dëgjuar një herë. Këtë armik e kishte parë një herë. Pardje e kishte pritur me gjithë batalionin. Tani po e priste së bashku me Ramizin. Ramizi ishte komandanti. Ajo ishte partizania. Detyrat qenë ndarë.

— Kristinë, shko atje! — tingëlloi rreptë zëri i tij. Zër vendin!

Partizania përmbodhi veten me të shpejtë dhe filloi të lëvizte.

Secili kishte zënë pozicionin e tij dhe rregullonte ar-mën.

Zhurma e makinave kishte pushuar. Tani dëgjoheshin zërat e armiqve. Tavani u mbush me klithma e urdhra në gjuhë të huaj. Zërat e tyre vinin si klithma korbash. Partizanët rrinin të heshtur nëpër vendet e tyre dhe përgjonin. Ata e shihnin armikun të gjallë, përmes vrimave të çatisë. Ramizi priste çastin e volitshëm për të hapur zjarr:

— I sheh, Kristinë? — pëshpëriti ai, duke i mbajtur sytë jashtë.

— I shoh...

Dhe, vërtet, ajo e shihte tani armikun, po pa dylbi, e shihte siç ishte, me sytë e saj. Dhe për çudi, nuk e kapi ajo drojtje që e kishte kapur më parë. Ndiante se atë e kishte mposhtur kësaj here.

— Kujdes! Drejtoje tytën andej nga ka më shumë gjermanë dhe prit urdhër!

Ai për herë të parë ktheu kokën. Ajo buzëqeshi. Po komandanti s'u përgjigj. Dëgjuan që u ndezën makinat. Zhurma shungulloi sërish përçark. Ajo vështroi Ramizin. Një rreze shprese i xixëlloi në sy.

— Mos po ikin?

Këto fjalë partizania i tha si një fjalë të vetme.

Po Ramizi nuk u ndie. As kokën s'e ktheu. Ajo pa ndehu se nuk e dëgjoi.

— Ramiz!

Ai ktheu kokën, po nuk foli. Vështrimi i tij ishte i hakërritur. Kristinës i theri përnjëherë në zemër. I dogjën sytë. Nuk i pëlqeu fytyra e tij. Ai diçka i fshihte.

— Ç'ke, Ramiz?

— Asgjë s'kam...

— Mos po vij në gjë sipër?...

— Jo!

U dëgjua një makinë që u nis. Partizanes i xixëlluan rishtaz sytë dhe pëshpëriti me të shpejtë:

— Më duket, po ikin...

— Po... po ikin...

Fjalët e tij mezi erdhën në veshët e saj. Ajo vuri re që ai kafshonte kyçet e gishtërinjve. Prapë i fshinte diçka.

— Ramiz!

Papritur zëri i tij buçiti:

— Shtrengoje armën mirë, Kristinë! Drejtoje andej!

Ajo u zbraps sikur e shtyu një erë e fortë. Partizania donte të shpjegohej. Donte ta pyeste. Po nuk qe nevoja. Ajo e kuptoi vetë. Pa fjolla tymi nëpër tavan. Pas tyre erdhi një shtëllungë e madhe. Asaj iu errësuan sytë. Çdo gjë ishte e qartë tani. Mbështeti kokën te një tra dhe shtrëngo i armën në duar. Një dhembje e tmerrshme ia përshkoi trupin. Jeta po jepte grahmën e fundit.

Makinat ishin ndezur të gjitha. Rapëtimia e tyre shungullonte me të madhe.

Ajo ndjeu që Ramizi po ngrihej më këmbë. Pastaj dëgjoi qartë fjalët e tij:

— Kristinë, m'i bëj hallall të gjitha... Mos të të vijë keq që po e bëjmë dasmën tonë këtu. Neve partizanëve kjo dasmë na ka hije. Le të vdesim kështu... Ne vdesim për një ideal... Vdekje fashizmit, Kristinë!

Kaq tha ai. Më shumë nuk mundi të thosh. Këto ishin fjalët e tij të fundit, të shqiptuara në ah të vdekjes. Fjalë që kishin një buçimë të fortë. Fjalë burrërore, që jehonin si plumb.

Ajo ngriti kokën të shihte, po tymi kishte mbushur tani gjithë tavanin. Me sy të picërruar dhe me zë të dridhur, ajo tha:

— Ramiz, pranë teje nuk e ndiej vdekjen... Më beso, për asgjë nuk më vjen keq. Liri Popullit, Ramiz!

Tymi i zi dhe gjuhët e flakës nuk e lanë partizanen ta shihte shokun e saj për të fundit herë. Dritarja mbi çati nuk lëshonte më dritë. Ajo e kuptoi se tani kishte ardhur koha. Ndjeu që ai qe çuar më këmbë.

— Zjarr! — buçiti zëri i Ramizit.

Jashtë gjëmoi një bombë. Brenda u dëgjua tringëllima e armëve. Pastaj një batare e tmerrshme. Toka u lëkund... Kështu filloi epopeja e dy partizanëve...

NË VEND TË EPILOGUT

Armiqtë nuk arritën t'ua shihnin fytyrën Kristinës dhe Ramizit. Nuk i la zjarri i rrufeshëm që u binte nga lart. U hutuan dhe u lemerisën nga thirrjet e tyre hakërruese. Armët u mbetën në dorë. Nuk dinin ç'të bënin. Partizanët qëllonin parreshtur...

Kur fashistët e morën veten, zjarri partizan kishte heshtur. Atë kohë luftëtarëve të lirisë po u merrte kurmi flakë!

Pas disa ditëve, batalioni zbriti në fshat. Shokët shkuan te shkolla dhe kërkuan gjurmët e tyre.

Shenjatat e betejës dukeshin kudo. Gërmadhat nxirrnin akoma tym. Pemëve përqark u qenë thyer krahët nga plumbat. Partizanët vështronin të heshtur dhe shtrëngonin dhëmbët. Frynte një erë e hollë, erë maji, trazuar me aromën e luleve dhe thymin e zjarrit të fashitur. Lart në qiellin e rimtë fluturonin me vrull dallëndyshet. Përqark gje-thet e blerta fëshfërinin. Nga larg vinin zërat e natyrës së ringjallur. Dukej se pranvera premtonte atë vit gëzime dhe shpresa të mëdha!

Partizanët, para se të largoheshin, u ulën në gjunjë kokëzbuluar dhe u përfalën përpara kujtimit të shokëve të rënë. Ata bënë përshëndetjen e fundit luftarake me një batë të fortë...

...Kanë kaluar kaq vjet që prej asaj kohe. Brezi që lindi atë pranverë, sot është versnik me Kristinën dhe Ramizin. Koha ka ecur përpara. Ne i çuam në vend amanetet

e tyre. Pasi dëbuam armiqtë, puna e parë që kryem, mblo-
dhëm shokët tanë të rënë anekënd vendit. I mblodhëm
ngado ishin të shpërndarë, nëpër male dhe fusha, buzë rru-
gëve dhe pranë ujërave, nëpër pyje dhe lugina. I ngritëm
dhe i prumë sa më pranë shtëpive. I mblodhëm të gjithë
tok, i vumë pranë e pranë, për krahu njëri-tjetrit, sikundër
ishin dikur në ditët e stuhishme. Çdo qytet e fshat sot ka
varret e tij. Varret e të rënëve në Luftë për liri. Po në to
nuk janë të gjithë sa ranë. Një pjesë e tyre mungojnë. Janë
ata që humbën honeve të Luftës, që u dogjën në zjarret
e betejave, që morën me vete lumenjtë e egër, që u shkri-
në nën dëborë... Ata që u zhdukën kundër dëshirës sonë.
Kështu ndodhi me Perlatin dhe Lirinë. Kështu ndodhi dhe
me Kristinën e Ramizin. Ata u dogjën të gjallë, duke lënë
pas vetëm kujtimin në zemrën e nënës e të shokëve, në
fatin e Shqipërisë. Ky kujtim krijoi heronjtë e këtij tre-
gimi.

Ndoshta, lexuesi i këtyre radhëve, kërkon të dijë se
cilët qenë heronjtë e gjallë. Kush ishin Kristina dhe Rami-
zi? Vërtet jetuan dhe vdiqën ashtu?

Po ç'rëndësi ka kjo? Sa djem e vajza dhanë jetën e
tyre në lulen e rinisë për çështjen tonë të shenjtë! A nuk
ishin ata versnikë me Kristinën dhe Ramizin?

Të gjithë këta ishin shokët tanë.

PROLOG

POSTA E LARGËT

NOVELË

P R O L O G

Posta më e largët e repartit ishte vendosur në majë të malit, në një pikë të lartë prej ku syri rrokte tërë panoramën e asaj krahine të thellë malore.

Mali, nga njëra anë, zbret thikë tatëpjetë mbi një hon të shkretë shkëmbor, plot skërka e bokërrina, kurse, nga ana tjetër, vjen e ulet shkallë-shkallë dhe është i veshur me pyje të rralla e kullota të varfëra. Në këmbë të tij, i shpërndarë nëpër një luginë të ngushtë, shtrihet fshati më i largët i krahinës.

Posta është një ndërtesë karakteristike malore, e ngrihur me gurë të mëdhenj, në ngjyrë të errët, e mbuluar me plloça që koha i ka nxirë. Nga larg ajo, bashkë me kullën e saj, duket si një zog i ngurtësuar, me kokën lart, i ngulur mbi kreshtën e malit. Kjo bie në sy veçanërisht në dimër, kur zhvishen drurët e shkëmbinjtë rreth e qark marrin një ngjyrë gri të mbyllur e mali merr një dukje pak të zymtë, po krenare.

Dimri këndej është i rreptë, me dëborë, stuhi e cingërima dhe herë-herë shtrëngon aq shumë, sa të ngjan sikur te ky kënd i vetmuar natyra gjen çfarë të shfryjë e të buçasë lirisht tërë tekat e saj. Në këtë kohë strehët e postës e sidomos kulla, që lartohet mbi të, uturojnë pareshtur nga zhurma e zëra të çuditshëm. Gjithë dimrit mbi këtë majë të vetmuar shkarkojnë rrufetë, pllakosin stuhitë, gjëmojnë bubullimat, po prapë posta ushtarake as që do t'ia

dijë. Ajo qëndron gjithnjë si zogu guximtar që është gati të sulet fluturim në çdo kohë.

Kur vjen pranvera jeta, sado e kursyer, edhe këtu gjallërohet e merr ngjyrat e saj. Pushon suferina e egër dhe zë e fryn një erë e butë, dëborë fillon e shkrin, retë, që vareshin gjithë dimrin mbi mal vijinë e ngrihen lart e humbasin në kaltërsinë e qiellit të pranverës. Dalngadalë mali vishet, gjelbërojnë drurët, hapin lulet dhe vendi ndërrohet pamje. Hija e rëndë e malit zbutet. Një gjelbërim i lehtë mbulon faqen e tij mbi fshat. Dëgjohet këndshëm shushurima e rrëkeve tek zbresin tatëpjetë, cicërima e zogjve dhe fëshfëritja e gjetheve të reja...

Ushtarët që shërbejnë në këtë postë të largët janë mësuar me jetën e vështirë, me trillet e natyrës dhe vetminë e përhershme. Zakonisht këtu qëndrojnë dy ushtarë. Dhe ndodh që gjithmonë njëri nga këta është i vjetër e tjetri i ri. Kështu, kur erdhi në këtë pikë ushtar Fatmiri, Xhaferri kishte mbushur vitin e parë të shërbimit e po kryente të dytin. Shoku me të cilin kishte shërbyer bashkë ishte lëruar dhe ai, si më i vjetër, kishte mbetur komandant poste.

I P A R I

*Revolucioni — dinamit që hap
minierat — ar të shpirtit njerëzor,
rrjedhin pastaj të kaltra burimet,
të pastra dëborë.*

(«Revolucioni» D. Siliqi)

Fatmiri arriti në postë në mbrëmjen e asaj dite që kishte ikur ushtari i liruar. Gjithë atë ditë Xhaferri kishte ndenjur i mërzitur, posta i dukej fare e shkretë, nuk i hiqej mendja nga shoku që e kishte lënë. Ushtarin e ri pothuaj nuk e njihte, veçse për fytyrë, kur atë mbrëmje vjeshte Fatmiri kishte thirrur nga sheshi: «O i zoti i shtëpisë!» — dhe kishte ndalur në prag të postës dhe aty ata ishin takuar si dy shokë të vjetër. Xhaferri ndieu padashur se kishte rrokur në qafë gjithë shokët e repartit e se zbrazësia e krijuar do të mbyllej me siguri shpejt. I kishte hequr me ngut çantën e shpinës, e kishte ulur në krevatin me çarçafë të larë dhe e kishte gostitur me çaj e mollë. Fatmirit sepse i qe dukur se kishte takuar një njeri të afërt me të cilin kishte shumë kohë pa u parë.

Të nesërmen nisi detyra e përbashkët e dy ushtarëve në postën e largët. Xhaferri e ngjiti shokun lart në kullë dhe që andej ata soditën vendin përçark. Dita ishte e

kthjellët. Vështrimi i tyre vërtitej sa andej-këndej në të katër anët e horizontit. Poshtë kullës, e zhytur në hapësirën e kaltër, shtrihej deri në pafundësi zona e postës së tyre. Gjithë ato male e fusha, lumenj e lugina, pyje e hone do t'i ruanin sytë e Xhaferrit e të Fatmirit.

Komandanti i postës e çoi pastaj Fatmirin te aparatet, i shpjegoi sinjalet, i tregoi disa nga ngjarjet e jashtëzakonshme që kishin ndodhur në postë. Ushtari dëgjonte, pyeste, provonte me dorën e tij instrumentet.

Dita e parë, sado e lodhshme, kaloi pa u kuptuar. Ushtarin e ri e preku kujdesi i shokut, sjellja e tij e përzemërt. Po në ditët që erdhën më pas, Xhaferrit papritmas sikur ndërroi, u bë njeri i heshtur, fliste pak ose, më mirë, nuk fliste si ditët e para. Fatmirit kjo i sëmboi përbrenda dhe për pak desh ia mori për keq. Kujtoi se mos ai ishte i pakënaqur nga puna e tij. Po dalngadalë Fatmiri zuri të kuptonte se kjo ishte natyra e tij. Ai sillej mirë, kujdesej për të, bile ndonjëherë e zgjaste shërbimin e vet, për të mos e munduar shokun e ri. Po megjithatë, banori i ri i postës s'e kishte kollaj të mësohej. Për kushedi sa ditë, dhe këto qenë javët e para, atë e mundonte heshtja që e rrethonte gjithandej. I dukej se e kishin hedhur aty në botën e heshtjes e të vetmisë. Ditët kalonin të plogëta. Atij i vinte t'i thërriste Xhaferrit, ashtu kot, pa shkak ose të dilte në majë të kullës e të sokëllinte me të madhe. Si ishte ndarë aq papritmas nga njerëzit, nga jeta plot gjallëri e repartit?! Ai ishte mësuar t'i binte kryq e tërthor shesheve të gjera të qytezës ushtarake. Në vesh i kumbonin akoma zërat e dashur të shokëve, zhurma ritmike e hapit të togës. Nga sytë e tij s'qenë zhdukur ende shumë skena të një jete të kaluar në mes gjithë atyre njerëzve.

Koha në repart rridhte shpejt, e gjallë, kurse në postë, sikur i ngjitej me zor së përpjetës së malit e i qëndronte Fatmirit mbi kokë. Kjo gjë e bënte këtë të druajtur dhe padashur e hutonte; e hutonte sidomos ajo heshtje e madhërishme që ndihej mbi mal, mbushte dhomat e postës, shtrihej nëpër sheshin e shkretë e varej natë e ditë mbi kullë. Për herë të parë këtu, ai ndjeu pushtetin e heshtjes,

mësoi të dallonte zhurmat e holla, njohu pak nga pak gjuhën e tyre. Në repart kjo gjë do t'i dukej qesharake, po këtu në postë Fatmiri nga dita në ditë mësoi ta njihnte hapin e prerë të Xhaferrit. Dhe hapat e Xhaferrit s'ishin një gjë e kotë, po thoshin diçka, kishin një kuptim në një orë të caktuar të ditës a të natës.

Xhaferri, që e kishte kuptuar me kohë gjendjen e shokut të tij, me qëllim nuk e shqetësonte. E dinte se kjo ishte si puna e njeriut që, kur futet në fillim në ujë, ka pak të dridhura, po pastaj vjen e mësohet. Se në fund të fundit, ai s'kishte ç't'i bënte për t'i ardhur në ndihmë. Detyra e tyre kështu e kishte, të qëndronin veç shokëve, në majë të malit, po me mendje të mbledhur dhe në gatishmëri të plotë.

Ato ditë Xhaferri e shikonte Fatmirin dhe duke buzëqeshur i tha:

— Do të kalojë shpejt, Fato dhe do të mësohesh si unë.

— Dreqi ta hajë! U mësova keq me repartin — ia priste Fatmiri, duke mos e parë shokun në sy.

— Po dhe ne repart jemi këtu!

— Repart me dy vetë? — thoshte me duf tjetri. — Lërmë, aman!

— Po, po, bile shumë i rëndësishëm. E kam seriozisht. Po nuk u binde për këtë, nuk do ta kesh kollaj të mësohesh!

Këto fjalë ushtarit të ri s'iu hoqën nga mendja për një kohë të gjatë.

«Po nuk u binde për këtë, nuk do ta kesh kollaj të mësohesh!»

Kështu ikën muajt e parë. Pas kësaj, ai s'ndjeu më nevojë t'i qahej Xhaferrit. Erdhi një kohë që ushtari i ri u mësua me heshtjen dhe s'i bënte aq përshtypje vetmia. Fatmiri iu shtrua detyrës sikur të ishte në repart, si të jetonte e të shërbente atje në mes të shokëve të togës. Ai ngjiste shkallët e kullës në mbrëmje, sapo binin hijet e para dhe zbriste poshtë në mesnatë ose ndodhte e kundërta. Flinte deri në mesnatë e pastaj e zgjonte Xhafa-

rrri. Ditën ata pushonin me radhë dhe stërviteshin, si mund të stërviten dy vetë. Në detyrë ishin të heshtur. Veprimet i bënin pa zhurmë, qetë e qetë, duke shkëmbyer më të rrallë ndonjë fjalë. Herë-herë merreshin vesh me gjeste e me të fërshëllyer e në këto raste ishin krejt të panevojshme fjalët. Detyra që ata kryenin kërkonte vëmendje të madhe, seriozitet, mendim të matur. Ajo nuk i duronte fjalët e tepërta, muhabetet kot së koti, shakatë pa kuptim. Fatmiri për këtë u bë i ndërgjegjshëm shpejt, dhe në shërbim e sipër tregohej mjaft i vëmendshëm e i aftë. Po megjithëse u mësua me jetën e veçantë të postës, sado i heshtur dhe i duruar që u bë, prapë nuk e ndryshoi natyrën e tij.

Për nga natyra, Fatmiri dhe Xhaferri qenë të ndryshëm. Xhaferri vinte i mbyllur, kishte fjalë pak, ishte mjaft i matur, kurse Fatmiri ishte i çelur, shpesh herë i gëzuar, i pëlqente më shumë të fliste se sa të rrinte gojëkuçur. Po megjithatë, kjo nuk i ndalonte dy shokët të merreshin vesh e të shkonin mirë me njëri-tjetrin.

Një herë Fatmiri, kur qenë bërë shokë të afërt, i tha Xhaferrit: «Ore, ç'është kjo kështu? Fjalët e tua i them unë, heshtjen time e mban ti! Hajde t'i trazojmë, se s'ka lezet!»

Xhaferri qeshi dhe s'diti si t'i përgjigjej. Atë çast fytyra e tij e gjerë, me ata sy të mëdhenj e mjekrën e ashpër, që i dukej gjithnjë si e parruar, shkëlqente nga një gaz i çiltër.

Ai ishte prej atyre njerëzve që nuk qeshte kollaj po, kur qeshte, i binte një nur fisnik; aq sa ta kishte ënda ta shikoje. Megjithatë, në këso rastesh Fatmiri rrudhte sytë, që i kishte në trajtë bajameje dhe e vështronte shokun me ngulm, si të donte me këtë ta qortonte. Ai kishte dëshirë që shoku i tij i vetëm të fliste e të fliste pa pushim.

Po kishte ditë dhe kjo sigurisht ndodhte më të rrallë, sa herë merrte ndonjë letër a kur kthehej nga reparti, që i binte më qafë Xhaferri Fatmirit. Në këto ditë atij i pëlqente të bisedonte, sidomos kur rrinte shtrirë në krevat, me sy të mbërthyer në tavanin e bardhë, ia bënte:

— Fato, po flë?

— Po flë, po mos më zgjo...

— Po ti zgjuar je!

Fatmiri gërhiste dhe, ndërsa Xhaferri pandehte se flinte me të vërtetë, ai kthehej me fytyrë nga ai dhe i thoshte:

— Të erdhi goja, ë? E di ç'do të më thuash!

Xhaferri nuk fillonte menjëherë po, kur shihte që Fatmiri vinte krahët nën jastëk dhe mbështeste mjekrën në kurrizin e dorës, niste nga rrëfimi. Në krye, zakonisht thoshte: «Nuk kisha ndonjë gjë të madhe», kurse Fatmiri ia priste aty për aty: «Pse, vetëm gjëra të mëdha duhet të thotë njeriu? Po gjërat e vogla, ç't'i bëjmë?»

Sa e nervozonte në fillim kjo natyrë e matur e Xhaferri! Zaten nuk i kishin pëlqyer kurrë njerëzit që çdo gjë e peshojnë me kandar dhe as nuk i kishte shkuar ndonjëherë ndër mend se një ditë do të jetonte tok me një njeri të tillë, vetëm, majë malit. Po kaluan muajt e parë dhe Fatmirin kjo gjë zuri ta shqetësonte gjithnjë e më pak. Dhe jo vetëm që nuk e nervozonin më heshtja e tij e shpeshtë, zëri i qetë, ajo maturi në të vepruar e në të shprehurit e mendimeve, po dalngadalë filloi dhe ai të merrte ndonjë zakon të shokut. Po gjithsesi Fatmiri kishte mbetur po ajo natyrë. Dhe kur e kapte trilli i tij, kishte qejf të fliste gjatë e gjatë, të këndonte, të thërriste me zë të lartë. Këtë të fundit e bënte me kënaqësi të madhe në telefon. Sa herë binte telefoni dhe qëllonte aty pranë, nxitonte i pari të ngrinte dorezën dhe jepte e merrte për një kohë të gjatë. Po të ishte ndonjë shok nga ata të ndër-lidhjes së repartit, e pyeste me hollësi për jetën e atjeshme, për shokët, qeshte e bënte ndonjë shaka e pastaj papritur bëhej serioz e jepte shpjegimet e rastit. Si mbyllte telefonin, i thoshte Xhaferrit: «Nuk na harrojnë shokët, jo! Mirë thua ti.»

Kur i merrte komandanti në telefon, Fatmiri i pëlqente t'i raportonte, dhe këtë e kryente me qejf të madh, veçanërisht kur kishte ndodhur ndonjë ngjarje dhe komanda kërkonte shpjegime... Në këto çaste ai ishte në qejfin

e tij: thërriste me zë të lartë, duke u munduar ta shprehte mendimin sa më qartë, me fjalë të shquara e ton të prerë. Xhaferri e dëgjonte në dhomën tjetër, me derë hapur dhe kur mbaronte, i thoshte me shpoti:

— Ore, po ti ç'bën kështu, na prishe qetësinë e postës!

— Ta dijë komanda se gjendja morale e postës sonë qëndron lart.

Detyra e dy ushtarëve kishte të bënte me gjëra të rëndësishme dhe ata mbanin lidhje të rregullta me reparatin. E ngritur thellë në mes të maleve, në një pikë të lartë që kontrollonte një zonë të gjerë, posta e tyre ishte syri dhe veshi i komandës. Nga lartësia e postës Xhaferri e Fatmiri, me sytë të tretur larg a të kërrusur mbi aparatet, vëzhgonin pareshtur tokën e qiellin. Ata e dinin se pa ndihmën e tyre reparti do ta kishte të vështirë të përballonte detyrat e shumta e delikate...

Ditët kur në postë vinin komisari dhe komandanti, për ushtarët ishin ditë feste. Oficerët përqafoheshin me ata si vëllezër dhe, para se të fillonin nga puna, uleshin e bisedonin shtruar. I pyesnin për shëndetin, për nevojat, dëgjonin ndonjë hall... Shumë herë fjalën e merrte Xhaferri, ndërsa Fatmiri heshte ose plotësonte. Dhe e kishin bërë zakon gjithë ushtarët e kësaj pike të largët që të mos ankoheshin kurrë e as t'u paraqisnin eprorëve, kur vinin, nevojat e tyre personale. Komisari ua kishte mësuar këtë zakon dhe, si i dëgjonte, u thoshte:

— Domethënë as koka s'ju ka dhembur?

— Koka na ka dhembur, po jo sa për të shqetësuar komandën — qeshte Fatmiri.

— Unë ju kuptoj drejt — vazhdonte komisari — që ju i jeni kushtuar detyrës, po ne duam njëkohësisht të na raportoni dhe për ndonjë nevojë.

— Tani për tani — përgjigjej Xhaferri — nuk kemi asnjë nevojë. Nuk na mungon asgjë. Po të kemi, do t'ju njoftojmë.

Ndërkohë komandanti, që shfletonte dokumentat e postës, dëgjonte fjalët e Xhaferrit dhe thoshte:

— Do t'jua shënojmë si detyrë dhe, po u bë detyrë, bisedojmë ndryshe pastaj.

— Dakord, ashtu duhet bërë — shtonte komisari, duke vështruar qortueshëm ushtarët, të cilëve s'ua kishte qejfi këtë bisedë.

Takimi vazhdonte gjatë. Komisari gjatë kësaj kohe bënte bisedën e zakonshme politike, komandanti sqaronte detyrat, jepte detyra të reja. Ushtarët as nuk e merrnin vesh si u ikte ajo ditë. Bile, në një nga bisedat e fundit komisari u kishte folur për një çështje shumë interesante. E kishte sjellë fjalën të lufta që po u bëhej kudo zakoneve të këqija, të cilat ndrydhnin mendjen dhe pengonin hapin e njerëzve të shkonin përpara. Ai u kishte folur pastaj për dy ushtarë të repartit që kishin vajtur në fshat dhe kishin prishur fejesat e padrejta. Në fund ai kishte pyetur me të qeshur:

— Ju këtu, besoj, nuk e keni problem, apo jo?

— Jo, shoku komisar — ia kishte pritur Fatmiri. — Ne jemi rehat me këto gjëra. Xhaferri është fejuar me dashuri. Unë, helbete, beqar!

— Në rregull, në rregull — ia kishte pritur komandanti.

— Ju po e lexoni dhe në shtyp — kishte vazhduar pastaj komisari. — Nuk keni ide, shokë, se ç'po bëhet në ato fshatra ku kanë hedhur rrënjë zakonet e skllavërimit të gruas. Ja, merrni krahinën ku është dislokuar reparti ynë. Prapambetja e së kaluarës e kishte robëruar gruan keq, po njerëzit tani, me fjalën e Partisë po lëvizin, nuk po i durojnë vargonjtë e rëndë të kanunit...

Fatmiri, që mbante fletoren e shënimeve në dorë, kur dëgjoi komisarin, që foli për një problem që s'lidhej drejtpërdrejt me punën e postës së tyre, shënoi vetëm fjalët e fillimit... dhe e la me aq. Ushtarëve ua donte zemra të luftoheshin këto zakone të egra po, duke qenë këtu, me shërbim, të veçuar nga njerëzit, zor se mund t'u qëllonte të merreshin drejtpërdrejt me këto gjëra. Puna që ata kryenin nuk kishte të bënte fort me njerëzit që banonin

përreth. Banorët e atyre anëve jepnin e merrnin pak me ta. Ushtarët ishin vazhdimisht të zënë e rrallë zbrisnin në fshat. Dhe kur zbrisnin, vetëm kalonin andej, përshëndeteshin, shkëmbenin ndonjë fjalë e pastaj se cili shkonte në punën e vet. Më tepër ata ishin lidhur me barinj të, të cilët kullosnin bagëtinë nëpër mal dhe vinin deri afër postës. Po megjithatë, në disa raste ushtarët e kësaj poste i ishin gjendur fshatit dhe fshatarët i quanin si njerëz të tyre.

Kur iknin komisari dhe komandanti, ushtarët mbeteshin prapë vetëm. Po ata ishin mësuar dhe zbrazësira që linin oficerët pas mbyllesh shpejt.

Me të rënë nata, ushtarët ngjiteshin me radhë në kullë. Mbi kokë hapej kupa e errët e qiellit, xixëllonin yjet, ngriheshin a uleshin retë, binte shi ose gjëmonte me poterë. Ushtarët nuk donin t'ia dinin nga asgjë, vëzhgonin horizontin e errësuar; syri i tyre depërtonte në largësi; dëgjonin sinjalet e repartit, përcillnin sinjalet e tyre. Ata bënë ecejake nëpër kullë, me mendjen zgjuar në çdo çast.

Kishte ardhur pranvera. Nata ishte shkurtuar. Qielli me yje ngrihej sipër postës i lartë e i pastër. Majën e mallit nuk e rrihnin më erërat e ftohta. Në kullë vinte një fillad i freskët që të kujtonte erën e luleve. Ushtarët hipnin e zbrisnin shkallëve të kullës të lehtësuar. Po detyra mbetej po ajo, delikate dhe plot tension.

Në një nga këto net, papritur u prish qetësia në postën e largët. Alarmin e dha Fatmiri tek bënte roje. Ai e ndjeu menjëherë atë gjë të huaj që sillej me aq dinakëri nëpër hapësirën e lartë. Zhurma tinzare vinte valë-valë, me jehonë të dobët. Qielli kishte humbur qetësinë e zakonshme.

Xhaferri e Fatmiri të kërrusur mbi aparate, ndejtën gati tërë natën zgjuar. Sytë e tyre u vërtitën në qiellin plot yje. Instrumentet e ndjeshme në duart e ushtarëve regjistruan zhurmat, kapën shenjat e huaja. Ata bënë kalkulime dhe raportonin pareshtur. Shtabi i repartit jepte e merrte orë e çast me postën e largët. Dhe posta dërgonte sinjale, jepte shenja, përcillte mendime. Ushtarët që aty e ndienin se dyshimet e hamendjet e tyre, tok me ato të shokëve,

zbulonin të vërtetën në tryezën e komandantit. Armikun e pabesë nuk e shpëtonte dot as errësira e natës e as lartësia e pafund. Ai do të kthehej sa më parë andej nga kishte ardhur. Posta e largët rrinte zgjuar.

Në të thyer të natës, alarmi mbaroi. Xhaferri dhe Fatmiri drejtuan trupin, morën frymë thellë dhe buzagaz e panë njëri-tjetrin në sy.

— S'ia mbajti më qenit! — tha Fatmiri dhe u ngrit më këmbë i lehtësuar.

— E merrte me mend se ç'e priste — ia bëri Xhaferri, që ende e kishte mendjen tek ajo që tashmë kishte kaluar.

— S'më flihet! — tha Fatmiri.

— As mua! — tha Xhaferri.

Ata qëndruan pastaj pa folur, në heshtje, njëri më këmbë, tjetri ulur. Mbi ta atë kohë po zbriste pa u kuptuar drita e mugët e një dite të re. Përreth mbretëronte një qetësi e thellë, qetësia e madhërishme që ndan natën nga dita në një majë mali. Ushtarët rrinin në heshtje dhe vështronin qiellin e tokën që zbardhnin aq bukur. Sytë u vetëtinin lehtë, ndërsa zemra u rrihte me gëzimin e njeriut që ka kryer një detyrë të vështirë.

Në mëngjes, kur ra dielli, në telefonin e postës së largët jehoi zëri i komandantit. Xhaferri mori dorezën dhe të dy rojet kokë më kokë dëgjonin fjalët e eprorit të tyre dhe përgjigjeshin me fraza të shkurtra e, sa herë që ai i përgëzonte, zëri i tyre i qartë e i prerë tingëllonte si një thirrje gatishmërie!

Ky ishte një gëzim deri atëherë i panjohur për Fatmirin, një gëzim që nuk kishin fatin ta provonin shokët e repartit të tij. Për herë të parë ai ndjeu thellë se ç'do të thoshte të shërbeje në një postë si posta e tyre. Dhe Xhaferri kishte pasur të drejtë, kur i kishte thënë njëherë, në ditët e para se këtu në postë detyra e vështirë ta shpërblen me një kënaqësi që nuk e gjen askund.

Pas kësaj ngjarjeje, ndodhi një ngjarje tjetër në postën e largët. Këtë herë ushtarëve nuk u hynë në punë ins-

trumentet e posaçme. Aparatet nuk i prekën fare. As hipën sipër në kullë për të marrë e për të dhënë sinjale. Ngjarja u doli përpara si një detyrë krejt e re, që kërkonte zgjidhje pa vonesë.

Kjo qe prova e fundit që e bindi Fatmirin se posta e tyre nuk ishte aq e vetmuar dhe e shkretë, si pandehte ai ditët e para.

I D Y T I

*Me kangë në buzë e me hove të reja
U zgjue agimi pranveruer,
Largësinat e hjedhta, ka zatetë hareja,
N'argjant shkëlqejnë brigjet tërthuer.*

(«Sonet pranveruer» Migjeni)

Ishte ora e fundit e shërbimit dhe Fatmiri nga maja e kullës, kohë më kohë vështronte qiellin nga lindja. Në vijën e lakuar të horizontit, sipër kreshtave të maleve, po regëtinte drita e mektë e agimit të parë. Dalngadalë mugëtira filloi të davaritej. Nën qiellin e zbardhur u dukën qartë malet hijerënda, kodrat e buta, fushat, luginat. Qetësia e natës pak nga pak humbi në cicërimin e zogjve e në jehonën e dobët të zhurmave që vinin nga larg. Poshtë, fshati po zgjohej. Roja, si ngaherë, vuri re njerëzit që dilnin nga shtëpitë dhe shpërndareshin nëpër luginë. Ata kishin pushuar gjithë natën dhe tani po shkonin në punë, kurse ai, në këtë kohë do të linte shërbimin dhe do të shkonte të qetësohej.

Fatmiri priti sa të dilte dielli dhe duke hedhur vështrimin e fundit për qark, zu të zbriste shkallët e kullës. Hapat e tij të rëndë kërcitën nëpër shkallinat e gurta. Mbi kokë, në tytën metalike të pushkës, shkrepëtinë rrezet e

para të diellit. Flladi i mëngjesit fëshfërinte nëpër gjethet e lisave që rrethonin postën.

Ai kaloi anësh sheshit dhe u fut brenda në postë. Në korridorin e errët, si mbylli derën e vendosi pushkën në armaturë, zbathi këpucët. Derën e fjetores e hapi ngadalë, duke vështruar nga ai që flinte. Po Xhaferri, ashtu siç ishte shtrirë më kurriz, me peshqirin hedhur në fytyrë, nuk u ndie fare. Në dhomë ajri ishte i ngrohtë. Dëgjohej vetëm frymëmarrja e shpeshtë e Xhaferrit. Dy dritaret e mëdha lëshonin dritën e mëngjesit.

Fatmiri mendoi të zhvishej njëherë e pastaj të zgjonte shokun për të marrë shërbimin. Atë kohë në dhomë hyri rrezja e parë e diellit. Ajo u fut lehtëzi, si një flutur e praruar dhe i qëndroi ushtarit mbi gjoks. Fatmiri as që e vuri re, sepse i rëndonin qepallat dhe trupin e ndiente të kapitur. Vari pantallonat në mur dhe ndenji në krevat të zhvishte xhakëtën. Kur uli kokën dhe u mat ta hiqte, iu bë sikur dëgjoji një zhurmë. Mbeti ashtu një çast, me kokën në mes të xhakëtës dhe vuri veshin. Zhurma tani ishte e qartë. Dëgjoheshin hapa të lehtë, që vinin nga prapa dritares. Ai uli xhakëtën dhe nxori kokën të dëgjonte më mirë. Hapat sa vinin e afroheshin. Padashur ai vështroi nga shoku. Xhaferri vijonte të flinte si më parë. Befas zhurma humbi. Fatmiri ktheu kokën nga dritarja e sakaq prapa xhamit të mbuluar me gazetë u duke hija e një dore. Ushtari u ngrit menjëherë më këmbë dhe u mat të fliste. Hija prapa xhamit lëvizti e pastaj u zhduk. Ai mori me të shpejtë pantallonat dhe u mundua t'i vishte. Vështrimi i tij qe larguar nga dritarja, po tamam në atë kohë në dhomë jehoi një e trokitur e lehtë. Fatmiri deshi njëherë të thërriste: «Kush je?» po ndërroi mendje. Vetvetiu zu të mbërthehej dhe ndërkaq ra një heshtje e nderë. Heshtja nuk zgjati. Dora e huaj trokiti rishtaz në xham. Ai iu afrua dritares duke shkelur mbi krevatin e tij, po hija u largua menjëherë.

Atëherë, Fatmirit nuk iu durua më e me gjysmëzëri thirri:

— Kush je?

○ Nga jashtë nuk erdhi asnjë përgjigje. Në dhomë hesh-

tja u bë edhe më e rëndë. Pastaj thirrja e ushtarit u përsërit:

— Folë, more, kush je?

U dëgjua një zhurmërimë e pakuptueshme. Diçka lëvizti matanë dhe fill pas kësaj erdhi një zë:

— Unë... jam... unë...

Ishte një zë i dridhur, që në veshët e ushtarit tingëlloi i çuditshëm.

Habia e hutoi aq shumë Fatmirin, saqë rrinte prapa xhamit e nuk i bëhej të hapte dritaren.

— Kush je ti? — pyeti me një tón të prerë. Po thirrja e tij mbeti pa përgjigje. Zëri përtej xhamit papritur heshti fare. Hija ishte zhdukur e nuk ndihej asnjë shenjë jete.

Ushtari atëherë nuk priti më. Doli nga dhoma në korridor dhe, kur u gjend te dera e jashtme, u kujtua se ishte këmbëzbathur. Po koha nuk priste. Ai kishte hapur derën dhe kishte dalë në sheshin prapa postës.

U dëgjuan disa hapa që vinin nga krahu i djathtë. Ai ktheu kokën dhe vështroi. Një vajzë e re po çapitej me droje për nga ai. Ushtari lëvizti padashur. Ajo qëndroi në vend.

Ata ishin tani përballë njëri-tjetrit po, ndërsa ajo rrinte me sytë ulur, ai e vështronte ngultas, duke e shqyrtuar me kujdes.

Vajza e panjohur ishte shtatgjatë, e veshur me një fustan që i vinte deri në fund të këmbëve. Duart i mbante të lëshuara si një fëmijë e turpshme. Kokën e kishte anuar nga supi i djathtë, kurse qepallat i qenë ulur fare, aq sa mbi mollëzat e kuqe i vizatoheshin qartë qerpikët e errët. Flokët e zez të shpleksur mbi një shami të bardhë tregonin tërthorazi shqetësimin e saj. Ajo, si ta ndiente atë vështrimin shqyrtues të ushtarit, ishte tulatur e rrinte si e ngrirë.

Fatmiri priti në heshtje që vajza e panjohur të fliste vetë, po ajo vetëm sa ngriti pak qepallat dhe i uli prapë. Ai zuri të mbërthente pullat e xhaketës së zbërthyer, duke menduar si të merrej vesh me të, ç'fjalë t'i thoshte e si t'i drejtohej. Më në fund tha:

— Ç'doni këtu? A e dini se është zona e ndaluar?
Zëri i ushtarit tingëlloi qortueshëm dhe vajza, në vend që të përgjigjej, u struk edhe më shumë, duke u mbledhur në vetvete, si t'i kërcënohej ndonjë rrezik.

Fatmiri vuri re se trupi i saj i hollë e sidomos supet e varura i dridheshin lehtë. Buzët i mbante gjysmë të hapura, ndërsa duart e lëshuara i rrinin si të këputura. Gjithë pamja e vajzës dukej e mjeruar, ajo ishte e lodhur dhe e vrarë, kurse ai, tek e vështronte me ngulm, ndjeu padashur që e lëndoi diçka përbrenda. Iu bë për një çast sikur e kishte parë atë fytyrë një herë...

— Flisni, çfarë doni? Mos keni ndonjë hall?

E panjohura ngriti kokën, duke mbajtur sytë ulur dhe Fatmiri pa ballin e saj të rrudhur e vetullat e zeza të bashkuara.

— Po... — pëshpëriti ajo me një fije zëri. — E kisha një hall...

— Çfarë halli? — ia priti ai. Po ajo, ndonëse ushtari kësaj here e kishte pyetur me një ton të butë, nuk u përgjigj menjëherë. Vajza ngriti qepallat dhe Fatmiri sakaq e vuri re se me sa mundim e bëri ajo këtë gjë. Vështrimi i saj u derdh përpara i druajtur, po ajo akoma nuk merrte guxim të vështronte nga djali i huaj. Sytë e saj ishin të mbufatur, të ngarkuar me frikë e pikëllim. Kjo gjë e bëri të stepej një hop ushtarin. Ai e mori me mend se në atë gjendje që ndodhej vajza, nuk ishte e kollajtë të përgjigjeshe.

— Desha të flisja — tha ajo, në një mënyrë të tillë sikur t'i drejtohej vetes dhe jo atij.

— Hë, flisni — u gëzua ai. — Mos kini turp...

Vajza papritmas sikur u gjallërua, drejtoi trupin, ngriti njërën dorë dhe ai vuri re se si rrudhat e ballit iu rralluan.

— Vetëm jeni? — pyeti ajo.

— Jo, jam me një shok — u përgjigj ushtari. — Po afrohu, afrohu...

Ai bëri një lëvizje, sikur t'i jepte asaj dorën që të kalonte ndonjë pengesë, ndërsa e panjohura hodhi me

ngathësi dy hapa drejt tij. Ata heshtën prapë dhe ai ia vuri fajin lëvizjes që bënë të dy. Ndoshta ajo u trubullua sërish dhe rrinte ashtu gjersa të mblidhte mendimet.

Vështrimi i saj binte te këmbët e tij të zbathura. Fatmiri mendoj se mos vajzës së huaj i vinte gjë turp nga pamja e tij e shkujdesur dhe ndoshta ndaj nuk fliste lirish.

— Hë, ç'keni? — tha ai i druajtur.

— Si e ke emrin ti? — pyeti ajo me një zë të pasigurt.

Ai u habit nga kjo pyetje dhe vuri buzën në gaz:

— Unë?!

Vajza u step, mbylli sytë përgjysmë. Mbi fytyrë i ra hija dhe s'u përgjigj derisa ai e mori fjalën prapë:

— Ushtari në detyrë nuk e ka zakon ta tregojë emrin, po meqë ti kërkon ta dish, po ta them: Fatmir ma thonë.

Nga fytyra e së panjohurës u zhdruk hija që kishte rënë. Ajo deshi të thoshte diçka, bile lëvizti buzët, po nuk tha asgjë. Fatmiri kuptoi se bëri mirë që ia tregoi emrin.

— Po ty si të quajnë?

— Mua më quajnë Zare!

— E gëzofsh!

Në shesh u dëgjua kumbimi i zileve. Vajza ktheu menjëherë kokën. Dy lopë që kishin ngjitur të përpjetën me vrull, zunë të kullosnin para postës. Ajo vështronte herë ato, herë ushtarin. Sytë e saj dukeshin të çapëlyer. Fytyra iu zbe edhe më shumë.

— Ç'ke? — pyeti ai i shqetësuar.

Ajo s'foli, po hodhi një hap drejt postës. Fatmiri hetoi përreth. Veç atyre dy lopëve që kishin ulur kokën e kullosnin në shesh s'kishte gjë të gjallë.

Vajza kishte qëndruar para pragut të derës dhe nuk guxonte të hynte.

— Kam frikë — tha me zë të dridhur, duke shikuar ushtarin në sy.

— Të ndjek gjë njeri?

— Jo — tha ajo — asnjeri nuk më ndjek...

— Pse ke frikë atëherë?..

— Kam frikë se mos është daja me bagëtinë...
Ajo fliste tani e penguar dhe Fatmiri e ndjeu se vajza, para rrezikut, e harroi drojtjen dhe padashur u bë e afërt me të. Dhe, siç rrinte ashtu, duke kthyer kokën herë më një anë, herë më tjetrën anë, merрте frymë me nxitim e lëvizte duart sikur të kërkonte t'i fshihte.

— Nuk dua të më shohin — pëshpëriti vajza.

— Kush?

— Të hyj një çikë brenda?

Ushtari nuk diti ç'të thoshte për një çast. Ajo s'priti përgjigje, po u fut në postë. Dera u mbyll ngadalë dhe ai mbeti vetëm në shesh.

«Dreq o punë!» — ia bëri ai me vete duke tundur kokën. Ç'po ndodhte kështu? As ai vetë nuk po e kuptonte. Nga një anë iu sulën një tufë mendimesh qortuese, po nga ana tjetër nuk i hiqej sysh fytyra e pikëlluar e Zares. Një njeri i dyshimtë s'mund të kishte atë pamje që kishte ajo. Po atëherë ç'hall e kishte shtyrë të ngjitej gjer atje në postë? Ushtarit atë çast i pëlqente t'i kujtonte vetes se e kishte parë një herë fytyrën e saj në fshat.

Ai doli në krye të rrugës dhe vështroi vendin përqark. Prapa shkurreve, të shpërndara sa andej-këndeј, kullosnin bagëtia. Dëgjoheј ndonjë zile, po nuk dukeј asnjë njeri.

— Nuk ka njeri — tha ai, kur hyri në korridorin gjysmë të errët dhe pa vajzën të strukur pas derës.

Ajo nuk foli, as kokën nuk e ngriti.

Ushtari ra përsëri në hall.

Ndoshta asaj i vinte turp që krijoi atë situatë.

Ndoshta nuk dinte ç'të bënte paskëtaj.

Zarja ngriti kokën dhe vështroi ushtarin. Sytë e saj tani nuk tregonin më frikë, po sikur luteshin për ndihmë.

— Ç'do të bësh? — tha ai, tek rrinte mbështetur te muri, ndërsa i binte në fytyrë drita e derës që kishte mbe-tur paksa e hapur.

Vajza ngriti supet lehtë dhe zuri të shtrëngonte shaminë e bardhë që mbante lidhur në gushë.

— Këtu është repart ushtarak — tha ai duke u munduar ta ndryshonte tonin.

— E di — murmuriti vajza.

Ushtari heshti.

— Unë prandaj erdha... — tha ajo, duke mbytur në gjoks valën e një ngashërimi që e bëri të dridhej të tërën.

Fatmirin dëjka e shtrëngoi përbrenda. Zëri i saj i buçiste në vesh si thirrje lutëse. Dhe atij sepse iu kujtua komisarari e iu zgjuan në vetdije mendimet e tij. Ky që një çast që vendosi.

Ai kaloi nëpër korridor me të shpejtë dhe hapi derën e dhomës, që gjendej përkundrejt fjetores.

— Hajde këtu... — dhe ia bëri me dorë.

Në korridorin e qetë hapat e saj u ndien si një fëshfërimë e zgjatur. Ajo ecte me hapin e një fëmije të druajtur, që s'di nga shkon. Fatmiri e shikonte nga pragu i derës.

— Hyrë, hyrë, si në shtëpinë tënde — i tha ai me vendosmëri. — Mos ki gajle...

Ajo u fut brenda dhe qëndroi në mes të dhomës gjithë turp e frikë, thua jse po e shikonin mijëra sy kureshtarë.

Fatmiri e harroi tani shqetësimin e tij dhe mendonte për gjendjen e saj. Kushedi si i dukej ajo dhomë e huaj, ato dyer që hapeshin e mbylleshin herë në gjysmerrësirë, herë në dritë; ai djalë i panjohur që e kundronte me vëmendjen nga kreu i dhomës! Ç'mendime vallë i sulleshin asaj vajze dhe e mundonin ashtu?

— Ulu — ia bëri ushtari, duke i afruar një nga karriget që qenë mbështetur pas tryezës.

— S'ka gjë, mirë jam...

— Jo, s'je mirë — ia priti ai dhe shtoi: — Mos ki turp. Ne jemi vëllezërit e tu. Ke vëlla ti?

Ajo atë çast po ulej në karrige dhe, kur ai e pyeti për vëllanë, nuk u ul. Fytyra i rrezëlliti nga një gaz i lehtë dhe tha me një zë të ngrohtë:

— Kam një. Edhe ai është ushtar si ti...

— A, shumë mirë, shumë mirë — ia ktheu Fatmiri. — Po ulu, ulu, mos rri në këmbë, se je lodhur.

Karrigia kërciti si kërcasin këthijat në zjarr dhe ajo vuri buzën në gaz, tek u ul me kujdes në anë të saj.

— S'ka gajle — i dha zemër ai. — Kështu kërcet ajo... Do rregulluar një çikë...

Vajza shikonte nga ai lirisht. Ishte hera e parë që Fatmiri e vinte re këtë gjë. Ndoshta ajo ishte natyrë e butë, naive dhe ajo zhurmë pak komike e karriges e bëri të qeshte, ose kushedi, ajo gjeti më në fund shkakun që të çlirohej nga tërë ajo barrë drojtjeje e frike.

Fytyra e Zares u çel, sytë i morën një shkëlqim të pastër, vija e buzëve iu drejtua.

Ai padashur vuri re nga afër tiparet e saj. Ajo kishte çuditërisht sy të kaltër me qerpikë të gjatë e të zez. Hunda i vinte e drejtë, me prenjka të rralla. Lëkura i qe rreshkur nga dielli.

— Je mirë tani? — pyeti ushtari.

— Mirë jam — tha ajo e qetë.

Ata s'folën për një kohë. Ajo i hodhi një shikim të shpejtë dhomës së huaj. I zoti i shtëpisë e vuri re që shikimi i saj kaloi nga tryeza e vendosur në mes, me karriget anësh, në krevatin te cepi i kreut, u vërtiti nëpër muret e zbukuruara me fotografi e parulla, vështroi dy dritaret e zëna përgjysmë me gazeta, pastaj u ndal në dyshemenë e shtruar me pllaka të kuqe dhe mbeti ashtu me sy poshtë.

Ai mori një karrige dhe u ul në anën tjetër të tryezës, karshi saj. Vajza ngriti sytë.

Ai tha:

— Domethënë ne jemi fqinjë dhe nuk njihemi! Nga Dara je, apo jo?

— Po, nga Dara — tha Zarja. — E kemi shtëpinë në Mëhallën e Përroit...

— E di, e di, te rrapi, atje është Mëhalla e Përroit...

— Unë të kam parë...

— Ashtu?! Po edhe unë sikur të kam parë. E kujt je nga Dara?

— E, Safet Dules.

— Është në kooperativë babai?

— Posi s'është. Sapo u ngrit vjet, hyri tok me shokët.

— Jeni shumë fëmijë në shtëpi?

— Jemi pesë e vëllai ushtar gjashtë.

— Ti je më e madhja?

— Unë jam vajza e dytë. Një motër e kam të martuar...

— Ku e ke martuar? — Zëri i tij tingëlloi shpëtimë.

Zarja qeshi mbyturazi.

— Pse qesh, mos pyeta gjë gabim?

— Jo. Po nuk e kam martuar unë.

— Mos është martuar vetë? — vijoi ai me tonin e parë, ndërsa Zarja buzëqeshte e drojtur.

— Jo — tha ajo, duke e vështruar me dyshim — si të martohej vetë!?

— Po kush e ka martuar atëherë?

— Babai... — tha ajo me gjysmë zëri.

Ai e ndjeu se përgjigjja mbeti përgjysmë, po njëkohësisht kuptoi se tani fillonte biseda e tyre e vërtetë. Ndërsa ajo lëvizte duart në prehër, ai e pyeti:

— Është i rreptë babai?

— ...

Karrigia e Zares kërciti. Vështrimi i tij e kishte vënë vajzën në një rreth të mbyllur.

— Po babai di gjë që ti ke ardhur këtu sipër?

— Jo, kush tha?... — ngriti kokën ajo duke vështruar e trembur.

— Them unë — ia ktheu i qetë ai. — Po di kush gjë?

— Asnjë nuk di — tha ajo e bindur.

— Të tha njeri të vije këtu?

— Jo, asnjeri.

— Vetë erdhe?

— Vetë... Po pse?

— Kot pyes...

Zarja filloi prapë të luante me gishtat e duarve. Ai mbështeti bërrylet në tryezë. Në xhamin e dritares u dëgjua një e trokitur e lehtë. Ajo ktheu kokën. Ai tha:

— Trokasin zogjtë...

Ajo nuk foli. Ai tha:

— Ke ardhur ndonjëherë këtu?

— Jo!

— Po si e gjete rrugën?

— Kur ka hall njeriu, e gjen rrugën...

Përsëri krahët e zogut fëshfëritën e kërcitën në xham. Ajo kësaj here nuk e ngriti kokën.

— Mirë — tha Fatmiri, duke u çuar më këmbë. — Do të bisedojmë për të gjitha, po do të presësh pak...

— Pres — tha ajo dhe u ngrit nga karrigia.

— Ulu, mos u ngre...

Zarja u ul prapë buzë karriges, duke vështruar nga ushtari.

— Në ushtri, si kudo, ka rregulla — tha Fatmiri me një zë të ngrohtë që ajo të mos e keqkuptonte. — Ai shoku është komandant i postës. Të vijë dhe ai e të bisedojmë. Ti mos u mërzit.

— Jo, s'mërzitem. Unë prandaj kam ardhur...

— Mirë atëherë — ia bëri ai dhe hapi sirtarin e tryezës e nxori që andje disa revista «Ylli» e «10 Korriku». — Na, shih këto.

Ai bëri të dilte, po u ndal një hop dhe shtoi:

— Të lutem, mos lëviz që këtu!

Ajo nuk diti ç'të thoshte. Ai sakaq e kuptoi se në rrethana të tjera ato fjalë mund të mos i kishte thënë fare. Në dhomë ra heshtje.

I T R E T I

Guzimi i jep vlerën përparimit.

V. HYGO

Fatmiri enkas hapi dhe mbylli derën e fjetores me zhurmë, po Xhaferri nuk u zgjua, vetëm sa lëvizi këmbët nën batanije; u përcoll duke shtrenguar buzët dhe humbi përsëri në gjumë.

Ai iu afrua krevatit dhe e vështroi shokun që flinte i shkujdesur. Xhaferri akoma nuk e dinte dhe s'kishte si ta dinte, që në postë kishte ardhur një njeri i huaj, për më tepër një vajzë. Detyra e Fatmirit ishte t'ia thoshte e, si ta bënte këtë, le të vendosnin pastaj bashkarisht. Po si t'ia thoshte?

Koha s'priste të mendonte gjatë. Kjo ishte një gjendje që i përngjante një situatë luftarake. Si mund të vepronte ai pa urdhrin e komandantit, kur komandanti ishte aty?

Fatmiri e preku Xhaferrin nga supi i djathtë që i kishte dalë mbi batanije dhe e tundi lehtë. Ai, pa hapur sytë mirë. u ngrit menjëherë ndenjor.

— Ç'ke? — tha duke fërkuar sytë e përgjumur. — Mos jam vonë?

Tjetri e shikonte dhe s'dinte të përgjigjej.

— Pa çohu një herë...

— Sa është ora?

— Mos pyet për orën, po çohu!

Tek hapte gojën, Xhaferri vuri re shprehjen e fytyrës së Fatmirit. Ai e kuptonte shokun dhe pa fjalë.

— Ç'ka ndodhur?

— Të doli gjumi?

— Gjumi më doli, po ç'do të më thuash?

Fatmiri i ktheu kurrizin dhe bëri sikur rregulloi batanijen e krevatit të tij.

— Asgjë s'ka ndodhur nga ato që të shkon mendja ty, po ngrehu vishu e merr shërbimin!

Fytyra e komandantit të postës u bë serioze. Fatmiri i hodhi pantallonat në duar.

— Ti bjer e fli — tha Xhaferri.

— Mirë, mirë — ia priti me gjysmë zëri Fatmiri, duke u munduar të tregohej i qetë.

Xhaferri u hodh nga shtrati dhe zuri të vishej me ngut.

— Si është puna?

— Ty akoma s'të ka dalë gjumi — qeshi Fatmiri, që mezi i bënte ballë presionit të komandantit — si të bisedoj?!
Ai vishej dhe s'ia ndante sytë shokut.

— Mos kanë marrë gjë në telefon nga reparti?

— Jo, jo, po hë, vishu!

Xhaferri u drejtua nga dera.

— Ku shkon? — ia bëri tjetri.

— Të marr shërbimin.

— Ulu, njëherë, ulu...

Të dy shokët u ulën nëpër krevate përballë njëri-tjetrit. Po, ndërsa Fatmiri kishte mbuluar gjysmën e fytyrës me duar, Xhaferri e hetonte me këmbëngulje.

— Hë, tani si është puna?

— E di si është puna... — filloi Fatmiri dhe mbeti një grimë, sepse ende nuk dinte në ç'mënyrë t'ia tregonte ngjarjen, me të qeshur apo seriozisht. Fytyra e tij ndërronte orë e çast, herë ndriste nga gazi, herë vrenjtej.

Më në fund mbylli sytë përgjysmë e tha:

— Na ka ardhur në postë një shoqe!

— Shoqe?! — ia ktheu i habitur Xhaferri dhe pada-
shur luajti nga vendi.

— Po — tha ai duke e shikuar ngultas në sy.

Xhaferri vuri buzën në gaz, ngaqë nuk donte ta be-
sonte. Kjo ishte një shaka, nga ato shakatë që kishte zakon
Fatmiri. Po prapë, mënyra se si foli e bënte të dyshonte.

— Fol tani si është puna? E kam seriozisht — tha
Xhaferri me ballë të rrudhur.

— Ta thashë, na ka ardhur një shoqe!

— Mos u tall, se s'janë gjëra për t'u tallur!

— Për ideal, e kam me gjithë mend!

Sytë e Xhaferrit mbetën të hapur.

— Si kështu?!

Tjetri nuk u përgjigj. Ai uli kokën i menduar. Fatmiri
pa që komandanti u ngrys në fytyrë. Ai e dinte mirë, se
kur ngrysej ashtu shoku i tij.

— Po ç'do kjo shoqe në postën tonë?

— Ka një hall, — tha, — shpjegoi shkurt ai.

— Po ku e gjeti ta qajë hallin te ne? Nuk i the që ne
jemi ushtarë dhe nuk merremi me çështje civile?

— Kështu nuk i thashë — u përgjigj i qetë Fatmiri.
— Unë s'mund ta zboja...

— Duhet t'i kishe thënë — foli Xhaferri, pa e parë
tjetrin në sy.

— Them të bisedojmë njëherë — ia ktheu ai duke u
munduar ta kapte vështrimin e tij, po tjetri e kuptoi dhe
i uli qepallat përgjysmë.

— Ç'të bisedojmë — tha ftohtë Xhaferri. — Shko thu-
aji ti dhe mos më nxirr mua jashtë.

Fatmiri ktheu kokën nga dera. Tjetri i tërhoqi vë-
mendjen.

— Ajo na pret në dhomën matanë!

Fatmiri ndjeu mbi vete vështrimin e ashpër të koman-
dantit të postës.

— Po ti i di rregullat?

— I di.

— Pse na vë atëherë në pozitë të vështirë?

— Si ta kuptosh këtë gjë. Unë s'e kuptoj kështu.

— S'ka si ta kuptosh... Rregullat janë rregulla...

— Po s'janë vetëm rregullat tona në këtë botë...

Vështrimet e ushtarëve u përpoqën. Sytë e tyre kishin marrë një shkëlqim të mprehtë. Po ndërsa vështrimi i Xhaferrit bëhej gjithnjë e më ngulmues, ai i Fatmirit erdhi e u zbut shpejt dhe vetvetiu nga një gaz i çiltër.

— Fato, mos u tall.

— Nuk tallem — ia ktheu Fatmiri. — E kam seriozisht.

Xhaferrit nuk i erdhi mirë që ai nënqeshi dhe këtë ia tregonin buzët e shtrënguara.

— Edhe unë e kam seriozisht. Pse më detyron të të përmend gjëra që ti i di aq mirë, sa dhe unë?

Fatmiri prapë ngjante sikur nënqeshte. E shikonte shokun dhe s'fliste. Tjetri vazhdoi me një ton qortues:

— Pa mendo njëherë se ç'njeri është ai!

— Ajo — korigjoi Fatmiri.

— Njësoj është — ngriti zërin tjetri.

— Jo, s'është njësoj — ia priti Fatmiri i vendosur — dhe ti, para se ta thuash mendimin tënd, duhet ta kesh parasysh këtë gjë.

Biseda mori zjarr papritur.

— Po, po njësoj! — tha Xhaferrit me duf. — Për mua e njëjta gjë është: edhe kështu mund të arrihet qëllimi i keq. Ti e di ç'rëndësi ka pika jonë. E di që jemi në një zonë të thellë. Armiku s'mund të vijë as me top e as me pushkë... Mjafton të dërgojë një njeri, qoftë...

— Këtë e mendova dhe unë qëparë — ndërhyri Fatmiri, po tjetri nuk e la të vazhdonte.

— Pra, mund të vijë dhe si ajo vajza... E kupton?

— E kuptoj... — tha ai, duke u munduar të tregohej i qetë — po rasti i sotëm ndryshon...

Xhaferrit iu afrua gati në fytyrë:

— Ku e di ti? Ajo s'e ka të shkruar në ballë. Armiku i klasës nuk flë...

Fatmiri, sado që ishte i bindur se në mes tyre po ndodhte një keqkuptim i çastit, prapë para shqetësimit serioz të Xhaferrit u step. Ai nuk e kishte parë asnjëherë për-

gjegjësin e tij të tronditej ashtu e të mernte zjarr si kësaj radhe. Po duke sjellë nëpër mend atë që kishte ndodhur pak çaste më parë, ai donte që shoku i tij, njeri i matur zakonisht, të tregohej gjakftohtë edhe në këtë situatë që ishte krijuar kaq papritur.

— Unë këtë që thua ti nuk e mendova. Pastaj më duket se e kam parë atë vajzë në fshat — tha Fatmiri duke folur ngadalë, ndërsa Xhaferri e shikonte qortueshëm. Dhe ti, po të ishe në vendin tim, Xhaferr, kështu do të veproje.

— Si?

— Do t'i silleshe mirë...

— Ajo është tjetër punë, po nuk do ta fusja brenda në postë.

Fatmiri heshti. Balli iu vrenjt dhe uli sytë. U bë një pauzë e nderë.

— Ta thashë — foli pastaj Fatmiri, pa i ngritur qepallat — ndoshta kam bërë gabim po se si ndodhi ashtu dhe unë s'pata kohë të mendoja. Më preku pamja e saj. Ishte vërtet për të qarë hallin! Ke për ta parë vetë. Për ideal, do të më japësh të drejtë!

Xhaferri shikonte nga shoku me sy të trubulluar.

— Ajo ka dhe një vëlla ushtar — shtoi Fatmiri.

— E ku ta dimë ne, se mos na dha dokument.

— Dokument s'më dha, po unë për veten time e besoj.

— E ç'rëndësi ka fundi kjo? — ia bëri Xhaferri duke u rrudhur edhe më shumë në fytyrë. Sa ushtarë ka Republika!

— Ka shumë rëndësi — ia ktheu menjëherë Fatmiri. — Ajo nuk erdhi kot këtu. E parë e punës, ajo e di se ne jemi ushtarë të këtij populli, që është ngritur më këmbë për të mbrojtur të drejtat e gruas dhe e dyta, në mungesë të të vëllait, vjen e na qan hallin neve. Po ta kishte të vëllanë në shtëpi, ndoshta s'kishte për të ardhur. Tani si t'i themi? Ik, se nuk merremi me këto punë, nuk na intereson halli yt, apo nuk e njohim vëllanë tënd?

Xhaferri kësaj here nuk e kundërshtoi, po u ngrit më këmbë dhe iu afrua dritares. Fatmiri e vështronte nga pra-

pa dhe, sado që nuk e shihte në fytyrë, e ndiente se fjalët e tij po ia fashitnin kundërshtimin e parë.

— Ku vajti na qëlloi neve! — pëshpëriti Xhaferri si me vete. — Për ideal, as që më kishte shkuar ndër mend se një ditë...

— ...do të vinte një vajzë në postën tonë — plotësoi Fatmiri, duke përfitur nga ajo mënyrë e ngadaltë me të cilën fliste, tjetri.

Fytyra e Xhaferrit nuk e kishte më rreptësinë e parë, megjithëse sytë i kishte ende të menduar.

— Ty të duket gjë e vogël, Fato!

— Po as aq e madhe sa e bën ti! E dëgjove komisarin se ç'tha, apo jo?

Xhaferri e shikonte shokun në sy dhe s'i përgjigjej.

— Ne s'po bëjmë ndonjë gjë të keqe — vazhdoi Fatmiri. — E dëgjojmë njëherë ç'do të na thotë. Bile u vonuam. Ajo e shkreta, pret matanë dhe kushedi se ç'mendon!

Xhaferri u ul prapë në cep të krevatit. Tjetri hapi sytë e tha:

— E, shkojmë?

Xhaferri tundi kokën sikur të turfullonte:

— Lëre tani... Kështu është, kur shkelen rregullat!

Fatmiri nuk e ngau me fjalën po u ngrit, mori këpucët e Xhaferrit dhe ia solli përpara.

— Mbathi, se ajo po pret.

Ai filloi t'i mbathte këpucët mekanikisht, me vetullat lëshuar, kurse Fatmiri iu afrua derës dhe qëndroi aty me frikë në zemër se mos komandantit i ndërrohej mendja.

— Rregulloi pak ata flokë — tha Fatmiri, kur ai u çua më këmbë.

Xhaferri i ngriti flokët me dorë dhe vajti pas shokut. Atë çast Fatmiri hapi derën dhe priu përpara duke ndjekur me bisht të syrit lëvizjet e komandantit. Ai kapërceu pragun si me zor, po kur u gjend përballë derës tjetër Fatmiri me qëllim i lëshoi rrugë dhe Xhaferri e hapi derën vetë e hyri i pari brenda.

I K A T È R T I

Bubullojnë këmbanet e revolucioneve

Po dridhet bota e vjetër

(«Poemë e blinduar» I Kadare)

Zarja sapo pa që një ushtar i panjohur u duk te pragu i derës, u ngrit menjëherë më këmbë, me kokën varur mbi gjoks.

— Si je, shoqe? — tha Xhaferri.

Asaj i rrahu zemra fort, aq sa mezi i shquajti fjalët që i tha ai, po kur ndjeu që pas tij hyri ushtari tjetër, tashmë i njohur për të, sikur mori frymë lirisht.

— Kjo është ajo shoqja — tha Fatmiri, duke u futur në mes tyre, me një pamje të çelur. — Ky është Xhaferri, komandanti i postës.

Komandanti i dha dorën. Zarja i zgjati të sajën dhe u mundua ta mbante drejt, po ajo iu drodh aq sa Xhaferri e vuri re. Ndërkaq Fatmiri kishte zënë vend në karrige. Xhaferri tha me zë të lartë:

— Si e ke punën, shoqe?

— Ulu, Zare, ulu — ia priti Fatmiri me zë të butë.

Zarja u ul buzë karriges dhe, megjithëse ajo kërciti, vajza nuk qeshi si herën e parë. Fatmiri buzëqeshi dhe kjo i tërhoqi vëmendjen Xhaferrit. Ai kishte mbetur më

këmbë dhe për një çast e humbi. Fatmiri ia bëri me shenjë të ulej dhe ai zuri vend në karrigen që kishte mbetur bosh. Dhoma për një çast ra në qetësi të plotë.

Ata kishin krijuar padashur një trekëndësh të çrregullt, duke i kthyer pjesërisht kurrizin njëri-tjetrit. Dy ushtarët qenë pothuaj përballë, kurse ajo vinte pak si mënjane.

— Shiko, Zare... — foli Fatmiri.

Vajza ngriti kokën. Ai ndjeu në fytyrë vështrimin e saj.

U bë një pauzë e shpejtë e pas saj Fatmiri vazhdoi:

— ...Ne jemi shokët e vëllait tënd, prandaj mos ki turp, fol!

— Unë të thashë... kisha një hall... — pëshpëriti ajo me një zë të zvergur.

— Na e thuaj atë hall — u hodh Xhaferri.

Zëri i tij tingëlloi i prerë e pak i ftohtë. Ushtari e mori me mend se vajza i druhej komandantit të postës.

— Ti kot s'ke ardhur? — tha Fatmiri.

— Kot s'vija kurrë — ia ktheu ajo e shqetësuar.

— Në të kuptojmë — ia bëri po ai — dhe na vjen mirë që na merr në këmbë të vëllait... prandaj mos ki turp...

Ajo lëshoi një psherëtimë të përmbajtur. Fatmiri shikoi shokun që rrinte i menduar.

— Të kisha vëllanë në shtëpi — arsyetoi vajza me një ton të pasigurt — nuk ju besdisja ju...

— Pse, ku e ke vëllanë? — pyeti Xhaferri dhe këtë e bëri jo se nuk e dinte, po sepse donte të hynte rishtaz në bisedë.

— E kam ushtar.

— Si ta quajnë?

— Mehdi.

— Mehdi kush?

— Mehdi Dule.

— Sa kohë ka që është ushtar?

— Ka një vit e ca.

— E mban mend numrin e repartit?

— Numrin nuk e mbaj mend, po e di që nget tanke...
Dalongadalë pyetjet e komandantit të postës e tërhoqën vajzën. Ajo ngriti kokën dhe Xhaferri pa sytë e saj të trubulluar e pak të habitur, fytyrën e hequr e buzët e thara. Ajo përgjigjej shpejt, pa u menduar gjatë, çiltër si ajo fëmija e humbur që, pasi ka heshtur një kohë, papritmas fillon e u përgjigjet me radhë të gjitha pyetjeve.

Vështrimi i Xhaferrit tani nuk ishte më i ftohtë. Singëriteti i saj, të cilin ai e ndjeu menjëherë, sikur po ia daraviste vargun e dyshimeve që i sillej nëpër kokë.

— Hë, si është puna? — pyeti ai pas pak. Kësaj here zëri i tij ishte i qetë, ishte toni me të cilin Xhaferri bisedonte zakonisht.

— Unë... ika... — tha vajza — ika nga shtëpia...

Po një valë mallëngjimi, që i erdhi papritur, ia këputi fjalën në mes.

Ushtarët e vështruan në sy dhe nuk e nganë.

— Ika se... s'desha të martohesha... — vazhdoi ajo pas pak, duke marrë frymë thellë. — Thashë... nuk desha...

Ajo u përpoq t'i mbante lotët, po sakaq fjalët iu ngatërruan. Atëherë heshti, gjuha iu lidh dhe lotët i ranë në prehër. Këtë gjë, si duket, ajo nuk e deshi dhe mbuloi fytyrën me duar.

Fatmirit, sado që i erdhi keq nga ai mallëngjim i papritur i vajzës, prapë me vete i quajti një gjë të mirë, një provë tjetër për të bindur shokun e tij.

Dhe vërtet, sytë e habitur të Xhaferrit tani ishin ngulur diku në mur. Ai s'e priste ndoshta këtë skenë, dhe kundër dëshirës së tij qe trubulluar. Pas pak në dhomë kumboi zëri i tij:

— Kush deshi të të martonte?

— Ata...

Ajo u mat të shtonte akoma, po ngashërimi e mbërtheu keq. Duart iu drodhën në fytyrë.

— Prindërit, si duket... — tha Fatmiri.

Xhaferri tundi kokën me vetullat varur, ndërsa nofullat i qenë shtrënguar.

— Mos qaj — shtoi komandanti i postës me një zë që

dhe atij i tingëlloi i huaj për detyrën që kryente. — Ne nuk do të mund të të ndihmojmë dot, në qoftë se nuk do të na i tregosh të gjitha...

Zarja zbuloi fytyrën dhe fshiu sytë me kurrizin e dorës. Pastaj psherëtiu thellë.

— Ç'të them, unë e shkreta... — theu ajo heshtjen e ngrirë të dhomës. — Unë s'desha... dhe ika... vajta...

Vajza për pak u ngatërrua prapë, po i erdhi në ndihmë Xhaferri:

— E njihje ti atë?

— Jo, unë nuk e njihja!

— Po babai e njihje? — pyeti Fatmiri.

Zarja nuk u përgjigj.

— E njihje, apo s'e njihje? — nguli këmbë tjetri me një ton të prerë, aq sa ajo ia pat menjëherë:

— Nuk e di...

— Të vjen keq për babanë? — vërejti Fatmiri.

Biseda përsëri filloi të ndërpritej nga heshtja e vajzës.

— Po kush e bëri këtë fejesë? — pyeti Xhaferri.

— Malua...

— Kush është ky Malua?

— Është shkesi... — Zëri i Zares kësaj here tingëlloi lirisht. — Ai ka martuar shumë vajza të fshatit tonë...

— E qartë... — ia priti Fatmiri. — Këta shkesët janë të tmerrshëm!

— Dale një herë — tha me seriozitet Xhaferri — ta marrim vesh mirë...

Vajza s'dinte ç'të bënte: shikonte herë nga njëri, herë nga tjetri. Ajo nuk i druhej më si përpara vështrimit të ushtarëve.

— Zare — foli Xhaferri, duke e thirrur për herë të parë me emër — mund të na thuash, pse nuk pranove të martoheshe? Nuk të pëlqente ai djalë?

Ajo bëri një lëvizje të kokës, që ata s'e kuptuan aty për aty se ç'deshi të thoshte, po kur ajo zuri të fliste, Fatmiri e ndjeu shpotinë në zërin e saj:

— Ai nuk është djalë... Është burrë i madh... i ka vdekur gruaja...

Fatmirit nuk iu durua e gati sa s'thirri:

«Shumë mirë ke bërë».

Xhaferri tha i përmbajtur:

— Ke shumë kohë e fejuar?

— Kam... — u përgjigj vajza me qepalla ulur. — Qëkur isha në shkollë...

— Po fshati ç'bëri? — pyeti Fatmiri me duf.

— Ç'të bënte fshati?.. Kështu ishte zakoni atëherë...

Vajzat fejoheshin të vogla.

— Po tani? — pyeti i menduar Xhaferri.

— Tani jo — tha Zarja dhe fytyra iu çel nga sytë që i morën një shkëlqim vetëtitës. — Ka thënë shoku Enver se atij që bën këto gjëra, do t'ia presim kokën...

— E sheh, pra... — ia priti Xhaferri, ndërsa Fatmiri vuri re që ai mori frymë i lehtësuar.

Papritur ata u gjallëruan dhe biseda filloi të rridhte lirisht.

— Po ti pse nuk e prishe fejesën? — tha Fatmiri.

Xhaferri ndërhyri:

— U bë mbledhje në fshatin tuaj për këto gjëra?

— U bë.

— Ishte në mbledhje yt atë?

— Jo...

Komandanti i postës kërkonte tani të sqaronte çdo gjë me hollësi.

— Po pse?

— Kishte vajtur në mal të priste lëndë druri për stallat...

— Kastile e bëri? — tha Xhaferri.

Vajza ngriti supet.

— Po ti ishe?

Zarja nuk u përgjigj menjëherë.

— Isha...

— Ishe!? — tha Fatmiri.

— Po — ia pat ajo, duke hetuar ndryshimin e papritur të ushtarit.

— Po kur paske qenë atje — tha i shqetësuar Xhaferri — si nuk u ngrite të flisje?

Vajza u kërrus akoma, sikur ta ndiente atë çast mbi vete tërë barrën e fajit të saj.

— Partia të jepte dorën — u hodh Fatmiri. — Ti duhej të flisje.

— Po të kishe folur atëherë — tha Xhaferri — do të kishe shpëtuar...

— Nuk doja t'i bëja keq babait... — tha Zarja, duke vështruar pllakat e shtruara nën këmbë.

— E sheh sa gabim! — ia ktheu Xhaferri. — Kështu i ke bërë keq dhe vetes dhe babait.

Vajza tha:

— Ju nuk i njihni njerëzit e tij...

— Të kujt? — tha Fatmiri.

— Të atij...

— Të dhëndrrit do të thuash? — pyeti Xhaferri.

— Po pëshpëriti ajo.

Vështrimet e ushtarëve u kryqëzuan. Vajza sikur u mblodh në vetvete. Përsëri ra një atmosferë e nderë.

— Dëgjo — tha Xhaferri pas një heshtjeje të shkurtër. — Ne kemi mundur armiç më të fortë e jo mos të mundim shkesët dhe dhëndurrët pleq. E kupton këtë?

— E kuptoj — tha vajza duke i treguar sytë e shkëlqyer. — Edhe atëherë e dija, po kisha frikë. Jemi shumë larg që këndeje.

— Po tani ke frikë?

Ajo ktheu kokën nga Fatmiri.

— Po të kisha frikë tani, nuk vija...

Ajo heshti pak, pastaj shtoi duke kapërthyer gishtat e duarve.

— Ata të shtëpisë më hoqën tri ditë përpara nga puna, më mbyllën brenda... Qëndisja në gjergjef... Donin të më çonin atje të enjten...

— Domethënë nesër?

Ajo tundi kokën, ndërsa duart nuk i lëvizte më.

— Po pastaj?

— Pastaj?.. Unë ika...

Ushtarët e ndienin se ajo, sa herë kujtonte shtëpinë, mallëngjehej e s'e kishte të lehtë të fliste.

— Ti bërë shumë mirë që ike — nisi të fliste komandanti i postës me vetullat lëshuar. — Po pse nuk shkove te sekretari i partisë së fshatit të bisedoje me të?

Zarja ngriti kokën.

— Fshati ynë është i vogël e s'ka sekretar. Sekretari i kooperativës rri në Dyresh.

— Të shkoje në Dyresh — tha Xhaferri i vendosur.

— Kush më linte mua të shkoja gjer atje? Është larg Dyreshi.

Fatmirit i vinte mirë që ajo i kishte menduar këto gjëra. Zarja tani fliste e qetë dhe e bindur.

— Je në rini? — pyeti sërish Xhaferri.

— Jo, nuk jam.

— Kush është sekretar i rinisë së fshatit?

— Kamberi, djali i Seitit.

— Pse nuk shkove te Kamberi?

— Shkova te Kamberi. I thashë që do të veja në postë dhe ai më tha: «Mirë, shko, vëllezër i kemi... mos u bëj merak, ata do të të përcjellin për atje ku do ti... Unë do të vete në Dyresh», tha ai...

— Dhe erdhe këtu... — shtoi Fatmiri.

— Po — tha ajo, pa vënë re gazin e lehtë në buzët e ushtarit.

Ndërkaq Xhaferri psherëtiu:

— Vërtet në hall të madh paske qenë, moj motër!

Pas këtyre fjalëve, ata nuk folën një kohë. Fatmiri u ngrit dhe iu afrua dritares. Dy të tjerët qëndronin ende ulur, të thithur në mendime.

— Po sikur të shkojmë ne e të bisedojmë me shokët e fshatit? — tha Xhaferri.

Vajza u ngrit përgjysmë nga karrigia. Fytyra papritur iu bë e ashpër.

— Jo, jo — thirri ajo e egërsuar — nuk dua... Më mirë iki... Iki unë... marr malet!

Fatmiri iu afrua tryezës.

— Ulu, ulu — tha me gjakftohtësi Xhaferri. — Ne s'do të bëjmë asgjë pa pëlqimin tënd! Apo jo, Fato?

— Ashtu është — tha Fatmiri, që rrinte më këmbë prapa tij.

— Ne mendojmë — vazhdoi Xhaferri — se në fshat ka njerëz që do të të ndihmojnë, pa qenë nevoja të largohesh kështu...

— Jo — tha ajo me këmbëngulje — nuk dua...
Zarja tani dukej e zemëruar, buzët i mbante mbledhur, sytë i kishin marrë një shkëlqim të mprehtë.

Fatmiri sepse i erdhi keq. U ul në karrige dhe u mundua të vështronte Xhaferin, po Xhaferri kishte ulur sytë. Heshtja që rënduar tepër.

— Si të duash — zuri të fliste i qetë komandanti i postës. — Edhe në fshatin tuaj ka komunistë, ka njerëz të ndershëm, që do të të kuptojnë drejt.

— E di, po më vjen turp tani...

— Si të të vijë më mirë — tha Xhaferri.

— Ju më keni në dorë... — pëshpëriti Zarja me zë të shuar.

Xhaferri u ngrys në fytyrë.

— Jo — i erdhi në ndihmë shokut Fatmiri — tani e ke ti veten në dorë...

— Unë dua të shkoj në hekurudhë...

Ajo i tha këto fjalë duke hetuar fytyrën e Xhaferrit. Xhaferri tha:

— Ne do të të ndihmojmë me sa të mundemi.

Zarja lëvizi e lirë në karrigen e saj.

Fatmiri u ngrit prapë më këmbë, sepse s'para rrinte dot ngulur në një vend. Xhaferri ende nuk ishte çliruar nga mendimet shqetësuese. Ai zuri të pyeste rishtaz:

— Të pa njeri kur erdhe për kënde?

Ajo sikur u step një çast e me vonesë shtoi:

— Jo...

— Asnjëri, fare, fare?..

Fatmiri ndiqte dialogun i heshtur, duke parë shqetësimin e të dyja palëve.

— Djali i Likos — tha Zarja — ai i vogli po kulloste qengjat...

— Ku?

— Te Fusha e Përroit.

— Të pa gjë?

— Nuk e di, po unë për vete e pashë...

— I fole?

— Jo. Ai ishte larg...

— Kështu do të jetë — ndërhyri Fatmiri, duke marrë anën e vajzës.

— Unë nuk i rashë nga rruga... — shpjegoi ajo.

— E qartë, e qartë — tha komandanti me zërin e tij të prerë. — Tani ne po të lëmë. Krevatin ja ku e ke, shtrihu dhe pusho.

— Jo, mirë jam — ia bëri ajo. — Rri dhe kështu...

— Pse, në karrige do të rrish gjithë ditën? — qeshi Fatmiri. — Rri e qetë, mos ki turp...

Xhaferri u ngrit më këmbë. Pas tij u çua menjëherë dhe ajo.

— Ulu — tha Fatmiri dhe shtoi me të qeshur: — Nus-ja ngrihet kështu. Po ti nuk u bërë nuse!

Vajza buzëqeshi me zor.

— Për çdo gjë — e porositi Xhaferri para se të dilte — trokit në derën përkarshi!

— Prit — ndërhyri tjetri. — Ne s'e pyetëm, mos do gjë për të ngrënë?

— Jo — tha ajo me të shpejtë — ju falem nderit.

Komandanti, që i ishte afruar derës, u kthye nga ajo:

— Mos ki turp. Në qoftë se s'ke ngrënë, fol. Ushtria e ka sofrën shtruar.

— Nuk më hahet, falemnderit!

I fundit doli Fatmiri. Ai tërhoqi derën ngadalë dhe e mbylli pas vetes. Në dhomë ra qetësi e plotë.

Zarja sapo pa që mbeti vetëm, mori të çlironte shaminë e bardhë që e shtrëngonte në gushë. Deshi ta hiqte fare nga koka, po nuk arriti dot. Atë çast trokiti lehtë dera dhe ajo vuri duart në prehër, ndërsa shamia filloi t'i rrëshqiste nëpër flokë. Kur trokiti dera për së dyti, shamia i ra supeve.

Dera u hap ngadalë dhe Zarja pa sytë e qeshur të Fatmirit. Ai qëndroi te pragu.

Vajza u ngrit padashur më këmbë. Ai zgjati dorën nga ajo.

— Çelësi — tha ai. — Mbylle, po deshe, nga brenda.

Ajo nuk lëvizi nga vendi. U vrenjt në fytyrë, sytë iu fshehën prapa qepallave, shamia i ra përdhe. Ushtarit i mbeti dora e shtrirë.

Ata qëndruan një kohë të hutuar. Ajo e ngrysur, ai i habitur.

— Ta vë në vend? — pyeti ai ashtu vetvetiu.

Ajo s'u përgjigj menjëherë, pastaj diç pëshpëriti.

— Nuk të dëgjoj — tha djali.

— Nuk e dua... — ia bëri ajo, me një ton gati fëmijëror, ku ndihej turpi e zemërimi njëherazi.

Ai e kuptoi se ç'deshi të thoshte vajza dhe mori ta vendoste çelësin në vrimën e vet prapa derës.

Në vesh i gjëmoi zëri i saj:

— Unë, po të mos kisha besim, nuk vija te ju.

— Ke të drejtë... — pëshpëriti ai dhe mbylli menjëherë derën pas vetes.

Dera u përplas dhe çelësi tringëlloi në çimento e ra përpara këmbëve të vajzës. Dhe ajo, në vend që ta ngrinte, e shtyu me majën e këmbës së djathtë. Çelësi u zhduk diku poshtë krevatit. Ballin e vajzës e mbuluan rrudha të holla.

Ah, të kishte mundësi, ta flakte tutje nga dritarja atë copë hekur të mallëkuar! Me një çelës të tillë e kishte mbyllur babai për ditë e net të tëra.

Zarja ndenji në karrige gjersa u lodh. Pastaj iu rëndua trupi, qepallat mezi i mbante. Ajo e ndjeu se nuk mund të qëndronte më ashtu. U ngrit nga karrigia dhe iu afrua shtratit.

Shtrati prej hekuri ishte vendosur në cep të dhomës, i mbuluar me batanije, ndërsa përsipër dilte si jakë çarçafi i bardhë. Po Zarja nuk u shtri menjëherë. Rrinte dhe e shikonte dhe se si i vinte të shtrihej mbi të. Ajo nuk ishte shtrirë kurrë mbi shtrat, aq më tepër mbi një shtrat të huaj.

Ndenji një copë herë më këmbë, po lodhja sa vinte e i merrte fuqitë. Atëherë nuk duroi më dhe, kundër dëshirës u ul ngadalë në cep të shtratit. Shtrati s'bëri zhurmë dhe ajo mori guxim e vuri kokën mbi jastëk. Menjëherë ndjeu kundërmimin e shtresave të huaja dhe iu kujtua sakaq shtëpia, ajo dhomë e madhe pa tavan, rrogozat, velenxat e verdha, jastëku me kashtë dhe dalngadalë e mori gjumi...

I P E S T I

Lumturia asnjëherë nuk e ka ngritur njëriun në lartësi të atillë, sa ai të mos ia ketë nevojën shokut

SENEKA

Xhaferri po rrinte më këmbë përpara dritares që binte nga sheshi kur Fatmiri hyri në dhomë.

— Ç'po shikon andej?

— Hiç... kot...

— Dhe ti kot u bëre merak! — tha Fatmiri, duke u shtrirë mbi krevat ashtu siç ishte, me rroba.

Ai nuk foli, po Fatmiri, tek vështronte kurrizin e tij që kishte zënë gjysmën e dritares, e kuptoi se ai ende ishte i shqetësuar.

Ata papritur heshtën pikërisht atë çast kur kishin aq shumë për të biseduar. Njëri shikonte tavanin e bardhë, tjetri kishte hedhur sytë diku në sheshin e vogël.

Për komandantin e postës kjo ishte një situatë që duhej gjykuar mirë. Fatmiri e dinte se çdo gjë ai tani e mendonte deri në hollësitë më të vogla. Vlerësonte situatën, hetonte rreziqet, bënte plane... Ai ishte komandanti i tij, po ata ishin njëkohësisht dhe shokë dhe Fatmiri nuk mund ta duronte gjatë atë heshtje të rëndë që ishte nderë

në mes tyre. Ai hoqi sytë nga tavani dhe vështroi nga kurrizi i Xhaferrit:

— Hë — tha ai me atë mënyrën e tij të çiltër — si do t'ja bëjmë?

Xhaferri zuri vend buzë krevatit përballë, kurse Fatmiri u ngrit ndenjurr.

— Atë po mendoj — tha Xhaferri duke e parë në sy.

— Besoj se tani e hoqe merakun. Ajo s'është njeri i keq...

— Ashtu është. Duket, halli e ka sjellë te ne, po...

— Çfarë?

— Tani ramë ne në hall...

— Ajo bëri shumë mirë që iku — tha Fatmiri pas një pauze të shkurtër.

Xhaferri e shikoi me dyshim.

— Mirë bëri, kush tha!

— Ti vazhdon akoma të çuditesh me atë që ka ndodhur...

— Çuditëm, se kam dy vjet këtu dhe s'kam parë asnjë femër këndejadi e jo më të trokasë në postën tonë.

Fytyra e komandantit ishte bërë serioze.

— Hiç mos u çudit — u gjallërua papritur Fatmiri. — Është tjetër kohë tani këndeji. Ti e dëgjove ç'tha komisar. Ç'kuptim do të kishte marshimi i revolucionit në këto zona të thella, pa këto akte të guximshme? Ndoshta kjo është vajza e parë që shkel prangat e zakoneve prapanike dhe kërkon të kapërcejë kufijtë e ngushtë të fshatit. E kupton se sa gjë e madhe është: një vajzë e thjeshtë malësore e ndien revolucionin në shpirt dhe ngrihet kundër botës së vjetër.

— Dakord — ia priti Xhaferri — dakord, po s'ma kishite marrë mendja se ajo do të ngjitej deri këtu e do të lypte ndihmën tonë. Ajo tha se kishte vëllanë ushtar...

— S'është vetëm nga kjo, them unë — ndërhyri tjetri me rrëmbim — ushtarë kanë shkuar gjithnjë djemtë e fshatit, po motrat e tyre, sado halle të tilla të kenë pasur, nuk di të kenë trokitur në postat tona. Arsyeja është gjetkë. Janë mendimet e reja që po vijnë në front të gjerë nëpër

këto vise të humbura e po lëvizin njerëzit, po ngrenë më këmbë rininë...

Xhaferri kishte ulur kokën dhe, kur në dhomë ra hesh-tja, s'e ngau më bisedën.

Fatmiri ishte skuqur në fytyrë dhe qerpikët, tek luan-te gishtat e duarve, i lëviznin të shqetësuar.

— Fato — tha i menduar Xhaferri, duke u ngritur më këmbë. — Mua më shqetëson diçka tjetër më e rëndësishme.

— S'ka gjë më e rëndësishme se kjo që thamë — ia bëri Fatmiri me një ton të prerë.

— Ti harron se ne jemi ushtarë — tha Xhaferri tek rrinte pranë dritares.

Ai i nguli sytë kurrizit të shokut.

— E pastaj?

— Pozita jonë është e veçantë...

— Po mos harro se dhe ne jemi pjesë e popullit. Si mund të rrimë ne larg halleve e gëzimeve të tij?..

Xhaferri u kthye në vendin e parë.

— Le t'i lëmë këto — tha duke u munduar të tregoh-
hej i qetë. — Mua më shqetëson diçka serioze. Më vete
mendja te një gjë: Po sikur ta marrë vesh fshati që ajo ka
ardhur në postë?..

Fatmiri ngriti supet. Xhaferri shtoi, duke i mëshuar
zërit:

— Sikur të na vijnë këtu... në postë...

Tjetri qeshi me hundë:

— Ku të shkon mendja dhe ty. Po a e dëgjove si tha?
Për këtë nuk di gjë asnjëri!

Xhaferri iu qas shokut. Vështrimi i tij ishte i për-
qëndruar; ai merrte frymë pak me zor, dhe Fatmiri u bind
edhe një herë se komandanti i tij ishte i shqetësuar se-
riozisht.

— E para — tha Xhaferri — ne jemi zbulues dhe,
sido që të jetë puna, nuk mund të besojmë verbërisht.
E dyta, mos harro se një fëmijë e ka vënë re duke u ngji-
tur për këndeje. Mjafton ky fakt, që të ndodhë gjëja më e

papëlqyer... Prandaj them, që çdo të papriture t'i dalim me kohë përpara.

— Mua më duket se edhe Zarja ka interes të na thotë të vërtetën, sepse, në radhë të parë, e tërë kjo bëhet për të!

— Jo, në radhë të parë — tha Xhaferri — po për të, për interesin e saj.

Kësaj here Fatmiri mezi priti që ai të mbaronte dhe nga padurimi u ngrit ndenjtur:

— Jo, s'jam dakord me ty. Këtu s'kemi të bëjmë me një interes thjesht personal. Në qoftë se ne i dalim në mbrojtje Zares, kemi mbrojtur të drejtat e saj, ato të drejta për të cilat lufton natë e ditë Partia e gjithë populli!

— Fato — tha Xhaferri, duke u munduar ta përmbante kundërshtimin. — Ne jemi ushtarë, jemi në detyrë dhe praktikisht mund të ndodhë kështu. Ta zëmë se fshati mori vesh që Zarja iku nga shtëpia.

— Fshati e ka marrë vesh — u hodh Fatmiri.

— Dakord — tha me duf Xhaferri. — Ti e kupton se ç'do të thotë për një fshat, siç është Dara, i prapambetur e fanatik, të ikë një vajzë. Mirë the ti, kjo është vajza e parë që ikën nga fshati, e para që ngrihet në këtë mënyrë kundër zakoneve të këqija. Ç'do të ndodhë?... Ose ç'po ndodh në fakt, ndërsa ne po bisedojmë? I tërë fshati e ka marrë vesh. Ka filluar shqetësimi i përgjithshëm.

— Pse, doemos do të jenë shqetësuar të gjithë? Rinia me siguri është gëzuar...

— Po dëgjomë njëherë — shtrembëroi fytyrën i pakënaqur Xhaferri — tani për tani nuk më interesojnë ata që janë gëzuar. E kam gjetkë fjalën, te ndonjë rrezik që na kanoset. Ki parasysh nderin e postës, domethënë tani kanë filluar hetimet, diskutimet, dyshimet... Gjithë njerëzit këtë bisedojnë. Pyesin njëri-tjetrin, pyesin barinjët, pyesin fëmijët, dhe kur ja, papritur del ai kalamani që zuri ngoje ajo dhe thotë: «Zaren e kam parë unë duke shkuar për në postë!»

— Po pse thua duke shkuar për në postë? Ajo mund të ketë dalë për të mbledhur karthija ose për të kullotur ndonjë dhi...

— Jo — ia ktheu përnjëherë tjetri — mos harrojmë se Zaren prindërit e kishin mbyllur brenda, dhe fakti që ajo është parë këndeje mund t'i bëjë njerëzit me të drejtë të dyshojnë. Atëherë ç'do të ndodhë? Do të ndodhë që të ngrihet fshati e të vijë këtu e të na thotë ty dhe mua bashkë: «Ju na keni fshehur vajzën. Turp të keni, jeni dhe ushtarë të popullit!» Hajde sqaroi po deshe! Fanatikët kanë bërë të tyren, gojët e këqija kanë llapur poshtë e përpjetë. Armiku i klasës ka gjetur terren për të vjellur. Fjala ka shkuar në repart. Merr vesh komanda. E kupton se s'është kaq e thjeshtë?

Fatmiri nuk u përgjigj. Xhaferri mori frymë thellë dhe nuk vazhdoi më tutje. Flegrat e hundës i dridheshin lehtë, buzët i qenë tharë. Dy shokët nuk shikonin më njëri-tjetrin në sy.

— E thjeshtë nuk është — foli pas pak Fatmiri, duke bashkuar me dorë vetullat e rrudhura — po dhe të alarmohesh kështu s'është mirë.

Xhaferri u prish në fytyrë.

— Unë alarm s'po bëj — mori zjarr ai — po s'ka asgjë të keqe në qoftë se u dalim përpara rreziqeve dhe ti e di që këtu nuk jemi as në shtëpi, as, ta zëmë, në shkollë a në një qendër pune, po në një postë ushtarake.

Komandanti ishte prekur keq. Fatmiri nuk e deshi kurrsesi këtë gjë dhe, sado që u mundua pastaj ta ndërronte tonin, prapë ata nuk bisedonin më qetësinë e parë.

— Ndoshta e kam gabim — foli Fatmiri — po ne këtu s'jemi të ndarë nga jeta. Vërtet detyra që kryejmë na ka veçuar në këtë majë mali, po me mendje dhe me zemër jemi të lidhur me gjithçka që e gëzon dhe e shqetëson popullin. Prandaj, po erdhën, mirë se të na vijnë! Do t'u flasim hapur: Kjo që ndodhi nuk ju nderon. Ju akoma nuk e njihni mirë vijën e Partisë. Te ju bëhen martesë mbi baza të padrejta. Gratë e motrat tuaja nuk janë akoma të lira. Ç'bëni ju?

Komandanti i postës qeshi lehtë e me shpoti. U ngrit më këmbë dhe, duke zgjatur dorën nga shoku, tha:

— Thua ti kështu, por po të ndodhë që ata ta marrin

vesh se ajo gjendet këtu, nuk do të vijnë kaq të qetë. Ta them unë: në fshat do të përhapet fjala në këtë mënyrë: ushtarët atje lart na kanë rrëmbyer vajzën. E di ti, ç'do të thotë për këtë fshat, që gjendet kaq thellë në malësi, ku sapo kanë filluar të thyhen konceptet e vjetra, t'u rrëmbejnë dy ushtarë një vajzë e t'ua mbyllin në postë?! Kjo do të ishte një fyerje për tërë fshatin dhe një rast shumë i favorshëm për fanatikët e për ata që s'na duan... Ata ç'nuk do të thonë, dhe njerëzit të prekur në sedër padashur do të përsërisin fjalët e tyre...

Kësaj here buzëqeshte Fatmiri, po Xhaferri, i rrëmbyer nga mendimet, nuk e vuri re.

— Po pse, ç'jemi ne? Populli na njeh mirë. Posta jonë qysh në fillim i është gjendur fshatit... dhe e ka ndihmuar në çdo rast...

— E mirë, mirë... Ti harron fanatikët. Po kjo mjafton, për të ndodhur ajo që thamë. Hajde pastaj mbushua mendjen njerëzve dhe qetësoi, po qe burrë!

— Ndonjë rrezik mund të ketë — tha i menduar Fatmiri — po ne do të bisedojmë po qe nevoja me të zotët e punës, me shokët tanë e jo me fanatikët...

Xhaferri u largua nga dritarja dhe u ul në krevat.

— Dëgjo — tha ai, me bërrylet mbështetur mbi gjunjë — po erdhi puna deri këtu, çështja do të ndërlikohet keq. Sepse ata do të jenë të nxehur. Ata do të vijnë këtu sipër. Do të na akuzojnë me zë të lartë si vagabondë, hajdutë, do të na bëjnë armiq fare! E kupton?

Tjetri nuk foli, po mënyra se si e vështroi e nxiti Xhaferri në vazhdonte më tutje:

— Do të thonë: e kanë rrëmbyer ushtarët! Dhe kur? Një ditë para dasmës! Atëherë, të revoltuar do të na kërkojnë që t'ua nxjerrim vajzën jashtë medoemos. Ç'do të bëjmë ne në një rast të tillë?

Xhaferri heshti dhe, duke ndenjtur në pritje, shikonte shokun drejt në sy. Fatmiri me qëllim nuk iu përgjigj menjëherë, në mënyrë që t'i kalonte tjetrit ai vrull shqetësues. Pastaj tha:

— Mua më duket se ne po e shikojmë këtë gjë pak

ngushtë. Nuk e marr me mend se si mund të ngrihet fshati e të vijë këtu. S'është aq kollaj sot t'i nxitësh njerëzit, aq më tepër me thashethemet e fanatikëve. Po le ta zemë për një çast se fjalët e fanatikëve do të bëjnë efekt. Kush është ai burrë që do të guxojë t'i nxisë njerëzit kundër postës sonë? Ata e dinë se posta jonë është një objekt ushtarak i rëndësishëm. Të mos harrojmë se në fshat ka pushtet, ka komunistë, ka plot njerëz të ndershëm dhe s'ka si të nxiten kaq kollaj...

Xhaferri në vend që ta vazhdonte bisedën, u shtri në krevat duke lidhur duart prapa kokës dhe ra në mendime. Mendonte për rrezikun që mund të cënonte nderin e postës. Ky ishte një rrezik që s'kishte të bënte me zhurma, me sinjale. Aparatet nuk hynin në punë fare. Përvoja e gjatë që kishte fituar në detyrë nuk i shërbente. Dhe sikur të mos mjaftonin këto, kësaj here nuk po merrrej vesh as me Fatmirin, me të cilin në situata të ndera gjithnjë ishte kuptuar, bile edhe pa fjalë.

Komandanti i postës kishte rënë vërtet në një hall të madh.

— Unë kështu mendoj — tha Xhaferri. — Bëmë mirë që e strehuam vajzën, po duhet të shqetësohemi seriozisht për pasojat që mund të na ndodhin.

— Ngrehu shih atëherë se mos po vijnë — e ngacmoi Fatmiri.

Xhaferri ngrii pak trupin dhe padashur pyeti:

— Kush?

— Ata të fshatit, kush tjetër!

— S'është për t'u tallur, Fato! — tha duke hetuar fytyrën e shokut dhe u çua.

— Po as për të menduar në panik gjithë këto gjëra! — ia ktheu Fatmiri me një farë shkujdesjeje që Xhaferrit nuk i erdhi mirë. Aq më tepër sepse pas kësaj Fatmiri u shtri, duke thyer jastëkun më dysh.

Ata heshtën një çast. Fatmiri, bile, mbylli sytë, sikur s'po ndodhte asgjë.

— Fato!

— Ë! Ç'ke? — tha ai me qepallat ulur.

- Mos të zuri gjumi?
- Jo, nuk kam gjumë!
- Thashë, se t'u bënë kaq orë pa fjetur.
- E ku më zë gjumi sot!
- Komandantit i pëlqeu kjo përgjigje: Fatmiri s'ishte aq indiferent sa dukej!
- Biseda me kaq sikur mbeti. Në mes të dy shokëve u ndeh një pauzë e gjatë.
- Si thua, ç'do të bëjmë? — tha Xhaferri me një padurim jo të zakonshëm për të.
- Ti je komandant — tha Fatmiri, me sytë të hapur përgjysmë. — Unë i bindem urdhrit tënd!
- Lëri këto, mos u tall — ia pat tjetri me keqardhje.
- Kur të kam komanduar ndonjëherë, që të të komandoj tani! Çohu të bisedojmë!
- Fatmiri hapi sytë dhe u kthye në brinjë, me fytyrë nga ai.
- Unë them të flasim me komisararin — tha Xhaferri.
- Ç't'i themi komisararit që tani?
- Të njoftosh komandën në kohë, s'është kurrë keq — tha Xhaferri me një ton të vendosur. — Bile, them të nisem vetë.
- Pse të shkosh ti, shkoj unë — u hodh Fatmiri, duke u çuar buzë shtratit. — Megjithëse them hëpërhë nuk është nevoja të vemë gjer atje, kur mund të merremi vesh dhe ndryshe.
- Jo, jo, Fato — tha i merakosur Xhaferri — të shkojë njëri nga ne dhe të bisedojë shtruar me komisararin. Ta them unë që dhe ai nuk do ta ketë kollaj të përgjigjet. Këtë nuk e përfshin as rregullorja dhe as di që të ketë ndonjë orientim konkret...
- Kujton ti — tha me të qeshur Fatmiri — po ushtria s'mund të rrijë e mënjanuar nga gjithë ato që po ndodhin përçark saj. E thamë këtë gjë kaq herë.
- Xhaferri dëgjonte me ballin të rrudhur, ndërsa fytyra e tjetrit ishte e qetë.
- Ngrehu — tha pastaj Xhaferri i ngurur — nisu sa pa u bërë vonë!

— Domethënë, të nisem thua... — tha Fatmiri në mëdyshje, duke u munduar ta shihte Xhaferrin në sy. Po ky me qëllim nuk ia tregonte sytë.

— Po, po, veç dëgjomë se ç'do t'i thuash...

— Nuk ka nevojë fare — ia ktheu Fatmiri. — Ne sot biseduam kaq shumë, sa s'kemi biseduar kurrë bashkë.

— Jo, jo, ka nevojë!

Komandantit nuk i erdhi mirë, kur pa që Fatmiri u ngrit më këmbë. Iu duk sikur ai s'deshi ta kuptonte seriozitetin e çështjes.

— Ka nevojë, se janë gjëra me zarar — u përpoq të arsyetonte Xhaferrin. — Do t'i thuash se erdhi vetë. Ne, i thuaj, as nuk e njihnim fare. Pastaj i thuaj se e kemi vendosur në dhomën numër dy. Po të pyesë se ç'ka thënë ajo, tregoja të gjitha me hollësi. Mos harro t'i përmendësh të vëllanë që ka ushtar...

Fatmiri zuri të përgatitej për udhë. Hoqi rrobat e vjetra dhe mori pantallonat e uniformës së liridaljes. Xhaferrin ishte ngritur më këmbë dhe bariste nëpër dhomë i menduar.

— Në rast se të pyet për mendimin tonë — vazhdoi ai — ia thuaj pa frikë. Ne jemi për ta ndihmuar, po megjithatë ne, thuaji, jemi ushtarë, prandaj urdhri i komandës dhe fjala e saj janë ligj.

Fatmiri, i veshur, mori pastaj të lustronte këpucët. Xhaferrin vështronte nga dritarja. Dëgjohej fëshfërima e furçës.

— Po sikur të thotë komisari: ç'keni bërë kështu? — tha Fatmiri, duke ndaluar lëvizjet e dorës.

Xhaferrin u kthye me fytyrë nga ai. Vështrimet e tyre u kryqëzuan.

— Sikur të thotë... — përsëriti si me vete.

— Të thotë: — plotësoi mendimin tjetri — ç'merreni me këto gjëra... Ta zëmë se do të jetë atje dhe komandanti. Të thotë: ju e dini se ç'detyrë delikate kenë...

Pas këtyre fjalëve, ai vazhdoi të lustronte këpucët, ndërsa Xhaferrin i vajti pranë dhe i tha:

— Thuaji, shoku komisar...

— Hë, ç't'i them?

Xhaferri u ngatërrua dhe mbeti një çast:

— ... thuaji... se ne e bëmë këtë... e bëmë, duke u nisur nga qëllimi... qëllimi i mirë, sigurisht... ose thuaji: hajdeni vetë, takojeni dhe bisedoni...

Ushtari, i veshur me uniformë, iu afrua pasqyrës të varur në mur.

— Po sikur të vijë e ta gjejë fshatin mbledhur para postës?

Ai qëndroi prapa tij dhe kur Fatmiri, duke lëvizur kokën, zbuloi një cep të pasqyrës, pa fytyrën e ngazëllyer të shokut. Dhe në vend që të përgjigjej, u kthye me fytyrë nga dritarja.

— Hë, ç'të bëjmë, atëherë? — pyeti Fatmiri duke rregulluar flokët e shkurtër para pasqyrës. — Dëgjon ti?

— Jo, nuk dëgjoj — tha me një ton të nervozuar Xhaferri.

Fatmiri u mundua të merrte një pamje serioze; rregulloi bustinën në kokë dhe, duke bërë një hap nga ai, iu paraqit ushtarakisht:

— Shoku komandant i postës, më lejoni të nisem për të kryer detyrën e ngarkuar?

Xhaferri nuk lëvizi, bile as e ktheu kokën, ndonëse Fatmiri qëndronte pas tij gatitu, me trupin drejt dhe dorën nderur në cep të ballit. Mbetën kështu për disa çaste. Në mes tyre vetëtinte një tufë rrezesh që hynin nga dritarja anësore. Ishte një atmosferë gazi të fshehur e zemërimi të lehtë njëherazi. Asnjëri nuk donte ta jepte veten i pari... Dhe ndoshta kjo gjendje do të zgjaste akoma, po të mos kishte tingëlluar zilha e telefonit në korridor.

I pari, si gjithnjë, u sul te aparati Fatmiri. Xhaferri ndenji në mes derës së hapur.

— Urdhëroni, shoku komisar, Shqiponja ju dëgjon!

Përçark ishte qetësi dhe zëri i komisarit, që vinte së largu, ndihej qartë.

— Gjatë natës së kaluar, shoku komisar, siç kemi njoftuar, nuk pati asgjë të rëndësishme.

Fatmiri dëgjonte duke lëvizur këmbët në çimento dhe

herë pas here hidhte shikimin nga Xhaferri. Ai vazhdonte të qëndronte në të njëjtin vend në mes derës.

— Po, po — tha ai në telefon duke shtrënguar dorezën — i morëm materialet dhe kemi filluar nga studimi... Na mjaftojnë...

Përsëri jehoi zëri i largët. Prapë ushtari dha sqarime.

— Jo, nuk do të niset Xhaferri. Do të vij unë. Kështu është puna. Ja, merreni vetë. Do t'jua tregojë ai si qëndron çështja.

Komandanti i postës kapi dorezën e aparatit dhe, duke i mëshuar zërit për të fshehur tronditjen, thirri:

— Urdhëroni, shoku komisar!

Në fillim Xhaferri nuk i vinin fjalët nga që nuk dinte nga t'ia niste. Po më pastaj, kur ndjeu që komisari nuk shqetësohej nga pauzat e tij, përkundrazi priste me gjakftohtësi e durim, Xhaferri mori zemër. Filloi t'ia tregonte ngjarjen me hollësi, i tha se ç'ishte ajo vajzë, rrethanat që e kishin shtyrë të vinte në postë dhe mendimin e tyre. Pastaj i tha se për këtë qëllim do të nisej për në repart Fatmiri.

Pas gjithë këtyre sqarimeve, Xhaferri heshti, vetëm dëgjonte, duke përsëritur me ton të prerë përgjigjen ushtarakë: «Si urdhëron!» Dalngadalë ai u çlirua nga ajo ngathësi që e kishte mbërthyer para se të merrte telefonin në dorë. Fytyra erdhi e iu çel dhe sytë i morën një shkëlqim të qetë.

— Si urdhëron, shoku komisar! — kumboi fortë zëri i Xhaferrit para se të ulte dorezën. — Si urdhëron, ashtu do të veprojmë!

Komandanti i postës mbylli telefonin dhe fshiu ballin, sikur të kishte shkarkuar nga vetja ndonjë barrë të rëndë. Fatmiri e shikonte me sy të qeshur. Tjetri ngrii kokën dhe s'u druajt të buzëqeshte.

— Zhvishu — ia bëri ai me një zë të ngrohtë. — S'është nevoja të nisesh.

— Këtë e mora vesh — ia priti Fatmiri, që kishte zënë gjithë derën. — Tjetër ç'tha?

— Do të na njoftojë më vonë se ç'duhet të bëjmë.

— Edhe këtë e mora vesh — shtoi ai duke u larguar nga dera që të hynte Xhaferri. — Tjetër?

— Tjetër? Tha që s'ka asgjë të keqe në këtë mes. Keni vepruar drejt, po prapë kini kujdes...

— Për çfarë?

— Ti e dëgjove ç'biseduam! — tha Xhaferri, duke e parë shokun sërish me dyshim.

— Ec brenda, se mos e zgjojmë atë... — tha me zë të ulët Fatmiri, duke tërhequr pas derën e dhomës.

Xhaferri kafshoi lehtë buzën dhe vetëm atë çast u kujtua se kishte thirrur në telefon, duke harruar se biseda e tij me komisarin që dëgjuar në dhomën përballë.

I G J A S H T I

Kurrë nuk është e gjatë rruga që të shpie drejt së vërtetës.

FJALË E URTË

— Po vete njëherë lart — tha Xhaferri.

— Mirë, shko — ia ktheu Fatmiri, që po zhvishte uniformën.

Ai kaloi me hap të lehtë nëpër korridor dhe ngjiti shkallët e kullës.

Mbi kullë qe derdhur dielli. Një puhi e hollë fëshfërinte nëpër gjethet e drurëve. Komandanti i postës rrudhi sytë dhe vështoi rrugën e bardhë që dredhonte ta-tëpjetë. Ajo ishte e shkretë. Më poshtë vinte fshati, i shpërndarë nëpër luginë. Njerëzit, si çdo ditë, kishin dalë në punë. Brigadat prashisnin nëpër ara e nga larg shquanin rrobat plot ngjyra të grave. Tek-tuk dukej ndonjë që lëvizte nëpër rrugët e fshatit. Përtej, në oborrin e shkollës ishin grumbulluar fëmijët.

Xhaferri mori frymë thellë. Fshati atje poshtë bënte jetën e tij të zakonshme. Kulla zotëronte gjithë vendin përçark.

Kur zbriti poshtë, ai nuk dinte ç'ti thoshte Fatmiri, që po pregatiste drekën në dhomën e vogël, që ata e quanin kuzhinë.

— E? — pyeti Fatmiri, duke trazuar me lugë miellin e skuqur në tigan.

— S'pashë ndonjë gjë për t'u shqetësuar — tha Xhaferri: Atij i picërruan sytë nga tymi i stufës së vogël dhe u ndal te pragu i derës.

— S'e di — foli prapë i pari — në do ta kënaqim mysafiren. Mielli kësaj radhe nuk është kaq i mirë për hallvë...

— Të kishte mundësi që edhe ai fëmija ta harronte që e ka parë Zaren...

— Bjermë pak sheqerin — urdhëroi Fatmiri, duke lëvizur me vrull lugën në tigan. — E ke poshtë në dollap.

Xhaferri mori sheqerin nga dollapi e u afrua te stufa. Tjetri hoqi tiganin.

— Ma jep mua — tha Fatmiri. — Ulu ti, se e bëj vetë.

Në një rast tjetër, Xhaferri do të kërkonte ta gatuanin së bashku, po atë ditë e kishte mendjen të prishur. Ai u ul në stolin afër tryezës dhe vështronte i përhumbur Fatmirin tek gatuate.

— Dëgjo këtu — tha Fatmiri, duke vënë prapë tiganin në zjarr. — Njëherë, një shok që ka shërbyer në marinë më tregoi diçka të çuditshme. Në flotat ushtarake dikur, mundet dhe tani në vëndet borgjeze, ishte ndaluar rreptësisht të hynte femra në anije. Sipas rregullit, anijen që e kishte shkelur këmba e femrës s'e quanin më anije luftarake dhe pasi e bënë me thimjanë, për të larguar shpirtrat e këqija e kthenin në anije transporti. Me një fjalë, shndërrohej në anije hamalle, siç i thonë me qesëndi marinarët ushtarakë.

Xhaferri shikonte ngultas, ndërsa buza e poshtme i qe lëshuar.

— E ç'do të thuash ti me këtë?

— Dua të them — u kthye me fytyrë Fatmiri — që kanë ndryshuar kohërat dhe ti mos u shqetëso kaq shumë. Punë e madhe dhe po erdhën, fundi ç'do të ndodhë? Nuk dëgjon ç'po bëhet për gruan?

— Fato — kumboi zëri i Xhaferrit me një notë qor-

timi — ty gjithmonë të pëlqen të filozofosh e të ëndërrorsh dhe nuk e ke keq. Po unë, nuk e di, e ndiej thellë përgjegjësinë. Tani për tani duhet menduar si të dalim faqebardhë nga kjo situatë ku kemi hyrë.

Fatmiri hodhi ujë në tigan dhe, duke e trazuar ngadalë, tha:

— S'kemi pse të shqetësohemi kaq shumë. Ti e dëgjove se ç'tha komisari? Kjo që po bëjmë, nuk është jashtë detyrave tona...

— Prit njëherë se kush po thërret — e ndërpreu Xhaferri, dhe u ngrit më këmbë. Fatmiri vuri re sytë e tij të habitur.

Pas një heshtjeje të shkurtër, zëri nga jashtë u dëgjua i qartë në kuzhinë:

— Djema, o djema!

Ushtarët u panë në sy.

— Kush të jetë ky? — ia bëri Xhaferri fytyrëngrysur. Fatmiri hoqi tiganin nga zjarri. Në dhomë ra qetësi.

— Po dal unë — tha Fatmiri.

— Jo, rri ti — ia priti komandanti i postës, që mendonte se kishte ardhur çasti kritik.

Fatmiri vuri përsëri tiganin në zjarr.

— Po ti lëre njëherë atë të shkretët tigan — u nxeh Xhaferri, kur tiganin zuri të bënte zhurmë.

Fatmiri e hoqi dhe atë çast u dëgjua sërish zëri nga jashtë:

«O Xhaferri!»

— Xha Fadili është — tha i qetë Fatmiri. — Mos e prish gjakun!

Balli i Xhaferrit ishte mbuluar me bula të vogla djerse. Ai kaloi kurrizin e dorës mbi ballë dhe mori frymë lirisht:

— Dreqi ta hajë! Më mirë të qe situatë luftarake se sa kjo gjendje kështu...

— Luftë është dhe kjo — dëgjoi nga pas ai, kur mori të dilte në korridor. Fatmiri e vuri sërish tiganin në zjarr.

Xhaferri hapi derën e postës dhe pa sheshin që zbardhonte nga tufa e deleve. Bariu me bërrucin krahëve ki-

shte hyrë në mes tyre dhe po e ndillte tufën për nga pylli i vogël që zbriste tatëpjetë.

— Xha Fadil! — thirri ushtari nga pragu i derës.

Bariu ktheu kokën dhe vuri dorën strehë mbi ballë. Pastaj, qetë-qetë, ndolli bagëtinë me gjuhën e tij.

Xhaferri u ul në stolin e gjatë, të ngulur në krahun e djathtë të derës. Bariu u afrua duke goditur tokën me kërrabë. Sytë i qeshnin përmes vetullave të zbardhura. Ushtari u ngrit më këmbë, duke zgjatur dorën nga i ardhuri.

— Thashë se mos flinit, kushedi — tha plaku, tek zuri vend në krah të Xhaferrit, — se ju jeni si lakuriqët. Natën rrini syhapur, ditën bëni gjumë. Po si shkoni këndej?

— Mirë, falemnderit... Si në detyrë...

Bariu mbështeti mjekrën në kokën e kërrabës, po atë çast dy dele varën këmbët te dritarja e krahut tjetër të postës dhe ai u ngrit.

Xhaferrit i rrahu zemra.

— Mos andej, mos, moj të uruara — ia bëri plaku duke i ndjekur delet.

— S'ka gjë, xha Fadil, s'ka gjë, po hajde, ulu!

Ai u kthye ku ishte dhe, si u qetësua, nxori kutinë e duhanit. Ja zgjati ushtarit, po ushtari buzagaz vuri dorën në gjoks.

— E di që ju ngatërroj — tha plaku, tek hapi kutinë prej alumini — ti e pi, apo Fatmiri?

— Fatmiri e pinte, po dhe ai e la se e mbyti kolla.

Plaku nxori majën e gjuhës dhe lagu letrën e cigares.

— Ti, kur s'e mësove këtu, s'ke për të pirë kurrël

Xhaferri shikonte xha Fadilin që shkrepse masátin. E kishte parë kushedi sa herë fytyrën e tij, me ato faqe të flashkëta e mjekrën pak të kërcyer, me mustaqet e rralla që i binin në dy cepat e buzëve, po tek e sodiste kësaj here dhe mendonte se kush ishte fshehur brenda, i shembëllente disi ndryshe.

Bariu i kooperativës kalonte herë pas here nga ato anë dhe ishte miqësuar me ushtarët e postës.

— Si ka ardhur puna, more Xhaferr — tha plaku duke thithur shpesh cigaren e trashë që mezi po ndizej. — Të jesh ushtar e të mos pish duhan! Dhe ku, në majë të malit, ku rrojnë çakajtë! Kur isha unë ushtar në kohën time, gjithë paratë duhan i bëja. Ishte mërzia e madhe atëherë ushtria. Vetëm duhani të bënte pak derman...

Xha Fadili ishte njeri i muhabetit, po komandanti i postës kësaj here nuk e kishte të lehtë ta dëgjonte me vëmendje.

— Dëgjo të të them një mesele të lashtë — filloi ai me atë maturinë e tij pleqërishte. — Se kështu lidhen këto gjëra: ju shoh ju kapedanë dhe më vijnë ndër mend ca histori të vjetra.

Xhaferrri tundi kokën në shenjë miratimi, sado që mendjen e kishte gjetkë.

— Plaku im — vazhdoi xha Fadili — e ka pasë bërë ushtrinë në Jemen. E di ku bie Jemeni? Tutje, më larg se Anadoli.

— E di, e di — tha ushtari. — Tani Jemeni është bërë Republikë, po populli, shkruan gazeta, akoma lufton kundër feudalëve që duan të sjellin mbretin.

— Ashtu, ë?! — u çudit bariu. — Thuaju të vijnë te ne, të mësojnë si zhduket fara e atyre dreqërve. Se kjo punë do zanat, ore! Kushedi se ç'yrnek kanë marrë ata. Se ka yrneke plot sot! Duket flori, po është safi bakër. Thuaji atij komisarit tënd që t'ia shtjerë në vesh qeverisë...

Ushtari vuri buzën në gaz, po plaku ndenji serioz.

— Mirë, xha Fadil, do t'ia them, po historinë e Luftës sonë e di gjithë bota. Po të duan, le ta mësojnë...

Plaku thithi disa herë cigaren që po i shuhej.

— Si të duash... po dëgjo se nuk e kam mbaruar atë meselenë e vjetër...

Ai e ndërpreu përsëri tregimin, sepse atë kohë u hap dera dhe ai i zgjati dorën Fatmirit, që doli me mëngë përveshur dhe me përparësë të bardhë.

— Paska gatuar, ë?

— Ç'të bëj, xha Fadil, do të hajë Xhaferrri!

— Pse, ti pa ngrënë rri? — ia ktheu plaku.

— Kuzhinieri ha pasi ngopen të tjerët!
Plaku qeshi, qeshën dhe ushtarët.

— Po tregoja për babanë tim, që bëri ushtrinë në Jemen — filloi rishtaz xha Fadili, duke shikuar nga Fatmiri që rrinte në këmbë. — Tani, mbase, duket afër Jemeni, po atëherë ngjante prapa diellit. Kur të nisej djali për andej, zëre se të kishte shkuar dëm. Sa rrinte, thua ti? Dhjetë, pesëmbëdhjetë vjet. Ishte lastar i njomë e, po qe se mbetej gjallë, vinte plak i fishkur, kokall, ore! Hajde pastaj të mos pije duhan. Hashash të pije e s'ta mbyste dot të keqen e shpirtit e të trupit. E që të mos e zgjas fjalën, më tregonte njëherë plaku: kishin mbaruar asqerllëkun dhe vinin për në shtëpi me një maunë. Ishin kushedi se sa shpirt, të gjithë shqiptarë që qenë dergjur me vite në dhé të huaj. Rruga nuk kishte të sosur nëpër një det të keq që ç'të të them. Vdiqën kaq herë e kaq herë u ngjallën. Kujtuan se do t'i linin koskat në fund të ujit, po s'qe e thënë, shyqyr. U vajti dëm vetëm një shok. Nuk e di nga ç'fshat ishte, po shqiptar qe. E kishte vrarë keq dheu i huaj dhe nuk e duroi dot rrugën nëpër dete. E shkundi dallga derisa ia mori shpirtin fare. Komandanti turk dha urdhër që ta hidhnin në fund të ujit. Tanët bënë sikur e dëgjuan, po shokun s'e lanë rrugës. E morën të vdekurin dhe e mbështollën fshehurazi me rrobat e tyre. Kush dha këmishën, kush pallton, kush kapotën dhe e bënë shokun deng, deng, ore, të më besoni. I thonë vëlla, s'hidhet vëllai në fund të ujit! E morën dengun dhe, që të mos e kuptonin turqit, e bënë si ndenjësë, ja si ky stoli ku jemi ulur ne. Ç'nuk ka pjellë mendja e shqiptarit nga e keqja! Shyqyr që qëlloi dimër dhe i vdekuri kishte duruar. Me të arritur në dheun tonë, ia kishin çuar nënës së shkretëtë... Këtë mesele ma ka treguar plaku me gojën e tij dhe unë po jua them juve...

Cigarja ishte shuar në mes të gishtave të xha Fadilit. Ai nxori përsëri eshkën dhe masátin.

— Sot këto ngjarje duken të pabesueshme — tha Fatmiri — po janë të vërteta.

— Kanë ndryshuar shumë kohërat — shtoi i munduar Xhaferri.

— Oj, s'kanë ndryshuar! — ia priti plaku duke u munduar të ndizte me eshkë kokën e nxirë të cigares. Po ai s'e kishte hedhur akoma eshkën, kur Fatmiri tha:

— Po me gratë si i keni punët, xha Fadil?

Plaku ngriti vetullën e djathtë dhe vështroi me dyshim nga ushtari:

— Me gratë?

Xhaferri qëndronte i heshtur në mes dy burrave e sakaq mendonte: «Ç'muhabet hap dhe ky Fatmiri!»

— E, me gratë? Ç'po bëhet në fshatin tuaj për të drejtat e grave?

Xha Fadili hodhi eshkën nën këmbë:

— Më zure ngushtë tani!

— Po pse, o xha Fadil? — vazhdoi gjithnjë Fatmiri i cili, duke qëndruar më këmbë, nuk ia ndante për asnjë çast sytë plakut.

— Se nuk i kemi punët aq mirë — tha bariu, duke qeruar zërin e zvargur dhe pastaj shtoi. — Pse, e morët vesh dhe ju këndej?

— Jo — u hodh Xhaferri.

— Pse, ç'ka ngjarë? — e ngacmoi tjetri.

Nga mënyra se si fliste plaku, djemtë vunë re se diçka e pengonte.

— Iku shejtania, iku — foli me të psherëtirë. — Janë bërë prindërit një grusht.

— Cila kështu? — pyeti Fatmiri.

— E bija e Safet Dules, Zarja. Nesër do të mar-tohej...

— E ku të ketë shkuar vallë? — e ngacmoi qetë ai që rrinte më këmbë. Xhaferrit befasi i kaloi një e rrëqethur në shtat.

— Nuk e di, po ka ikur që mbrëmë — tha plaku dhe, për t'i shpëtuar vështrimit ngulmues të ushtarit, ktheu kokën nga Xhaferri.

— Ashtu! — u habit padashur komandanti i postës. Megjithëse xha Fadili mudohej të mos e jepte ve-

ten, prapë ndihej hutimi i tij. Fatmiri e ndjeu këtë dhe s'e la të kalonte këtë rast.

— Kjo është e qartë! — tha duke u hequr i shkujdesur. — Kushedi se ç'burrë do t'i kenë dhënë prindërit. Besoj, as e kanë pyetur fare. Po të jetë kështu, kështu duhet të jetë, mirë ua ka bërë, për nder!

— Pse, si thua ti, mor bir, ka prind që t'i dojë të keqen fëmijës?

— Ta them unë, xha Fadil, që nuk i kanë dhënë burrë për të genë — ia pat me rrëmbim Fatmiri, sado që ishte në krah të Xhaferrit dhe ky i fundit i ra për herë të dytë me bërryl.

— Vajza kishte shumë vite fejuar — u mundua të shpjegonte plaku shtruar. — Ajo ta thoshte, xhamën, që përpara. Ata s'do ta martonin me zor. Kush të marton me zor sot! Po vajti e gjeti një ditë para dasmës.

— Vajza do të ketë pasur ndonjë shkak të fortë — foli Xhaferri, si të fliste për një gjë të zakonshme.

— Babai do të ketë menduar vetëm për interesin e tij — tha Fatmiri. — Në këtë mes do të ketë luajtur leku, kurse për jetën e vajzës nuk i është bërë vonë fare.

Plaku kishte kthyer kokën nga ushtari dhe, kur mbaroi ai, tha:

— Ore Fatmir, po kështu e kanë këto, ore!

— Kështu e kanë?!

— E!

— Po si, të shitet vajza për qejf të babait? E drejtë është kjo!? Ti, që gjykon aq mirë për shumë gjëra, sot po mendon shtrembër, xha Fadil!

Plaku nxori përsëri kutinë e duhanit. Xhaferri ngri-ti kokën dhe i shkeli syrin Fatmiri në shenjë qortimi. Po Fatmiri, si të mos e kishte parë gjestin e tij, vazhdoi i prekur seriozisht.

— Po t'ua kishit vënë veshin mirë fjalëve të Partisë, ju s'do ta kishit lënë të ndodhte kjo gjë. Po i keni harruar porositë e saj. Dhe vajza ka bërë shumë mirë që ka ikur.

— Po fshati ç'thotë tani për vajzën? — ndërhyri Xhaferri.

Xha Fadili nuk u përgjigj menjëherë. Bile as cigaren nuk e ndezi, megjithëse eshka i digjej në mes të gishtave. Sytë i mbante ulur.

— Ç'nuk thonë — tha i trubulluar plaku. — Disa duan e thonë se ka shkuar te Ramazani të ankohet... Po ta dinte ai, do të mblidhte fshatin e do ta bindte. Ai s'di gjë fare...

— Kush është ky Ramazani? — e ndërpreu Xhaferri.

— Është sekretari i partisë së kooperativës.

— Po Ramazani s'rri në fshat? — pyeti Fatmiri.

— Jo, rri në Dyresh, matanë malit — sqaroi plaku dhe pastaj shtoi: — Po s'ma merr mendja të ketë shkuar tek ai, se do të ishte marrë vesh. Disa thonë se ka ikur me një shofer të gjeologjikes. Njëri tha se e kishte parë duke ngjitur Malin e Stojanit. Nuk merret vesh puna. Akoma trubull është.

— S'është për t'u bërë aq merak — tha Xhaferri. — Sot nuk humbet njeriu. Njerëz të mirë ka kudo. Do të merret vesh shpejt ku ka shkuar.

Fatmiri plotësoi:

— Puna është që prindërit të pranojnë gabimin, e të vënë mend edhe të tjerët!

Fytyra e plakut ishte mbushur me rrudha të thella, buzët i rrinin shtrënguar dhe mjekra e ngritur sa nuk i takohej me hundën...

— Po s'është kaq kollaj, mor bir. Ka një kokë ai babai i vajzës... — u dëgjua zëri i tij i përçarë. — Pastaj nuk na ka bërë vaki ndonjëherë në fshat të na ikë vajza. Andej nga fusha po, po këndeje sipër, meazallah!

Ushtarët s'folën. Plaku hodhi cigaren e përgjysmuar dhe heshti. Kërraba i kishte rënë përtokë. Në shesh ishte qetësi. Këmborët e bagëtive dëgjoreshin larg.

— Ti vetë the, o xha Fadil — theu heshtjen Xhaferri, duke u rënë krahëve të plakut — kanë ndryshuar kohërat.

— Koha s'ka ndryshuar vetëm për burrat, po dhe për gratë — u hodh Fatmiri, që kishte dalë përballë plakut.

Bariu ngriti kokën dhe për herë të parë e vështroi ushtarin drejt e në sy.

— Punët e burrave i marr vesh, mor bir — tha, duke u bërë gati të ngrihej — po këto të grave, le të më vrasë gjynahu, po i kuptoj një çikë më ngadalë...

— Do t'i kuptosh, do t'i kuptosh — tha Xhaferri. — Hajde këndeje të bisedojmë!

— Hë, ç'jeni rehat ju nga këto gjëra...

Fatmiri u mat të fliste, po Xhaferri, që ishte ngritur më këmbë, i shtrëngoi krahun dhe nuk e la.

— Kur s'jeni ju rehat — nxitoi të përgjigjej komandanti i postës — as ne s'e ndiejmë veten mirë këtu. Është luftë që na takon të gjithëve!

Plaku u dha dorën ushtarëve, po sytë i fshihte prapa vetullave të rëna.

— Më lidhët sot, djema! Thuaj ik sa pa lëshuar ndonjë të papjekur tjetër. Mirë ju gjeça!

— Mirë ardhsh!

Ushtarët buzëqeshnin të lehtësuar, ndërsa plaku largohej duke kërkuar me sy bagëtinë e shpërndarë tatë-pjetë malit.

— Më vjen keq — tha Xhaferri me gjysmë zëri — që e përcollëm pa i thënë të vërtetën.

— Po të jetë për mua — qeshi Fatmiri — thirre dhe për drekë e të gëzojmë të gjithë bashkë!

Tjetri rrudhi vetullat dhe kapërceu i pari pragun e derës.

I S H T A T I

Të mendosh se armiku i dobët nuk dëmton, është njëlloj si të mendosh se nga shkëndijz nuk lind flaka.

SAADI

Në korridor Xhaferri për pak desh u përplas me Zaren. Ai nuk e vuri re vajzën tek rrinte në gjysmerrësirë, me duart mbledhur në gjoks dhe sytë të çapëlyer. Vetëm kur hyri Fatmiri dhe në korridor u derdh drita e diellit, ai shquajti fytyrën e saj të trembur dhe dëgjoji të thosh me një zë të pasigurt:

— Çfarë tha dajë Fadili?

Ushtarët qëndruan para vajzës.

— Erdhi të të kërkonte ty — tha Fatmiri — po ne i thamë: na e lë ta bëjmë ushtare...

Ajo buzëqeshi me zor. Xhaferri mbylli derën dhe në korridor u bë errësirë.

— Hajde hyjmë këtu — tha ai, duke u drejtuar për në fjetore.

— Jo, shkojmë në kuzhinë — ia priti Fatmiri — se mos më digjet gjella.

Vajza rrinte e mbërthyer në vend dhe, kur Xhaferri ia bëri me dorë që të futej në kuzhinë, ajo u step një çast dhe pastaj hyri në dhomën e panjohur.

— Ulu — tha Fatmiri, duke i vënë përpara mysafires një stol, ndërsa vetë iu afrua sobës dhe ngriti kapakun e tenxheres.

Në kuzhinë bënte pak nxehtë. Ajri kundërmonte erë gjellë. Nga dritarja që binte prapa dukej pylli i vogël që ngrihej fill pas postës. Zarja kundronte muret e bardha, sobën e vogël, tryezën që kishte përpara, e cila sapo ishte larë dhe vinte erë sapuni. Xhaferri rrinte ulur përballë saj. Fatmiri, si gjithnjë, qëndronte më këmbë pranë dritares.

Papritur ra heshtja, po kjo nuk zgjati sepse Xhaferri, që rrinte me vështrim nga dritarja, pyeti:

— Ku e njeh xha Fadilin ti?

— Fadili është daja im — foli vajza si me turp, duke shikuar ushtarët që poshtë qepallave.

— Ashtu!?

— Si, moj, daja yt qenka xha Fadili?! — thirri Fatmiri i habitur.

— Po — murmuriti Zarja.

— Ne e kemi mik xha Fadilin — shpjegoi Xhaferri duke u kthyer nga vajza. — Është burrë i mirë.

— Na vjen gjithnjë këtu — shtoi tjetri, të cilit ende i vinte çudi nga ajo që dëgjo.

Zarja sikur e ndiente veten më pak të druajtur tani, kur në mes saj dhe atyre hyri xha Fadili. Për herë të parë i lindi dëshira të fliste, të tregonte dhe për gjëra të tjera e të mos u përgjigjej vetëm pyetjeve që ata i bënin kohë pas kohe.

— Daja s'ju heq nga goja ju — tha vajza me një zë që tingëlloi aq intim, sa të dy ushtarët ngritën sytë nga ajo.

Ajo heshti një hop. Xhaferri vështroi nga dritarja. Tjetri s'e largonte shikimin nga mysafirja.

— Unë e dëgjova kur erdhi — tha ajo si një fëmijë që kërkon të tregojë për herë të parë një ngjarje përpara të rriturve. — Daja flet me zë të lartë... Unë e dëgjova dhe u ngrita...

— Po sikur të hapej dera? — qeshi Fatmiri.

— Unë s'rrija prapa derës — tha ajo dhe sytë pa-

pritur i morën një hije të lehtë. — Nuk më rrihej në dhomë. Hyja e dilja në korridor.

— Kujtoje se mos do të të dorëzonim? — qeshi së-
rish Fatmiri, duke vështruar nga vajza, që e preu tre-
gimin në mes.

— Ajo pak rëndësi ka — tha Xhaferri, duke e shkë-
putur vështrimin e përqëndruar nga dritarja. — Unë
mendoj tjetër gjë: pse të mos bisedonim njëherë me xha
Fadilin?

— Si të fjaloseni!? — u habit Zarja dhe shtoi pre-
razi: — Jo, nuk dua ta dijë njeri që kam ardhur këtu...

— Pse, — u hodh Fatmiri dhe afroi një stol nga
vetja — ç'do të thoshte fshati po ta merrte vesh?

Zarja u nemit menjëherë. Xhaferri pa vëngër sho-
kun.

— Ë? — ia bëri Fatmiri.

— Nuk e di — ngriti supet ajo.

Fytyra serioze e ushtarit e trubulloi papritur vaj-
zën.

— Ka djem ushtarë fshati juaj? — vazhdoi të pyeste
po ai.

— Ka, si nuk ka! — tha Zarja shpejt e shpejt. Ajo e
kuptoi se me kaq keqkuptimi u largua, kur ai ia pat me
një zë të vendosur:

— Dhe ne si ata jemi!

— Pse, nuk e di unë? — u qa ajo —... unë prandaj
kam ardhur këtu...

Xhaferri nuk e kuptoi se si hyri ashtu biseda në
një rrugë pa krye. Dhe deshi të ndërhynte e, tek shikoi
qortueshëm nga Fatmiri, dëgjoi zërin e saj:

— Në brigadën tonë të gjithë ju lavdërojnë ju të
postës. Kur doli përroi vjet dhe ju shpëtuat djalin e
Abeditit, s'ngeli njeri pa thënë fjalë të mira. Dhe shoku
Lame, kryetari, s'ju heq nga goja...

Ajo fliste kokulur. Xhaferri e ndjeu brengën e vaj-
zës, që e lëndoi padashur shoku i tij dhe tha:

— Po mbrëmë ku fjete?

Kjo ishte një pyetje e befasishme, që shpërndau
mjegullën që u ndeh në mes tyre.

- Pse, kush të tha?
- Të pashë unë — u hodh Fatmiri, kësaj here me fytyrë të çelur. — Syrit të ushtarit s'i shpëton asgjë.
- Edhe unë të shikoja — tha vajza me një sinqeritet naiv, qe e preku ushtarin. — Ti ishe në majë të kullës dhe unë të shikoja kur lëvizje sa andej-këndeje...
- Po pse, ku ishe ti? — pyeti Fatmiri.
- Vajza nuk e pati të lehtë të përgjigjej.
- Ku isha?
- Po.
- Poshtë, isha! Isha fshehur te mullarët e fierit.
- Tallet Fatua — tha Xhaferri — ne s'dinim gjë për këtë, po na tha xha Fadili.
- Sytë e vajzës ndërruan në çast e Fatmiri e ndjeu këtë dhe tha me një ton të ngrohtë:
- Atje fjete?
- Ajo e pa shtrembër, po, kur vuri re fytyrën e tij të çelur nga gazi, nuk e mbajti dot atë zemërim fëmijëror që e kishte kapur dhe qeshi:
- Ku kisha gjumë unë. Rrija shikoja yjet. Shikoja kullën tuaj. Doja të gdhinte sa më parë.
- Pse nuk erdhe këtu? — pyeti Fatmiri.
- Nuk doja t'ju bezdisja... që mbrëmë...
- Punë e madhe! — tha Xhaferri. — Të kishe ardhur. Nuk do të kishe ngrirë gjithë natën nga të ftohtët.
- Kur ka hall njeriu — tha ajo — i duron të gjitha...
- Biseda tani rridhte lirisht dhe ata e shikonin njëri-tjetrin si njerëz të njohur prej kohe. Zëri i Zares tingëlonte i plotë, megjithëse herë pas here ndihej brenga e saj e fshehtë. Kjo ndodhte sidomos kur bisedonte me Xhaferrin, kurse Fatmiri, sado që i binte nga pak më qafë, s'e kishte atë hijen e rëndë të shokut të tij. Ai kishte një zë gazmor dhe dashur padashur të bënte të flisje. Këtë Zarja e ndiente, aq më tepër kur mendonte se me çfarë kureshtje i kishte parë këta njerëz tek rrinte në fshat. Asaj i vërtiteshin kushedi sa pyetje në kokë dhe nuk dinte nga ta niste më parë.

— Ju rrini çdo natë jashtë? — pyeti ajo në mes heshtjes së plotë.

— Kështu e kemi detyrën — tha Xhaferri. — Na bie ta bëjmë shërbim në çdo kohë.

Vajza mori kurajë.

— Nëna ime — tha ajo — kur bën kohë e keqe thotë: «Gjynah për ata atje lart...»

— Pse gjynah? — u hodh Fatmiri.

— I vjen keq — pëshpëriti ajo. — Ju keni detyrë të vështirë...

— Ka të drejtë Fatmiri — tha Xhaferri me takt. — Çdo detyrë ka vështirësitë e veta. Pse, e paktë është puna që bëni ju në ara, apo bariu në mal?

Zarja dëgjonte me vëmendje e deshi ta kundërshtonte, po ndërhyri Fatmiri:

— Po ty, të vinte keq kur thoshte nëna ashtu?

— Si s'më vinte... më vinte — ia priti vajza me një zë të çiltër. — Kur isha e vogël, njëherë po kullsoja dhinë këndeje lart. Nuk ishit ju atëherë. Ishin ca të tjerë, të cilëve s'ua di emrin. Gjithë paraditen bëri kohë e mirë, po nga dreka koha u prish. Qielli u mbulua me re dhe filloi të vetëinte e të bubullonte. Unë mblodha dhinë dhe i vura përpara. Po mbaj mend që, kur zura të zbrisja, bëja ç'bëja dhe ktheja kokën nga kulla juaj. Më dukej që gjithë ato rrufe do të binin mbi atë ushtarin që bënte roje në majë të kullës. Kur vajta në shtëpi, i thashë nënës. Dhe ajo kishte merak... Nuk ishit ju atëherë... Po nuk ndodhi gjë, shyqyr...

Ajo heshti një hop e, kur pa që ata po e dëgjonin, vazhdoi:

— Në fshatin tonë asnjë nuk e di tamam se ç'bëni ju këtu...

— Sa mirë! — tha Fatmiri.

Zarja shikoi nga Xhaferri.

— Detyrat në ushtri janë sekrete — shpjegoi tjetri.

— Vëllai im, kur vjen me lejë, nuk do që ta pyesësh për këto gjëra. «Mos, thotë, se nuk bën...» Dhe nuk tregojnë asgjë, sikur ta vrasësh.

— Ashtu është — tha Xhaferri. — E lyp detyra...

Fatmiri ngrii kapakun e tenxheres, po harroi që ajo digjte dhe e lëshoi menjëherë. Kapaku prej alumini ra me zhurmë në çimento. Zarja qeshi. Qeshi edhe Xhaferri.

— Do dhe shumë dreka? — pyeti ai.

— Edhe pak — tha tjetri, duke shkundur dorën e djathtë në ajër.

— Unë do të iki — tha vajza papritur.

— Ku do të shkosh? — ia ktheu Fatmiri, duke ngriitur kapakun e tenxheres me këndin e bluzës së bardhë. — Prit njëherë... ohu... kemi kohë... Do të hamë drekë, do të rrimë, do të bisedojmë...

— Presim fjalën e komisarit — u dëgjua zëri i Xhaferrit. — Apo ke ndonjë arsye?

Zarja nuk foli e ushtarëve iu duk sikur ajo u mbyll në vetvete si në takimin e parë.

I T E T I

Në qoftë se e di mirë si duhet filluar, nuk do ta kesh vështirë as në fund.

FJALË E URTË

Komandanti i postës u ngrit dhe doli jashtë. Fatmiri filloi të fshinte tryezën me një leckë të lagur.

— Bëhet merak — tha ai. — Nuk i rrihet pa kontrolluar herë pas here.

— Për çfarë? — pyeti ajo.

— Për ty! — tha i qetë ai.

Vajza nuk po kuptonte gjë, ndaj e pa me habi.

— Po, — tha ai — mendon se mos vijnë njerëzit e tu...

Një hije kaloi para syve të saj. Ajo u drodh lehtë. Ata heshtën një copë herë.

— Keni fshesë? — tha ajo pastaj.

— Kemi — tha ai.

— Ma bjer, po deshe!

— E pse të lodhesh?

— Jo, kam qejf...

Ai nuk e kundërshtoi po mori fshesën prapa derës. Ajo u ngrit më këmbë.

— Sot nuk kemi fshirë — tha ai, duke i zgjatur fshesën. — U hutuam nga ardhja jote.

Zarja bëri sikur nuk i dëgjoi fjalët e fundit. Mbësh-teti fshesën te muri dhe filloi ta spërkaste çimenton me ujin e kanës që gjendej mbi tryezë.

Fatmiri e vështronte me buzë në gaz nga mesi i derës.

Ajo ngriti kokën të merrte fshesën, kur ndeshi vësh-trimin e tij.

— Mos qesh — tha Zarja. — Pse, s'ke parë njeri të fshijë?

— Kam parë — tha ai me seriozitet — po këtë çimento e ka fshirë gjithnjë një dorë burri...

— E pse, unë nuk bëj mirë që po e fshij? — tha ajo, duke i mëshuar fshesës lehtë e lehtë.

— Mirë bën — tha ai — bile e tërë kjo punë është e menduar mirë. Ti na nderove që erdhe këtu...

Ajo nuk e pa fytyrën e tij, po e kuptoi se ai fliste me tërë mend. Zëri i tij tingëllonte bindës.

— Vajzat këndeje nga ju — tha Fatmiri — janë mësuar ta ulin kokën kur takojnë ushtarë. Kushedi ç'kujtojnë... Po nuk është e drejtë...

Zarja harroi të lëvizte fshesën.

— Se fundi, ç'jemi ne? — ngriti zërin ai. — Ne jemi vëllezërit tuaj...

— Ashtu është — tha ajo. — Po ja që ka mbetur. Ushtari ka hije të rëndë. Pa pyetmë mua se ç'hoqa sa vendosa të vija këtu...

Ai nuk e ngau. Ajo lëvizi fshesën mbi çimento.

— Prapë më vjen shumë rëndë — tha ajo, ndërsa dëgjohej fëshfërima e fshesës.

— Nga kush të vjen rëndë? Nga unë?

— Jo — ia priti ajo. — Nga ai shoku...

— E ke gabim. Mos i vërë faj që rri ashtu. Ka, tipin ashtu. Po është xhevahir djalë.

Zarja e kishte sjellë togun e pluhurit afër derës, prapa këmbëve të ushtarit.

Ajo drejtoi trupin dhe shikoi nga Fatmiri, po atë çast u hap dera e jashtme. Xhaferri hyri në korridor e, tek pa Zaren me fshesë në dorë, tha:

— Ç'bën kështu, Fato, pse e lodh Zaren?

— I thashë, po s'do — tha Fatmiri duke u larguar nga dera.

Vajza u afrua nga Xhaferri.

— Kishte njeri jashtë? — pyeti ajo me kureshtje.

— Jo, — asnjeri veç bagëtive.

— S'u shkon mendja kurrë që kam ardhur këtu — foli ajo me një gëzim të papërmbajtur.

— As neve s'na kishte shkuar ndonjëherë mendja — tha Xhaferri, duke zënë vend në një stol pranë tryezës. Fatmiri iu afrua sobës.

Ajo tha:

— Keni një kovë me ujë të laj çimenton?

— Rri — tha Xhaferri — s'ka nevojë.

Zëri i tij tingëlloi i prerë dhe Zarja u tulat një çast. Fatmiri e mori me mend dëshirën e vajzës. Ajo donte medoemos të bënte diçka të dobishme për ta.

— Kur ke qejf — tha ai, duke ngritur kovën me ujë që gjendej poshtë dritares — urdhëro, ja dhe lecka...

Zares i qeshi fytyra. Xhaferri tundi kokën pa folur.

Ata dolën jashtë pastaj për të mos e penguar. Ajo filloi të punonte lirisht, duke e larë çimenton pëllëmbë për pëllëmbë. Kishte një gëzim të madh në shpirt e gati sa s'fluturonte, duke lëvizur trupin e duart sa andej-këndej. Të kishte mundësi ta pastronte tërë atë ndërtesë nga themelet deri në majë, t'i fshinte të gjitha, një e nga një, që çdo gjë aty të shkëlqente e të vetëtinte...

Kur e lau kuzhinën, Zarja zuri të fshinte korridorin. Ushtarët që rrinin jashtë, e ndien fëshfërimën e fshesës dhe pritën derisa ajo të mbaronte.

Ajo mblodhi të fshirat prapa derës dhe s'guxonte të dilte jashtë. Priti me fshesë në dorë, gjersa Fatmiri e kup-toi dhe thirri që jashtë:

— Mos i lërë pluhurat brenda!

Vajza s'dinte ç'të bënte, ta hapte apo mos ta hapte derën. Po sikur ta shihte ndonjë njeri, fshehur prapa drurëve të pyllit apo kaçubeve, që ngriheshin matanë sheshit?

Megjithatë ajo e hapi derën ngadalë. Dielli u fut në

korridor dhe asaj iu lëbyrën sytë e nuk pa fytyrën e qeshur të Fatmirit që i qe afruar te pragu. Xhaferri rrinte ulur jashtë.

— Vazhdo — tha Fatmiri.

Ajo zuri padashur ta fshinte përsëri. Ai hyri brenda dhe u fut në kuzhinë.

...Kur u kthye Zarja dhe Xhaferri, e gjetën tryezën shtruar. Fatmiri e kishte rregulluar si për festë. Në mes kishte vënë një gotë alumini me një tufë lule mali. Në krye kishte vendosur pjatën e mysafires, që ndryshonte nga dy të tjerat, të vëna anësh. Te vendi i saj ishte dhe një pecetë e bardhë. Kana më ujë shkëlqente.

— Urdhëroni, tani — tha Fatmiri. — Ti, Zare, ulu atje. Jo, jo atje!

Ajo gjithë turp u ul në krye të tryezës. Xhaferri kishte zënë vend që më përpara. Fatmiri shërbente.

— Mirë se erdhe, shoqe — tha Xhaferri kur të tre qenë ulur rreth tryezës.

— Ju bëftë mirë dhe gjellën mos ma shani shumë — ta bëri kuzhinieri i postës.

Zarja priti të fillonin të zotët e shtëpisë dhe pastaj ngriti lugën e saj.

Ata përtypnin në heshtje. Ajo mbante sytë mbi pjatë. Ushtarët hanin me oreks.

— Po nuk e mbarove... pjatën — tha me ndërprerje Fatmiri — nuk ke të drejtë të ngrihesh nga tryeza. Është rregull ky në ushtri.

— Ti pyete, a i pëlqeu gjella — u hodh Xhaferri

Vajza i lëvizte nofullat ngadalë, ndërsa lugën e kishte lënë në pjatë.

— Gjella është bërë shumë e mirë — tha ajo, pasi kapërdiu kafshatën e parë...

— Fatua gatuan mirë — tha Xhaferri. — Mua s'më vjen ndoresh fare...

— Mos flisni shumë — tha tjetri — se s'na shijoni gjellën pastaj...

Zares i erdhi për të qeshur. Dhe në vend ta fuste lugën në gojë, e uli përsëri në pjatë.

— Kemi gjë tjetër, ta dimë? — ia bëri Xhaferri, që po e boshatiste pjatën e tij.

Kuzhinieri s'u përgjigj, po u ngrit dhe vuri në mes të tryezës një tas me mish kutie.

— Ja, kështu nderohet miku — tha i kënaqur Xhaferri.

Vajza deshi të thoshte diçka, po e kishte gojën plot. Fatmiri tha:

— Se mos thuash nesër që shkova në postë dhe më lanë pa ngrënë!

— Jo, jo — ia priti ajo duke e kapërdirë ushqimin me të shpejtë. — Unë dhe me kaq u ngopa.

— Pa bukë nuk të lamë, sigurisht — vazhdoi Fatmiri — po do të thuash se të pritëm me groshë, me ca groshë të këqija... E shoh që mezi po i ha.

Zares i erdhi keq dhe deshi të shpjegohej menjëherë, po Xhaferri i tha:

— Merr mish.

— Është mish derri — u hodh Fatmiri.

Ajo mblodhi buzët. Luga i mbeti në dorë. U bë një heshtje e shkurtër. Ata padashur vështronin mysafiren.

— Po nuk pate qejf — tha Xhaferri, duke mbushur lugën — mos e ha me zor.

Ajo ngriti sytë dhe tha me gjysmë zëri:

— Ne s'e hamë në shtëpi... As në fshat nuk e hanë..

— Po vëllai e ha? — pyeti Xhaferri.

— Nuk e di...

— Sigurisht, ka mësuar ta hajë atje ku është — tha Fatmiri me bindje — po dhe ti duhet ta hash...

— Se si më vjen... — murmuriti ajo.

— Merr — nguli këmbë Fatmiri.

Zarja e mbante lugën nderur dhe as e ulte, as e zgjaste.

— Hë, se nuk të djeg — tha prapë i pari.

Ajo e vuri lugën në pjatën e mishit. Xhaferri vështronte i shqetësuar.

— Fute në gojë tani, se s'është ilaç — urdhëroi Fatmiri.

— Mbase nuk e ke qejf, — ndërhyri Xhaferri.

— S'është punë qejfi — tha Fatmiri. — Kjo bëri gjithë atë gjë të madhe, theu një zakon shekullor, mos të hajë këtë mish të shijshëm! Për nder, është i mirë...

Vajza nuk priti më. Ngriti lugën dhe e futi në gojë duke rrudhur lehtë buzët. Xhaferri s'ia ndante sytë, kurse tjetri vazhdonte të hante i shkujdesur.

— Merr bukë — tha Fatmiri — se të vel ashtu thatë... Ajo mbllaçitej ngadalë.

— Hë, si të duket? — pyeti Xhaferri me padurim. Ajo e kapërceu menjëherë atë që kishte në gojë.

— S'është i keq...

— E, nuk të thashë? — u gëzua tjetri. — Ha, se duke ngrënë do të të vijë oreksi...

Ata vazhduan të hanin duke vështruar njëri-tjetrin tërthorazi. Fatmiri me këmbënguljen e tij i kishte vënë të dy në hall. Ajo nuk e kundërshtonte dot, po dhe komandanti i postës s'dinte si t'i vinte në ndihmë mysafires.

— Mos i bjerë në stomak — tha Xhaferri më në fund.

— Edhe ky është një zakon i keq që na ka mbetur nga e kaluara — zuri të shpjegonte Fatmiri. — Kështu duhet ta kuptosh, Zare. Po ta kuptosh mirë këtë, do të mësohesh kollaj pastaj...

— Dalngadalë — tha Xhaferri. — Sot e provoi... nesër...

— Unë e dija se ishte i hidhur ky mish — tha ajo, pa menduar se i priste fjalën komandantit të postës. — Më kishin thënë se kishte erë të keqe...

— Këto janë profkat e fanatikëve — u hodh Fatmiri.

— S'kanë sjellë derra në fshatin tuaj? — pyeti Xhaferri.

— Deri tani jo — tha ajo, duke mbështetur lugën mbi pjatën e saj — se ne jemi kooperativë e re...

Ndërkohë, Fatmiri u ngrit dhe vuri mbi tryezë një pjatë me hallvë.

— Këtë e ka bërë për ty — tha Xhaferri. — Në vend që ta hanim për festën e Një Majit, po e hamë sot.

— Pse, festë kemi dhe sot — tha Fatmiri dhe zgja-

ti dorën të merrte i pari. — Ne sot festojmë fitoren e parë të Zares kundër botës së vjetër. Apo s'është kështu?

— Po — pëshpëriti vajza.

— Atëherë, ha, se, po nuk e hëngre pjesën që të përket, do të ta jap me vete — qeshi Fatmiri.

— Jo — kundërshtoi tjetri — hallvën s'e ka të de-tyruar. Sa për mishin, po, kishe të drejtë...

— Më duket se të pëlqen të hash dhe pjesën e saj — tha me të qeshur Fatmiri. — Që ta dish ti, Zare, ky komandanti im e ha shumë hallvën.

Xhaferri deshi të kundërshtonte përsëri, po e kishte gojën plot. Vajzës i shkëlqente fytyra.

Ata hanin me shije ëmbëlsirën.

I N Ë N T I

Ujë të rrjedh nuk kthehet prapa.

Tryezën deshi ta pastronte Zarja, po ushtarët nuk e lanë.

— Jo, rri ti — tha Xhaferri, i cili ishte ngritur ta bënte vetë këtë punë. — Ti je mysafire.

— Kot që biseduam atëherë — u hodh Fatmiri, duke iu drejtuar vajzës. — Ti je mësuar në shtëpi t'u shërbesh gjithmonë burrave. Këtë kërkon ta bësh dhe këtu, po s'është e drejtë... Lëre Xhaferin, se e ka ai radhën e shërbimit.

Ajo u kthye në vendin e saj e pakënaqur:

— Po mua kur më bie radha?

— Domethënë e ke vendosur të rrish në postë? — tha Fatmiri. Zarja vari kokën.

— Po ndenje këtu — vazhdoi ai — do të të caktojme detyra, veç detyra të barabarta dhe jo si në shtëpi... Xhaferri ngriti pjatat.

— Po vëllai të ndihmonte ndopak?

Ajo rrudhi supet, pa ditur ç'të thoshte. Fatmiri ia pat sërish:

— Asnjëri nga ne nuk ndihmon sa duhet nënën apo motrën në punët e rënda të shtëpisë. Kujtojmë se ato janë punë që u takojnë vetëm grave...

Sytë e saj rrinin të mbërthyer tek ai. Xhaferri si pas-

troi tryezën zuri të lante enët në një kënd të dhomës së vogël.

— Kjo është e vërtetë — tha ai tek mori ujë të ngrohtë dhe e hodhi mbi enët e palara — sidomos në fshat. Dhe ne, megjithëse e dimë, nuk bëjmë asnjë përpjekje për t'i ndihmuar. Po duhet t'i jepet fund kësaj gjendjeje — foli Fatmiri. — Kjo është një lloj skllavërie që shoqëria jonë po e shkatërron...

Zarja dëgjonte bisedën e tyre, po nga ana tjetër vështronte me kureshtje lëvizjet e Xhaferrit. Ajo nuk kishte parë kurrë në jetën e saj një burrë të lante enët, kurse ushtari e bënte këtë gjë me shkathësi e në mënyrë krejt të lirë.

Ata ndenjën një copë herë në heshtje. Dëgjohej tringëllima e pjatave, zhurma e lehtë e ujit dhe gishtat e Fatmirit që godisnin mbi tryezë.

— Ç'ke që mendohesh? — foli Fatmiri.

— Hiç — tha ajo.

— Kushedi ç'thua me vete: aman të iki sa më parë që këndeje...

— Jo, kush tha? — ia ktheu ajo, duke i hequr sytë për një çast nga Xhaferrit.

Xhaferrit ktheu kokën:

— Mos u mërzit, do të bëhet ashtu si dëshëron ti.

— Unë jam në dorën tuaj — murmuriti vajza.

— E ke gabim — tha me një ton të prerë Fatmiri.

— Nuk të kemi ne në dorë, po e ke ti veten në dorë tani. Mendo për një çast sikur të vijë babai yt këtu ose ata të burrit...

— Jo, nuk vijnë ata — ia bëri Zarja e tronditur.

— Sikur, them unë — vazhdoi ai. — Ti s'duhet të kesh frikë. T'u dalësh para e t'u thuash ato që na the neve.

— Ti nuk i njeh ata! — tha ajo me zë të dredhur dhe menjëherë u tulat sikur e goditi njeri.

— Shiko — tha Fatmiri i vrenjtur — lufta që keni nisur ti dhe shoqet e tua është e gjatë dhe e vështirë. Ti sapo e ke filluar këtë luftë. Ike nga shtëpia dhe mirë bëre, po duhet ta forcosh guximin. Ti tani s'je vetëm. Ta dinë mirë ata këtë gjë!

— Ty të ka marrë në mbrojtje shoqëria — tha Xhaferri, që e la punën një çast dhe iu afrua tryezës. — Kush të prek ty, tani, ka të bëjë me gjithë popullin.

Ajo padashur ngriti kokën. Sytë i qenë fryrë. Një bulë loti i varej nën qerpikë. Xhaferri filloi të shpëlante enët, po kësaj here nuk e tërhiqte më vëmendjen e vajzës.

— Me kokën ulur e me të qara — tha pas pak Fatmiri — nuk do të fitosh asgjë. Ti do të largohesh nga ne, e ne, si vëllezër, duam të të japim një këshillë: bëhu e zonja e vetes, apo jo, Xhaferr?

Xhaferri s'u përgjigj menjëherë, po fshiu dhe pja-tën e fundit dhe erdhi e u ul rreth tryezës:

— Fatua e tha bukur: të bëhesh e zonja e vetes! Po e more me frikë e me lotë, do të thonë është penduar. Domethënë, çdo përpjekje vete kot...

— Unë s'jam penduar — thirri ajo dhe papritur u shkreh në vaj. — Ta di të vdes e s'martohem me të kurrë!...

— Ti s'ke pse të vdesësh, as të shkosh te burri me pahir — tha Xhaferri me vetulla të mbledhura, duke shikuar nga Fatmiri që ishte rrudhur në fytyrë.

— Unë prandaj ika... erdha këtu — murmuriti ajo përmes lotëve.

— Dhe mirë bëre — foli Xhaferri.

— Po kjo s'është e tëra — foli tjetri. — Ti erdhe për ndihmë të ne. Ne të pranuan. Po të ndihmojmë e do të të ndihmojmë akoma. Po mos harro se do të kesh tela-she të tjera...

Ajo fshiu lotët me dorë e, duke marrë frymë thellë, tha:

— E di... i kam marrë parasysh të gjitha. Mos m'ri shikoni lotët... As unë s'dua të qaj... Po më dalin vetë...

— Shumë mirë atëherë — thirri Fatmiri. — Ne kë-të deshëm të dinim...

Ushtarët e vështruan njëri-tjetrin në sy. Vajza dalë-ngadalë po e merrte veten. Vetëm ndonjë ngashërim i lehtë herë pas here i shuhej përbrenda në gjoks. Ata qën-dronin të tre rreth tryezës së zbrazët.

— Të shqetësuam ca — tha Xhaferri.

— Si? — ngriti kokën ajo.

— Të ramë më qafë me këto muhabete — shpjegoi ai.

— Po ky është halli im — tha ajo. — Po të mos e qaja me ju hallin, me cilin do ta qaja?

Në korridor jehoi me ndërprerje zilha e telefonit. Sytë e Zares ranë mbi ushtarët. Fatmiri brofi më këmbë. Pas tij u ngrit dhe tjetri. Po ndërsa Fatmiri mori dorezën e telefonit, Xhaferri i rrinte pranë. Në korridor doli dhe Zarja. Ajo qëndronte disa hapa larg tyre. Zemra i rrihte fort. Buzët i mbante të hapura. Duart s'dinte ku t'i vinte.

Zëri i largët kumbonte i ngjirur në korridorin e ngushtë. Ajo shikonte me ngulm fytyrën e çelur të Fatmirit, dëgjonte përgjigjet e prera dhe rrinte e nemitur.

Biseda qe e shkurtër, megjithëse Zares iu duk pa mbarim.

— Bëhuni gati — tha Fatmiri duke ulur dorezën e telefonit. — Komisari këshillon të niseni!

Ajo vështronte e hutuar, me një fytyrë që ishte vështirë të lexohej. Ushtarët bisedonin, kurse asaj papritur iu lidh gjuha.

— Komisari pyeti si është Zarja — zu të tregonte Fatmiri. — Tha mos është mërzitur. Thuaj, tha, se bisedova me sekretarin e partisë të kooperativës. Ai është dakord me të gjitha. Bile na pret në repart te komisari.

— Tani je e kënaqur? — tha Xhaferri.

— Po — pëshpëriti ajo.

Qepallat e saj ishin të mbufatur dhe ajo përpiquej të mos i lëvizte sytë.

— Kishe ndonjë gjë tjetër? — tha Xhaferri.

— Kisha, dhe ca rroba... — tha Zarja me një fije zëri.

— Ku i ke? Në shtëpi? — e ngacmoi Fatmiri.

— Jo, jo — ia bëri ajo duke qeshur. — Kam lënë bohçen me rroba te mullarët atje poshtë...

— Mirë — tha Xhaferri. — Ti rri. Do të vemë ne ta marrim.

Pas kësaj, të tre hynë në kuzhinë dhe filluan nga pregatitjet.

Asnjëherë posta e largët nuk kishte pasur aq gjallëri e gaz si atë ditë.

I D H J E T I

*Në qoftë se rri drejt, mos ki frikë nga
hija e shtrembër.*

FJALË E URTE

Ai u vonua pak dhe Zarja e Xhaferri, që prisnin në postë, u bënë merak.

— Mezi e gjeta — tha Fatmiri kur u kthye, duke ia dorëzuar vajzës bohçen e bardhë. — Ku të kishte shkuar mendja?! Nuk lashë ferrë pa kërkuar.

Ai u ul, duke marrë frymë me nxitim.

— Tani, vishu — tha. — Bëhu gati dhe ti, Xhaferri!

— Është akoma shpejt, më duket — ia ktheu komandanti i postës.

Zarja rrinte më këmbë, me bohçen në dorë.

— Tani urdhëroj unë — qeshi Fatmiri. — Unë do t'ju nis.

— Prit ta bisedojmë punën — tha Xhaferri i menduar. — Ulu, Zare. Neve do të na duhet të kalojmë nga fshati. Si t'ia bëjmë?

— Vërtet — u hodh ajo. — Si do t'ia bëjmë? Mua më njohin të gjithë!

— Ju nuk do t'i bini fshatit mes për mes — tha Fatmiri. — I dilni anësh, andej nga përroi.

— Po njerëzit e fshatit janë kudo — ndërhyri vajza.

— Mirë thotë Zarja — tha Xhaferri. — Më mirë të presim sa të errësohet pak.

— Po të vonoheni — arsyetoi tjetri — kam frikë se do të na ikin makinat e fermës.

— Eci më këmbë unë — tha ajo.

— Është shumë larg më këmbë — shpjegoi Xhaferri.
— Duhet të gjejmë patjetër makinë që të arrijmë në kohë.

Heshtën një hop. Fatmiri tha:

— Shko vishu!

Vajza vështroi nga ai, pastaj nga Xhaferri. Mos bënë te prapë shaka Fatmiri? Komandanti i postës tundi kokën i tërhequr nga mendimet e tij. Ajo doli.

— Ngrehu dhe ti! — tha Fatmiri kur mbetën vetëm.

— Kollaj unë — murmuriti Xhaferri me sy të ngulur mbi tryezë. — Po dëgjo. Druhem derisa të dalim jashtë rrezikut. Deri tani, në vetëm e mendonim këtë, kurse këtë e tutje mund të gjendemi ballë për ballë me të. Se duhet pasur parasysh një gjë: ne do të kalojmë nëpër një zonë ku Zaren e njohin. E jo vetëm kaq, po një vajzë me një ushtar... kushdo qoftë, mund të dyshojë. Duhet menduar puna mirë para se të nisemi...

— Megjithatë, s'duhet zmadhuar gjërat — tha Fatmiri me gjysmëzëri.

Kurse Xhaferri vazhdoi, sikur të mos i kishte dëgjuar fjalët e shokut:

— Se të themi që nuk na panë. Po po na panë? Ç'duhet bërë atëherë? Për të gënjer, s'ke si gënjen. Po dhe të mundohemi t'i ikim, s'është punë që bëhet!

— Ti je zbulues — tha Fatmiri. — Prandaj ka rëndësi rruga që do të ndiqni, si do të dredhoni, si do të mas-koheni...

— Ashtu është — tha i preokupuar komandanti i postës. — Se mendoj dhe këtë. Ja, na pa një fëmijë dhe vajti dha kushtimin në fshat. Ç'të bëjmë ne atëherë? Të kthehemi mbrapsht?

— Jo — kundërshtoi i vendosur Fatmiri — s'keni pse ktheheni këtu. Shkoni në këshill e kërkoni të takoheni me komunistët e fshatit; çoji fjalë komisarit, të vi-

jë dhe ai me sekretarin e partisë të kooperativës dhe të bëhet mbledhje me të gjithë njerëzit. Të flasë vetë Zarija. Sigurisht, do të flasë dhe populli. Do të thonë fjalën e tyre dhe komunistët. Ata s'ka si të jenë dakord me të atin e Zares dhe fanatikët e tjerë.

Xhaferri kishte rrudhur ballin, trupin e mbante drejt, gati të ngrirë dhe, kur mbaroi Fatmiri, ai tha me zë të ulët:

— Sidoqoftë, nuk më pëlqen, bile të them të drejtën, nuk na intereson të ndodhë kjo gjë. Ne duhet t'i ruhem këesaj gjithsesi.

— Për mua njësoj është — ia priti me bindje Fatmiri. — Në të dy rastet do të goditen fanatikët... E reja do të triumfojë. Do të marrin shembull të tjerët.

— Ndoshta kjo s'na takon neve... — tha me mëdyshje Xhaferri. Ka kush i bën këto punë!

Fatmiri mori rishtaz vrull ta kundërshtonte, po sa-kaq u hap dera e kuzhinës dhe hyri Zarija e ndërruar, e veshur me një fustan të kuq me lule të mëdha që i varej deri poshtë këmbëve, me xhakëtë të gjelbër e këpucë të zeza me taka të trasha.

Ushtarët nuk e drejtuan menjëherë vëmendjen nga ajo, ndaj ajo nuk foli asnjë fjalë, po qëndroi më këmbë si një nuse e turpshme. Këtë gjendje të trubullt ia krijuan jo vetëm rrobat e reja që kishte veshur, po dhe fytyrat e vrenjtura të të zotëve të shtëpisë.

— Mirë — tha Fatmiri, duke i hedhur një vështrim të shpejtë pamjes së re të vajzës. — Ulu njëherë...

— Jo, s'është mirë kështu — ia bëri Xhaferri ftohtë.

— Me këto ngjyra të forta dhe helikopteri të shquan...

Zarija vari kokën si të ishte fajtore.

— Ulu — tha prapë Fatmiri.

Ajo zuri vend në stolin e saj dhe tërthorazi vështroi fytyrën e menduar të komandantit të postës.

— Si thua ti? — pyeti Xhaferri.

— T'i biem nga përroi, anës e anës — tha vajza.

— Prapë mua s'më fle mendja — ia bëri Xhaferri.

— Ngado që të kalojmë mund të ndeshemi me njerëzit. Ecën, bie fjala nëpër një shteg të humbur, kur papritur

dëgjon: «Si u ngryse, shok?» Shkon më tutje, të del një tjetër që kërkon të ndezë cigaren. Këta mund të jenë barinj, druvarë, njerëz që kthehen nga puna dhe çlodhen prapa ndonjë kaçubeje a ferre. Lëri fëmijët, pastaj, që janë shpërndarë kudo si shpezët...

Zares i ra një hije në fytyrë, me gjithë vezullimin e dobët që i jepte fustani i kuq.

— Si thua ti, shoqe? — pyeti me seriozitet Xhaferri.

— Ç'të them unë, e shkreta. Hall kemi sa të kalojmë fshatin...

— Po sikur të nisemi natën? — tha komandanti.

— Është puna të veni në kohë — ia priti Fatmiri. — Komisari këtë pati parasysh kur tha të niseni sa më parë. Sigurisht, njerëzit e Zares në fshat akoma nuk e kanë mbledhur mendjen e po e kërkojnë, po prapë kjo s'duhet të bëhet shkak për të na penguar.

— Ata të atij... kushedi se ç'kujtojnë... — foli Zarrja. — Kujtojnë se mos jam rrëmbyer me ndonjë në fshat dhe sillen andej rrotull.

— Ashtu është — tha Xhaferri. — Shumë gjëra mund të ndodhin dhe unë këtë po mendoj...

— Ne duhet t'ua hedhim fanatikëve — tha Fatmiri me një ton të gëzuar, që e bëri vajzën ta drejtonte pak shtatin. Xhaferri sikur nuk u dha rëndësi njëherë këtyre fjalëve, po pas një pauze tha:

— Më ka shkuar mendja për një gjë. Nuk di sa do të jeni ju dakord. Them të të veshim, Zare, me rroba ushtarake!

Ajo hapi sytë e thirri me zë të vogël:

— Qyqja, si të vishem unë ashtu!?

— Shumë mirë të ka shkuar mendja — u hodh Fatmiri. — Ky është maskimi më i saktë në këto rrethana...

Fytyra e vajzës kishte një shprehje gazi e habie bashkë. Ajo shikonte herë nga njëri, herë nga tjetri. Ata ishin të vendosur.

— Zare, kjo s'ka ndonjë gjë të keqe — tha Xhaferri duke kapur vështrimin e saj pyetës. — Do të vishesh me

rrobat tona, po jo me këto që na sheh veshur. Kemi të tjera, të reja...

— Ka merak, si duket — qeshi Fatmiri.

Ajo sa s'iu hodh në grykë:

— Jo, jo, s'kam merak... po se si më vjen...

— Ne i mbajmë pastër — vazhdoi ai me ton gazmor.

— Nuk na i pastron as nëna, as motra, vetë i pastrojmë...
— Hiç, mos ki gajle — tha i qetë komandanti, ndër-
sa sytë i kishin marrë një shkëlqim të lehtë. — Tani
të duket e çuditshme, po kur të mbarosh punë me to,
do t'i kujtosh...

— Bile do të të pëlqejnë pastaj — shtoi tjetri.

— Të jap rrobat e mia — tha Xhaferri.

— Ti do t'i veshësh vetë — ia priti Fatmiri.

— S'ka gjë — tha ai — vesh të vjetrat.

— Jo — kundërshtoi ajo. — Ti vish të tuat...

— Prapë erdhe në dorën time — tha Fatmiri.

Ajo buzëqeshi.

— Si thua? — tha Xhaferri.

— Ju e dini më mirë.

— Mos e pyet atë — i hoqi vërejtjen shokut Fat-
miri gazmor. — Ti je komandanti ynë. Urdhri yt është
ligj për vartësit. E di këtë ti, Zare?

Ajo ngriti supet.

— Pse, s'ke qenë ndonjëherë në zbor? — pyeti rish-
taz po ai.

— Jo, s'kam qenë.

— Shumë keq — tha Fatmiri.

— Po s'e kam fajin unë — tha ajo me gjysmë zëri.

— Unë kam shumë qejf...

— Ke qejf të bësh ushtri?

Zarja, tek rrinte ashtu e druajtur, mblodhi veten
dhe shfreu me duf:

— Si të them... Ah, sikur të bënim dhe ne një gjë
si kjo... Nuk e di se ç'mund të bënim, të iknim dhe ne
ca kohë nga fshati... të shkonim në një vend... të mëso-
nim... Do ta shihnit, s'do të ishim këto që jemi... Djemtë e
fshatit, kur kthehen nga ushtria, ndryshojnë shumë...

— E sheh se ç'është ushtria? — tha Fatmiri.

— Dhe ajo e dinte, pa erdhi te ne — ia priti Xhaferri duke miratuar me sy vajzën, fjalët e së cilës, të thëna me aq zjarr, i kumbonin ende në vesh.

— Po ç'e do — buzëqeshi tjetri — po na ikën shpejt. Të kishte ndenjur, ta kishte provuar jetën në ushtri.

— Kësaj here e solli nevoja — i doli krah komandanti i postës. — Herë të tjera do ta sjellë detyra. Këtë punë që bëjmë ne, mund ta mësojnë dhe vajzat e fshatit...

Sytë e vajzës i kishte mbuluar një tis mosbesimi.

— Si thua, Zare?

— Ku ta di unë! Këto janë gjëra të zorshme!

— S'janë hiç të zorshme — tha Fatmiri.

Zarja nuk dinte ç'të thoshte tek dëgjonte fjalët e ushtarëve. Asaj nuk i kishte shkuar kurrë mendja tek ato.

U bë një pauzë e shkurtër. Nga dritarja hynin brenda rrezet e fundit të diellit të pasdites. Në tërë postën zotëronte një heshtje e thellë.

— Ngrihemi e vishemi, Zare — theu qetësinë Xhaferri.

Ajo nuk tha asgjë dhe u ngrit më këmbë.

— Prit, të të jap rrobat — tha Fatmiri dhe nxitoi në fjetore.

Pas pak ushtari u kthye i vetëm në kuzhinë dhe priti, duke ndenjur më këmbë përpara dritares. Vështronte pyllin e vogël që shtrihej prapa portës, e ndërkaq sillte nëpër mend ngjarjen e asaj dite që kishte nisur aq papritur e që po merrte fund aq shpejt... Dhe kur mendonte se ajo do të largohej prej andej përgjithmonë, sepse i zgjohej një ndjenjë e çuditshme që herë i përngjante gazit, herë brengës, po më shumë kësaj të fundit...

I NJËMBËDHJETI

*Ej, ju njerëz të rinj, rroftë e ardhmja
e juaj!*

M. GORKI

Ajo hyri e fundit në kuzhinë dhe të tre mbetën më këmbë. Vështrimi i ushtarëve u derdh mbi të, ndërsa ajo nuk dinte si të rrinte. Kishte një shqetësim të vazhdueshëm. Në fytyrë ishte skuqur. Duart herë i ngrinte, herë i ulte.

— Në rregull — tha Xhaferri, pasi i bëri një shqyrtim të shpejtë pamjes së vajzës dhe u përkul të lidhte kalçat e këpucëve.

Ajo kishte veshur uniformën verore dhe xhaketa i rrinte shumë mirë pas trupit, kurse pantallonat i binin pak të gjata.

Fatmiri qëndronte i heshtur pranë dritares, po një gaz i lehtë i lëvizte nëpër fytyrë. Ajo e ndiente këtë e me sy ulur luante gishtat nëpër komçat e xhaketes.

— Nuk është në rregull akoma — tha Fatmiri me një seriozitet të shtirur, që Zarja e kuptoi nga toni se si fliste.

— S'ka ushtar me taka dhe me flokë të gjatë!
Vajza vështroi nga vetja.

— Vërtet, s'kemi ku shkojmë kështu... — vërejtji Xhaferri.

— Të t'i presim një çikë — foli Fatmiri, duke i shkelur syrin shokut. — Të gjitha vajzat, kur venë në hekurudhë, i shkurtojnë flokët.

Sytë e vajzës hetonin tërthorazi. Ushtarët e ndien pakënaqësinë e saj.

— Jo, nuk i pres — kundërshtoi ajo e vendosur, duke ulur kokën.

— Nuk do t'i presësh — tha i qetë komandanti i postës. — Do të marrësh kokoren time. Ajo është e madhe e do t'i futësh flokët nën të.

Fatmiri sepse i erdhi keq, kur vuri re që vajza u shqetësua me gjithë mend:

— Edhe sikur të thuash ti — tha ai, duke u larguar nga dritarja — ne nuk kemi gërshtë fare... Po që duhet t'i presësh kur të vesh atje, duhet...

— Ne nuk do t'i bëjmë të gjitha — tha Xhaferri, duke qëndruar në mes të të dyve. — Zarja tani e di mirë që e pret përpara një jetë e re...

Fatmiri u ul në karrige dhe filloi të zgjidhte këpuçet për t'ia dhënë vajzës.

— Si të më thonë... — tha ajo me një zë të butë — po thanë t'i pres... do t'i pres... ashtu si të gjitha shoqet...

— Të lumtë, motër! — ia bëri Xhaferri, duke vënë në krah çantën e shpinës. — Fole shumë mirë!

Ajo vështronte ushtarët me sy të lumtur.

...Pas pak, Fatmiri hapi derën e jashtme të postës dhe të tre dolën në sheshin e vogël, ku po binin hijet e para të mbrëmjes.

— Tani nuk dallohesh fare — tha ai që po i përcillte. — Je tamam ushtar nga ata që s'u ka dirsur akoma mustaqja.

Ajo rrinte në mes tyre e hutuar dhe s'fliste. Vetëm sytë i vetëtinin. Në kokë kishte ngjeshur kokoren e leshtë, kurse krahëve kishte lidhur çantën e shpinës.

Komandanti i postës u kthye nga ajo.

— Dëgjo, motër — tha ai. — Derisa të arrijmë në

repart, harro se kush je. Tani, nuk je më ajo vajza e mbyllur. Je një ushtar që shkon me shërbim. Prandaj trupin mbaje drejt, kokën lart, hapin hidhe serbes. Kështu s'do të biesh hiç në sy.

Ajo provoi të drejtonte trupin dhe ngriti menjëherë kokën, po vështrimi i saj ndeshi me sytë gazmorë të Fatmirit.

— E fute Zaren në siklet të madh — tha ai, duke e parë vajzën që e kishte zënë turpi.

— S'ka gjë — ia priti Xhaferri i bindur. — Le të mësohet që tani.

— Unë ushtarë e Republikës jam — tha me turp vajza.

— Ashtu është — tha komandanti.

Ata bënë disa hapa dhe dolën në krye të sheshit. Para tyre shtrihej tatëpjetë gjithë faqja e Malit të Darës. Që aty niste rruga e bardhë që dredhonte poshtë. Vajza dhe ushtarët kishin hedhur sytë larg e nuk flisnin. Era e butë e mbremjes që po afronte, u binte në fytyrë.

U bë një heshtje e shkurtër. Xhaferri tha:

— Unë them që t'i biem rrugës drejt, deri afër fshatit, pastaj atje marrim anësh përroit. Po t'i dalim nga Qafa e Valit, do të na vejë larg. Si thua ti, Zare?

— Mirë — tha ajo me një zë të plotë, ndërsa shikimin e kishte hedhur përpara. — Po të kalojmë përroin, e kemi afër Pyllin e Bredhit. Pastaj hyjmë në pyll.

— Ju keni të dhëna për zbuluese — tha Fatmiri.

Vajza qeshi dhe ktheu kokën nga ushtari.

— E kam me gjithë mend — vazhdoi ai, duke kryqëzuar vështrimin me të. Ajo shikoi në mënyrë të përqëndruar, aq sa ushtari u step për një çast. Sytë e saj atë çast kishin një shkëlqim aq të pastër e të thellë, sa që ushtarit padashur i kujtuan shkëlqimin e dritës së parë të mëngjesit, që ai e kishte kundruar sa herë nga maja e kullës. Pas atyre syve fshihej një jetë e tërë. Këtë ushtari e ndiente në shpirt.

— Si thua, nisemi? — foli Xhaferri.

Fatmiri papritmas i kaloi një përqethje e lehtë në për shtat. Ai u bë gati t'u zgjaste dorën, kur Zarja hoqi

çantën nga shpina dhe me duar të dridhura nxori që andej një peshqir të bardhë.

Ushtarët, në fillim, nuk po merrnin vesh asgjë, po kur ajo i zgjati peshqirin Fatmirit, pa thënë asnjë fjalë, ata sa s'lëshuan një pasthirmë habie.

— Lëre, ç'janë këto? — tha Fatmiri. — Mbaje, se të duhet...

Xhaferrit padashur iu lidh gjuha. Ushtarit i mbeti peshqiri në dorë.

— Nuk di si t'jua shpërblej — ia bëri ajo me zë të dridhur. — Ju m'u gjendët vëllezër e shkuar vëllezërve...

— Ti do të na e shpërblesh vetëm në dasmë — tha Xhaferrit.

Vajza u skuq dhe uli kokën të lidhte çantën e shpinës.

— Të na çosh fjalë, se do të vijmë — shtoi Fatmiri.

— Do të vijmë patjetër — tha Xhaferrit. — Ajo do të jetë dasma jote e vërtetë. Ti do të martohesh me atë që do të duash.

— Mos u marto me njeri tjetër — ndërhyri Fatmiri. — Ndryshe çdo gjë do të vejë dëm... Edhe këto që po bëjmë ne, do të shkojnë kot. Dëgjove, Zare?

Ajo s'u përgjigj, po ngriti çantën që kishte përdhe dhe e hodhi lirisht mbi shpinë.

— Zarja do ta ndiejë veten këtej e tutje ushtar — tha Xhaferrit. — Dhe ushtari nuk zbrapset para asnjë vështirësie...

— Unë tani s'e mendoj fare martesën — tha ajo, duke hedhur një shikim të kthjellët përpara. — Dua vetëm të shkoj në hekurudhë. Ta di që s'martohem kurrë, vetëm të jem e zonja e fatit tim, të mos bëhet pazar me mua, të rroj me djersën time...

— Shumë mirë e ke menduar — tha Fatmiri i rrëmbyer nga vrulli që i ngjallën papritmas fjalët e saj. — Po ta arrish këtë dhe martesë do të lidhet, ashtu si ta do zemra ty!

Xhaferrit vështroi rrugën që zbriste poshtë dhe bëri një hap përpara.

— Po të lëmë vetëm, Fato!

Fatmiri i zgjati dorën vajzës dhe ajo ia dha, si një dorë fëmije.

— Të dëgjofsha zërin e mirë, Zare! — tha ai.

— Mirë mbeç — ia bëri ajo me një zë të dobët, ndërsa qepallat e rënduar i ranë mbi sy.

Ata zunë të zbrisnin tatëpjetë rrugës së bardhë.

— Fato, — ktheu kokën Xhaferri, — njofto me telefon komisarin se ne u nisëm.

Fatmiri nuk foli, po tundi kokën me miratim dhe, kur ata u varën poshtë e dolën te Gropa e Ujit, ai rendi me vrap përmes sheshit. U ngjiti me nxitim nëpër shkallë dhe hipi sipër në kullë. Që andej shihte dy ushtarët që po i afroheshin urës me dërrasa. Papritmas ushtari me kokore qëndroi, ndërsa tjetri shkoi përpara. Fatmiri e mori me mend pse e bëri këtë Xhaferri. Edhe ai, si zbulues, ashtu do të vepronte. Me siguri do të kishte parë shenja të dyshimta. Ndoshta, kishte parë ndonjë njeri që ai s'e dallonte nga kulla. Ushtarët pastaj u bashkuan dhe ecën tok një copë rrugë. Për një çast ata s'u dukën, veç kur bënë ballë në Livadhin e Madh.

Atë kohë hijet e muzgut sa vinin e shpeshoheshin. Ush-tari rrudhte sytë larg dhe nuk i bëhej të largohej.

Vetëm kur hynë në shtratin e përroit dhe s'u dukën më, Fatmiri zbriti shkallët e kullës dhe u fut në postë.

Në korridor ai rrahu telefonin dhe ngriti dorezën: — Shoku komisar, — kumboi zëri i tij i fuqishëm

nëpër postë. — Urdhri juaj u zbatua, raporton Shqiponja!

Jashtë, atë kohë po ndehte krahët e butë errësira e një nate prilli. Në qiell filluan të dridheshin yjet e para.

Fatmiri hodhi armën në krah dhe u ngjiti për në kullë.

Për herë të parë ai do të qëndronte tërë natën në postin luftarak.

PASQYRA E LËNDËS

TREGIME:

	Faqe
Fytyra e heroizmit	5
Peisazhi	22
Beteja e heshtjes	29
Një legjendë e kohës sonë	42
Në mes të të gjallëve	52
Bredhi i bardhë	61
Një natë shiu	73
Zemërimi	86
Lufta e klasave	93

NOVELA:

Ëndrra dhe plagë	97
Posta e largët	177